monumentet

DO NOT COPY



1992-1999

DO NOT COPY

MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTEVE
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
T I R A N Ë

DO NOT COPY

monumentet

1992 - 1999

Botimi i këtij periodiku u mundësua nga Fondacioni SOROS
Drejtor i programit Pirro Misha, koordinatore Teuta Barbullushi

DO NOT COPY

© **Instituti i Monumenteve të Kulturës**
Botim i Institutit të Monumenteve të Kulturës
Tiranë, 2001

Në ballinë: Selia e re e I.M.K.-së

Tirazhi: 500 kopje
Shtypur në Republikën e Shqipërisë nga Shtëpia Botuese **"Aksion 2000"**

Pasqyra e lëndës

Artikuj		
Artan Shkreli	EDITORIAL	5
Guri Pani	SANTUARI I ASKLEPIT NË BUNTRINT	13
Valter Shtylla	TRASEJA E VIA EGNATIAS NËPËR SHQIPËRI DHE MAQEDONI	51
Luan Përzhita	KËSHTJELLA TË PERIUDHËS ANTIKE TË VONË PËRGJATË RRUGËS LISSUS - NAISSUS	85
Kasem Biçoku	PORTRETI I MARIN BARLECIT DHE NJË SAKTËSIM PËR SHQIPONJËN E KASTRIOTËVE	113
Latif Lazimi	SHKOLLA E SHQIPTARËVE NË VENECIA	123
Mustafa Arapi	ANALIZË MBI DY IKONA TË PIKTORIT DAVID SELENICA	129
Skënder Mihalcka	TË DHËNA MBI DISA VEPRA IKONOGRAFIKE ARTI NË SHQIPËRI	137
Maks Velo	STUDIM MBI ELEMENTE TË ARKITEKTURËS FUNERALE MYSLYMANE NË SHQIPËRINË E MESME	149
Fatbardha Shkupi	ZBUKURIMORJA E SKALITJES NË GUR TË VARREVE SHKËMBORE TË SELCËS SË POSHTME	167
Flamur Doli	TIPARET ARKITEKTURORE FORMËSUESE NË KULLAT E ISA BOLETINIT	193
Emin Riza	ARKITEKTURA POPULLORE SHQIPTARE	211
Shpresa Prifti	NJË SHEMBULL I ZHVILLUAR I BANESËS SHKODRANE DHE PROBLEMET E RESTAURIMIT TË SAJ	219
Komunikatë për shtyp		246

DO NOT COPY

Contents

Artan Shkreli	EDITORIAL	5
Guri Pani	SANCTUARY IN BUTRINT	48
Valter Shtylla	THE TRACK OF THE VIA EGNATIA WITHIN ALBANIA AND MACEDONIA	81
Luan Përzhita	LATE ANTIQUITY CASTLES ALONG THE LISSUS-NAISSUS ROAD	109
Kasem Biçoku	THE PORTRAIT OF MARIN BARLETI AND A PRECISE DESCRIPTION OF THE KASTRIOTS'BICEPHALOUS EAGLE	122
Latif Lazimi	THE ALBANIAN SCHOOL IN VENICE	127
Mustafa Arapi	ANALISYS REGARDING TWO ICONS OF THE PAINTER DAVID SELENICA	135
Skënder Mihalcka	DATES ABOUT SOME ARTWORK OF ALBANIAN ICONOGRAPHY	146
Maks Velo	STUDY ON THE ELEMENTS OF THE FUNERAL IN ISLAMIC ARCHITECTURE OF MIDDLE ALBANIA	166
Fatbardha Shkupi	THE STONE CARVING DECORATION OF THE ROCK TOMBS AT LOWER SELCA	191
Flamur Doli	THE ARCHITECTURAL FEATURES OF THE ISA BOLETINI TOWERS	209
Emin Riza	ALBANIAN FOLK ARCHITECTURE	217
Shpresa Prifti	DEVELOPED EXAMPLE OF THE SHKODRA DWELLING AND ITS RESTORATION PROBLEMS	243
Komunikatë për shtyp		246

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Artan SHKRELI

EDITORIAL

Periodiku i Institutit te Monumenteve te Kultures rifillon rrugen e tij pas tetë vjet vakumi për pasojë të krizes se sistemit institucional shqiptar ne tranzicion dhe mungesës së fondeve per botime me karakter shkencor e teknik te subvencionuara nga shteti.

Shumë gjera janë vënë në diskutim këto vite, kryesisht mbi bazen e vlerave te reja per dikë, apo të antivlerave të reja për të tjerë, por fakti kokeforte i nje trashegimie arkitekturore gjith e me ne rrezik ka qene vazhdimisht kembekryq aty mes pauzave, polemikave, heshtjeve, zhgenjimeve dhe natyrisht shpreses.

Fatkeqesisht "*MONUMENTET*" ka munguar gjithe kete kohe, ndaj nuk ka qene e mundur te persiatet mbi çka ka ngjarë ne kete tranzicion te paqarte. Tash periodiku rishfaqet, dhe kjo rishfaqje nuk është rastesi: shoqeria shqiptare kthen syte nga ajo qe më fort i ka munguar keto vite; nga identiteti i saj specifik kulturor dhe natyrisht globalizmi domethenes po aq specifik per Shqiperine e vogel.

Duket se te gjithe, pas lebyrjes se syve nga vlerat e rreme ose te diskutueshme, shpesh veç të sojit material, po shohin çka me art e teknike u krijua ne shekuj per jetese, per mbrojtje, per t'u falur, per te sfiduar natyren dhe ne fund te fundit per t'u shprehur e lidhur me botet gjithfarë qe rrethonin palcin e ngjeshur shqiptar.

Ne mekanizmat e pashtruara te nje shteti që po formohej mes deshtimesh te lodhshme e arritjesh te mundimshme, u lind nevoja per pika me te sigurta e te sprovuara referimi, per zgjedhjen e një baze ekzistence me te qendrueshme, e cila t'i përgjigjej natyrshëm pyetjeve parësore: *nga vijme, kush jemi dhe cili do te jete fati yne?*

Keshtu u ra nder mend se diku ne nje zone te qete te kryeqytetit hiqte shpirt i vetmi institucion, qe nen pluhurin e harreses, fshihte memorien dhe potencialin e rimbledhjes se magmes qe njeriu shqiptar plazmoi në pergjigje te atyre pyetjeve te mistershme; hiqte shpirt nje institucion, që me nje personel te traumatizuar nga largimet e specialisteve, rrogat e paperfillshme, indiferenca institucionale dhe, çka eshte me tragjikja, nga mplakja fizike, duhej ringritur dhe i duhej dhene autoritet ligjor ne nje kontekst social shume me te ndryshen se ai ne te cilin dikur e kish marre udhë. Me shtyrjen e moshes se specialisteve dhe profesoreve te njohur nderkombetarisht ne fushe te restaurimeve, po ndryshonte edhe klima e nje grupi njerezish me qendrime shpesh kontradiktore, por sidoqofte mbi baza teorike, jo vetem ndaj kritereve te nderhyrjes, por dhe vlerave qe duheshin mbrojtur. Dhe tani ne drite te nje kembimi shekujsh e te nje paqartesie ndoshta po aq te madhe sa para njemije vjetesh

DO NOT COPY

(kur nderronte Mijevjeçari i Pare per te i Dyti) nje flake shprese, pikerisht tash, ne te ndame te dy mijevjeçareve tane, rreket te na hapë syte mbi çfarë ndodh pas nje ndergjegjesimi me serioz nga ana e strukturave qytetare e shteterore ne ruajtje te asaj qe nuk mund te rikthehet nese bjerret.

Prandaj ky numer reviste do te ishte fatlum, nëse me teper se kujtdo do t'i sherbente atyre te rinjve qe duan te njihen me MONUMENTET e qe ndoshta do tu bjere rasti te luftojne krah kesaj aradhe njerezish, emri i te cileve eshte i lidhur me të Bukurën e Pashoqe të këtij vendi.

E shoh te udhes, meqe ka vite qe periodiku nuk ka informuar, te bej nje paraqitje te asaj se çka perfaqeson sot Instituti dhe cilat jane sfidat e tija te aferta e te ardhme.

* * *

Instituti i Monumenteve te Kultures u krijua në vitin 1965 ne Tirane. Objekti i punes se ketij institucioni eshte gjurmimi, studimi, restaurimi dhe mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore kryesisht te patundshme ne Republiken e Shqiperise; gjithashtu eshte detyre e I.M.K.-se edhe publikimi dhe botimi i arritjeve me të rëndësishme qe behen ne kete fushe, perpos informimit te publikut te interesuar per arritjet e fushes ne pergjithesi (edhe nga organizma te tjere).

Instituti Monumenteve të Kulturës vepron në të gjithë territorin e vendit për të gjurmuar, mirëmbajtur dhe mbrojtur ato objekte qe konsiderohen "monumente kulture". Ky aktivitet realizohet ne masen me te madhe nepermjet tete Degëve dhe Ateljeve te Monumenteve te Kultures, të cilat veprojnë në rrethet Shkodër, Durres, Tiranë, Berat, Korçë, Vlorë, Gjirokastër dhe Sarandë.

Shqipëria, ndonëse ndër vendet më te vogla te Europes ka vertet një histori të larmishme dhe traditë ende te gjalle e të pasur kulturore. Trashëgimia arkitekturore e Shqiperise, e krijuar gjatë epokave historike dhe variacioneve social-ekonomike, vjen deri në ditët tona me një shumëllojshmëri monumentesh të rralla, si nga vlerat arkitekturore ashtu dhe ato artistike, por njekohesisht ne nje gjendje shume kritike nga pikepamja e amortizimit fizik.

Në teritorin e Shqipërisë mbrohen me ligj mbi 2400 objekte monumentale, kala të periudhave antike dhe mesjetare, fortifikime të ndryshme, ndërtime popullore e inxhinjerike, monúmente kulti, vepra të artit muziv apo ikonografik dhe afreska te çmuara.

Nder më të spikaturat e kësaj trashëgimie janë qëndrat arkeologjike të qytetërimeve të lashta si ato të Butrintit, Apolonisë, Durachium-it, Bylisit si dhe qëndrat historike monumentale të qyteteve muze të Beratit, Gjirokastrës, Krujës, ndërtimet qytetare të Korçës, Shkodrës, Tiranes etj.

I.M.K.-ja ka nen administrim dhe kontroll keto tipologji ndertimesh:

- Monumente kulti gjithsej 180, ndermjet te cilave:

Kisha 110, rrenoja kishash 33, manastire 12, xhami 11, tyrbe 3, teqe 5, kompleks islamik 1.

- Monumente antike e mesjetare gjithsej 591, ndermjet te cilave:

Kala, rrënoja, site 483 dhe ura, ujësjellësa e ndërtime inxhinerike 109.

- Ndertime popullore, të cilat ndahen ne te kategorisë së parë 373 dhe te kategorise së dytë 1151.

Vendndodhja e tyre dhe numuri sipas perkatesise se qyteteve eshte si me poshte: Berati 428, Gjirokastra 378, Elbasani 20, Korça 150, Shkodra 80 dhe Vlora 25.

Deri tani vetëm Butrinti është përfshirë në listën e pasurive të kulturës botërore (World Heritage Site) që mbrohet nga UNESCO, por kandidatë për të fituar këtë status janë edhe qytetet-muzé te Beratit dhe Gjirokastres.

DO NOT COPY

Sistemi arkivor

Instituti i Monumenteve te Kultures disponon një sistem arkivor relativisht të pasur (me i rendesishmi ne Shqiperi per fushen) të dokumentacionit tekniko shkencor, qe paraqitet me: 2.300 dosje të dokumentacionit grafik të monumenteve, 130.000 negativa bardhë e zi e me ngjyra, 250.000 foto bardhë e zi të monumenteve, fryt i nje pune 35-vjeçare te disa breza studiuesish e restauratoresh.

Aktualisht eshte ne zhvillim nje program katalogimi (në bashkëpunim me Ministrine Italiane të Kulturës) qe materiali arkivor te hidhet ne suport magnetik per tu bere keshtu jo vetem me i shfrytëzueshem dhe me i ruajtur nga rreziqet e mundshme qe paraqet perdorimi i kopjes origjinale, por edhe per krijimin e kushteve te nje aksesi nga ana e te interesuarve jashte ketij institucioni. Gjithashtu ka filluar specializimi i personelit, i cili ne nje te ardhme te afert do të kryejë katalogimin e plotë sipas kritereve dhe normativave CE te monumenteve te kultures ne te gjithe Shqiperine (me publikimin perkates).

Instituti eshte i pajisur gjithashtu me nje biblioteke te specializuar ne fushen qe ai mbulon, në të cilën numerohen mbi 3.000 volume.

Struktura dhe personeli

I.M.K. nga pikepamja tekniko-shkencore funksionon mbi bazen e nderveprimit te katër sektoreve baze:

a) sektorit te monumenteve të arkitekturës antiko-mesjetare,

b) sektorit te arkitektures popullore,

c) sektorit te arkitektures bashkëkohore,

d) sektorit te artit monumental.

Po ashtu ushtrojne funksionet e tyre sektore te tjere ndihmes (sektori i marrëdh. me jashte, ai i informacionit, redaksia, zyra juridike etj.).

Institucioni perbehet nga një personel prej 342 punonjësish, prej të cilëve 25 jane personel shkencor, 274 teknik, dhe 63 administrativ. Tabela e shpërndarjes së punonjësve ne qender dhe dege paraqitet si me poshte:

- Instituti ka ne organiken te tij 54 punonjës
- Dega e Monumenteve Tiranë 63 punonjës
- Dega e Monumenteve Gjirokastër 49 punonjës
- Dega e Monumenteve Berat 49 punonjës
- Dega e Monumenteve Shkodër 40 punonjës
- Dega e Monumenteve Korçë 36 punonjës
- Dega e Monumenteve Vlorë 19 puonjës
- Dega e monumenteve Durrës 20 punonjës
- Dega e Monumenteve Sarandë 12 punonjës

Totali, 342 punonjës

Tre specialiste kanë titullin Prof. Dr. dhe disa te tjere titullin Dr. i Shkencave. Aktualisht nje numer punonjesish po ndjekin SH.P.U.-te (shkollat pasuniversitare) per graden e doktoratures ne dege te veçanta te historise, arkeologjise, restaurimit etj.

Problemet

Trashëgimia kulturore e vendit, e konceptuar në dy linja të mëdha (në monumentet e tundshme dhe të patundshme), përballet sot me probleme të mprehta të shkaktuara nga ndikimi i:

a) faktorëve natyrorë,

b) indiferenca dhe mosndërhyrja në kohë e institucioneve të specializuar,

c) mosangazhimi i duhur i Pushtetit Lokal për mbrojtjen e zonave arkeologjike dhe muzeore nga ndërtimet pa lejë, grabitjet dhe ndërhyrjet e natyres vandale,

d) mangësitë e legjislacionit që merr në mbrojtje të gjitha vlerat e trashëgimisë kulturore të krijuara gjate shekujve ne Shqiperi si dhe nga

e) mungesa sistematike e fondeve per restaurim.

Nuk munguan ta rëndonin më tej këtë gjendje edhe fondet tepër të pakta, për të mos thënë të papërfillshme (pasi te pakta jane edhe aktualisht), të akorduara nga qeveria në vitet 1991 -1997.

DO NOT COPY

Politikat e reja te Ministrise se Kultures (formimi i Drejtorise se Trashegimise Kulturore) prane kesaj ministrie, ndonëse ne kushte mungesash ende te medha, po e mbeshtesin me fonde gjithnje ne rritje restaurimin e disa prej Monumenteve më parësore, të cilat kane nevoje per zgjidhje të menjëhershme e ne kushte emergjence. Përballimi i punimeve tërësisht me fondet shtetërore për rehabilitimin e Kalasë së Krujës, me një vlerë prej gjysëm milioni USD në dhjetor te 1998-es, është një nga gjestet më emancipues të qeverisë dhe Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe që tregoi në mënyrë bindese për rezultatet qe mund te arrihen kur nuk mungon kujdesi dhe vullneti politik në mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore.

Kohët e fundit, si pasojë e zbatimit të një strategjie të re dhe politikave integruese, po punohet më mirë në drejtim të zgjerimit dhe bashkëpunimit me struktura të qëndrueshme brenda dhe jashtë vendit për thithjen e fondeve të tjera shtesë ndaj zonave të caktuara arkeologjike, ndërhyrjeve në monumente të veçanta, apo në banesat karakteristike të zonave muzeore. Janë për t'u përmendur fondet e akorduara nga UNESCO prej mijera dollaresh dhe tani së fundi prej 100.000 mijë USD të tjerë për punime restauruese dhe konservuese në qytetin antik të Butrintit etj. Nga bashkëpunimi me komuniteteve fetare janë siguruar fonde për rehabilitimin dhe restaurimin e kishave bizantine të Beratit, Ardenicës, kishave të Myzeqesë, Mborjes, Boboshticës, Vithkuqit, Voskopojes atyre katolike te Lezhes, Rubikut, Shkodres etj. të xhamive në Durrës, Elbasan, Tiranë, Korçe etj., krahas fondit të planifikuar nga Ministria për ndërhyrjet restauruese në monumente.të tjera. I.M.K.-ja gjithashtu eshte ne fazen e thithjes se fondeve edhe nepermjet atasheve kulturore te ambasadave Gjermane, Austriake dhe Italiane per nderhyrje emergjente ne Rodon, Rubik apo pika te ndryshme te aksit te rruges antike Egnatia.

Sidoqofte me problematike per momentin paraqitet mbrojtja se arkitekturës popullore qytetare dhe fshatare. Vështirësi ne kete sektor rrjedhin kryesisht nga nga disa faktorë.

• Banesat janë pronë private dhe simbas ligjit *"Për mbrojtjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme"* Nr 7867 dt 12.10.1994, shpenzimet për ndërhyrjet restauruese duhet te përballohen 50% nga pronari dhe 50% nga shteti, gje e cila nuk aplikohet qe me renien e sistemit te kreditit te lehtesuar qe shteti nuk po mundet ta garantoje.

• Ekonomia e pronareve eshte ende e dobet. Në kushtet e liberalizimit të çmimeve është rritur ndjeshëm kostoja e restaurimit të banesave "Monumente Kulture", çka e bën thuaj të pamundur shlyerjen financiare të këtyre shpenzimeve nga ana e vetë pronarëve. Zgjidhja dhe dhënia e kredisë afatgjatë dhe me interes të pranueshëm do të ishte një masë e domosdoshme, e cila do të ndikonte ndjeshëm në ruajtjen e vlerave të qëndrave historike të Beratit, Gjirokastrës, Korçës, Shkodrës etj.

• Veprimi i policise se ndertimit mbi pronen private eshte i dobet nderkohe qe prirja e familjeve eshte modifikimi i vazhdueshem i banesave per shkak te rritjes natyrale te popullsise dhe pamundesise per te blere apo bere te reja..

• Kërkesat për vënien në pronësi shtetërore objekteve me rëndësi historiko-kulturore, në kushtet aktuale po hasin në kundërshtimin e hapur të pronarëve. Ende mungon një ligj taksativ mbi shpronesimet, që mundëson dhe favorizon institucionet shtetërore,. Hartimi dhe miratimi i një ligji të tillë është më se i domosdoshëm.

Sfida e I.M.K.-se

Hyrja ne ekonomine e tregut ka radikalizuar menyren e administrimit dhe ushtrimin e kontrollit te territorit nga ana e shtetit dhe institucioneve perkatese qe kane te bejne drejtperdreit apo terthorazi me ushtrimin

kompetencave me anë të legjislacionit, planifikimit, ndertimit dhe ruajtjes se vlerave bazilare.

Askund ne territorin shqiptar nuk mund te thuhet se eshte ushtruar, ne nivel te kenaqshem, ky administrim dhe kontroll - mjaft t'i hidhet nje sy pejsazhit urban dhe atij mjedisor. Kjo situate kryesisht ka rrjedhur si pasojë e:

- nje mungese legjislacioni te pershtatshem ne fushen e trashegimise kulturore, i cili pasqyron e paraprin kerkesat krejtesisht te ndryshme nga ato te disa viteve me pare e qe gjithashtu karakterizohen nga nje dinamike e madhe.
- per pasoje te mungeses se P.P.R.-ve (planeve te pergjithshme rregulluese) per realizimin e te cilave duhet thene se akoma mungojne: a) kuadri ligjor, per te filluar pregatitjen e tyre; b) niveli profesional i specialisteve te urbanistikes, qe per hir te se vertetes, do pohuar se eshte krejtesisht periferik.
- se treti, mungesa e nje vullneti të paprerë institucional per te ngulitur ne superstrukturen e tij qendrore dhe lokale domosdoshmerine, urgjencen dhe rregullat perkatese per marrjen nen kontroll te teritorit me ane te: a) krijimit te strukturave qe do pergatisin kushtet per te ndermarre realizimin e P.P.R.-ve ne projekt dhe zbatim; b) forcimit te Policise Ndertimore, qe sot pothuajse nuk e kryen funksionin e saj dhe nuk perligj egzistencen, perveçse kompromeron autoritetin shteteror ne syte e shtetasve; c) konvertimit te nje serie institucionesh shteterore (dhe krijimit te te tjereve nese paraqitet nevoja) ne institucione veçmas per përgatitje legjislacioni dhe te ushtrimit te kontrollit ndaj menyres si do te zbatohet ky legjislacion.
- se katerti, mungesa e impenjimit qe i karakterizon intelektualet elitare ne problemet e planifikimit urban dhe ato te ruajtjes se trashegimise kulturore, territoriale e mjedisore. Kjo ka bere qe presioni i bumit demografik dhe i shtresave fshatare e me nje kulture civile e urbane siperfaqesore, te dominoje mbi ate te opinionit qe respekton rregullat dhe eshte me i ndjeshem ndaj *bonum commune.*

Instituti i Monumenteve te Kultures ndodhet kësisoj perballe nje sfide: me e madhja për nga pikepamja e aresyes se egzistences se tij dhe nder me te medhate nga pikepamja e moralit institucional (pas krizes morale te tij te 1967-es). Sot problemet me te mprehta me te cilat ai perballet jane:

1. Struktura dhe organizimi i brendshem; te cilat nuk i pershtatet me funksionit dhe pergjegjesive qe ky institut duhet te marre ne te ardhmen e afert. Aktualisht Instituti i Monumenteve vepron nepermjet ushtrimit te kater funksioneve baze qe jane:

a) gjurmimi, studimi, katalogimi dhe botimi i monumenteve

b) pregatitja e legjislacioneve dhe normativave per krijimin me pas te rregulloreve te ndryshme (per çdo qytet apo sit arkeologjik apo monument) ne baze te ligjeve kombetare e kartave nderkombetare.

c) kontrolli i zbatimit te ketij sistemi ligjesh e rregullash

d) projektimi dhe restaurimi i nderhyrjeve ne monumentet e kultures

Keshtu nga keto te katerta, eshte pika "d" ajo qe priret te dobesohet doradorës me forcimin e shtetit ligjor dhe me rritjen e kompetencave te institutit mbi territor.

Ne kete menyre do te duhet qe ne te ardhmen te perpunohen platformat e krijimit te nje rregulloreje per kriteret e dhenies se liçensave subjekteve private, me te kualifikuara ne drejtim te projektimit, e me pas te restaurimit, nga ana e I.M.K.-se dhe M.K.R.S.-se.

2. Struktura dhe organizimi i jashtem i I.M.K.-se se shpejti do ndertuar mbi baze rrjeti Drejtorish Rajonale qe te mbulojne te gjithe territorin e Shqiperise. Drejtoria qendrore duhet te shnderrohet ne *Drejtorì te Pergjithshme* dhe

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Instituti i Monumenteve duhet te emertohet *Instituti Kombetar i Monumenteve te Kultures.*

Aktualisht ateljete e rretheve ekzistojne ne nje forme inferiore, me emertimin "Deget e Monumenteve te Kultures ne Rrethe", te cilat sillen thuaj'si ndermarrje ndertimi dhe jane ne funksion te I.M.K.-se qendrore. Fatkeqesisht organizimi i tyre nuk eshte i karakterit shkencor-teknik, por ekskluzivisht teknik duke patur per detyre vetem restaurimin e objekteve ne baze te projekteve te cilat vleresohen dhe behen ne I.M.K. Me kalimin ne ekonomine e tregut keto struktura rajonale e kane humbur progresivisht rolin e tyre si ndermarrje ndertimi, rol ky qe ishte i domosdoshem ne periudhen e ekonomise se centralizuar. Sot ato nuk kane me aresye te funksionojne si te tilla, pasi me rrogat shteterore specialistet me te mire te sektorit jane larguar duke i shnderruar keto brigada ndertimi ne "streheza asistence" per punetore te pakualifikuar. Gjithashtu shteti ka treguar se nuk mund te konsumoje fonde pagash per te gjithe periudhen ne te cilen ai paguan nga buxheti i tij mbi 200 punonjes, qe pjesen me te madhe te vitit, per mungese fondesh restaurimi, marrin vetem rrogen, kur keto mund t'ja kalonte restaurimeve. Keshtu do te qe me vend qe ateljete e rretheve te kthehen ne Drejtori Rajonale te I.M.K.-se e te shndërrohen ne organe qe kryejne kryesisht veprimtari edhe sipas pikave te mesiperme "a), b) e c), gjithë sipas kritereve të percaktuara nga specialistet e qendres ne Tirane. Organika e tyre duke u rithurur mbi kete baze te re, do te ndërmarrë nje specializim te shpejte te saj sipas ketyre pikave. Gjithashtu eshte e domosdoshme qe diçka e tille te behet duke e rritur numrin e drejtorive rajonale qe Shqiperia te mbulohet ne menyre sa me homogjene.

Objektivi afatshkurter i I.M.K-se

Mbulimi dhe kontrolli i shume sferave te tjera te trashegimise. Sot ndoshta jemi i vetmi vend ne Europe dhe ndoshta edhe ne bote qe nuk kemi marre akoma nen kontroll *trashegimine e arkitektures bashkekohore, parqet monumentale, kopshtet historike, fortifikimet moderne, pallatet mbreterore, trashegimine inxhinjerike me vlere kulturore si urat e hekurit, betonarmese apo arkeologjine industriale, parqet kombetare e te mira te tjera mjedisore.* Kjo e fundit ka nje rendesi te madhe per kontrollin e pejsazhit urban te qytetit shqiptar. Ne baze te ligjit te ri I.M.K.-ja duhet dhe mund te bllokoje çdo ndertim te ri qe do te jete jashte standarteve (masshtabeve, ngjyrave, karakteristikave) arkitekturore te percaktuara ne P.P.R. dhe firmuar nga Kryeministri. I vetmi institucion, pra qe mund te realizoje kete, mbeten I.M.K.-ja dhe Drejtorite Rajonale, gjithë duke bashkëpunuar me bashkite dhe policine e ndertimit.

Botimet

I.M.K. boton ne menyre periodike (çdo gjashte muaj) revisten "Monumentet". Tani, ky periodik, qe ishte nderprere qe nga 1991, ridoli perseri me nje tirazh te rritur dhe me nje permbledhje te artikujve ne anglisht (perpara permbledhja behej ne frengjisht).

Aktualisht jane gati per botim librat e meposhtem:

- *"Restaurimi i monumenteve te kultures"* - Prof. Emin Riza.
- *"Butrinti dhe fortifikimet e tij"* - Prof. Gj. Karaiskaj (ne anglisht).
- *"Monumentet"* - (pas nje nderprerje 8-vjeçare rifillon me nr. 1992-1999).
- *"Trashëgimia kulturore e Shqipërisë në rrezik"* - A. Shkreli, F. Lubonja.
- "*Piktoret korçare te afreskut ne Malin Athos*" - Koço Zheku.

Jane ne plan per te ardhmen:

- ➢ *"Atlasi i mozaikeve ne Shqiperi"* - me ilustrime.
- ➢ *"Arkitektura orientale shqiptare"* - me ilustrime
- ➢ *"Albumi: 2.000 vjet art kristian ne truallin Shqiptar"*

- Albumet e ekspozitave ikonografike.
- Monumentet e Kultures ne Kosove.
- Harta e Monumenteve ne Shqipëri (rrethet, qytetet, atlaset monografike)

Aktivitetet
Ne proçes:

- Ekspozita shetitese e Ikonave ne Gjermani - Itali
- Pavioni i Ikonave ne Muzeun Kombetar - Tirane.
- Bashkepunim per Ekspoziten Fotografike te Atasheut Kultural Turk me teme *"Ndikimi otoman ne arkitekturen dhe etnografine shqiptare".*
- Ditet e Trashegimise Kulturore - ne Shqiperi.
- Fushata *"Europa nje trashegimi e perbashket".*

Ne plan per te ardhmen:

- ✓ Pavioni permanent i I.M.K-se ne Galerine e Arteve Figurative - Tirane
- ✓ Itinerari i trashegimise arkitektonike e urbane bregdetare nen influencen e Republikes se Venedikut (Sistemi foritifikues ne bregdetin e Adriatikut dhe Jonit) - program ne bashkepunim ne Bashkine e Venecias.

Objektivat ne proces

- Ligji i Ri i Trashëgimise Kulturore
- Gjetja dhe rifunksionalizimi i selise se re Institutit te Monumenteve
- Riorganizimi i brendshem dhe ngritja e statusit te I.M.K.

Adresa zyrtare
Instituti i Monumenteve te Kultures
Rr."M. Toptani", nr. 9 - Tiranë
Tel./Fax.: + 355 4 2275-11 (Drejtoria)
Tel. 2285-12 (Administrata)
E-mail: imk@albmail.com

Pergatitur ne Vjeshte, 1999

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Dr. Guri PANI

SANTUARI I ASKLEPIT NË BUNTRINT (*)

Mjaft herë studiues të ndryshëm që kanë vizituar Buntrintin, janë ndalur në trajtimin e elementeve të veçanta të zhvillimit ekonomik, politik e administrativ, duke përmendur edhe cilësitë e dallueshme arkitekturore të tij.

Ndërtimet e ndryshme që formojne sektorin e Shenjtë në Butrint, si tempulli i Asklepit, teatri etj., me madhështinë e tyre paraqesin një kompozim mjaft të arrirë arkitekturor. Monumentet e zbuluara ofrojnë të dhëna të rëndësishme për studime ende më të gjera në lëmë të urbanistikës, arkitekturës, teknikave të ndërtimit etj.

Studimi i arkitekturës së sektorit të Shenjtë (ose Santuarit të Asklepit) si dhe punimet e restaurimit të këtij kompleksi do të përbëjnë materialin e këtij artikulli.

POZITA GJEOGRAFIKE E SANTUARIT TË ASKLEPIT

Kodra e Buntrintit zgjatet në drejtim të liqenit te Buntrintit, duke formuar kësisoj një gadishull të vogël me përmasa që arrijnë 410 m gjatësi dhe 225 m gjerësi.

Kuota më e lartë e kodrës në skajin lindor arrin 55m mbi nivelin e liqenit të Butrintit. Nga ana veriore e lindore, faqet e kodrës bien me një



Fig. 1 a. Planimetria e qytetit antik të Butrintit

pjerrësi të lehtë deri në bregun e liqenit, ndërsa nga ana perëndimore lidhen me qafën e masivit

(*) *Artikulli është botuar për herë të parë në volumin: "Bouthrotos. The researches of the Greek - Albanian Archaeological Mission in Butrint, 1991-1999", Atene, 2001.*

te Ksamilit. Në anën jugore shpati i kodrës zbret thikë në një sektor të gjatë rreth 100m, në terrenin e sheshtë të kanalit të Vivarit.

Thyerja shkëmbore që ndante në mënyrë të dukshme këtë pjesë të qytetit, ka përcaktuar dhe strukturën kompozicionale të Santuarit, (fig.1).



Fig. 1 b. Santuari i Asklepit

Duhet të ketë pasur ndonjë arësye që ndërtuesit në gjithë gjerësinë e masivit zgjodhën këtë vend dhe jo një tjetër për ndërtimin e Santuarit. S'ka gjasë të jetë thjesht rastësi apo dashje për t'iu larguar qendrës urbane, pasi mjaft pjesë të tjera të masivit në fjalë e ofronin po njëlloj këtë mundësi ndërtimi. Përzgjedhja e vendit duket të jetë bërë duke u nisur nga kriteri religjoz; siç do ta trajtojmë më poshtë, territori ynë favorizohet nga konfiguracioni natyral i shkëmbit dhe prania e burimit të "shenjtë" (1).

Historikisht jeta e sektorit të shenjtë, e lidhur me besimin në vetitë hyjnore të objekteve të veçanta të natyrës - në Butrint ishte zgjedhur "burimi i ujit" - duhet të ketë filluar në shek.VI – V p.e.s. (2).

VEÇORITË E TERRENIT

Veçoritë e terrenit kanë krijuar me skemën e zhvillimit urbanistik të vazhdueshëm të kësaj qendre religjoze një lidhje disi të veçantë.

Akropoli, i ngritur në majën më të lartë të kodrës, ka detyruar ndërtuesit të ndajnë sektorin e banimit nga sektori i shenjtë. Kësisoj, nëse banesat na japin pak gjurmë të vendosjes së tyre në shpatin lindor dhe verior të kodrës, Santuari është menduar të ndërtohet në këmbët e shpatit thikë, në anën jugore të masivit të Akropolit. Pamja me të vërtetë mistike që krijon kjo thyerje shkëmbore si dhe prania e burimit të ujit pikërisht aty, ka nxitur banorët e lashtë të kësaj qendre të ndërtojnë në këtë vend Santuarin e Shenjtë.

HAPËSIRA E ZHVILLIMIT TË SANTUARIT

Në lidhje me hapësirën e mundshme për zhvillimin e mëvonshëm të Santuarit të Shenjtë në periudhën helenistike, arkitektët e kësaj periudhe synonin kryesisht në përdorimin me nikorqillëk të hapësirës në fjalë si në ruajtjen e ekuilibrit mes masës së godinave dhe hapësirës rreth tyre.

Kompleksi i ndërtimeve si tempulli i Asklepit, Prytaeioni, teatri etj., përpara se të fitonte veçoritë e tij tipike arkitekturore, kaloi nëpër një rrugë të gjatë të zhvillimit, duke u shndërruar në element pazgjithshmërisht i lidhur me ndërtimet e tjera që vijnë e i ndërvaren, deri në zhvillimin e plotë të ansamblit.

Evolucioni nëpër të cilin kalon Santuari në Butrint do të bëhet objekt i studimit tonë. Ai do të na ndihmojë të njohim gjenezën e kompozimit të këtij ansambli e të vlerësojmë drejt tiparet e arkitekturës së objekteve të veçanta, të cilat shërbejnë si bazë e formimit të tij.

Një temë e tillë është ende e pa prekur në mënyrë tërësore. Studimet e veçanta të botuara deri tani për santuarët antike (3) apo për objekte

DO NOT COPY

DO NOT COPY

të veçanta si tempujt, teatrot (4) etj., japin një material ndihmës për krijimin e një vizioni të përgjithshëm mbi elemente të veçanta të këtij kompozimi. Parë në këtë dritë, Santuari në Butrint nuk është shembull unikal i botës antike. Me këtë shembull ne do të përpiqemi kryesisht të rimëkëmbim, aq sa të mundemi, zhvillimin e këtij ansambli, jetën e tij në veprim si dhe do të mundohemi të zbërthejmë metodat arkitekturore e artistike, që na përcjellin idenë e kompozimit.

Para se të kalojmë në trajtimin e arkitekturës dhe urbanistikës së kësaj qendre, po shohim shkurtimisht disa nga faktorët politikë dhe ekonomikë, që ndihmuan në krijimin e saj.

Së pari, pozicioni i favorshëm për komunikimin me botën helene, krahas marrëdhënieve me fiset fqinje të Epirit dhe Ilirisë Jugut, ndikuan për një zhvillim të dallueshëm në krahasim me ato të territoreve fqinje që gjendeshin disi më në brendësi. Butrinti është vendosur në fasadën bregdetare të Epirit, në pikëtakim me qytete helene, gjithë duke u ndikuar edhe nga prania fare e afërt e ngulimeve koloniale, si fjala vjen Korkyra (fig.2).



Fig. 2. BUTRINTI dhe vendbanimet antike në mijëvjeçarin e I p.e.sonë

Së dyti, faktori politik, që shpjegohet me zhdukjen e mbretërisë, në një kohë kur ky regjim vijonte të mbahej në këmbë më në brendësi (sikurse përmend Thukidit) (5), luajti një rol të rëndësishëm në zhvillimin e qytetit. Por në se Thukiditi vë në dukje që në Epir, në vitin 429, dy popuj janë cilësuar *Abasileutoi* (pa mbret); zhdukja e mbretit dhe zëvendësimi i tij nga dy Prostat në Butrint, ka ndodhur jo shumë kohë më parë. Duket vërtet se mbretëria sapo qe hequr te Kaonët dhe se ky popull kish adoptuar një regjim të ndërmjemë, në të cilin pushteti suprem u qe besuar dy magjistratave që zgjidheshin çdo vit.

Natyrisht, ky organizim i shoqërisë ndihmoi në zhvillimin e jetës qytetare, madje jashtë ngulimeve koloniale bregdetare, realitet ky që e njihnin si krahinat e Kaonisë, ashtu dhe territori ilir fqinjë (6), por asnjëherë deri sa të arrinte atë shkallë zhvillimi, që do ta çonte në lindjen e një qyteti-shtet.

Mbishkrimet e teatrit në Butrint, kanë vërtetuar sa të shumta qenë grupet e etnive, madje në gjirin e një shteti siç ishte koinoni i Prosaibeve (7).

Këta faktorë patën ndikimin e tyre edhe në arkitekturë. Kushtet e krijuara për ndërtimin e objekteve të artitekturës, që i shërbenin asaj shoqërie, parakuptojnë një veprimtari politike e shoqërore të një qendre më se qytetare.

FORMIMI I ANSAMBLIT TË TEMPULLIT

Shqyrtimi i kompozimit të ansamblit të tempullit në antikitet, formimi dhe zhvillimi i tij, është i lidhur doemos me funksionin e ansamblit dhe të ndërtesave të veçanta, që e përbëjnë. Veçoritë e kompozimit të ansamblit, shndërrimet historike të cilësive të tij praktike e artistike, varen shumë nga funksioni i ndërtesave që e formojnë ansamblin.

Studimi i kompozimit të Santuarit në Buntrit në lidhje me anën praktike të pjesëve të saj përbërëse si dhe ndryshimi i rëndësisë sociale të objekteve të veçanta në të, besojmë se hap

DO NOT COPY

mundësi konkrete për të kuptuar drejt arkitekturën e ansamblit dhe ligjet objektive të lindjes së saj.

Si e përmendëm më lart, sektori i shenjtë në Butrint lindi mjaft herët, kohë para se të ndërtoheshin tempujt. Ndërtimi i tempullit, që lidhet me kultin e Asklepit, fillimisht pranë burimit "të shenjtë" e më vonë te Abatonit në lindje të tij, që shërbente si portik kurimi "Eukomeisis abaton", na shtyjnë të mendojmë se Temenosi apo sektori i shenjtë, përfshinte njëherë e një kohë krejt gjatësinë e qendrës shoqërore të ardhshme të qytetit (8).

1.a Burimi i shenjtë

Periudha e lashtë e Temenosit lidhet, siç thamë më lart, me besimin e parë të ilirëve, në forcat e elementet e natyrës; me gjasë ata besonin te objekte të natyrës, si burimi (9), në çarjen shkëmbore, rrëzë masivit të akropolit, mbi të cilën më vonë u ndërtua tempulli i Asklepit (10) (fig.3).

Edhe pas ndërtimit të tempullit shpella nuk u braktis, por u kthye në një mjedis shtesë i tij, ku viheshin blatimet (11).

1.b Tempulli i Asklepit.

Tempulli i Asklepit u ndërtua relativisht vonë në Butrint, duke pasur parasysh se tempujt në botën antike njihen nga shek.VI p.e.s. Kjo dëshmon se ndikimi i ikonografisë së perëndive të Olimpit ka hyrë disi vonë në Epir, nëpërmjet ndikimeve kulturore të njohura me emrin "kultura helenike".

Tradita është e shek. IV p.e.s., që i përket kohës kur pjesa jugore e Kaonisë dhe Kestrinës përfshihet në sundimin e familjes mbretërore Molose. Molosët, në fillim të shek. IV p.e.s. erdhën e u bënë mjeshtër të santuarëve. E morën këtë zanat për të forcuar titullin e vjetër, me zotërimin mbi Santuarin e Dodonës (12).

Tempulli i Asklepit, në krahasim me tempullin pranë tij ose me ndërtesat e tjera të kompleksit, nuk ka ndonjë dallim të dukshëm në



BURIMI I SHENJTË (planimetria dhe prerja tërthore).



Fig. 3. Planimetria e tempullit të Asklepit dhe Burimi i Shenjtë.

madhësi. Përmasat 6.3m x 8.6m të tempullit nuk shquhen si të mëdha në krahasim me tempujt e tjerë të kësaj periudhe. Ai është vendosur në

qendër të kompleksit (13) dhe, në kufijtë e pjerrët të sektorit ku është ndërtuar, duket si "vetmitar" apo i palidhur me objektet e tjera.

1.c Enkomeisis abaton

"Enkomeisis abaton" (14), ndërtim i cili deri vonë është quajtur si shëtitore, lidhej në mënyrë funksionale me tempullin e Asklepit. Zbulimet arkeologjike nxorën në pah mjaft elemente domethënëse, të cilat ndihmuan të përcaktohej funksioni i dikurshëm i këtij objekti. Gjetja e pusit në hyrje të ndërtimit e lidh fatin e këtij objekti me ritualin e Asklepit.

Nëpër këtë objekt kalonte dikur rruga që të çonte për në tempullin e Asklepit, kjo prej ritualit që zhvillohej (siç do të shpjegojmë më poshtë) përpara prezantimit me Zotat. Krejt ndërtimi është zgjidhur në fasadën e dukshme me disa harqe, ose më mirë të themi me disa pseudoharqe në formë trapezi, të formuara nga zhvendosja horizontale e blloqeve trapezoidale prej guri.

Objekti ruan mjaft gjurmë të fazës së parë të ndërtimit (fig.4). Arkitektura e tij është realizuar



Fig. 4a. Gjurmë të fazës së parë të Abatonit



Fig. 4b. Skicë panoramike e Abatonit. pusit dhe Pandokeionit

DO NOT COPY

DO NOT COPY

me elemente të pakta e të thjeshta dekorative dhe me një trajtim planimetrik, që e dallon cilësisht atë nga ndërtimet e tjera. Mungojnë kolonat dhe fasada ballore është trajtuar si mur i drejtë me disa pseudoharqe, që kapin hapësirë drite deri në 4.4m, të vendosura njëra pas tjetrës në distanca rreth 3.3m. Krejt muri është punuar me blloqe guri, të latuara rrafsh në faqet e dukshme. Blloqet e gurit kanë në përgjithësi formë kuadratike dhe trapezoidale me lartësi, që varion nga 0.20 - 0.40m dhe gjerësi 0.40 - 1.3m. Muratura që shërben për lehtësimin e peshës së çatisë mbi pseudoharqet, është përforcuar me kontrafortë, të cilët në fasadën e dukshme të objektit ngjajnë si pilastra dekorativë, kapërthyer muraturës në gjithë lartësinë e saj.

Kontrafortët në faqen ballore janë të gjerë 0.6m dhe dalin po kaq nga sipërfaqja e murit, duke pasuruar mjaft pamjen ballore të tij. Kësisoj ata kanë jo vetëm funksion konstruktiv por edhe dekorativ (fig.5).

ruhet në lartësinë më të madhe. Fragmenti i skajit perëndimor të ndërtimit ruhet deri në 11 radhë blloqesh, që së bashku kapin lartësinë 3.80m, ndërsa muratura e skajit lindor, ku është dhe hyrja e abatonit, ruan vetëm pjesërisht këtë lartësi, në qoshen ku lidhet me murin e brendshëm.

Gërmimet e vitit 1982 zbuluan në krah të hyrjes elementin më domethënës të këtij ndërtimi, burimin e ujit, i cili na ndihmoi të përcatonim dhe funksionin si "enkomeisis abaton" të objektit (fig.6). Falë tij u arrit të shpjegohej lidhja e tempullit me abatonin ose portikun e kurimit, për të cilin do të flasim më poshtë.

Abatoni me hyrjen pranë burimit, për mendimin tonë, zgjatej në drejtim të perëndimit deri te kthesa që merr faqja shkëmbore pranë tempullit të Asklepit. Gjatësia totale arrinte rreth 35m, nga e cila tashmë kanë humbur rreth 14m, si pasojë e ndërtimit të teatrit; ky i fundit u ndërtua më vonë, në një fazë të dytë, e cila lidhej me shndërrimet e mëtejshme si dhe me shuarjen



Fig. 5. Rikonstruksion hipotetik i pamjes ballore të Abatonit

Blloqet e themelit mbështeten drejt e në truallin shkëmbor. Ato diku i shohim të vendosura në radhë për një e diku në radhë për dy, në përpjekjet për të siguruar mbështetjen në shkëmb. Këto blloqe formojnë një xokolaturë të punuar ashpër, e cila krijon menjëherë kontrast me blloqet e sheshta të objektit.

Vetëm në anën lindore dhe në skajin perëndimor, ku teatri ka mbuluar pjesën tjetër të ndërtimit, muratura orgjinale ka mbërritur të

hap pas hapi të funksionit parësor religjoz të Tempullit të Asklepit.

Shembuj të lidhjes së tempujve me portikë të tillë janë mjaft të njohur në antikitet (15). Këtë funksion, kuptohet më të cunguar, portiku ka gjasë ta ketë ruajtur për disa kohë edhe pas ndërtimit të teatrit.

Gërmimet arkeologjike na japin mjaft të dhëna për ngritjen e portikut. Ato e datojnë objektin aty nga fillimi i shek. III p.e.s. (16).

DO NOT COPY



Fig. 6. Faza e parë e SANTUARIT të Asklepit

Sidoqoftë mendojmë se ndërtimi i tij duhet të jetë kryer diçka më herët; kjo për faktin se portiku funksionoi përpara teatrit (i datuar ky i fundit në shek.III p.e.s. (17) dhe gjithashtu i lidhur me funksionin religjoz të tempullit). Si kohë e mundshme e ndërtimit të portikut do menduar gjysma e dytë shek.IV p.e.s.

Ç'funksion kishte "Enkomeisis abaton"

Në Asklepionin e Butrintit vinin edhe të sëmurët, të cilët duhet të kryenin procesionin dhe faljen në kor, me qëllim që të kuroheshin nga zotat. Kur këta të sëmurë ose pelegrinë mbërrinin në Tempullin e Asklepit, mendja të thotë se ata ishin përgatitur shpirtërisht, gjatë kalimit nëpër rrugën e procesioneve, e cila fillonte diku pranë portës lindore të qytetit. Kur afroheshin në hyrjen e Abatonit, ata përdornin ujin e shenjtë për pastrim, ujë që rregullisht është quajtur kështu. Një nga detyrimet ishte t'u ofronin sakrifica Asklepit dhe Apollonit. Të varfërit bënin sakrifica duke sjellë fruta, ëmbëlsira dhe sende të tjera modeste. Pas faljes, pastrimit dhe sakrificave, njerëzit e sëmurë duhet të vuanin provën e religjonit dhe të përgatisnin shpirtin e tyre për të takuar Zotin.

Nuk bëhej kurrë e ditur si zhvilloheshin këto rituale dhe ku zhvilloheshin ato, ndofta ngase duhej të mbeteshin sekret. Mbas sprovës së shpirtit, arrihej tek momenti i fundit i quajtur "enkomeisis". Priftërinjtë shoqëronin invalidët për nga godina që quhej Abato. Kjo ishte banesa në të cilën pelegrinët duhej të kalonin natën e pritjeve të mëdha. Brenda saj fillimisht luhate drita e mbytur misterioze që lëshonin kandilët me vaj. Më pas priftërinjtë largoheshin duke lënë ambjentin në errësirë. Duke pritur me ankth

DO NOT COPY

përfundimin e mrekullisë, të sëmurët lëshoheshin në gjumin plot ëndrra, duke përfytyruar Zotin, që do të shfaqej e do të përmbushte gjithçka.

Nga burime të vjetra mësojmë se ishte ndërhyrja mjekësore e priftit të Santuarit, i cili vinte e u shfaqej të sëmurëve në shëmbëllesë të Zotit.

Në vazhdë të shekujve, zhvillimi i mjekësisë filloi ta lëkundte besimin, ndaj Santuari i Asklepit në Buntrint, po si Asklepionët e tjerë, rrezikonin të humbisnin mbrojtësit e tyre. Për këtë arsye u bënë disa ndryshime. Këto u përqëndruan në ruajtjen e proceseve që i paraprinin ritit të fundit të quajtur "enkomeisis". Karshi këtij monumenti, priftërinjtë u kërkonin të sëmurëve t'u tregonin shqetësimin që i mundonte dhe ata u jepnin këshilla. Këshillat e priftit vinin e shndërroheshin në ëndërr gjatë natës si të ishin thënie të zotave. Në mëngjes i sëmuri rrëfente ëndrrën e tij, dhe priftërinjtë duke përdorur njohjen e tyre mjekësore, interpretonin thëniet e zotave si metodë shëronjëse, duke kërkuar sigurisht, që i sëmuri të frekuentonte Santuarin.

PËRFUNDIME

Kështu Santuari i Asklepit nuk mbeti vetëm një qendër fetare, por mori edhe trajtat e një qendre kurimi, ashtu posi mjedis i qetë e i kënaqshëm, me ujë të ftohtë e të ngrohtë në "termat", që u ndërtuan më vonë në periudhën romanike, në të cilat kryheshin diskutime apo në palestrat, ku kryheshin ushtrime fizike. Santuari iu përshtat kësaj shkalle progresive për të mos rënë në shkatërrim, por bëri një hap të dytë në shek.II, me rindërtimet e periudhës romake.

Deri në fund të shek. IV e.s., pelegrinet shkonin në tempullin e Asklepit me shpresën për t'u kuruar. Dyndjet e gotëve e shkatërruan atë dhe më vonë fanatizmi i religjonit të ri, që po lindte krahas krishtërimit, nuk kishte më respekt për artin antik.

Më lart përmendëm disa elemente të zhvillimit historik të qendrës fetare, e cila në shekuj pësoi shndërrime të vazhdueshme ndaj mënyrës se si qe krijuar. Pa dyshim këto ndryshime u përçuan edhe në arkitekturë, pra në evolucionin e vazhdueshëm kompozicional të kësaj qendre në përgjithësi, dhe objekteve të reja që do ta plotësonin atë dora-dorës, në veçanti.

Vetëm në këtë mënyrë mund të kuptohet evolucioni ose zgjidhja kompozicionale e kësaj qendre, vetëm kështu mund të diskutohet mbi idenë e vendosjes "rastësisht" të objekteve këtu, apo të ndërtimit të tyre sipas një koncepti fillestar. Për të argumentuar idenë tonë duhet të shohim në vazhdim lidhjen e objekteve të tjera që formojnë këtë qendër. Studimi i ndërtesave që përbëjnë ansamblin, paraqitet si bazë jetësore e formimit të tij, çka përcakton në fund të fundit veçoritë dhe strukturën arkitekturore, vendin e ngritjes së ndërtesave dhe evolucionin e mëtejshëm historik. Vetëm me studimin shkencor të destinimit praktik dhe të domethënies së tyre publike, mund të kuptohen drejt dhe të zbulohen lidhjet objektive të kompozimit arkitekturor që ka ky ansambël.

2.a PRYTANEIONI

Nga ndërtimi kanë mbetur disa gjurmë, të cilat i përkasin periudhave dhe fazave të ndryshme. Ndërhyrjet e shumta në kohë kanë mbuluar gjurmët më të hershme madje, në masë të madhe i kanë zhdukur ato, duke e bërë mjaft të vështirë të përcaktuarit e këtij objekti. Përpara se t'i analizojmë ato, do të japim disa mendime të përgjithshme për formën arkitekturore dhe elementet e tyre përbërëse, që së toku mund të na ndihmojnë për të pikasur funksionin e këtij objekti.

Vendodhja: Objekti shtrihet në skajin perëndimor të Asklepionit, duke mbyllur perspektivën e sheshit të tempullit të Asklepit. (fig.6).

Mbetjet: Pas punimeve arkeologjike (18), rrënojat e zbuluara e të vendosura mbi njëratjetrën, në pamje të parë të krijonin një përshtypje të rrëmujshme (fig.7). Perimetralisht ndërtimi kishte përmasa të vogla, rreth 11.5 x 14.5 m. Muret veriore dhe jugore të ndërtesës janë



Fig. 7a. PRYTANEIONI. Pamje e gjendjes ekzistuese



Fig. 7b. PRYTANEIONI. Planimetria me fazat e ndryshme të ndërtimit

respektivisht muri jugor i teracimit të kodrës dhe muri i rrethimit të Sektorit të Shenjtë. Ka të ngjarë që godina të jetë ndërtuar ndërmes këtyre strukturave të njëkohëshme, që në fazën e parë të saj. Disa gjurmë fragmentare të kësaj faze edhe mund të kuptohen. Ato konsistojnë në disa mbetje të pragut të hyrjes, oborrit të brendshëm me peristil dhe hapësira e nevojshme për mjediset. Ruhen disa gjurmë të shtrimit me pllaka të oborrit peristil, kollonat me diametër rreth 50 cm dhe interkolumjet rreth 1.35 m (21).

Ndërtimet e periudhës romake ripërdorin strukturat planimetrike të fazës së parë, doemos me ndryshimet e nevojshme që lidhen me përdorimin gjatë kohës në fjalë. Në periudhën perandorake vihen re disa ndërhyrje që mund të ndiqen me lehtësi. Është fjala për ndërtimin e një oborri më të madh kuadratik, me brinjë mbi 6.20 m. Peristili formohet nga tri kolona tulle në çdo anë. Kolonat kanë një diametër baze rreth 40 cm. Sheshi i shtruar me pllloça të mëdha guri, përgjithësisht ruan gjurmët e fazës së parë.

Datimi: Kemi disa të dhëna, të cilat mundësojnë të datuarit e dy periudhave kryesore të ndërtimit. E lidhim periudhën e parë me ndërtimin e mureve që kufizojnë Santuarin si dhe me materialin arkeologjik të zbuluar (22). Ka gjasë të jemi aty nga shek. III p.e.s. Faza e dytë e ndërtimit lidhet me një mbishkrim të gjetur jashtë hyrjes kryesore të objektit, që i takon kohës së Augustit (shek.I p.e.s. – shek.I e.s.), i cili i kushtohet mirëbërsit Libert i Gai Domicit (23).

Më lart përmendëm disa elemente arkitekturore të ndërtimit. Ato janë mjaft të ngjashme me një banesë të zakonshme me peristil. Duke analizuar disa elemente të arkitekturës si, prania e prodomosit, mbishkrimi në hyrjen kryesore, mbeturina eshtrash të djegura (24) që lidhen me ritet mbi sakrificat si dhe pozicioni që zë objekti ynë në Santuarin e Asklepit, mbërrijmë në fund të kuptojmë funksionin e objektit. Kësisoj mendimi ynë është se kemi të bëjmë më tepër me një godinë shoqërore "Prytaneion". Këto objekte kanë patur funksione dhe formë arkitekturore të përcaktuar (25). Prytaneioni, fjala vjen, kishte si funksione kryesore atë fetar dhe politik. Vend të rëndësishëm në të zë vatra e zjarrit, që ushqen

DO NOT COPY

zjarrin e pashuar, ku kryhen dhe ritet e sakrificave. Gjurmë të mjediseve nga faza e parë nuk ruhen. Më shumë gjurmë na mbërrijnë nga faza e dytë, (fig.7c) ku mund të përmendim "archeionin" (26), i cili është plotësuar në hyrje



Fig. 7c. PRYTANEIONI. Rikonstruksion hipotetik i fazës së dytë

me një prodomos. Ky mjedis shërbente për të nderuar fituesit e garave dhe personat më të rëndësishëm që vizitonin qytetin. Prytaneioni ka shërbyer edhe si gjykata e qytetit dhe institucioni i mbarëvajtjes sociale (27), i cili megjasë ka pasë shpërblyer njerëzit me merita ose veteranët.

2.b - MJEDISET NDIHMËSE PRANË PRYTANEIONIT

Mjediset në fjalë janë ndërtuar brenda murit rrethues të Santuarit, në të dy anët e hyrjes për në sheshin para tempullit të Asklepit.

Ato bartin më shumë gjurmë të fazës së dytë. Vija e kanalit, e ruajtur mirë, që shkarkonte në një pusetë ujrat e mbledhura nga kullimi i çatisë së këtij ndërtimi, na ndihmoi disi për të ndjekur rrugën e shtrirjes së saj. Fasada e dukshme e mjediseve që hijeshuar me kolona, bazamentet e ngurosura të të cilave ende duken në muraturat e ndërtimit të fazës së dytë. Kolonada fillonte nga Prytaneioni dhe zgjatej në drejtim të lindjes. Pjesa më e madhe e saj është e mbuluar nga rrënojat e skenës së tearit (fig.8).



Fig. 8. Mjedise ndihmëse pranë Prytaneionit

3.a - TEATRI

Në Butrint si dhe në Epiduar, Priene, Pergam etj., në fund të periudhës helenistike, teatri erdh e u bë një nga ndërtesat më popullore. Kjo lidhej edhe me humbjen a bjerrjen e kuptimit udhëheqës ideologjik të religjionit në jetën shoqërore.

Ansambli i tempujve pushoi së qeni qendër publike kryesore dhe u detyrua të ndante parësinë e vet me ndërtesën e teatrit. Në këtë mënyrë teatri në sheshin e tempullit të Asklepit ndjehej krejtësisht i natyrshëm e i përligjur. Ndërtesa e tij, njëlloj si Prytaneioni, tempujt etj, ishte tashmë një nga moria e pjesëve përbërëse të këtij ansambli. Krahas ndryshimeve që pësoi teatri nga periudha helenistike në atë romake, vihet re që edhe tempulli i Asklepit që ndodhet në krah të teatrit (fig.9), pësoi ndryshime si pjesë e pandarë e tij.

Teatri si objekt i lidhur me ndërtimet e tjera më të hershme, në varësi nga roli shoqëror i lojrave teatrale, mori edhe funksione të ndryshme në sistemin e kompleksit ku bënte pjesë (funksionoi si buleoterion, odeon etj (28).

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 9 a. Santuari i Asklepit (faza e dytë, helenistike)



Fig. 9b. Rikonstruksion hipotetik i ndryshimeve që pësoi tempulli i Asklepit dhe Teatri në fazën e tretë (periudha romake)

Veç kësaj, në periudhën romake, ai ndryshoi dhe formën arkitekturore. Rregullimet që iu bënë teatrit, për aq sa lejonte trualli mbi të cilin qe ndërtuar, qenë në përshtatje me rregullat e reja të teatrit romak. Ndërtesa teatrale, kavea dhe skena bashkohen, parodosët mbulohen, duke u përfshirë dhe ato brenda një trupi të vetëm, mbi të cilat ndërtohen tribunalet. Logeioni helenistik zëvendësohet tani nga një sipar disi më poshtë nivelit të orkestrës, por më i gjerë dhe më i gjatë

Disa përshtatje u bënë edhe në kavenë e teatrit, e cila mori formë të harkuar në pjesën fundore të saj. Kaveja e teatrit u mbulua me tendë, për të penguar rrezet e diellit. U ndërtua

DO NOT COPY



Fig. 10a. Santuari në fazën e tretë (faza romake). Planimetria e përgjithshme



Fig. 10b. Santuari në fazën e tretë (faza romake). Rikonstruksion hipotetik.



Fig. 10c. Rikonstruksion hipotetik i teatrit (shek. II e.s.)

për herë të parë një skenë në dy kate dhe e hijeshuar me kolona, nike e skulptura ndërmjet tyre (fig. 10).

Në dallim nga teatri i fazës së parë, i cili më fort qe i lidhur me tempullin dhe peisazhin që nuk fshihej nga skena e ulët e periudhës helenistike, në fazën e dytë kjo lidhje zbehet (29), dhe teatri tashmë bashkëpunon me godinat e tjera, të ndërtuara rishtazi si Pandokeioni, terma, gjimnazi (palestra) etj.

Ndërtimi i ansamblit të teatrit të Butrintit, paraqitet si një nga shembujt më të përsosur dhe më interesantë në praktikën e ndërtesave antike të zbuluara deri tani në Shqipëri. Historia e lindjes dhe e zhvillimit të ansamblit teatral, tregon qartë se ndryshimi i metodave dhe i parimeve të kompozimit, si të vetë ansamblit ashtu dhe të ndërtesave të lidhura me të, duhen kuptuar në mënyrë të pandarë nga ndryshimet e karakterit ose funksionit të kompleksit, i cili paracakton ndërtesat publike, sipas rëndësisë së tyre.

Përcaktimi i ndërtesave që përbëjnë ansamblin, paraqitet si bazë jetësore e formimit të tij, çka vendos tek e fundit, veçoritë dhe strukturën arkitekturore, vendin e ngritjes së ndërtesave dhe evolucionin e tyre të mëtejshëm historik. Vetëm duke studiuar mirë destinimin praktik të këtyre ndërtesave dhe domethënien e tyre publike, mund të zbulohen dhe të kuptohen drejt ligjet objektive të ndërtimit e kompozimit të ansamblit arkitekturor.

Le të ndjekim objektet e tjera të ndërtuara në Santuarin e Asklepit.

3.b - PORTIKU ME KOLONA

Në periudhën romake shohim se pranë teatrit nisin të ndërtohen një sërë objektesh me funksion dytësor. Një rëndësi të veçantë i kushtohet edhe shëtitoreve të zbukuruara me kolona. Portiku me kolona, që i aneksohet teatrit, shërben njëkohësisht për ta lidhur atë me objekte të tjera si Pandokeioni, termat, palestra etj, si dhe si vend shlodhjeje, shëtitjeje dhe diskutimesh nën strehën e portikut. Pra, ndërtimi i Portikut duke iu aneksuar teatrit, ka zmadhuar njëkohësisht dhe sipërfaqen e krejt kompleksit të këtij të fundit si dhe rolin shoqëror të tij (fig.11).



Fig. 11. Portiku me kollona (shëtitorja) dhe Pandokeioni (rikonstruksion hipotetik).

3.c - PANDOKEIONI

Teatrot romake prireshin të ishin ndërtesa të pavaruar, të lidhura vetëm me ansamblin e rrugës kryesore. Në atë kohë arkitektura e teatrit dhe karakteri i tij përcaktoheshin në masë te madhe nga ky kusht i lidhjes së ndërtesës me rrugën kryesore të qytetit dhe me strukturën e saj, çka e vërë re në qytetet e Italisë dhe në kolonitë greke të Italisë së Jugut.

Në Butrint nuk kemi përpjekje për ndryshime rrënjësore e kjo me siguri lidhet me popullaritetin që ka fituar ky objekt nga periudha helenistike dhe ndikimi që ushtron kjo arkitekturë ndaj ndikimeve të tjera të periudhës romake. Prirja për ta parë atë si ndërtesë të pavarur, të lidhur me ansamblin e rrugës, bëri të domosdoshëm ndërtimin e mjediseve ndihmëse që do t'i shërbenin teatrit jo vetëm për shfaqjet artistike por edhe për takimet e rëndësishme të Këshillit të qytetit (Buleterion) apo takimet oratorike e prezantimet e muzikantëve (Odeon).

Godina e Prytaneonit, e cituar më lart, ndërtuar në mbyllje të perspektivës së sheshit të tempullit, ishte relativisht e vogël për të përballuar veprimtaritë gjithnjë në rritje të këtij

DO NOT COPY

DO NOT COPY

ansambli. Kësisoj godina e Prytaneionit, i ndan tani funksionet e saj me një ndërtim të ri që i aneksohet teatrit, me "Pandokeionin" (fig.12). Ndërtesa e re, e cila i ngjan një banese me oborr përgjisnin më tepër banesave private. Për këtë arsye objekti pranë teatrit është quajtur nga arkeologët "banesa me peristil" ose "shtëpi banimi" (32).



Fig. 12a. Pandokeioni, skicë planimetrike e gjendjes



Fig. 12b. Rikonstruksion hipotetik

të brendshëm peristil, u ndërtua për të strehuar në raste festash të ftuarit e rëndësishëm, aktorët dhe muzikantët. Po ashtu në Pergam dhe Delos (30) njihen këto konstruksione që shembëllejnë fort të ngjashme me ndërtimin e Butrintit. Në Athinë e njëjta gjendje e krijuar pat sjellë nevojën e Prytanis – aneks në formën e Thollos-it (31). Ndërtime të tilla, të quajtura në antikitekt "Pandokeion" luanin rolin e bujtinave dhe i

Për mendimin tonë një shtëpi banimi e veçuar, brenda kompleksit të ndërtimeve shoqërore që kemi shqyrtuar deri tani, sikur nuk përligjet fort, aq më tepër që gërmimet arkeologjike nuk kanë zbuluar kurrfarë elementi të ndonjë kuartalli banimi aty pranë. Shkallët e ndërtuara nga ana perëndimore e objektit që vijnë e lidhin mjediset e tij me teatrin, janë një fakt tjetër që të shtyn të mendosh se kemi të bëjmë më tepër me një ndërtim aneks të teatrit se sa me një banesë.

Vendndodhja: Ndërtimi shtrihet në lindje të teatrit dhe vjen e lidhet me "abaton-in" nga ana veriore dhe "portikun me kolona" nga ana jugore. Në drejtim të lindjes, ndodhen ende të pazbuluara ambjentet e tjera të ndërtimit. Struktura e zbuluar deri tani zë një sipërfaqe rreth 815 m^2. Niveli i dyshemesë së atriumit, është rreth 3.5 m nën kuotën e sheshit të Abatonit.

Mbetjet: Gjatë gërmimeve arkeologjike (33) për të zbuluar lidhje të objektit, përgjatë pjerrësisë së kodrës, u zbuluan mbetjet e tjera të ndërtimeve romake, ndofta të palidhura me objektin tonë (ende nuk mund të japim një mendim të qartë, për pa u plotësuar me zbulime të tjera arkeologjike).

Me ndërtimin që po shqyrtojmë, lidhen disa gjurmë muresh të zbuluara në mjediset e Abatonit, të cilat dëshmojnë se Pandokeioni në periudhën romake ka përfshirë brenda tij edhe Abatonin. Gjatë gërmimeve arkeologjike të vitit 1982 dolën me shumicë gjetje arkeologjike si fragmente tjegullash, fragmente qeramike, kokë mermeri që paraqet një centuar, pllaka mermeri me ngjyrë të bardhë, të kuqe, vishnje e jeshile me trashësi 1.5-3 cm etj.

Peristili që formon atriumin e brendshëm ka përmasa 6.75 x 7.30m dhe është i shtruar me pllaka guri 0.70 x 0.40 x0.17 m. Një radhë blloqesh guri me përmasa 1.5 x 0.65 m, formojnë një kornizë kuadratike (stilobati) ku mbështeten kolonat e peristilit. Ruhen ende të gdhëndura mbi këtë kornizë gjurmët e bazamentit të kolonave, të cilat na dhanë dorë të gjenim diametrin e kolonave të peristilit. Këto të fundit duken të kenë qenë rreth 46 cm të gjera në bazamentin e tyre. Na kanë mbërrirë veç tri bazamente të kolonave dhe dy pjesë mjaft fragmentare të tyre.

Korridori, me gjerësi 3m nga ana veriore e jugore dhe 2.5m nga ana lindore e perëndimore, qarkonte oborrin e brendshëm me peristil.

Mendojmë se hyrja kryesore e objektit, duhet të ketë qenë nga ana jugore, pra nga ana e Portikut me kolona. Vestibyli i hyrjes në një periudhë të dytë është ngushtuar deri në 2 m dhe më vonë është mbyllur. Mbyllja dallohet mirë nga teknika "opus incertum" dhe "opus reticulatum".

Mjediset nga ana perëndimore vijnë e mbështeten në murin e jashtëm të teatrit. Një shkallë shërbente për të lidhur ambjentet e Pandokeionit me nivelin e menianit të parë të teatrit.

TEKNIKAT E NDËRTIMIT

Si fazë të parë përmendim teknikën "opus quadratum" - shek. I p.e.s., të cilën e hasim në xokolaturën e muraturës jugore, pranë hyrjes kryesore si dhe në muraturën që ndodhet në anën veriore të oborrit, aty ku lidhet me Abatonin.

Teknika e dytë, "opus reticulatum", që herë-herë shkrihet natyrshëm me teknikën "opus incertum", i përket mesit të shek. I deri në shek. II e.s. dhe për mendimin tonë lidhet me fazën e parë të ndërtimit. Faza e dytë e ndërtimit është lidhur me disa shtesa që i bëhen objektit ku dallohen teknikat "opus testaceum". Karakteristikë e kësaj teknike në Butrint, janë përzierja e teknikës lateracia me breza tullë "opus mixtum" dhe "opus vitatum" (me breza horizontale të gurëve), ku duken qartë vijat e gërvishtura në fugat e llaçit, karakteristike për shek. II e.s. Kjo teknikë vihet re edhe ne rikonstruksionet e periudhës romake në skenën e teatrit dhe në tempullin e Eskulapit.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Teknikat e tjera që hasen rrugës, si ajo e gërshetimit të gurëve me tulla të vendosura pjerrët ose të përzierjes pa kriter të gurëve dhe tullave, i përkasin periudhës nga shek.III-IV e.s. dhe përbëjnë fazën e fundit të përdorimit të këtyre teknikave dhe mjediseve të ndërtuara sajë tyre.

3.d - MURI I TARRACIMIT

Në vazhdim të Abatonit, aty drejt lindjes, zgjatet një mur i ndërtuar me blloqe masive guri, mbi të cilin mbështeteshin dherat e kodrës (fig.15). Muri i ndërtuar me teknikën mjaft të përdorur në Butrint "trapezoidal izodomik" ruhet deri në lartësinë 8m. Është me interes të përmendim edhe përshtatjet konstruktive që i bëhen murit. Ato duken qartë sidomos kur bëhen për të lënë të lirë rrjedhën e ujit nga damari shkëmbor në pusin e shenjtë. Në një fazë të dytë pusi mbulohet me qemer tulle.

Ndërtimi duket të jetë i njëkohshëm me ndërtimin e Abatonit. Kjo vërehet nga lidhja e mirë e blloqeve të murit të hyrjes së Abatonit me murin e tarracimit si dhe nga teknika e njëjtë e punimit të faqeve të dukshme të gurëve. Një gufmim i lehtë në sipërfaqen e dukshme të gurëve, puthitja e fugave horizontale e vertikale në mënyrë të përkryer dëshmon për të njëjtën dorë punimi e kohë ndërtimi - shek.IV p.e.s. ose fillimi i shek. III p.e.s.

Në periudhën romake ky mur teracimi i nënshtrohet një meremetimi, që prek krejt pjesën vijuese në drejtim të lindjes.

Më lart përcaktuam në vija të përgjithshme fazat kryesore të zhvillimit të Sektorit të Shenjtë. Vihet re se në fazën e parë (fig.6) mbizotëron ndikimi religjoz i kësaj qëndre, çka vazhdon edhe gjatë periudhës së Aleancës Epirote (325-232 p.e.s.). Në këtë periudhë shohim të ndërtohet tempulli i dytë i urdhrit jonik, rreth 15 m në veri të tempullit të Asklepit. Me gjasë koha kur është ndërtuar tempulli i dytë është shek.III p.e.s., duke u mbështetur edhe në njoftimin që na jep Dakaris (34).

Faza e dytë, ajo e sektorit të shenjtë (fig.9), lidhet me ndërtimet e reja si rezultat i zhvillimit ekonomik e politik, sidomos mbas fitores së Pirros në Heraklea ndaj romakëve në vitin 280 p.e.s. Kjo periudhë është mjaft e përmendur për ndërtime, si për fortifikime mbrojtëse ashtu edhe për ndërtimin e objekteve shoqërore. Në Dodonë e Butrint u ndje forca ndërtuese e Pirros (ai vetë i quante ndërtimet ndihmë ndaj orakujve, të lidhura këto dhe me ambicjet e tij politike). Në vitin 272 përfundoi ndërtimi i teatrit në Dodonë. Thuajse të kësaj periudhe duhet të mendojmë ndërtimin e teatrit në Butrint.

Faza e tretë i takon periudhës pas viteve 228 p.e.s., periudhë kur ngjau pushtimi romak i qytetit (fig.10). Rikonstruksionet dhe ndërtimet e reja, që zënë e shtohen në shekujt e parë të erës sonë bëhen për t'iu përshtatur nevojave të reja të shoqërisë skllavopronare.

Vihet re se rruga historike e evolucionit të arkitekturës, përpara se kjo e fundit të fitojë veçoritë e saj tipike për çdo funksion, paraqitet si element i lidhur apriori me ndërtimet e tjera më të hershme. Shembulli më i qartë i kësaj ideje, është ndërtimi i teatrit antik në territorin e Santuarit. Ndërtimi i teatrit, lidhja organike e tij me objektet e tjera të ndërtuara më parë shpjegohet me rënien e rolit udhëheqës të objekteve të kultit dhe ndarjen e parësisë së tyre me ndërtime reja, që plotësojnë më së miri kërkesat në rritje të shoqërisë.

PËRFUNDIME

Më lart është përmendur lidhja e burimit të ujit, me fillimet e jetës së Santuarit. Deri në një kohë të panjohur qartë prej nesh, në këtë shesh lëviznin nga viti në vit procesionet e shenjta, të cilat përshkonin rrugën rituale.

Dikur u desh të prishej ky shesh e të ngrihej aty një tempull e më vonë të tjera ndërtime. Në kundërshtim me arsyen dhe traditën, këtu u shpërfillën ligjet religjoze të kodifikuara ndër shekuj, duke prishur funksionin e parë të sheshit, ndërsa më vonë, me ndërtimin e teatrit, prishën dhe trasenë e "rrugës së shenjtë", pra tek e fundit shprishën qoftë qëllimin e religjonit qoftë kuptimin e kultit në këtë Santuar.

Ç'shkaqe të rëndësishme duhet të kenë shtyrë vendasit të kryejnë të tilla shkelje të shenjta, duke prishur përfytyrimin shekullor mbi religjonin. Vallë nuk ka pasur vende të tjera të lira për ndërtimin e objekteve, duke e kursyer kësisoj sheshin e shenjtë?

Një shkelje e tillë, në një kohë kur s'u ndërpre kurrë veprimtaria religjoze e vendit të shenjtë, zor se mund të bëhej rastësisht. Çka përshkruam më lart mjafton për të kuptuar sa i pabazë do të qe mendimi mbi "rastësinë" e ndërtimeve në sheshin e Santuarit. Materialet faktike na tregojnë se zgjidhja e kushtëzuar nga disa shkaqe, është në thelb një mendim artistik i kompozimit arkitekturor në ndërtime disi të ndërlikuara.

Në qoftë e thënë të çuditemi për diçka, është pikërisht forca e mendimit artistik ajo, e cila lind njëherë e mandej lëviz përpara duke iu nënshtruar arritjeve të reja për pasojë të domosdoshmërisë së ruajtjes dhe dorëzimit të "stafetës" së mendimit fillestar. Nëse ne pranojmë se Santuari, zgjidhjen fillestare e pati të kushtëzuar nga burimi i ujit, na duhet ahere të deshifrojmë metodat arkitekturore ose mënyrat e shprehjes së mendimit në lëvizjen përpara, me anë të arritjeve të reja, gjithë duke u mbështetur mbi atë çka na jep vetë arkitektura e objekteve.

Që të gjejmë e qartësojmë si shkaqet, ashtu dhe rrjedhojat e tyre, me fjalë të tjera pra të kuptojmë mendimin e kompozimit dhe mënyrën si ai shprehet në format e arkitekturës, duhet të futemi në brendinë e jetës dhe në "funksionin" e çdo elementi të këtij uniteti të pleksur. Kësisoj do parë në veçanti tempulli i Asklepit, teatri dhe portiku në lindje të tij, si bërthama të këtij kompozimi.

Duke e thelluar idenë, mund të paraprijmë me vërejtje të karakterit të përgjithshëm, për aq sa njohim nga "sektorët e shenjtë". Vendet e shenjta në Delf, në Olimp në Korinth, në ishullin e Delos etj., kanë së toku një tipar të përbashkët: konceptin e njëjtë arkitekturor, pa u ndalur në individualitetin e qartë të çdo kompozimi në veçanti. Në bazë të gjithsecilit prej tyre qëndron ideja e madhe e moralit religjoz, e cila ka nevojë për veprimtarinë e ceremonisë së kultit, ndërsa veprimi në vetvete ka nevojë për gjendjen përkatëse. Kjo me sa duket ka qenë çështje fort e rëndësishme në përcaktimit e zonës për vendin e shenjtë, sa para së gjithash është menduar të zgjidhej vendi që mund t'i përgjigjej më së miri "mikroskenave" të mëpasshme si dhe veçorive të kultit përgjegjës.

Vetëm kësisoj përcaktohej ideja e ardhshme arkitekturore; as arkitektura e një ndërtese marrë në veçanti (qoftë kjo tempull a teatër), as madje kompleksi i tyre nuk zgjidhte problemin e kompozimit. Vetëm përcaktimi religjoz i Zotit që jeton në vendin e shenjtë, (në tempull) si simbol e qëllim veprimi, mund ta zërë vendin kryesor dhe të marrë rol udhëheqës në kompozimin e kompleksit.

Së këndejmi mbërrijmë të mendojmë se në hapësirën e përgjithshme të kompozimit në varësi me zotërimin e tij dhe rëndësinë, tempulli duhet të zinte një vend, prej nga do të do të mund të rrokej qartë kuptimi i tij, si bërthama e krejt kompozimit.

Megjithatë arkitektët që punuan për ngritjen e vendit të shenjtë në Delfi, ishullin Delos etj., duket se e kanë menduar krejtësisht ndryshe. Tempulli ishte njëri nga objektet në përgjithësi, të cilët ishin të barabartë mes tyre dhe përbënin krejt kompleksin. Nga kjo dallohej dhe planizimi i vendit të shenjtë në Butrint. Tempulli nuk zuri vendin e objektit mbizotërues, pra nuk u vendos në mbyllje të perspektivës së sheshit, por duke

DO NOT COPY

qenë i barabartë me të tjerët, i la vend Prytaneionit. Në një kompozim të tillë, secili përbërës i ansamblit me të drejta të barabarta në një moment të dhënë bëhet "udhëheqës" për aq kohë sa nuk e zëvendëson kush. Individualiteti i ansamblit bëhet i dukshëm kryesisht nga rrugët e ndryshme, nëpër të cilat vijnë e zhvillohen më tej hapësirat e kompozimit.

Do përmendur se koncepti i kompozimit, që tek e fundit përcakton bërthamën apo qendrën e kompozimit, është i lidhur edhe me elemente të tjerë anësore, të cilat është e vështirë t'i zbulosh menjëherë. Në se shqyrtojmë disa shembuj të hyrjeve në "sheshin e shenjtë", do të hasim në paraqitje të përsëritura, po njëlloj të pakuptueshme, që ngjajnë si të rastit e mandej bëhen si të ligjshme. Kështu në Akropolin e Athinës deri në ndërtimin e periudhës romake, populli ngjitej me zik-zake në shkallën kryesore, ndonëse ngjitja nuk është aq e përpjetë, sa të mos realizohet drejpërdrejt. Sa më tepër i afrohemi kohës së re, aq më pak ndeshemi me zgjidhje kësisoj, të cilat fillimisht duken si të paarsyeshme.

Në forumet romake ngjitja kalonte nëpër linjën e boshtit, duke shpalosur madhërisht krejt kompleksin e forumit në perspektivën ballore. Në Butrint, njëlloj si në periudhën e parë edhe në periudhën romake hyrja në sheshin e tempullit gjendej jo më në boshtin e sheshit, por anash tij, çka paraqitej si metodë e veçantë. Të tilla metoda i gjejmë edhe në disa qytete helenistike, si në Priene, Magnezia, Milet madje dhe në Pompei.

Rëndësia e këtyre metodave, të pakapshme në vështrim të parë, duhet të ketë shpjegimin e vet. Ajo zbulohet porsa i drejtohemi analizës më të thellë të kompozimit. Sipas të gjitha të dhënave, tempulli i Asklepit zinte vendin kryesor në Santuar, duke u sjellë kësisoj si i plotfuqishëm. Po ne kurrkund nuk gjejmë ndonjë shprehi arkitekturore, e cila na dëshmon një kuptim të tillë rëndësor të tempullit, duke na detyruar ne ta pranojmë si të tillë. Madje siç e pamë më lart, kemi një zvogëlim të ndjeshëm të përmasave të tij, gjithë sipas vullnetit të barazimit harmonik të tempullit me përbërësit e tjerë të kompleksit. Si është plotësuar kjo?

Tempulli është vendosur në anë të sheshit, duke lënë vend edhe për ndërtime të tjera. Si konceptohej kjo panoramë nga njeriu, i cili kalonte rrugën rituale, nga hyrja e qytetit, që mendohet të ketë qenë pranë Portës së Liqenit, rreth 200m në lindje të tempullit të Asklepit? Në këtë rast vëllimi natyral i tempullit, parë nga larg e në mënyrë perspektive duket i zvogëluar. Pamja e dukshme e panoramës vepron me forcë ndaj korrigjimit të gjykimit e dukjes prej së largu. Ajo që ngjan e vogël në plan, e vendosur në thellësi të sektorit, bëhet si thuash më e madhe.

Të shohim tani vendosjen e tempullit në krahasim me planin e sektorit të shenjtë në tërësi. Tempulli është vendosur në pikën më të mirë e më të leverdisshme, thuajse në qendër të sektorit. Dimë se orientimi i tempullit diktohej nga kërkesat e kultit e si rrjedhim nuk i nënshtrohej dëshirës së ndërtuesit. Në rastin konkret, mund të mendojmë se rastësisht ka ndodhur që tempulli u vendos në mënyrë të papërcaktuar në krahasim me sektorin dhe brinjazi në raport me muret e rrethimit.

Mos vallë një vendosje e tillë në qendër të sektorit na paraqitet si diçka e papëlqyer, që nuk shpjegohet assesi?

Po hamendësojmë se ajo qenkësh bërë ngase muri i rrethimit ka qenë ndërtuar kur nuk ka ekzistuar asgjë, pra as tempulli. Po në shekujt e parë të erës sonë, kur tempulli u rindërtua dhe ishte momenti më i volitshëm për të ndrequr të papëlqyerën dhe gabimin e mëparshëm? Në rast se vendosja në fjalë ka qenë vërtet e gabuar, pse nuk u rregullua, po u la çdo gjë sipas së vjetrës? Kjo dëfton se në një vendosje të tillë të tempullit në krahasim me kufirin e sektorit, arkitektët nuk shihnin asnjë gabim. Ata jo vetëm nuk e ndjenë nevojën për ndryshim, por e quanin një gjendje të tillë si më të drejtën, që përmbushte disa kërkesa të përcaktuara.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Si përkapet kjo vendosje e tempullit nga njeriu që ecën nëpër rrugën e shenjtë, që nga hyrja deri në Tempull? Pasi hyn në portën e rrethimit, ai e sheh tempullin në fokus, me vëllim të thyer, kështu madhësia e përgjithshme vjen tek ai më shumë se sa çdo faqe në veçanti. Duke lëvizur më tej nëpër rrugën që të çon atje, vrojtuesi duke menduar vendosjen gati paralel të tempullit me rrugën, nuk sheh më vëllimin e tempullit, por sheh vetëm sipërfaqen e brinjës anësore. Në këtë mënyrë ndeshemi përsëri me iluzionin e zvogëlimit të objektit që vrojtohet, d.m.th me atë efekt vrojtimi që është ndjerë edhe më parë, por në mënyrë tjetër, për të barazuar qoftë dhe afërsisht madhësinë e tempullit me objektet e tjera.

Mënyrat arkitekturore që përmendëm, janë të lidhura jo vetëm më perceptimin e vrojtimit të ndërtesës së tempullit, por edhe për të krijuar në përfytyrimin e njeriut, siç e pamë më lart, jo idenë e "mbizotërimit" të një pjese të kompleksit mbi të tjerat, por të kundërtën, barazinë e plotë, shoqërizimin harmonik dhe lidhjen e përgjithshme të tyre në një të tërë.

Natyrisht duhet të marrim parasysh edhe gjendjen shpirtërore të njerëzve që vinin në Santuar. Imagjinata e tyre trazohej e bëhej romantike sa s'ka më falë natyrës së veçantë në Butrint. Mistikat gati teatrale të mikroskenave rituale, krejt ceremonia fetare, pritja e profecisë së orakullit nga njëra anë si dhe gjendja shpirtërore e raskapitur nga ana tjetër, ajo mbingopje ekzaltimi na shtyn madje që edhe dukurinë më se të njohur fizike të sapothënë ta marrim si një ndjesi të një loje fantastike hyjnore. Sigurisht ne nuk mundemi t'u hyjmë në brendësi emocioneve që kanë provuar njerëzit e lashtë në të tilla kushte e në të tillë vend. Po, tamam kështu, ne nuk mundemi të kuptojmë gjer në fund fuqinë e shpirtëzimit të natyrës dhe dukurive të saj siç e kanë perceptuar njerëzit e botës antike. Përfytyrimet e personazheve mitologjike, të cilat për ne janë si të thuash "literaturë", për krijuesit e tyre kanë qenë vetë konkretizimi i vlerës reale. Duke u nisur nga sa thamë, do pranuar se në rrethanat e përmendura, larg nga jeta e përditshme, në përshtatje me gjendjen shpirtërore të asaj kohe, ky ligj i natyrës ka fituar vetitë e një loje hyjnore. Kjo ishte po aq konkrete sa çka besonin ata, pra ekzistenca e zotave, shndërrimi i tyre në kafshë, në njerëz e në fenomene të natyrës.

Me sa duket kështu përmbyllen logjika dhe parimet e kompozimit, të cilat kërkojnë vëmendje për t'i kuptuar e interpretuar në evolucionin e tyre. Qartësohet, pra, çka më parë ishte ende e paqartë, kaotike apo e rastit.

Ndërtimet e periudhave të ndryshme, kanë lënë gjurmë sipas shijeve të kohës në të cilën ato u ndërtuan. Ndiqet në mënyrë të veçantë teknika e periudhës helenistike dhe ajo romake me veçantitë e tyre stilistikore dalluese. Santuari ngjan se është ndërtuar sipas një plani kompozicional të menduar mirë, ku arkitektët dhe artistët janë përpjekur të shpalosin talentin e tyre.

Ndërtimet religjoze e publike të zbuluara deri tani, janë një informacion i mjaftueshëm për të kuptuar që Butrinti njëlloj si Dodona, ishin qendra të rëndësishme fetare e shoqërore qoftë rajonale, qoftë më gjerë akoma, mesdhetare. Me përpjesëtimet e përmasat e harmonizuara më së miri me tërësinë e vetë madhësinë modeste të qytetit ku ato u ndërtuan, zbatuan paq arritjet e arkitekturës së përparuar bashkëkohore.

Studimi mbi arkitekturën e urbanistikën e Santuarit të Asklepit në Butrint, destinimi praktik i objekteve që përbëjnë atë dhe domethënien tyre religjoze e publike, është një përpjekje për të ndihmuar studimet e ardhshme lidhur me këtë qendër të rëndësishme arkeologjike; të tilla studime do të përcaktojnë edhe vlerat e vërteta të Butrintit deri në vitet e fundit të jetës së tij.

DO NOT COPY

1. A.Karamopullos, "Guide de Delf" Athens, 1909. (Edhe në Delf"periudha e lashtë e temenosit, lidhet me burimin e ujit).

A.Baçe, Vështrim mbi besimin dhe arkitekturën e kultit tek Ilirët, "Monumentet" Tiranë 1984 /2 fq.6

2. Të dhëna historike nga shek.VI para Kr., përcaktojnë kur çfaqen vizitat e para në Delfi. Edhe orakulli I Dodonës, lidhur me "lisin e shenjtë" ka filluar të vizitohet në këtë kohë (S.I.Dakaris, Dodona, fq.83).

3. A.Baçe, N.Ceka, Shëtitoret e periudhës qytetare, "Monumentet" 1981/2 fq. 5-54

4. S.Anamali, Amantia, Iliria II 1972, FQ. 61-133.

Dh.Budina, Teatri në Orikum, Studime Historike, 1664.I fq.155

G.Pani, Tempulli në Shtyllas, "Monumentet" 1985 /I fq. 79-84

G.Pani, Arkitektura e dy tempujve në Butrint, "Monument"1988/I fq. 23-37

5. Thucydide II,80, 5-6

6. P.Cabanes, L'Epire, da la mort de Pyrrhos a la conquete romaine (272-167) fq. 172-185

7. P.Cabanes, Shoqëria dhe institucionet në Epir dhe Maqedoni në epokën klasike dhe helenistike, "Iliria" 2, 1981, fq.65.

8. A.Baçe, Vështrim mbi besimin ..., (vep.cit.) fq.6

9. Burimi u mbulua me qemer në shek. IV par K.r Qemeri mbulonte një hapësirë rreth 1.5m të lartë, rreth 1.0 m të thellë 1.3 m të gjerë, të mbështetur pjesërisht në faqen shkëmbore të terenit (fig. 3/a)

10. L.M.Ugolini, L'Acropol di Buntrint, 1942, fq. 112-24

11. L.M.Ugolini, L'Acopol..., fq.98, përmend rreth 260 enë të zbuluara aty, gjatë gërmimeve arkeologjike.

12. S.I Dakaris, Dodona, Janina 1971 fq.32

13. G.Pani, Arkitektura e dy tempujve në BUTRINT, "Monumentet" - 1988/I, fq.23.

14. Objekti ishte zbuluar nga Misioni arkeologjik Italian (L.M.Ugolini: Butrinto, il mito d'Enea, fq.124).

Në vitin1982 u kryen punime arkeologjike në këtë objekt, të organizuar nga Akademia e Shkencave, në kuadrin e Kursit të kualifikimit pasuniversitar. Gërmimet u drejtuan në këtë sektor nga prof. S.Islami. Dokumentacioni është përgatitur gjatë gërmimeve nga autori i këtij artikulli, kurse gjetjet arkeologjike janë trajtuar nga arkeologu K.Lako.

15. Ch. Darenberg, E. Saglio, Porticus, "Dictionnaire des Antiquiteys Grecque et Romains" Vol. IV FQ. 585

16. Datimi i objektivave është bërë nga K.Lako (material. pa bot.)

17. F.Drini, Mbishkrime të reja të zbuluara në Butrint, "Iliria" 1981,1 fq.227

18. Punimet arkeologjike u kryen ne vitin 1979 nga arkeologu Dh. Budina dhe K.Lako (materiali i pabotuar)

19. Të dhëna mbi diametrin e kolonave dhe hapësirat e intercolumjeve, janë nxjerrë duke matur gjurmët që janë ende të inçizuara në stilobatin e peristilit.

20. Materiali arkeologjik është në arkivën e Insti. Arkeolo.

21. Mbishkrimi para hyrjes ka këto gërma latine: CN.DOMITIVS, CN L. EROID...

22. Autori i gërmimëve, arkeologu Dh.Budina përmend disa mbeturina eshtrash të djegura, të zbuluara në një ambjent, dhe për këtë arsye e emërton objektin "banesë gjyetari".

23. S.G.Miler The Pryteneion, Its funktion and architectural form. Fq. 4-37.

24. Archeioni është ambjent ngrënie. Pausania përmend një sallë ngrënie në prytaneionin e Olimpias, hanin fituesit e garave.

25. S.G.Miler, vep. Cit. Fq. 17-19, përmendet ambjenti i arkivës dhe muzeut, ku vendoseshin objektet më të rëndësishme të qytetit. Eshtë vështirë të themi që këto ambjente ekzistonin edhe në objektin e zbuluar në Butrint, për faktin se ndërtimi është shumë i vogël dhe ka një numër të kufizuar ambjentesh.

26. G.Caputo, II teatro di Leptis Magna, Roma 1948, fq. 281 M.Beare, The roman stage, London 1950.

27. Tit Livi, në Librin X-XII dhe Apiani "Luftrat civile" I, 28,633, përmendin luftën e ashpër ndërmjet atyre që qëndronin në pushtet dhe që ishin në anën e shfaqjeve teatrale, dhe kundërshtarëve të shfaqjeve teatrale. Nga kjo lindi nevoja për t'u shtuar lojrave teatrale dhe ndërtesën e kultit ose lidhjen në të.

28. T.B.Mepster, Elenismo, Milano 1967, fq. 50 dhe 159.

29. S.G.Miller, vep. Cit. Fq.126.

30. L.M.Ugolini, Il mito d'Enea... fq.158.

31. Objekti është zbuluar nga gërmimet arkeologjike të Misionit italian të drejtuara nga Ugolini. Në vitin 1982 u bënë gërmime arkeologjike të organizuara nga Akademia e Shkencave, në kuadrin e kualifikimit pasuniversitar të një grupi arkeologësh dhe arkitektësh.

32. S.I.Dakaris, vep. Cit. Fq.54, përmend mbishkrimin në tempullin Afroditës dhe konfirmimin e kultit të Eneas Afrodit, të cilën Pirro e solli nga Segesta, në fillim të shekullit të III para Kr. Këtë kult, Pirro e formoi në Zakynthos, Leukas, Actium, Ambraki dhe Buthrotum.

DO NOT COPY

METODOLOGJIA E PËRDORUR NË KONSERVIMIN DHE RESTAURIMIN E SANTUARIT TË ASKLEPIT

Metodologjia e punimeve konservuese të kryera në objektet e Santuarit të Asklepit ka marrë për bazë kriteret themelore të ndërhyrjeve në monumentet antike, duke u paraprirë nga vrojtimet dhe informacionet e mbledhura në të gjitha objektet e kësaj qendre. Punimet në fjalë u mbështetën kryesisht te përvoja e fituar nga të tjera ndërhyrje konservuese në monumente antike tonat.

Pikënisjet kryesore të konservimit janë organizuar në disa drejtime njëherësh:

a. Aspektet strukturore të objekteve.
b. Shkaqet e dëmtimit
c. Fazat e ndryshme ndërtimore, meremetimet e teknikat specifike.
d. Fillimi i ndërhyrjeve konservuese.

Studimi historik dhe gjurmët e lëna në monument vijnë e lidhen me objektivat e përcaktuara në mënyrë që të vendoset drejt e saktë mbi përgatitjet dhe udhëheqjen e punimeve konservuese-restauruese.

Gjasat politike dhe ekonomike të periudhave kur u ngritën këto struktura na ndihmojnë të analizojmë kronologjinë ndërtimore që nga zanafilla e qendrës në shqyrtim e deri në ndërprerjen e funksionit të saj. Analizat e parimeve estetike dhe konceptet e kompozimit na dhanë dorë ndërkohë në rikonstruksionin e objekteve kryesore si tempujt, teatri, abatoni etj.

Ndërhyrjet konservuese të kryera janë përqëndruar në rrënojat arkeologjike të zbuluara deri sot, ndërsa ardhmëria e ndërhyrjeve të mëtejshme parakupton planifikimin hartimin e një programi punimesh të ndërthurura me nevojat për gërmime arkeologjike në sektorë të veçantë.

1. Aspektet strukturore

Një strukturë ndërtimore mund të rezistojë natyrshëm ndaj gjithfarë ngarkese të përllogaritur nga projektuesi. Ndërkaq vendosja e mbingarkesave të rënda pritet të ketë efekt të madh e të ndryshëm nga ngarkesat e vendosura prej parit apo të projektuara. Në fillim, pra, duhen shqyrtuar shkaqet e krijimit të çarjeve në muraturë dhe mandej të kalojmë në shërimin e tyre. Pikësëpari na duhet të kuptojmë se çfarë problemesh krijojnë të tilla sforcime në strukturë. Pa nënvlerësuar faktorët e tjerë, dy janë më kryesorët:

- Lëkundjet sizmike
- Mbingarkesat e strukturave

Forcat që veprojnë brenda në strukturë tashmë dihet cilat janë: tensione, ngjeshje, përkulje, përdredhje etj.; s'do mend se është e domosdoshme që objekti t'u bëjë ballë atyre. Për pasojë konstruksioni duhet planifikuar e ngritur me materialet e duhura, vetitë statike të të cilave njihen mirë. Më anë tjetër do menduar një

konstruksion i qëndrueshëm dhe i ekuilibruar. Në rast se ky ekuilibër prishet, struktura bëhet statikisht e paqëndrueshme, ndaj çdo ngarkesë mund t'u çelë rrugë pasojave të rënda. Si mund t'i hasim dukuritë në fjalë te objektet e Santuarit:

1.a Strukturat me blloqe guri

Strukturat antike që sot shohim në Santuarin e Asklepit në Butrint, paraqiten masive dhe disi të paqëndrueshme, pasi materialet prej guri të përdorura aty o nuk u kanë rezistuar ekspozimit ndaj agjentëve atmosferikë, ose një pjesë janë plasaritur për shkak të difekteve që mund të ketë pasur vetë blloku i gurtë. Ato struktura tempujsh tra-kolonë (35) të përdorura në Butrint, sa të qëndrueshme aq edhe estetike, nuk i shohim dot më, jo vetëm si rrjedhojë e shndërrimeve që kanë ndodhur në periudhën romake, por edhe nga lëvizjet sizmike ose shkaqe të tjera.

Për pasojë janë shembur jo vetëm strukturat e tempullit të Asklepit, tempullit mbi teatër, (fig. 14) por edhe të shëtitores me kolona dhe skenës helenistike të teatrit.



Fig. 14. Rënojat e stilobatit të tempullit mbi teatër.

Nga strukturat e këtyre objekteve kanë mbetur vetëm rrënojat e stilobatit ose strukturat pjesore të muraturave, disi më të qëndrueshme ndaj sforcimit. Këtu mund të përmendim dhe konin e madh të kavesë së teatrit, struktura e të cilit, e formuar nga blloqe të mëdhenj guri, që vijnë e mbështeten në terrenin e pjerrët të shkëmbit e të lidhura me formën planimetrike të harkuar, ka mundur t'u bëjë ballë në mënyrë harmonike tensioneve të shkaktuara nga lëkundjet e ndryshme sizmike.

1.b Strukturat me llaç

Ndryshe paraqitet gjendja në strukturat me llaç.Në mënyrë më të plotë ndiqen strukturat e muraturave me llaç gëlqere. Në këto struktura, të cilat ruhen sot në nivele të ndryshme, sforcimet në godinë mumd të kuptohen vetëm në tërësi. Në teatër ta zemë, konstuksioni i ri, që vjen e i shtohet atij, në shekujt e parë të erës sonë, duke qenë se përmban elemente të reja strukturore, mund të themi se thjeshtohet mjaft si në vëllim dhe në formë. Nga ana tjetër, kjo zgjidhje mbingarkoi disi konstruksionet e vjetra. Në lartësinë rreth 10 m ku u ngrit skena romake, trajtat estetike janë realizuar me kujdes dhe në shkallë gjeometrike (36) (fig.10), por nuk janë marrë parasysh elementët konstruktivë të themelit si dhe struktura e tokës.Uljet e kavesë, të cilat vihen re menjëherë në pjesën që lidhet me skenën, janë shkaktuar nga mbingarkesa e themelit. Çarjet e krijuara nga cedimet e themeleve me siguri kanë sjellë më pas shembjen e strukturave romake.

Vështirësitë vijnë e rriten atëhere kur në të njëjtin objekt janë përdorur materiale të ndryshme. Prandaj në studimin e zhvillimeve historike që kanë patur strukturat e muraturave me llaç, klasifikimi do të nisë nga format e parapëlqyera për kohën.

Elementet përbërëse që janë të diskutueshme, do t'i ndajmë në disa grupe:

- trarët dhe arkitrarët,
- harqet,
- kolonat dhe mbështetjet vertikale,
- themelet.

Pastaj grupet e ndryshme të godinave në tërësi, do t'i vëzhgojmë të radhitura sipas fazave, nga format më të thjeshta deri në ato të

DO NOT COPY

ndërlikuarat. Ky klasifikim është ndofta më i miri për të ravijëzuar rrugën që ka ndjekur zhvillimi i brendshëm qoftë i elementeve të vecanta ashtu dhe i godinave komplekse. Në të njëjtën kohë fitojmë aftësi njohjeje ndaj karakteristikave thelbësore të çdo forme.

2. Elementët strukturore

2.a Muret

Çdo periudhë historike pa dyshim ka pasur shembëlltyrat e veta në ndërtimin e mureve. Prandaj, çdo tip muri që na shfaqet në Butrint sipas fazave të ndryshme, i bie të ruhet po në mënyrë të ndryshme gjithë në varësi të konstruksionit, zgjidhjes planimetrike dhe të materialeve të përdorura në secilën fazë. Kështu blloqet poligonale ose trapezoidale dhe më pas muret me gurë e tulla të lidhura me llaç, përbëjnë një masë të madhe teknikash të periudhave të ndryshme.

Këto rrënoja, siç thamë më lart, na kanë përcjellë informacion mbi natyrën e sistemit strukturor. Nga ana tjetër, për të ruajtur strukturat e mureve nga shprishjet e mëtejshme, u desh të merreshin masat e para parandaluese për mbrojtjen e strukturave të brendshme (bërthamave) të muraturave nga dëmtimi që shkaktonin ujrat e shiut (37) dhe vegjetacioni (fig.15). Mjaft herë muret, përpos atyre që shohim të veshura me pllaka guri ose mermeri, janë punuar edhe me muratura të mbuluara me suva. Qëndrueshmëria e këtyre strukturave varet kryekëput nga cilësia e gëlqeres; mjaft të krahasojmë strukturat solide të muraturave me llaç gëlqere të teatrit me muraturat me llaç gëlqere, por gjithsesi të dobëta, të mjediseve prapa murit rrethues ose në sektorin perëndimor dhe lindor të Santuarit (fig.16).

Këto të fundit tashmë janë në gjendje të rëndë dhe shkak për shkatërrimin e tyre bëhet qoftë veprimi i faktorëve natyrorë, qoftë difektet materialeve dhe strukturore.



Fig. 15. Dëmtimet nga vegjetacioni mbi muret e rënojave

Duke vërejtur çarjet në strukturë, u bë klasifikimi i kujdesshëm i tyre në varësi të shkakut që i pat krijuar (38). Vërejtja me kujdes e këtyre difekteve ishte e domosdoshme jo vetëm për mbylljen ose riparimin e tyre ku ishte e nevojshme (gjë që nuk përbënte ndonjë problem të vështirë teknik në muraturat me llaç), por edhe na ndihmoi në përcaktimin e mureve shtesë ose fazave të vona në ndërtim.

Difektet në blloqet e gurit.

Çarjet në blloqet e gurit janë shkaktuar kryesisht nga mangësitë e vetë materialit (damarët). Çarje të tilla shohim tek muret e

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 16. Struktura të dobëta të muraturave

abatonit ose tek shkallët e teatrit në anën perëndimore. Thyerjet e blloqeve të gurit në kavenë e teatrit bëhen të dukshme sidomos në sektorin ku deformacinet në harkun e kavesë janë më të mëdha si rezultat i uljeve që ka pësuar tereni.

Një tjetër dukuri, e cila shfaqet apriori në sipërfaqen e blloqeve të gurit është ajo që lidhet me dëmtimin e sipërfaqes së dukshme të gurëve ose të kores së formuar nga ekspozimi i gjatë. Korja që zë sipërfaqja e gurit, shumë herë cilësohet si ndryshim i ngjyrës së gurit nga koha. Ndonëse në blloqet prej guri veshja e sipërme e krijuar nga koha gjason si kore mbrojtëse ajo në fakt është shkatërrimi i materialit të gurit. Nëpër të nis e hyn me lehtësi lagështia e rreshjeve, e cila, me ndryshimin e temperaturave, shkakton kohë pas kohe shkëputje, duke ia dalë të gërryejë, pra, sipërfaqen e ekspozueshme të gurit.

Siptomat e difekteve në bashkimet e blloqeve me ganxha metalike, janë shoqëruar me çarje të lehta, të shkaktuara nga trysnitë lokale, pasojë e oksidimit të ganxhave në fjalë.

Këto difekte kanë sjellë në disa raste nevojën e zëvendësimit të materialit prej guri të kolonave me materiale tulle ose ndërtimin e mureve mbajtëse si, ta zemë, te Prytaneioni apo në muraturën e jashtme të Pandokeionit. Mbylljet e hapësirave të dyerve janë kryer me siguri nga difektet në arkitrarë.

2.b Harqet dhe qemeret.

Vlerësimi i kushteve dhe sforcimeve që i sillnin muraturave harqet dhe qemeret ishin një nga problemet më të vështira që hasnin ndërtuesit e periudhës antike. Rrallë ata mund t'ia dilnin të llogaritnin sforcimet e këtyre harqeve, ndaj zgjidhjen e tyre ia linin përvojës. Kësisoj, për mendimin tonë, disa deformime kanë ndodhur për shkak të mosnjohjes së sforcimeve, që lindin në muraturat mbështetëse.

Kjo pasqyrohet në ndërtimin e harqeve të skenës së teatrit. Mendohet se gjatë ndërtimit të muraturave të skenës janë vërejtur deformacione, që duken dhe sot në anën veriore të harkut qëndror të skenës, të cilat kanë detyruar ndërtuesit antikë të dyfishojnë muret mbështetëse të harqeve. Në këtë dritë ne mund të shpjegojmë dyfishimin e murit të skenës, i cili, nga teknika dhe përbërësit e llaçit, duket qartë që është ndërtim i së njëjtës periudhë. Po kështu mund të shpjegohet fuga që duket në shpatullat e harkut (e cila është lënë e dukshme edhe mbas punimeve tona retauruese).

Ndryshe është zgjidhur problemi i sforcimeve horizontale, në qemerin e tempullit të Eskulapit. Ana lindore e mbështetjes së harkut është siguruar duke iu ngjitur murit anësor të teatrit ndërsa mbështetja tjetër është përfocuar me kontraforte, që janë ngritur çdo 2.00m. Përveç

kësaj nga kjo anë janë bërë më vonë dhe përforcime të tjera duke mbështetur këtu qemerin e korridorit të rrugëkalimit për në teatër, i ndërtuar ky në krah të tempullit.

Ndërhyrjet restauruese në harqet e skenës së teatrit, u pasuan edhe nga vrojtimi i çarjeve, shembjeve dhe shkaqeve që kishin dëmtuar atë.

Vumë re disa çarje diagonale dhe tangenciale, që binin në sy në pjesën e sipërme të harkut dhe në muraturën mbështetëse. Këto çarje kishin dëmtuar lidhjen e elementeve, të cilat duke rënë kohë pas kohe nga harku dhe shpatullat mbështetëse, kishin dëmtuar rëndë strukturën konstruktive të harkut. Përveç dëmtimeve të shpatullave të harkut, si rezultat i shkëputjeve të herëpashershme të gurëve të tij, pjesa e sipërme e harkut ishte zhveshur thuajse e tëra nga muratura përbërëse dhe nga masa mbajtëse e harkut kishin mbetur vetëm 30 cm. Edhe disa fragmente të masës mbajtëse të harkut, të cilat e kishin humbur pjesërisht mbështetjen e tyre në çelësin e harkut, qëndronin për mrekulli ende pa u rrëzuar, falë aftësisë lidhëse mjaft të mirë të llaçit të përdorur.

Punimet restauruese të kryera në harkun qëndror dhe lindor të skenës, shmangën rrezikshmërinë e shembjes së tyre. Restaurime të tjera plotësuese në muraturat e dëmtuara krijuan mandej një gjendje konstruktive e estetike të nevojshme (fig. 17).

Gjurmë të degradimit të vazhdueshëm binin në sy edhe në qemerin që mbulonte Naosin dhe Pronaosin e tempullit të Eskulapit. Përveç çarjeve në gjerësinë e masës mbajtëse të qemerit me tulla, të shkaktuara këto nga lëkundjet sizmike, rrezikshmëria rritej dhe nga prania e lagështisë në gjithë gjatësinë e qemerit.

Edhe pse llaçi i gëlqeres dhe tulla janë të qëndrueshme ndaj lagështisë, në rastet kur ajo mbërrin të depërtojë në masën e plotë të tyre, këto bëhen mjaft të dobëta gjatë proçesit të tharjes në ajër. Ndaj për t'i ruajtur sa më mirë fragmentet origjinale të harkut, në të cilat ende lexohet forma e tij e dikurshme, pikësëpari u desh të përcaktoheshin qartë shkaqet e degradimit.

Në vazhdim ndërhyrjet restauruese u përqëndruan në largimin e lagështisë, duke zëvendësuar llaçin e degraduar në zonat e ekspozuara ndaj agjentëve atmosferikë. Më pas u morën masat mbrojtëse për konsolidimin e



Fig. 17/1. Skena e teatrit.
a) Gjendja para konsolidimit të harqeve.
b) Konsolidimi i harkut të parë dhe të dytë.
c) Gjendja pas konsolidimeve.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

a)



b)



c)



Fig. 17/2. Cavea e teatrit.
a) Gjendja para restaurimeve.
b) Pamje gjatë punimeve restauruese.
c) Pamje mbas punimeve restauruese.

a)



b)



c)



Fig. 18. Tempulli i Eskulapit
a) Gjendja para punimeve restauruese.
b) Restaurimi i harqeve.
c) Gjendja mbas restaurimeve.

muraturave dhe qemerit. Gjithashtu për të lehtësuar ngarkesën e qemerit të dëmtuar, si pasojë e trysnisë që shkaktonte muratura perëndimore e korridorit (e cila kishte humbur dhe vertikalitetin) përgatitëm një brinjë konstruktive mbajtëse, në formën e harkut të qemerit (fig.18). Në këtë mënyrë krijuam një mbështetje të sigurt, duke përdorur material tulle të gatitur më parë, gjithë me përmasat dhe ngjyrën e tullave origjinale. Përdorimi i tullave të reja dhe teknikave origjinale, u pa i domosdoshëm për të ruajtur dhe vizionin estetik të kompleksit.

2.c Kolonat

Në ndërtimet e fazës së parë kanë gjetur kryesisht një përdorim më të gjerë kolonat prej guri dhe elementet e tjera konstruktive e dekorative, si kapitelet, frizat, kornizat etj. Këto elemente pothuajse janë zhdukur, duke lënë në mjegull vlerat e vërteta estetike dhe arkitektonike të ndërtimeve në periudhën helenistike.

Elementet e kolonave që trashëgojmë nga kjo periudhe janë vërtet të pakta. Ndër to mund të përmendim: dy fragmente kolonash (mjaft të pjesshme), vendosur në murin pranë fontanës në sheshin e tempullit, një fragment kolone përdorur në teatër si altar, disa copa kolonash në oborrin peristil të Pandokeionit dhe një tjetër në tempullin mbi teatër. Fragmente të tjera kolonash i shohim të përdorura si material ndërtimi në muraturat e objekteve të antikitetit të vonë.

Shkaku i zhdukjes së tyre duhet të lidhet jo vetëm me ndryshimin e shijeve në arkitekturë dhe zëvendësimin në disa raste nga kolona të përgatitura me tullë, por edhe në difektet e vetë materialit prej guri, me të cilin ato qenë përgatitur. Në këtë përsiatje na çon vetë fakti që përdorimi i kolonave me tulla në një periudhë të dytë ndofta lidhet me mungesën e materialit të qëndrueshëm për përgatitjen e kolonave prej guri.

2.d Themelet

Historikisht metodat dhe materialet e përdorura për ndërtimin e themeleve janë përgjithësisht të njëjta me muret, të cilat mbajnë.

Lëkundjet sizmike ose dukuritë që sjellin në strukturën e tokës këto lëkundje nuk mund të njiheshin saktë nga ndërtuesit e vjetër, pasi ato sot e gjithë kohën përbëjnë një problem mjaft të ndërlikuar. Gjithashtu nuk njiheshin dukuritë gjeologjike, ujrat nëntokësore apo pasojat e rreshjeve të mëdha.

Janë më se të zakonta ndryshimet e strukturës së tokës ose lëvizjet e terrenit ku ka ndërtime të lashta, por për zonat arkeologjike apo objekte me vlera të veçanta historike, këto lëvizje duhen njohur e cituar bashkë me kohën kur me gjasë kanë ndodhur ato.

Si shfaqen këto fenomene në Butrint?

Po t'i hedhim një sy hartës së rajonizimit sizmik të vendit tonë, zona e Butrintit përfshihet në zonën me intesitet lëkundjesh 8 ballë MSK (39). Një tërmet i fortë, që preku bregdetin Jon shënohet në vitin 358 dhe një tjetër në vitin 1153.

Në shumicën e monumenteve vrojtohen çarje të shkaktuara nga tërmetet. Për t'i vendosur drejt në kohë këto çarje duhet të kapërcejmë disa vështirësi. Së pari, kemi të bëjmë me tërmete mjaft të hershme, në një zonë aktive sizmike (40). Për rrjedhojë, pasojat që vrojtohen mund të jenë rezultat i më shumë se dy tërmeteve të njohura. Krahas kësaj, shumë gjurmë në monumente e në truall, janë zhdukur si pasojë e dëmtimeve të tjera natyrore dhe rikonstruksioneve pasuese. Po ashtu shumica e monumenteve ku vrojtohen këto çarje janë në gjendje rrënoje deri afër themeleve dhe çarjet shpesh kanë karakter fragmentar. Së dyti, të dhënat historike dhe makrosizmike për tërmetet e pasojat e tyre në këtë zonë janë shumë të pakta.

Duke gjurmuar pasojat e tërmeteve, bie në sy se ato shpërndahen sipas drejtimit VL-JP. Dëmtimet përqëndrohen në faqet verilindore dhe jugperëndimore të monumenteve. Përgjithësisht

DO NOT COPY

ato janë çarje diagonale prerjeje, por vihen re edhe çarje tërheqje-hapjeje. Në dyshemetë e monumenteve nuk janë qëmtuar dëmtime.



Fig. 19. *a) Harta e intensitetit sizmik.*
b) Skema e veprimit në kavenen e teatrit.
c) Gjurmët që duken mbi kavenen e teatrit.

Të marrim në shqyrtim pasojat në shkallët e teatrit dhe në objektin e abatonit. Çarjet diagonale të prerjes vihen re në shkallën dhe murin e saj mbajtës (fig.19), ndërsa ato të hapjes në murin e abatonit.

Duke u bazuar në të dhënat e rajonizimit sizmik të Shqipërisë (41), Butrinti përfshihet në një zonë me prirje të vazhdueshme në ulje, ku trashësia e depozitimeve kuaternare arrin deri 200m. Një studim i kryer nga S.Zuber (42) shënon një ulje të terrenit nga ujrat. Duke vërejtur edhe sot nivelin e ujrave nëntokësore si dhe gjendjen e krijuar në sheshin para tempullit të Asklepit, duhet të mendojmë një ulje të terrenit në shek.I e.s. Portiku i ndërtuar pranë Prytaneionit është ngritur rreth 20-40cm më lart nga kuota e sheshit, me siguri për shkak të ngritjes së nivelit të ujrave.

Këto lëvizje graduale gjeologjike dhe rritja e nivelit të ujrave nëntokësore kanë qenë një nga faktorët kryesorë në dëmtimin strukturave mbështetëse të themeleve të godinave.

Ndërhyrjet konservuese-restauruse në muraturat e rënojave.

Muraturat e rënojave arkeologjike të Santuarit, paraqitnin difekte të ndryshme, ndaj dhe ndërhyrjet në to duhet të kryheshin sipas rasteve dhe gjendjes së atyshme. Më i domosdoshëm qe konsolidimi i konturit të sipërm të rrënojave, i cili erdh e u krye pjesë-pjesë sipas një programi paraprak.

Përpara fillimit të punimeve, u organizua një konsultë me specialistë të fushës lidhur me konsolidimin e rrënojave. Konsulta ishte e domosdoshme për të vendosur mbi mënyrën e ndërhyrjeve të ardhshme. Gjendja e paraqitur kërkonte masa të menjëhershme dhe ndërhyrje restauruese me teknika bashkëkohore, të cilat do të zëvendësonin mënyrën tradicionale të konsevimit, të përdorur më parë.

Mënyra tradicionale e konservimit të rrënojave konsistonte në mbulimin e konturit të sipërm të rrënojave me një shtresë plisash me bar, të cilat paraprakisht përgatiteshin në formë

DO NOT COPY

kuadrate, duke u prerë nga terreni pranë objektit. Mbulimi në këtë mënyrë i muraturave (fig.20) mbronte konturin e sipërm nga veprimet direkte të agjentëve atmosferikë si dhe pengonte në një farë mase rrëzimin e gurëve të shkëputur nga konturi i sipërm i rrënojës.



Fig. 20. Mënyra tradicionale e konservimit të mureve

Kjo masë konsoliduese e rrënojave kishte filluar të shfaqte anët e saj negative. Me kohë dherat e plisave të vendosura mbi konturin e mureve hidhnin e zgjatnin rrënjë, të cilat depërtonin më pas në zgavrat e muraturave dhe në bërthamën e murit. Gjithashtu, kjo masë e konservimit të muraturave nuk mund të pengonte lagështinë që vinte nga rreshjet e shiut.

Kësisoj u mendua të përdorej një tjetër teknikë konsolidimi. Tenika e re konsistonte në fiksimin e gurëve ose tullave të shkëputura nga struktura e muraturës. Për përforcimin e duhur të strukturave ishte e nevojshme të kryheshin restaurime plotësuese në konturin e sipërm të rrënojave. Kjo duhej bërë me kujdes dhe fillimisht duhej pastruar sipërfaqja e epërme e konturit të mureve nga dherat dhe bimësia (fig.21). Për të mbrojtur muraturat e degraduara ishte e nevojshme të studiohej më parë materiali lidhës



Fig. 21. Mënyra e re e përdorur pë konservimin e rënojave

DO NOT COPY

origjinal si dhe përbërësit e tij; kjo pasi materialet lidhëse të reja nuk duhej të binin në sy në sipërfaqen e murit të restauruar. Nga ana tjetër, mbushjet e jashtme ose restaurimet plotësuese të zgavrave duhet të ishin njëlloj me pjesën tjetër ekzistuese të murit, pa krijuar shqetësime në konfiguracionin e përgjithshëm të tij.

Kjo ishte faza e parë e ndërhyrjeve konservuese-restauruese në rrënojat e Santuarit. Rezultatet pozitive të pikasura menjëherë pas këtyre ndërhyrjeve, çelën perspektivën dhe besimin për të kryer ndërhyrje konsoliduese edhe më të ndërlikuara.

Në fazën e dytë, ndërhyrjet restauruese ishin disi më të vështira dhe kërkonin vëmendje të veçantë. Mund të përmendim të drejtuarit që iu bë në kah vertikal murit lindor të mjedisit nr.2 të Pandokeionit si dhe restaurimin e murit "opus retikulatum" të termës romake, e cila ishte në rrezik shembjeje. Në qoftë se në rastin e parë realizuam vendosjen në kah vertikal të murit, duke e shtyrë atë me krik, pasi ishin të mundura masat mbrojtëse për fiksimin e elementeve origjinale të murit, në rastin e dytë, sipërfaqja e shkëputur e murit nga bërthama konstruktive e tij nuk mund të sillej në pozicionin fillestar, pa e zbërthyer më parë pjesërisht atë. Për këtë arësye, fasada e murit rreth 60 m/², e punuar me teknikën "opus retikulatum", duhej zbërthyer gur për gur, dhe të ringrihej përsëri. Zbërthimi i fasadës kërkonte marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të fiksuar me saktësi të gjitha elementet orietuese në disa modina të vendosura në të dy anët e murit, në mënyrë që të rivendoseshin sërish në pozicionin fillestar të gjitha elementet origjinale të fasadës. Pasi kryem punimet e nevojshme për konsolidimin e strukturës së dëmtuar të muraturës filluam ringritjen e fasadës me materialet lidhëse të reja, gjithë të përgatitura me ngjyrën dhe frakturën e llaçit origjinal.

Muraturat me tulla.

Problem tjetër paraqesin muraturat me tulla, të cilat shpesh janë mjaft të dëmtuara nga erozioni ose të thyera. Në rastet kur tullat origjinale ekzistonin, jemi mjaftuar me rivendosjen e tyre aty ku ato janë gjetur, kurse kur ato ishin plotësisht të dëmtuara ose mungonin, u pa e domosdoshme të zëvendësoheshin me tulla të reja, për të siguruar qëndrueshmërinë statike të muraturës. Për këtë arësye u kryen disa eksperimente dhe përpjekje në gatitjen e tullave të reja me përmasat, ngjyrën dhe porozitetin e tullave antike.

Rezultatet qenë të kënaqshme. Për realizimin e pjekjes së tullave të reja,ndërtuam një furrë pjekjeje, që imitonte një furrë origjinale romake të zbuluar disa kohë më parë në qytetin antik të Durrësit (43).

U mbajt parasysh që tullat e reja të përdoreshin kryesisht për arsye statike ose për rritjen e qëndrueshmërisë së muraturës. Të gjitha ndërhyrjet janë kryer për të qënë të prapësueshme dhe të dallueshme nga muraturat origjinale.

FAZAT NDËRTIMORE SIPAS STRUKTURAVE

Në paragrafët e mësipërm folëm për strukturat e muraturave të ndryshme, të cilat na ndihmuan t'i ndanim në katër grupe:

1. Niveli dhe orientimi i objekteve të veçantë, në raport me objektet e tjera më të zhvilluara ose më pak të zhvilluara.

2. Harmonia në planin e përgjithëshëm të godinës.

3. Veçoritë e strukturës ose ndryshimi i metodave të konstruksionit.

4. Karakteri i materialeve dhe tipet stilistike të muraturës.

Në klasifikimin e ndërtimeve me llaç gëlqere, të cilat fillojnë e shfaqen në shekujt e fundit p.e.s., kemi pasur parasysh cilësinë e materialit të gurit, gëlqeres, kësisoj ndërtimet po të krahasohen për nga materialet që kanë përdorur, dallojnë fort si në hapësirë ashtu edhe në kohë (44).

DOWNLOADED BY

Ende nuk kemi të dhëna ku nxirrej dhe përpunohej çimentoja pucolane që është përdorur në Butrint, por dimë me siguri ku nxirrej guri, një pjesë e të cilit përdorej për gëlqere. Gjurmë të këtyre guroreve gjenden në anën jug-perëndimore dhe perëndimore të vetë masivit të Akropolit (45) (gurët e përdorur në shkallë) (46), ndërsa gurët e bardhë e kompaktë, të përdorur në skenën e teatrit, gjenden në Kepin e Stillos, pranë derdhjes së Vivarit. Që këndej janë marrë dhe gurët për përgatitjen e kubikëve të bardhë për mozaikët, ndërsa guri i zi merrej pranë Muzinës.

Në të vërtetë s'ia dalim dot të përcaktojmë kufijtë e saktë kronologjikë për muraturat me llaç në rastet kur mungon trajtimi sipas teknikave të njohura i sipërfaqes së muraturës. Prandaj për të caktuar një farë kronologjie të objekteve kemi marrë për bazë ndarjen e periudhave kryesore historike të lartpërmendura si dhe teknikat e ndërtimit.

FAZAT NDËRTIMORE SIPAS TEKNIKAVE TË NDËRTIMIT

Së fundi, duke pasur parasysh teknikat e shumta të ndërtimit që janë përdorur në Butrint do të bëjmë dhe një ndarje kronologjike të tyre. Në këtë klasifikim do të kemi parasysh muraturat me blloqe masive guri, të cilat përbëjnë dhe grupin e parë. Grupin e dytë do ta përbëjnë muraturat me llaç e gëlqere. Muraturat e grupit të dytë do t'i ndajmë më tej në:

a. Strukturat që kanë një nukël të brendshëm dhe sipërfaqe të trajtuar me teknika të veçanta.

b. Struktura pa trajtim të sipërfaqes. Këtu hyjnë nënstrukturat, muret e izoluara (të cilat, për nga pozicionini dhe përdorimi i tyre duken si nënstruktura), themelet, harqet dhe qemeret.

Për të dalluar në përgjithësi teknikat e ndryshme, të krahasuara midis tyre, kemi bërë një ndarje të muraturave si më poshtë:

1. Muraturat me blloqe poligonale
2. Muraturat me blloqe trapezoidale
3. Muraturat me teknikën opus incertum
4. Muraturat me teknikënopus reticulat dhe opus mixtum
5. Muratura me strukturën lateracia (opus testaceum dhe opus vitatum)

Për ndarjen kohore të tyre duhet pasur parasysh një karakteristikë e Santuarit të Asklepit së Butrintit. Muraturat poligonale dhe trapezoidale me blloqe masive në murin rrethues të qytetit nuk paraqiten si periudha të ndryshme kohore, madje vende-vende i gjejmë të mpleksura së bashku. Bën përjashtim vetëm muri me blloqe masive guri poligonal, që ruhet pjesërisht në Akropol (fig.22). Ky fragment muri lidhet me



Fig. 22. Muret në Akropol (poligonale)

fortifikimin e majës më të lartë të kodrës, që më vonë shërben si akropoli i vendbanimit të atjeshëm. Ka gjasë ndërtimi të jetë i shek.V (47), por jo më herët, siç i klasifikonte Ugolini (48).Të këtij mendimi janë dhe studiues të tjerë, të cilët janë marrë me fortifikimet në Butrint (49).

Përdorimi i teknikës poligonale dhe trapezoidale në dukje të një kohe, për mendimin tonë duhet të lidhet me shfrytëzimin me nikorqillëk të materialit të gurit.

Për t'i shtrirë në kohë teknikat e lartpërmendura, duke pasur parasysh format

DO NOT COPY

DO NOT COPY

arkitektonike, nivelet, strukturat, ndryshimet e stilit në fasadë, karakterin e materialit etj, jemi rrekur të bëjmë këtë ndarje kohore të muraturave:

1. Tenika poligonale dhe trapeziodale, shek.IV-III
2. Teknika opus incerium, shek.II-I para erës sonë
3. Teknika retikulatum, shek.I p.e.r-shek.II e.r.
4. teknika opus mixtum, shek.I-II e.r
5. Tenika lateracia, shek.I-III e.r.

Teknikën e parë e hasim në muret e rrethimit të Santuarit si dhe në muret e tarracimit të tempullit mbi teatër, abaton dhe në teatër brenda (fig.23).





Fig. 23. Teknika trapezoidale dhe poligonale.
a) Muri taracimit të tempullit
b) Muri taracimit pranë Prytaneionit.

Teknikën e dytë e gjejmë në objektin e emërtuar Pandokeion dhe pjesërisht në Prytaneion.

Teknikën opus mixtum e gjemë në objektin në perëndim të Santuarit (Prytaneion), në banjën romake pranë teatrit dhe te gjimnazi (fig.24).



Fig. 24. Teknika "opus mixtum"

Teknikën retikulatum e gjejmë të përdorur rëndom thuajse në të gjitha objektet (fig.25).



Fig. 25. Teknika "opus retikulatum"

DO NOT COPY

Teknika e fundit, struktura lateracia, është përdorur vetëm në banjën romake dhe te gjimnazi. Kjo teknikë përdorej kryesisht në ato muratura,që duhet t'i qëndronin temperaturave dhe lagështisë (fig.26).



Fig. 26. Struktura lateracia

E ngjashme me këtë teknikë (ku në vend të tullës përdoret guri në formë pllakash, i nxjerrë nga shtresa të holla të guroreve) është muratura e emërtuar "opus vitatum", të cilën e gjejmë të përdorur kryesisht në teatër dhe në tempullin e Eskulapit. Kjo teknikë është mjaft e përhapur në Italinë Qendrore e Veriore si dhe në provincat romake.

Njihen tre tipe të teknikës opus vitatum, të përdorur në Butrint:

1. Tipi i thjeshtë, i formuar vetëm nga pllaka guri, të vendosura në linja të rregullta (fig.27 a).
2. Tipi mix, i kombinuar me gurë e tulla (fig.27b).
3. Tipi me përpunim të fasadës, ku tullat vendosen vertikal ose pjerrët, gjë që e shohim tek Pandokeioni dhe gjimnazi (fig.27c).

Muraturat e tipit të fundit përbëjnë dhe ndarjen e fundit kohore të të ashtuquajturave "teknika romake". Pas kësajperiudhe, muraturat humbasin karaktaristikat stilore që cituam dhe arsyet janë të lidhura me rënien ekonomike e



Fig. 27. Teknika "opus vitatum" (a.b.c)

kërkesat estetike, por kryesisht këto muratura vijnë e shfaqen si ndreqje, rikonstruksione ose mure të ndërtuara fill pas tërmetit të përmendur në vitin 358. Prandaj këto mure janë grupuar si muratura pa trajtim në fasadë.

Në përfundim mund të themi se studimi i elementeve strukturore, ndarja kohore e periudhave dhe karaktaristikat stilore të mureve qenë më se të domosdoshme në përgatitjen e projektit të punimeve restauruese-konservuese.

Dallimi i fazave të ndërtimit gjatë ndërhyrjeve tona konservuese u realizua për të ruajtur konfiguracionin e tyre zanafillor, duke plotësuar pjesë të veçanta në mënyrë të dallueshme nga origjinali ose duke përforcuar gjurmët e tyre origjinale.

Konservimet në strukturat arkeologjike kanë qënë një objekt i një pune të gjatë dhe të kujdesshme, më se njëzet vjeçare. Problemet e konservimit, që kanë dalë vazhdimisht gjatë ndërhyrjeve tona restauruese, janë bërë herë pas here objekt i konsultave dhe diskutimeve në disa sesione shkencore, të organizuara në Sarandë (50) dhe Tiranë (51).

Praktika botërore e përdorimit të një numri metodash të bazuara në konservimin nga pikëpamja e ngopjes së konstruksioneve me substanca kimike (poliuretanë dhe rezina, solucionë polimerike e substanca të tjera) është parë me vend rezerva të mos përdoret, duke njohur pasojat negative gjatë përdorimit në vende të tjera si në Itali, Maqedoni etj.

Rrjedhimisht, për konsolidimin e konstruksioneve me llaç gëlqere kemi parë më të arsyeshme përdorimin e gëlqeres së stazhionuar (në disa raste e përzier me përqindje mjaft të vogël çimentoje). Për të rritur jetëgjatësinë e këtyre ndërhyrjeve, kemi marrë gjithmonë parasysh faktorët klimatikë, qarkullimin e natyrshëm të lagështisë dhe avullimin e nevojshëm, që quhet "frymëmarrja e murit".

Kjo rrugë kërkimesh ka kaluar nëpërmjet studimeve të objekteve të veçanta,që përmendëm e më pas në ndërhyrjet konsoliduese e restauruese,duke qënë ky një proces i vazhdueshëm, i përhapur edhe në përvojën botërore. Duke vëzhguar me kujdes gjendjen e rrënojave arkeologjike, jemi prirur kah mendimi për të konsoliduar. Përgjigja mbi ardhmërinë e punimeve restauruese, si në çdo rast, nuk mund të jetë një formulë. Dalja e plotë në dritë e rrënojave ende të pazbuluara plotësisht si fjala vjen termat romake pranë teatrit, gjimnazi etj., do të krijojnë kushte të reja dhe perspektiva për ndërhyrje restauruese edhe më të gjera.

Zbulimet në këtë sektor do të ndihmojnë në radhë të parë për shpjegimin e mjaft problemeve të historisë së arkitekturës, urbanistikës dhe jetës së kësaj qendre qytetare. Së dyti, zbulimet e reja do të hapin një tjetër sektor për vizitueshmërinë dhe interesat shkencore e turistike ndaj Butrintit. Materialet arkeologjike dhe studimet e arkitekturës urbane, do të jenë një bazë e re, jo vetëm për historinë e kësaj të fundit, por do të pasurojnë stendat e muzeut të ri, që po rindërtohet në Butrint.

Në përfundim mund të themi se kërkimet tona në Santuarin e Butrintit janë një ndihmesë për të plotësuar me fakte të reja mangësitë në njohjen e fizionomisë dhe zhvillimet të arkitekturës së qytetit antik të Butrintit.

---

35. Elementët e strukturave tra-kollonë paraqiten mjaft elegante nga ana estetike, por delikate nga ana konstruktive. Çdo element i saj si arkitraret, frontonet etj., do të humbisnin qëndrueshmërinë për një nga shkaqet që përmendëm dhe deformimet e krijuara, do të prishin ekulibrin.

36. Në këtë artikull po paraqesim rikonstruksionin hipotetik të skenës së teatrit, në periudhën romake dhe proporcinet e saj, i cili bën pjesë në studimin teatrit antik, ende të pa botuar.

37. Ekziston edhe një rrezik tjetër, ku gëlqerja është përdorur në muret e trasha. Në disa raste ajo mbetet e pakarbonizuar në brëndësi të mureve. Një fenomen të

DO NOT COPY

DO NOT COPY

tillë e kemi ndeshur në sektorin perëndimor, ku muraturat e vona janë veshur anash mureve, pa eleminuar lagështinë e tyre.

38. Janë përcaktuar disa kritere të përcaktimit të shkaqeve kryesore të dëmtimit të objekteve duke unisur nga konfiguracioni i çarjeve të dukshme në muraturë:

- Çarje tërthore të murit, që çfaqen tre tipe, shkaktohen nga difektet në themel.

a. Tipin e parë e përbëjnë çarjet që duken mbi sipërfaqen e murit, të shkaktuara nga përkulja e murit jashtë qëndrës së gravitacionit.

b. Çarje të ekstremiteteve (që duken njëherësh në dy ekstremet ku lidhet muri) shkaktohet kur muri ka pësuar ulje në lidhje me muret tërthore ose ndarëse.

c. Çarje në pjesët fundore, që shkaktohen nga ulje të terenit.

e. Çarje diagonale, rezultojnë përgjithësisht nga peshimi jo i barabartë.

f. Çarje që çfaqen në formë gërshërë, shkaktohen nga mbështetjet e muraturave shtesë, mbi konstruksionin ekzistues.

39. E.Sulstarova-S.Koçiaj, Katalogu i tërmeteve të Shqipërisë, Tiranë 1975.

40. Xh.Hasani, Mbi pasojat e tërmeteve në qytetin e Butrintit, "Monumentet" 1989/2 fq.125-133.

41. E.Sulstarova-S.Koçiaj,Sh.Aliaj, "Rajonizimi Sizmik i RPSSH", Tiranë 1980.

42. S.Zuber, Descriziona geologica della zona di Butrinto. "L, Acropol di Butrinto" fq.271-278.

43. Guri Pani, Lazër Papajani, Një furrë antike në Durrës dhe probleme të zhvendosjes së saj, "Monumentet"1986/1 fq.15-22.

44. Në periudhën nga shek.I deri në shek.II në monumentet e ruajtura në Pompei, janë bërë klasifikime të sakta jo vetëm nga kualiteti i llaçit e teknikat e muraturave, por edhe nga ngjyrat e intonakeve të muraturave të suvatuara, të cilat në periudhën e Adrianit bëhen kryesisht në ngjyrë të kuqe.

45. L.M.Ugolini, L'Acropol di Butrinto, fq.10.

46. K.Zheku, Gurorja e Shkallës, BUSHT, seria "Shkencat Shoqërore" Tiranë 1963,1, fq.228-232.

50. G.Pani, Probleme restaurimi në fortifikimin e Butrintit, Probleme restaurimi në qytetin antik të Butrintit Almanak 1dhe 2, Sarandë 82.

51. G.Pani, Probleme restaurimi në monumentet antike të vendit tonë. Simpozium org. IMK,1986.

DO NOT COPY

SANCTUARY IN BUTRINT
(Compositional and architectonic solution)

The monuments uncovered in various periods in Butrint provide many important data for a more extensive study of the architecture, town-planninu, technique of construction ctc.

Bringing to evidence the architectonic composition of the Sanctuary of Asklep, its evolution in time and the restoration work made in it, are the aspects dwelt wpon in the article.

Space of sanctuary,s development

The special studies made for ancient boulevards, temples, the political factors the mutual exchanges with the neighbouring" territories etc., provide an auxiliary material for the creation of a general vision on particular elements of this composition.

The sacred sector in Butrint emerged very early, much earlier than the temples were constructed. The ancient time of Sanctuary is related with the first belief ot the residents in the forces and elements of the nature as was the spring in the rift at the foot of the Acropolis large mass of rock (fig.2) where later the temple of Asklep was built. The temple of Asklep was made under the influence of the iconography of the Olympian gods brought to Butrint by the royal family of Molose.

In quite a functional mode with the temple of Asklep was another construction which we will refer to as "Eukomesis abaton". The archeological excavations of 1982 uncovered also another very important element in the entrance of the object as was the water spring linked with the functioning of this construction. This very significant element for this religious object orientated us in defining the function of the object and the reason why it was constructed precisely in that place.

Now it is clear the relationship of the temple of Asklep with "abaton" or the healing portico. The latest excavations bring forth information dating the object back to the beginning of the 3d century before our era or the late 4th century before our era.

The sick people who came to Asklep had to carry out the procedure, passing the road of processions, etc., with the aim of being healed by the God. When pilgrims reached the abaton having completed the processions, they used the water at the entrance for cleaning. According to prays, cleaning and sacrifices, the sick people had to stay the test of the religion and prepare their spirit to meet with the God. After the spirit test, the last moment called "enkomeisis" arrived. The priests directed the invalids to this building called "abato" where they stayed overnight.

As centuries passed, the development of medicine started to shake the belief and the Butrint sanctuary, like other Askleps in the ancient world, risked to lose its protectors. To this end, some changes were made. They consisted in maintaining the processes before the last mo-

ment called "encomeisis". Before this moment, the priests asked the sick people to tell them of the pains they had and the priests gave them advice, certainly asking from the sick person to come to the Sanctuarv frequently lfence.

Hence, the Sanctuary did not remain only a religious centre but it also developed as a healing centre. The thermal springs and baths with cold and warm water which were built later and other facilities such as those for performances, physical training, etc., created the possibilities for the Sanctuary not to be ruined.

Until the end of the 4th century ot our era, the pilgrims went to the Sanctuary hoping to be cured there. The incursions of gotes destroyed it and later the fanaticism of the new emerging religion with Christianity had no longer respect for ancient works.

The historic development of the religious centre was, without doubt reflected in architecture as well, hence in the continuous evolution of the concept of the composition of this centre in general and the new objects which would complete it in particular. The study of the buildings which make up the ensemble, such as the Temple of Asklep, Prytaneioni, Abaton and later the Theater, the Portico with pillars, the thermal springs of the gymnasium helped people understand the criteria of the construction and the composition of the airchitectonic ensemble. The technique of the Hellenic period and Roman period was followed with distinguishing stylislic particular features.

Methodology for the construction and restoration of the sanctuary

The measures for conservation have been based mostly on the fundamental criteria of interventions for restoration in ancient ruins.

The basic principles of the conservation applied have bcen organised in the following directions:

a. The structural aspects ot the objects
b. The causes of damage
c. The stages of construction
d. The restorations work and specific techniques

I: STRUCTURAI ASPECTS, without neglecting the other factors, have been observed in two directions: the uverburdening of the structures and the deformations from seismological tremors. The ancient structures we see in the Butrint Sanctuary are presented as follows:

- The structures in stone blocs - (Temple 1st stage, Theater, Abatoni)
- The structure with lime mortar - (Temple, 2nd stage, Theater Stage)

Classification in the study of the historic development of the structural forms of the walls with lime mortar has been based initially on the architectonic forms preferable for the time. The component elements which are disputable, have been divided in several groups, such as the walls, the pillars (the beams and arch beams) the arcs, the vertical supporting elements and the foundations. Then, we considered the various groups of the buildings in general classified according to the stages, from the simpler forms to most complex ones. The stone blocs of the trapezoidal, polygonal and quadratic shapes of the earlier ancient stages have specific problems of consolidation as compared with later walls which have lime mortar as the linking element. This is noticed in the very solid structures of the theatre stage and in the walls of the Temple of Asklep of the Roman period. In a worse state is the situation of the walls in the southern and western sections of the Sanctuary.

The causes of the damage of the walls are:

- Damages from natural factors (quakes, erosion, humidity)
- Damages from construction defects (overweight, choice of the building material)
- Damages from later constructions, added after the ruin of the Sanctuary.

DO NOT COPY

On the basis of these observations was made later the consolidation and restoration work in the wall ruins of Pajtineion, Pathokeion, and supplementary restoration work, with new bricks made in Butrint, with the old technology, in order to maintain the dimensions, the colour and the signs of the original bricks

b. The columns

There was an extensive use of stone columns in the constructions. We have inherited only some segments of columns which we re-used as building material in the walls of the later periods.

The aim of their disappearance must be linked with the collapse of the constructions due tn seismological tremors the defects of the stone material with which they were made of as well as with the changes of tastes in architecture. The use of brick columns in a second stage must be linked with the lack of the proper material for the construction of the stone columns.

The walls made to fill in the spaces between the brick columns is perhaps linked with their damaging from seismological tremors and the gradual reduction of the importance of the religious centre.

c. The arches and ribs

The restoration work in the arches of the theater stage and the rib of the temple of Asklep were realised after structural observations were made to ensure the static stability of the constructions. The restoration work eliminated to the greatest extent the causes of their damage.

d. Foundations

A study made by S.Zuber points out a lower level of the terrain. By observing also today the level of the underground waters compared with that of the 70s, we may distinguish an elevation in their level. These gradual geological movements and the presence of waters have harmed to a certain extent the supporting structures of the foundations in the sector close to the theater.

The seismological tremors have left traces in many ruins but in general their situation does not present any urgent need for intervention.

Conclusions

The studying of various structures offered us a lot of information which helped prepare the project of restorations. The outstanding techniques of the constructions were fixed in the situation of their protection according to the structural constructions classified into two groups:

a. *Structures with inner nucleus and surface treated with special techniques*
b. *The structure without treatment of the surface.*

The techniques of construction, taking into consideration the architectonic forms and stylistic peculiarities and the character of the material used, fall into:

a. *Walls with massive stone blocs*
b. *Walls with the use of pucolana cement and other linking materials.*

The conservative interventions were made by leaving in evidence the phases of construction and their original configuration. In order to ensure a long life for these interventions, the climatic factors, humidity and other factors have been taken into account.

By making a careful balance of the situation of the archaeological ruins, we support more opinion in favour of eventual consolidations and less that for supplementary restorations.

DO NOT COPY

Prof. Dr. Valter SHTYLLA (*Tiranë*)
Dr. Zhivojin VINÇIÇ (*Shkup*)

TRASEJA E VIA EGNATIAS NËPËR SHQIPËRI DHE MAQEDONI

DO NOT COPY

Hyrje

Një nga pikat e marrëveshjes, për bashkëpunim ndërmjet institucioneve për mbrojtjen e monumenteve të kulturës së Shqipërisë dhe Maqedonisë, ishte miratimi dhe realizimi i projektit kërkimor në lëmin e trashëgimisë së kulturës materiale. Ky projekt mban emrin: "Traseja e Via Egnatias nëpër Shqipëri e Maqedoni".

Në ekspeditën e udhëhequr nga Prof. Dr. Valter Shtylla dhe Dr. Zhivojin Vinçiç -kështillëtar shkencor, morën pjesë: Mensur Bezhani - topograf, Bllagoja Pejkovski dhe Franc Guralumi – arkitektë dhe Mile Velçovski - arkeolog. Në pajtim me programin, duke kombinuar vrojtimet arkeologjike e topografike me sondimet kontrolluese, projekti u realizua në këtë mënyrë: Në datat 13-18 Shtator 1994 dhe 15-25 Tetor 1995 kërkimet u zhvilluan në Maqedoni dhe në datat 5-12 Shtator 1996 kërkimet u zhvilluan në Shqipëri.

Detyra parësore e projektit tonë kërkimor ishte përcaktimi i mbetjeve nga të gjitha elementet e ndërtimit të rrugës: kalldrëmi, muret mbështetëse e rrethuese dhe karakteristikat paralele e morfologjike. Të gjitha këto veprime duhej të shoqëroheshin me dokumentim të plotë teknik e fotografik. Gjatë realizimit të projektit kaloi në plan të dytë interpretimi i burimeve themelore dhe aktuale, mendimet e kundërvëna në lidhje me gjatësinë e disa pjesëve të rrugës si edhe identifikimi e saktësimi në terren i disa toponimeve. Kalimi i këtyre detyrave në plan të dytë u bë për arsye të mjeteve të shumta dhe kohës së gjatë që kërkonte realizimi i tyre.

Interesi ynë shkencor për studimin e kësaj traseje antike lidhet dhe me nevojën e projektimit aktual të një transversaleje ballkanike me pothujase të njëjtën shtrirje. Kjo transversale ka në pikat e saj ekstreme bregun e Adriatikut dhe atë të Detit të Zi, prandaj studimi mbetet aktual dhe me vlera.

Të dhëna historike

Ndërtimi i transversales ballkanike, Via Egnatia, u pa i domosdoshëm menjëherë pas luftërave Ilire (më 228 dhe 219) dhe maqedonase (më 215, 200-197 dhe 171-167). Shndërrimi i Ilirisë e Maqedonisë në provinca romake gjatë shek. II të erës së vjetër, solli një rindarje territoriale në rajonin e gjerë të Ballkanit dhe u shoqërua nga inkuadrimi i vendeve të pushtuara

DO NOT COPY

në skemën administrative e fiskale të perandorisë romake. Ndërtimi i rrugës Egnatia do të hapte rrugën e komunikimit ndërmjet metropolit (Roma aetern-ae) dhe provincave ballkanike[1]. Roma e ndërmori ndërtimin e kësaj rruge menjëherë pas pushtimit të Maqedonisë në vitin 148 para Krishtit, duke u mbështetur në drejtimin e rrugës së vjetër ballkanike që kalonte ndërmjet Adriatikut e Egjeut. Rruga e re dhe e modernizuar ka shërbyer në mënyrë aktive për një funksionim më të mirë të administratës dhe ekonomisë rajonale romake. Fakti që rruga ka qenë një nga arteriet rrugore më të frekuentuara të shtetit romak i jepte asaj një rëndësi të madhe kulturore duke i krijuar perandorisë romake mundësinë e përhapjes së kulturës romake në trevat e përshkuara nga kjo rrugë[2]. Po nga e ka marrë emrin kjo rrugë romake? Në vitin 1974 në aluvionet e lumit Galikos pranë Selanikut u gjet një gur miljar i kësaj rruge (fig.a). Në këtë gur i gdhendur në latinisht dhe greqisht, lexohet emri i Prokonsullit të Maqedonisë, Knaesus Egnatius, biri i prijësit romak Gaius si dhe është shënuar edhe distanca prej 260 miljesh ndërmjet Dyrrachionit dhe Tesalonikut. Ky shënim në gur i shtetarit më të lartë romak të Provincës së Maqedonisë, nën kujdesin e të cilit u ndërtua kjo rrugë, qartëson faktin historik se punimet për Via Egnatian janë kryer në periudhën republikane ndërmjet viteve 146 dhe 143 p.e.sonë dhe pikërisht në fillimet e Prokonsullatit të Egnatiusit në Maqedoni, pas vitit 148 p.e.sonë kur romakët shtypën revoltën e Andriscos në Maqedoni, e cila u kthye në provincë romake[a].

Çdo ndërrmarrje që kishte të bënte me rrugën, duke filluar nga ndërtimi në tërësi e deri tek riparimi i pjesëve të shkurtra, ka qenë nën kompetencën e perandorit (Cura Viarium) gjë që na le të kuptojmë rëndësinë e saj. Organizimi i drejtpërdrejtë dhe përkujdesja për rrugët kryhej nën mbikëqyrjen e shefit suprem të komunikacionit (praefectus vehiculorum). Një rëndësi të veçantë mori gjatë kohës së Augustit shërbimi për lidhjet (cursus publicus) që realizonte shërbimin postar (cursus celer dhe cursus clabularis). Ndër personat e ngarkuar me mirëmbajtjen e rrugës duhet të përmendim inspektorët rrugorë, selitë e të cilëve ndodheshin në stacionet përgjatë rrugës. Një grup tjetër personash që ishin njëfarësoj përgjegjës për trasimin dhe ndërtimin e rrugëve kanë qenë edhe mensores. Këta bënin pjesë në legjionet romake dhe midis të tjerave kishin për detyrë matjen e rajoneve të pushtuara me qëllim inkuadrimin e tyre në hartën e perandorisë.

Një informacion që na ndihmon të njihemi me mënyrën e përdorur për matjen e rrugës së përshkuar na vjen nga Vitruvi - arkitekt i njohur që ka jetuar në kohën e Gaj Jul Cezarit dhe Cezar Oktavian Augustit. Sipas Vitruvit, për këtë qëllim përdorej një aparat i përbërë nga dy torza dhe dy recipientë që mbanin gurët, 400 rrotullime të torzës së poshtme i korrespondonin një rrotullimi të torzës së sipërme. Në këtë rast gjatësia e rrugës së përshkuar do të ishte 5000 shputa (një shputë romake = 0,2963 m) – një mijë hapa të dyfishtë ose një mila passum (Mp). Për të llogaritur gjatësinë e rrugës mjaftonte të numëroheshin gurët e rënë në enën e poshtme.[3]

Gjatë organizimit kompleks të rrugës, romakët kanë shfrytëzuar përvojën e vendeve lindore dhe mesdhetare, tradita e të cilëve e kalonte atë romake me rreth 5 shekuj. Fakti që Via Egnatia ka paraqitur lidhjen më të shkurtër ndërmjet Gadishullit Apenin dhe Azisë dëshmohet nga mënyra racionale e trasimit të saj[4]. Via Egnatia paraqiste komunikacionin më të rëndësishëm ndërmjet bregut të Adriatikut dhe brendisë së Ballkanit, veçanërisht gjatë fazës së vonshme të republikës dhe fazës së hershme të perandorisë. Për këtë arsye ajo u inkuadrua menjëherë në rrjetin e organizuar rrugor që romakët kanë ndërtuar ose riparuar në Itali dhe provincat e tjera të perandorisë (Via publicae populi romani). Via Egnatia lidhet me Via Apia që lidhte Romën me Kapuan dhe që u ndërtua në

vitin 312 nga censori Apie Klaudio. Vazhdimi i rrugës deri në Egnatia, Tarent dhe Brundizij nga ku bëhej dalja në Dyrrachionin ilir buzë Adriatikut, është bërë më vonë [5].

Në tempullin e Saturnit që ndodhet në forumin romak ("Forum Romanum") ka qenë vendosur milatreguesi fillestar – zero (lapis miliarus) i njohur edhe me emrin milatreguesi i artë (miliarus aureus). Nga kjo pikë nisnin të gjitha rrugët nëpër të gjithë drejtimet e eikumenave të atëhershme. Kjo vendosje i dha zanafillën shprehjes: "Të gjitha rrugët të çojnë në Romë"[6]. Edhe autori i Tabula Pojtingeriana-s e fillon nisjen nga i njëjti vend i forumit romak.

Via Egnatia është përshkuar në të dy drejtimet nga karvane me mallra, tregëtare, udhëtarë, ushtarë, avanturierë etj., që karakterizoheshin nga përvoja, zakone, njohuri e besime të ndryshme. Këta njerëz, duke këmbyer mallrat dhe vlerat e tyre morale kanë bërë të mundur depërtimin e tyre nga njëri skaj i Ballkanit në tjetrin. Megjithatë aktiviteti më i përhapur përgjatë rrugës Egnatia mbetet tregëtia. Dio Kassius tregon se pikat e tregëtisë kanë qenë të përcaktuara saktësisht përgjatë rrugës[7]. Këto vende s'ishin gjë tjetër veçse kampe ushtarake në të cilat tregëtia zhvillohej nën mbikëqyrjen e beneficiarëve. Pavarësisht nga zhvillimi i madh i tregëtisë disa mallra të veçanta nuk e kanë gjetur dot rrugën e këmbimit. Kështu, sipas Tacitit, provincat nuk kanë mundur të eksportojnë kripë, vaj, drithëra, verë, armë, flori si dhe të gjitha mjetet e punuara nga hekuri, si rezultat i proteksionizmit dhe regjimit që mbronte mallrat me rëndësi strategjike[8].

Ndërmjet dy pikave të skajshme, përgjatë Via Egnatias kanë ekzistuar tri kategori stacionesh (staciones ose statmos). Së pari: staciones – civitates, municipium dhe kolona. Përcaktimi i këtyre stacioneve bëhej në varësi të statusit jundik në kuadër të organizimit administrativ perandorak të provincave romake që kjo rrugë përshkonte. Provinca të tilla ishin: Dyrrachion (Dyrrachium), Skampis (Scampa), Lihnidos (Lychnidos) dhe Heraklea (Heraclea Lincestis) si dhe të tjera jashtë rajonit të Shqipërisë e Maqedonisë. Kategoria e dytë e stacioneve ishin mansionet (mensiones) si dhe vendbanime më të vogla se këto me karakter rural, ekonomik dhe fortifikues, të cilat u krijonin mundësi për pushim udhëtarëve. Së fundi vinin stacionet e vendndërrimeve të vendosura jashtë ose në afërsi të vendeve të banuara. Këto stacione shërbenin për ndërrimin e karrocave të kuajve dhe për sigurimin e mjeteve të transportit dhe pajisjeve për kuajt. Një tezë e hedhur kohët e fundit mbron mendimin se për nevojat e këtyre punëtorive rrugore, Roma ka pajtuar një numër të madh farkëtarësh nga Egjipti. Pikërisht për rikthimin e këtyre njerëzve, që supozohen të jenë paraardhësit e motshëm të romëve tanë, ekziston një kërkesë drejtuar pushtetit romak. Për të hedhur dritë mbi disa çështje të rëndësishme lidhur me aspektet e ndryshme të ekzistencës së Via Egnatias me interes janë përmendoret epigrafike të zbuluara në afërsi të saj. Një ndër to është edhe mbishkrimi i zbuluar në fillim të këtij shekulli në rrethin e Heraklesë, i cili paraqet një dekret për ndërtimin e disa rrugëve. Ka të ngjarë që ky dekret të jetë lëshuar nga pjesëtarët e fisit Antanon që mbuluan një të tretën e shpenzimeve në këtë ndërmarrje[9].

Milatreguesit janë gjithashtu një pjesë me interes të veçantë. Ata pak milatregues që janë gjetur, kanë qenë të vendosur pranë rrugëve dhe informojnë për tërë corsus honorum-in e perandorit në kohën e të cilit është ndërtuar ose riparuar rruga. Duke shënuar numrin e milave romake deri te stacioni fqinjë, milatreguesi tregonte vetëm distancën nga një destinacion i caktuar, por jo drejtimin e shtrirjes së trasesë së rrugës. Përcaktimi i këtij drejtimi lihej në dorën e udhëtarëve. Një milatregues i tillë është ai i zbuluar në Strugë, i ndërtuar në kohën e perandorit Karakala, 211-217 (Imp. Caesar Marcus Aurelius (Severus) Antoninus Augustus) me largësi prej VIII MP deri në Lihnidos. Burimi

DO NOT COPY

më i vjetër që vërteton ekzistencën e komunikacionit antik Via Egnatia është milatreguesi i zbuluar në afërsi të Selanikut (Thessallonice) rreth VII mila në perëndim të lumit Galikos. Mbishkrimi daton nga gjysma e dytë e shek. II p.e.s dhe në të është shënuar emri i Via Egnatias dhe gjatësia e saj nga Dyrrachioni deri në Thessallonice-CCLX MP[10]. Ndër të tjera, pranë rrugëve ka pasur edhe vende vëzhgimi (speculae) që kanë qenë objekte të vetmuara fortifikuese me personel të armatosur. Detyra e këtij personeli ka qenë të siguronte një pjesë të caktuar të rrugës nga plaçkitësit dhe kriminelët.

Identifikimi i pjesës më të madhe të trasesë nëpër Shqipëri e Maqedoni në sajë të kontributit tonë, krijon kushtet për studimin e mëtejshëm të ndërlidhjes së saj në tërësi gjatë gjithë Gadishullit Ballkanik. Gjithashtu ky identifikim luan rol të rëndësishëm në saktësimin e një pjese të mansioneve dhe mutationes, pasi përcaktimi i tyre vështirësohet nga prania e dy apo më shumë toponimeve në të njëjtin lokalitet.

Via Egnatia si transversale antike ballkanike përmendet në shumë gjeografi antike dhe të mëvonshme nga shumë kronistë, historiograk dhe udhëtarë, por burimi kryesor për studimin e trasesë së saj dhe stacioneve të veçanta mbeten itineraret dhe Tabula Pojtingeriana (Tabula Peutingeriana). Kjo e fundit paraqet kopje të një harte gjeografike të Romës së vonshme (Itinerarium Pictum) në të cilën janë prezantuar vendet nga Spanja në Indi. Harta e ka marrë emrin nga zotëruesi i saj Konrad Pojtingeri (1485-1547) nga Augsburgu. Sot harta gjendet në Bibliotekën Kombëtare të Vjenës (Osterreichische Nationalbibliotek in Wien). Veçoritë paleografike dëshmojnë se harta është punuar në shek. XII ndërsa si bazë ka shërbyer origjinali që daton nga shek. III i erës sonë. Edhe kjo hartë e dytë mendohet të ketë pasur si shembull "Orben Terrarum, orbi spektandum" -hartën e botës të hartuar nga Agripa (Marcus Vispanius Agrippa)-bashkëkohës i Augustit dhe kozmograf i tij. Kjo hartë është përdorur nga gjeografët, kartografët dhe përshkruesit e mëvonshëm antikë, ndër të cilët edhe kozmografi dhe filozofi romak Kastorius gjatë gjysmës së dytë të shek IV. Ky personalitet përmendet si autor i mundshëm i Tabulës[11]. Rotulusi i ruajtur i Tabulës është i ndarë në 11 fletë pergamenë me një gjatësi të përgjithshme prej 6.75 m dhe gjerësi prej 0.34 m. Prezantimi i përgjithshëm i Tabulës ka karakter piktografik. Në këtë mënyrë rrugët paraqiten me ngjyrë të kuqe, toka me ngjyrë të verdhë, malet me ngjyrë hiri, të verdhë dhe rozë ndërsa detet dhe lumenjtë të gjelbër. Stacionet më të rëndësishme (Dyrrachion, Lychnidos dhe Heraclea) janë shënuar me kullë të dyfishtë. Simbole përkatëse janë përdorur edhe për banjat dhe tempujt. Largësia ndërmjet stacioneve, të cilët përmenden me emra, është shprehur me numra romake në mila passum (milia passum)-njëmijë dyhapëshe e barabartë me 1482 metra.

Pavarësisht nga rëndësia e madhe e Tabulës, shkenca bashkëkohore e trajton disi me skcpticizëm këtë burim. Për shkak të projeksionit të zgjatur ose zig-zag ndodh të mos respektohen pikat e orientimit të botës, por harta respekton nga ana tjetër drejtimin perëndim-lindje si dhe deformimin e tokës. E njëjta dukuri ndodh me paraqitjen e lumenjve, maleve dhe deteve, gjë që shkakton mungesë saktësie si në orientimin e përgjithshëm ashtu edhe në përcaktimin e distancës ndërmjet disa destinacioneve. Plotësimet dhe ndërhyrjet që u takojnë kohëve të mëvonshme, janë shprehur në gjuhën e toponimeve dhe numrave, gjë që e bën shumë të vështirë përputhjen e hartës me gjendjen në terren në tërësi.

Nga Roma deri në Bizant, Tabula Pojtingeriana përgjatë Via Egnatias paraqet këto stacione: Dyrratio XV, Clodiana XX, Scampis IX, Genesis fl. VII, ad Dianam IX, Canadavia IX, Pons Servili XIX, Lygnidus XVI, Stacion i paemër, Nicea XI, Heraclea XXXII, Cellis XLV, Edessa XLV, Pela XXVII, Thessallonice. Duke mos

DOKTORATË

DO NOT COPY

përfshirë të dhënat për stacionin e paemër gjatësia e përgjithshme e rrugës ndërmjet Romes e Bizantit është 264 MP, përkatësisht 390.7 km.[12] (fig.1).

Itinerarium Antonin (Itinerarium provinciarium Antonini Augusti) fillimisht është krijuar në kohën e ndonjërit prej mbretërve romakë Antonin gjatë shek. III. Ekziston mendimi që ky itinerar ka qenë pjesë e shkëputur nga ndonjë hartë romake në të cilën kanë qenë të shënuara rrugët dhe se po kjo hartë e cila s'ka patur karakter zyrtar[13], ka qenë burim i itinerarit që ka përdorur autori i Tabulës.

Pa marrë parasysh plotësimet e mëvonshme ky itinerar numëron disa stacione të Via Egnatias si edhe të rrugës Larisë – Selanik. Itinerari përmban 17 kapituj nga të cilët interes për studimin tonë paraqet kapitulli X (Via Dyrrachium-Vizantium) sepse kjo rrugë përshkon afërsisht trasenë e Via Egnatias pavarësisht se mban emër tjetër. Autori i itinerariumit në territorin e Maqedonisë përmend vetëm Lychnidos XXVII, Scirtiana XXVII, Castra VI dhe Heracleia (fig. 2).

Largësitë janë shprehur në mila passium. Interesant është fakti që disi më poshtë për të njëjtën pjesë rrugë është bërë ndërrimi i emrave të stacioneve dhe i largësive si vijon: Lychnidos XXVII, Niceà XXXIV, Heracleia. Llogaritë e bëra në bazë të ndryshimit tregojnë se distanca ndërmjet Lychnidos-it dhe Heracleia-s arrin LXI mila passium pra 90 km[14], gjë që nuk përkon me distancën e vërtetë prej 66 km.

Një itinerar tjetër që vlen për t'u përmëndur është Itinerarium Bordigalensis ose Itinerarium Hierosolymitanum, i cili daton në vitin 333[15]. Në këtë itinerar stacionet janë renditur nga lindja në perëndim dhe janë kategorizuar në civitates, mansiones dhe mutationes. Në këtë mënyrë saktësohet statusi i secilit stacion ndanë rrugës. Rruga që përshkon Maqedoninë përmban: civitat Heracleia XIII, mutatio Parambole XII, mutatio Brucida XIX, finis Macedoniae et Ephyri, civitat Cledo XII, mutatio Patrae[16]. Sipas këtyre të dhënave Lychnidos njihet me emrin Cledo dhe largësia është 24 mila passum – përsëri e pasaktë. Të gjitha sa u thanë më lart na çojnë në përfundimin se jo vetëm dy itineraret dhe Tabula Pojtingeriana nuk pajtohen së bashku, por ne nuk mund të gjejmë një përputhje të saktë ndërmjet secilit prej këtyre burimeve dhe gjendjes së vërtetë në terren. Distanca Lychnidos- Heracleia linc është e vetmja pikë ku itineraret përputhen me realitetin. Një përfundim i saktë shkencor mund të arrihet vetëm në sajë të një projekti shumëvjeçar kërkimor në këtë drejtim.

Ptolemeu, një nga gjeografët më të njohur të lashtësisë dhe burim i rëndësishëm gjatë periudhës së hershme mbretërore, veçon vetëm qytetet Heracleia dhe Lychnidos pa përmendur trasenë e kësaj rruge antike[17]. Studiuesi i njohur i antikitetit Petar Lisiçar, kur bëhet fjalë për transversalen më të njohur ballkanike e cila që në kohën e Polibit (shek. II p.e.s – periudha e depërtimit të romakëve në Maqedoni) quhet Egnatiase (Egnatia hodos – Via Egnatia) paraqet të dhënat e Strabonit marrë nga Polibi. Sipas Strabonit: "Nga Apollonia në Maqedoni shpie Egnatia- hodos e drejtuar nga lindja, e ndarë me mila të shënuara me shtylla deri Kipsel dhe lumin Ebron. Rruga është 535 mila e gjatë... Ndodh që për shkak të largësisë së njëjtë në këtë rrugë të takohen ata që janë nisur nga Apollonia me ata që janë nisur nga Epidamnosi. E tërë rruga quhet Egnatia. Për pjesën e parë të rrugës tregojnë se duke kaluar ndërmjet Kandavisë dhe Malit Lirrik, dhe duke përshkuar kufirin ndërmjet Iliridës dhe Maqedonisë ajo shpie në qytetin Lihnidos dhe vendin Pilon. Prej këtej rruga shkon nga Barnunti nëpër Herakle dhe vendet e linkesteve e eordëve drejt Edesës dhe Pellës deri në Tesalonikë. Polibi tregon se këtu ka 267 mile" (Strabo, lib VII, p322; Polyb. XXXIV, fr.12)[18].

Një numër i madh arkeologësh dhe udhëtarësh janë marrë prej më tepër se 200 vjetësh me intepretimin shkencor të burimeve të



Fig.2

DOI 10.3986/


VII.
VIII.
Mesia Inferior
Dardania
Dacia ripensis
Thessalia
Macedonia
Epirus
Duratio (DRAČ)
Theranda (KOD SUVE REKE)
Aulona (VALONA)
Scampis (ELBASAN)
Faliatis (D. MILANOVAC)
Drubetis (TURN SEVERIN)
Scoppis (SKOPLJE)
Lignido
Sertica (SOFIJA)
Tessalonice
Sarmategre
ad aquas
Apula
Petris
Burridava
Pretorio
Stenarum
ad novas
Pomodiana
Camistro
Augtis
ad putea
Sertica (SOFIJA)
Santo
Egirea
Subradice
Stenas (DEMIR KAPIJA)
Idomenia (MILETKOVO)
Heraclea (HERAKLEJA)
Tauriana (DOJRAN)
Gallicum
Cellis (OCTROVSKA B.)
Edessa (VODEN)
Ceramus (DJAVATO) (VAROŠ KOD PRILEPA)
Euristo (DRENOVO)
Ypicea
Meldus
Stopis (GRADSKO-STOBI)
Trampara
Astibo (ŠTIP)
Gurbita
Lignido (OHRID)
Pons Servili
Hadrianopoli
Bersovia
Centu Putea
Caput bubali
Tivisco
Viminatio (KOSTOLAC)
Municipio
Iovis pago
Iclimo
Horrea Margi
Presidio-dasmini
Presidio pompei
Clevora
Vortico
Naisso (NIŠ)
Gramrianis
ad fines
ad herculem (BRESTOVAC)
Scoppis (SKOPLJE)
ad dianam
Genesis fl.
Lapsum fl.
Clodiana (PEKINI)
Scampis
Genesis
Apollonia (POJANI)
Aulona (VALONA)
Amatria
Scrocenario
Rutharoto
ad dianam
Drubetis
Pelendova
Dimustria
Egeta
Cusum
Almo
Remetodia
Katiaris (ARCER)
Timaco Minori
Timaco Maior
Combustra
Romesiana
Turrib
Pelendova
Ad Malum
Ad cephalon
Ad fines
Ad hercule
Presidio
Ad aquas
Ad Media
Pretorio
Faliatis
Scrofulas
Ad novas
Vico cuppe
Ad Cezava
Ad Bosman
Puniicum
Federata
Apo Flamaris
Ad Ricina
Ad Varadia
Ad Cezava
Ad Bosman
Ad Scrofulas
Ad Novas
Ad Vico Cuppe
Ad Federata
Ad Puniicum
Ad Viminatio
Ad Flamaris
Ad Ricina
Ad Varadia
Ad Centu Putea
Ad Bersovia
Ad Caput bubali
Ad Tivisco
Ad Media
Ad Pretorio
Ad Faliatis

DO NOT COPY

vjetra e të vonshme dhe me analizën e Vias Egnatia. Puna e këtyre kërkuesve është përqendruar kryesisht në identifikimin dhe përcaktimin e stacioneve (mutatio dhe mansia) në terren si dhe me verifikimin e varianteve të mundshme të shtrirjes së trasesë së rrugës. Ndër studiuesit që kanë dhënë kontributin e tyre në drejtim të ndriçimit të kësaj vepre të madhe antike mund të përmendim: K. Myler, M.Dimica, Kubicek, K.Piepert, Ch.Etson, Th.L.Fr. Tafel, J.Cvijiq, N.Vuliq, F.Papazoglu, P.Lisiçar, K.Romiopulu, N.Ceka, V.Shtylla dhe L.Papajani. Veprat e këtyre studiuesve janë përdorur gjerësisht gjatë realizimit të këtij punimi.

Suksesi dhe funksionimi i mirë i Via Egnatias duhet parë edhe në faktin që ky komunikacion ishte i lidhur me shumë rrugë të tjera tepër ose pak të rëndësishme të kësaj pjese të Ballkanit në atë kohë. Para së gjithash duhet përmendur lidhja me rrugën që kalonte përgjatë bregdetit shqiptar të Adriatikut. Më pas vijojnë lidhje të tjera si ajo me rrugën që kalonte nga rrjedha e mesme e Shkumbinit për në Dibër dhe rrugën që nga bregu i liqenit të Ohrit kalonte nëpër Pogradec, Korçë e më tej. Duke mbetur në pjesën lindore vazhdojmë të përmendim rrugën për në Uskanë që bashkohej me Via Egnatian pranë Strugës. Në të njëjtin rajon bëhej edhe lidhja e Via Egnatias me rrugën që kalonte në bregun lindor të liqenit të Ohrit. Më në jug hasen lidhjet e Via Egnatias me rrugët që përshkonin brigjet veriore të liqenit të Prespës. Në rajonin e Pellagonisë, përveç rrugëve që kryqëzohen në Heraklea dhe më saktësisht në zonën e Nikesë, Via Egnatia është e lidhur me "rrugën diagonale" që përshkon këto stacione: Heraclea Linc., Styberra (Çepigovë), Ceramiae (Varosh), Euristus ose Euradist pararomak (Drenove), Stobi (pusto Gradsko), me stacion të fundit Bizantion. Njëkohësisht në Stobi, nëpërmjet kësaj rruge diagonale Via Egantia është e lidhur me Via Militaris (Viminacium, Naisus, Scupi, Stobi, Thessallonica).

Për përshkrimin e ngarjeve historike që kanë ndodhur gjatë dhe përreth rrugës Egnatia, para së gjithash në qytetet Dyrrachion, Lichnidos dhe Heraklea Linkestite, do të duheshin shumë vëllime për faktin se në këtë arterie kanë kaluar të mira dhe të këqija me rëndësi të madhe për stacionet ndanë rrugës dhe vendet e shtrira në brendësi të territorit. Për të shpjeguar më qartë kuptimin e të mirave e të këqijave që kjo rrugë ka përcjellë nga njëra trevë e Ballkanit në tjetrën, mjafton të themi që Via Egnatian e kanë përshkuar legjione të shumta romake gjatë marshimeve pushtuese drejt bregut të Danubit si dhe mjaft hordhi barbare gjatë sulmeve ndërmjet mbretërive që kjo rrugë lidhte. Më saktësisht mund të përmendim depërtimin e gotëve të cilët, të prirë nga mbreti i tyre i fundit Teodorihu i madh shkatërruan Stobin e Heraklenë në vitin 479, për të vazhduar më pas drejt Lihnidos-it dhe Dyrrachionit[19]. Qytetet nga kaluan gotët u dogjën e u rrënuan, ndërsa banorët e tyre u vranë ose u dërguan në robëri. Në kohë të tilla lufte fati i rrugëve është shumë i paqartë ndërkohë që urat mund të thuhet me më tepër siguri se kanë pësuar dëme të mëdha. Kështu shumë ura të Via Egnatias ndër të cilat ajo mbi Shkumbin, janë shkatërruar. Periudhat e krizës në masë të madhe janë manifestuar në shkallën e shfrytëzimit të rrugës. Kështu në dallim nga periudha menjëherë pas ndërtimit kur duket se rruga është përdorur me intensitet të madh, në antikën e mëvonshme shfrytëzimi i saj ka rënë[20]. Arsyeja para së gjithash qëndron në krizën e përgjithshme të shprehur në ndryshimet organizative në fushën e prodhimit gjatë dobësimit dhe shthurjes së sistemit skllavopronar.

Traseja rrugore e Via Egnatias e ruajti rëndësinë e saj dhe mbeti aktive gjatë gjithë periudhës mesjetare. Krahas dyndjeve të përmendura të hordhive barbare, nëpër të në shek.IX kanë kaluar normanët dhe kryqëzuesit[21] si dhe basileusi Vasili II gjatë invazionit mbi shtetin bullgar[22]. Në fund të po këtij shekulli,

DO NOT COPY

Aleksie Komneni në udhëtimin e tij drejt lindjes përshkoi këtë rrugë dhe u ndal te Babja në Shqipëri. Më 1257 në këtë rrugë ka kaluar prijësi ushtarak Georgi Akropoliti me qëllim që të shuante kryengritjen në Shqipëri. Në të njëjtën kohë kjo trase ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbretërinë maqedonase të Samoilit dhe ne Arqipeshkvinë e Ohrit.

Këto dëshmi dhe ngjarje të tjera historike të kohës, vërtetojnë mendimin se në kohën e Bizantit rruga jo vetëm që është mirëmbajtur, por në disa vende dhe është riparuar. Krahas ndërhyrjeve të vogla numërohen dhe riparime të dukshme siç është ai i kryer në urën mbi lumin Shemnica, poshtë fshatit Kazhani në afërsi të kastrumit romak (mutatio Parambole). Riparimet e kryera i përkasin kryesisht shtresës së sipërme të rrugës – kalldrëmit. Si të tilla mund të përmendim meremetimet në vendet pranë urave turke në Përroin e Vilzës në Xhyrë, dhe ndërhyrjen e bërë në fazën e dytë të harqeve të urës në Qukës, mbi Shkumbin.

Pas njëfarë rënieje, traseja e Egantias filloi të aktivizohej në vitet e para të pushtimit turk pas vdekjes së Skënderbeut. Nëpër këtë rrugë ka marshuar sulltani Mehmedi II gjatë ekspeditës së njohur drejt Krujës në vitin 1466. Me këtë rrugë, veçanërisht me pjesën Heracleia Linc. – Thessallonice, është i lidhur fati i shumë



Fig. 3. Spatharë



Fig. 4.

kryengritësve dhe luftëtarëve maqedonas të cilët luftuan kundër pushtimit turk. Nga sa u tha, mund të arrihet në përfundimin se pushteti turk ka luajtur një rol të rëndësishëm në përtëritjen e trasesë së Via Egnatias. Ndërhyrjet hasen jo vetëm në pjesën e Qershizës dhe të Rafjeve të Spatharit në Shqipëri (fig. 3), por edhe në segmente të shtrira në Maqedoni (fig. 4), kryesisht në zonën e lumit Openica (Openiçka Reka) dhe të fushës së Caparit (Caparsko Pole) si dhe në Pellagoni.

Zhvillimi i trasesë së Via Egnatias

Pasi kalon Adriatikun te Portat e Otrantit, shtrirja e Via Egnatias nëpër Gadishullin Ballkanik (fig. 5) sipas Tabula Pojtingeriana-s, nis nga qyteti dhe porti antik Dyrrachion, (civitas Dyrratio-Dyrrachium) kryeqytet i Epirit duke iu afruar bregut të detit në drejtim të juglindjes, mbi Kavajë dhe Shkumbin.

Gjatë gërmimeve në vitin 2001 për çlirimin e murit të Kalasë së Durrësit, nën muret e shtëpisë së Pionierit Durrës u zbuluan gjurmët e Golden Gate (Hyrja e Artë), porta e hyrjes e Via Egnatias në Ballkan. Konstruksioni i saj përbëhej në fazën fillestare nga një hark i madh, anash të cilit janë dy më të vegjël. Harku i madh ka qenë me



Fig. 5

DOKTORATURA

DO NOT COPY

hapësirë 9,6m ndërsa dy të vegjlit kanë qenë me hapësira nga 2,5 m. Sot ruhen harku i vogël djathtas dhe fillimi i harkut të madh.

Golden Gote i Dyrrachionit, i shekullit të IV, nga pikëpamja tipologjike, është i njëjtë me atë



Fig. 6

të Stambollit në kalanë Jedikule, ku Via Egnatia hynte në Kostandinopojë (fig.6).

Në udhëkryqin e Rrogozhinës në drejtim të lindjes traseja shtrihet nëpër bregun e djathtë të lumit deri në stacionin Klodiana (Coladina) në distancën prej XXVI mila passum (38.5 km) nga Dyrrachioni. Në këtë vend rruga Egnatia është e lidhur me një rrugë dytësore të brendshme që vjen nga veriu. Duke studiuar këtë shtrirje të rrugës, disa studiues kanë hedhur mendimin se kanë ekzistuar dy krahë të Via Egnatias që nga bregu i Adriatikut (Dirrachioni) kanë çuar deri në Peqin. Këtu duhet të përmendim kilometrazhin pak më të vogël të rrugës Durrës – Peqin i cili kap 48 km, dhe që kërkon shpjegim. Para se të vazhdojmë rrugën drejt Skampisit, në fshatin Bradashesh hasim stacionin antik, ad Quintum, në të cilin gjenden mbeturinat e ruajtura mirë të një banje romake të shek. II[23]. Pasi të përshkojmë XX mila passum në lindje do të gjendemi në stacionin Skampis (Scampa)- Elbasani i sotëm, i vendosur në bregun e djathtë përgjatë rrjedhës së mesme të Shkumbinit. Në këtë stacion Via Egnatia kryqëzohet me rrugën bashkëkohore Durrës-Tiranë-Elbasan e cila zgjatet më tej, drejt bregut të liqenit të Ohrit për të kaluar kufirin Shqiptaro – Maqedonas në vendkalimin e Qafë Thanës.

N.q.s largohemi VIII mila passum (13.3 km) nga Skampisi në drejtimin veri-lindor, do të ndeshim stacionin Genezis Flumen (Genesis Flumen) sot i njohur si fshati i Polisit. Në këtë fshat, me anë të urës, traseja e Via Egnatias kalon në bregun e majtë të Shkumbinit. Në pjesën e përshkruar deri tani në raste shumë të rralla janë ruajtur fragmente të rrugës pararomake e romake. Edhe n.q.s. këto të fundit ekzistojnë, ato janë të vendosura nën strukturat e krijuara gjatë riparimeve të mëvonshme ose janë mbuluar nga veprimi i erozionit, kryesisht fluvial.

Mbetjet e para të Via Egnatias duke u nisur nga Dyrrachioni në brigjet e Adriatikut në Shqipëri, gjenden në fshatin Qeret të Kavajës. Në këtë zonë, nën shtresën fluviale prej 0,5 m dallohen në profil mbeturina të kalldrëmit me gjerësi 4-5 m të shtruar me gurë të mëdhenj në formë pllakash. Më tej gjurmët e Egnatias shfaqen në zonën e kalimit të urës së Haxhi Beqarit (mbi Shkumbin) e cila lidh banorët e fshatrave Mirakë dhe Polis (Genesis Flumen). Në këtë pjesë, traseja e Egnatias hyn në masivin e malit homonim Polis i cili në kohën pararomake njihej me emrin Kandavija (Candavia).

Në themel të urës së Haxhi Beqarit, midis ndërhyrjeve të kohëve të ndryshme, gjenden edhe mbeturina të Via Egnatias që njihen nga qemeri prej tullash (gjerësia 3.2 m., trash. 0.70 m) si dhe nga muri i anës jugore i punuar me kombinacion të opus mixtum me opus incertum - punime karakteristike për shek. II dhe III të erës sonë. Ura është rrënuar gjatë depërtimit të gotëve në këto anë, (viti 478) (fig. 7).

Rreth 500 m nën këtë urë, te Përroi i Gostimes, janë zbuluar mbeturina të rrënjëve të urës me emrin e Keçit (fig.8). Kjo urë ka qenë e përbërë prej katër qemerësh me tulla (dim:35.35m x

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 13

mes janë vendosur pllaka më të vogla, (fig. 13). Në vendet që vijojnë traseja e rrugës është e mbrojtur me mur mbrojtës ndërtuar me gurë të mëdhenj:

- Tek hanet e Hoxhës.
- Në Xhyrë Mal, menjëherë pranë urës turke, ku traseja e ruajtur ka një gjatësi prej 50 m dhe gjerësi prej 3.5 m.
- Në Qukës (In Candavia ose Tres Tabernae) në urën turke mbi Shkumbin përballë rrugës bashkëkohore Elbasan-Korçë, (fig.14). Duke u



Fig. 14



Fig. 15

bazuar në gurët e përpunuar të përdorur për ndërtimin e sfondeve, ura është datuar në shek. I, (fig.15). Stacioni vijues i Via Egnatias është Pons Servili (sot fshati Urakë) që gjendet IX mila passum në lindje të Qukësit.

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

4.50m) ashtu si ura e Haxhi Beqarit, gjë që i daton të dyja urat në të njëjtën periudhë kohore – shek. II-III era jonë. Lartësia e madhe e urës dëshmon për praninë e një delte të gjerë të krijuar nga bashkimi i dy lumenjve.

Pas kalimit të urës së Haxhi Beqarit dhe të Qafës së Dervenit (fig. 9), rruga hyn në stacionin ad Dianam (sot fshati Babja) i cili gjendet VII mila passum (10.3 km) nga stacioni Genesis Flumen (fig.10, *fletëpalosje*). Nga ad Dianam-i, duke përshkuar malin e Polisit (Kandavisë) rruga kalon nëpër: Qershizë-Kulla e Pirgut – Rafjet e Spatarit – Spatare – Çerkez i Dardhës-Bregu i Shqepurit – Përroi i Gurrës – Zeza – Qukës Skënderbej – Lumi Shkumbin – Qukës. Në largësi IX mila passum (13.3 km) nga ad Dianam-i ka ekzistuar stacioni In Candavia ose Tres Tabernae.

Në pjesën e përshkruar, në një lartësi prej



Fig. 9

1000 m mbi nivelin e detit, ka shumë mbeturina të trasesë së Via Egnatias, rrugës së Kandavisë, por ka gjithashtu edhe mjaft ndërtime, mbindërtime dhe riparime të mëvonshme. Shenja të njëjta mbajnë edhe mbeturinat e urave antike të konstatuara vetëm mbi fshatrat Babje e Spatar (fig. 11). Në Çekrez të Dardhës traseja e Via Egnatias është ruajtur në një gjatësi prej 50 m



Fig. 11

dhe arrin një gjerësi prej 5-6 m, (fig. 12). Pllaka të mëdha guri janë vendosur anash, ndërsa në

S SHKUMBINIT · VIA EGNATIA



SHK. 1:2500

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Fig. 10

DO NOT COPY

Ngą Pons Servili deri në bregun e liqenit të Ohrit mbeten dy mundësi. E para sugjeron kalimin e Via Egnatias përafërsisht nëpër trasenë e rrugës bashkëkohore deri në Qafë Thanë, (fig.16).



Fig. 16

Mundësia e dytë ofron një zbritje direkte deri në zonën e vendbanimit të sotëm të Linit i ngritur në bregun e liqenit (mansio Claudanon që tashmë është fiksuar si stacion)[24]. Ne jemi të mendimit se varianti i parë është më i pranueshëm. Në këtë pjesë traseja e rrugës gjatë zbritjes duhet të kalojë një diferencë lartësie prej 200 m duke ndërruar njëkohësisht drejtimin dhe duke u nisur drejt veriut. Pas kësaj kthese, rruga kalon kufirin shtetëror maqedono – shqiptar dhe mbërrin në rajonin e quajtur "Shkëmbi Shqiptar" ("Albanska Karpa") në Qafën e Thanës. Izohipset e kësaj zone arrijnë 800 m. Në këtë rajon panorama piktografike e liqenit të Ohrit dhe bregut të tij plotësohet nga lëndina dhe livadhe duke krijuar një pamje mjaft të bukur. Në territorin jugor, në zonën e fshatit Radozhdë, traseja e Via Egnatias ka kaluar nëpër lokalitetet: "Zavoj", "Llazovo Pole", "Istoçnik so kladence" dhe "Dukurit". Nëpër pikat e përmendura traseja e rrugës identifikohet në bazë të shtegut malor. Kjo trase në mënyrë të vazhduar kufizohet nga shkëmbinj prej gurësh të thyer, të ruajtur pjesërisht në trajtën e mureve të ulëta. Këto mure dallohen nga pjesa e sipërme ose e poshtme e shtegut dhe përfaqësojnë mbeturinat e vetme të konstruksionit të rrugës antike. Një ndërtim i tillë i rrugës vihet re më dukshëm në lokalitetin "Bogorodica" dhe nën kishën e vogël fshatare "Sv. Sreda". Disi më tej ndeshet lokaliteti "Kallderma" prej nga traseja rrugore me rënie prej 10%, nëpërmjet periferisë jugore të fshatit dhe lokaliteteve "Izvor" dhe "Mlaki", zbret në bregun e liqenit të Ohrit, pikërisht nën shkëmbinjtë e periferisë veriore të Radozhdit (fig.17). Lokaliteti "Kallderma" gjendet rreth 500 m në veri – perëndim të Radozhdës dhe



Fig. 17

paraqet rëndësi për faktin se këtu ruhet një fragment i vazhduar prej 100 m me elementë pothuajse, të paprekura të rrugës Egnatia. Rruga me gjerësi 2.2 m është e shtruar me pllaka guri me përmasa 0,15 deri 0.30mx0.10 deri 0.20m, ndërsa skaji i saj përbëhet nga bordura prej pllakash të mëdha guri të thyer, vende-vende të gdhendur me dimensione prej rreth 0.6x0.5 ose 0.4m. Pllakat e rrugës janë vendosur me mbushje dheu ranor dhe deri më sot nuk janë mundur të konstatohen zgjidhje të tjera teknike për shtrimin e trasesë së rrugës. Në pjesën anësore shtresa e pllakave gurore të përshkruara mbështetet në blloqe të mëdha guri, pothuajse amorfe me dimensione: 1.40x0.70x0.50 m me të cilat është realizuar mbrojtja e saj e qëndrueshme. Në këtë mënyrë shtrirja e rrugës në gjerësi i kalon 3 metra. Kjo shtrirje bëhet akoma më e madhe po të llogariten muret prej guri të thyer me gjerësi prej rreth 1 m dhe me lartësi 1 ose pak më shumë se 1 m, që shërbenin për të mbrojtur rrugën kryesisht nga erozioni fluvial. Në ato vende ku traseja e rrugës e "thyen" izohipsen si dhe në vende ku disnivelet bëhen të theksuara, rruga është mbuluar me pllaka të mëdha edhe në pjesën e mesme të saj, gjë që përndryshe haset vetëm në skajet e rrugës. Njëkohësisht në pjesët e rrugës ku rënia është e madhe, shfaqen pllaka të vendosura në mënyrë të ashpër që mundësojnë kalimin nga shkallina më e lartë në atë më të ulët. Mendohet që një ndërhyrje e tillë i takon një periudhe më të vonshme. Në bazë të njohurive të deritanishme lirisht mund të konstatohet se mbetjet e konstruksionit të Via Egnatias të zbuluara në fshatin Radozhd paraqesin segmentin e ruajtur më mirë të këtij komunikacioni antik nga territoret e të dy shteteve. Për këtë arsye shërbimi për ruajtjen e përmendoreve të kulturës duhet t'i përkushtojë kujdes të veçantë. Analogjitë më të plota për ndërtimin dhe pamjen e rrugës gjatë periudhës së re romake në brendi të Ballkanit i ndeshim në territorin e Shqipërisë, Maqedonisë dhe në pjesën bregdetare të Jugosllavisë. Në këto rajone ndërtimi i rrugës është kushtëzuar nga karakteristika të ngjashme gjeomorfologjike të terrenit si dhe nga një zhvillim përafërsisht i njëkohshëm i punimeve[25].

Prej fshatit Radozhd, traseja e rrugës del në bregun e liqenit të Ohrit dhe nuk i ndahet atij deri në fshatin Podmole. Që këtej rruga i drejtohet "Sv. Erazmo"-s tek shkëmbinjtë nën Kalanë (Kale), (fig. 18). Në largësinë IV mila passum nga Claudanon (sot fshati Lin në Shqipëri) pasi kalon



Fig. 18

fshatin Radozhdë, traseja tashmë pjesërisht e dëmtuar, shtrihet përgjatë bregut të liqenit deri në mutation Patra (sot fshati Kalisht[26]. Ana e rrugës që përkon me bregun e liqenit mbahet nga blloqe gurësh mbështetës që shihen si në breg ashtu edhe në ujin e cekët pranë bregut. Kjo mënyrë ndërtimi bëhet më e theksuar veçanërisht në zonën e shkëmbinjve të lartë para dhe rreth manastirit "Sv. Bogorodica", ("Shën Maria").

Identifikimi i mutatio Patra-s me zonën bregore të Kalishtes dhe manastirin bëhet në bazë të dy drejtimeve. Së pari, distanca prej 4 MP nga mansio Claudanon në mutatio Patras e caktuar në Itinerarium Burdigalensis përputhet me distancën reale nga Lini në Kalisht. Së dyti, në Kalishtë janë bërë dy gjetje që vërtetojnë ekzistencën e stacionit antik të Patras: mbishkrimi kushtuar strategut Nikijas në shek I

DO NOT COPY

DO NOT COPY

(i zbuluar në manastirin e Kalishtes[27]) dhe statuja në miniaturë e perëndeshës Artemida e mbetur nga periudha mbretërore[28]. Në bazë të të dhënave të mësipërme mund të konstatojmë se Via Egnatia duke u nisur nga Pons Servili (sipas Tabula Pojtingeriana-s) ose nga Claudanon (sipas Itinerarium Burdigalensis) nuk ka kaluar përmes vendkalimit kufitar të Qafë Thanës dhe më tej luginave jugore të Jabllanicës (me lartësi 1000 m mbi nivelin e detit) Mali Mlai-t dhe Frangovës. Po kështu nuk mendohet që rruga të ketë shkuar drejt Strugës nëpërmjet opidum Vajtos-it ndërmjet fshatrave Oktisi dhe Vevçani.

Ky fortifikim i rëndësishëm i periudhës pararomake ka formë elipsoide të realizuar me blloqe monumentale romboide deri trapezoide prej guri në teknikë të thatë (e quajtur muratori kiklopike dhe e ngjashme me opus pseudoisodomum) dhe është ruajtur më tepër në anën veriore. Këtu kemi të bëjmë me fortifikata karakteristike për shek IV p.e.s në rajonin dasaretas dhe ilir[29]. Për sa i përket rajonit të Strugës e të Ohrit, fortifikatat e ndërtuara në Tatesh, Dellogozhd, Kala e Trebenishit[30], Shën Erazmo dhe Lihnidos janë më të vogla se fortifikatat e lartpërmendura. Shumë prej pikave të fortifikuara dhe veçanërisht nekropolet e tyre paraqesin thesare të vërteta të fondit arkeologjik. Nekropolet përmbajnë një repertor të gjerë te veglave e mjeteve të metalit, enë qeramike e metalike, stolive të arta si dhe sendeve të tjera të kultit ose përdorimit të përditshëm përfshirë këtu edhe ato të importuara nga Egjeu ose Mesdheu. Këto gjetje i përkasin një shtrirjeje kulturore dhe kronologjike që fillon nga fazat e hershme të kohës së hekurit, vazhdon me periudhën arkaike dhe klasike deri në periudhën helenike. Disa objekte i përkasin edhe antikës së vonshme madje edhe mesjetës. Një nekropol që mund të merret si shembull në këtë kontekst është ai i quajtur "Tri Nofullat" ("Tri Çeljusti") në fshatin Gorencë[31]. Në këtë fshat, në vitin 1972, nën drejtimin e një prej autorëve të këtij libri, u kryen gërmime mbrojtëse arkeologjike nëpër trasenë e magjistrales perëndimore. Duke vazhduar nga mutatio Patrae (Kalisht) traseja e rrugës e shtrirë përgjatë bregut të liqenit, mbërrin në Strugë. Praninë e rrugës në këto anë e vërtetojnë blloqe të zhvendosura guri që janë karakteristike për mbështetësen anësore të Via Egnatias në tërë gjatësinë e saj. Në pjesën e mesme të kësaj ndërlidhjeje gjendet lokaliteti "Verbnik" që ka përfaqësuar një lagje të fuqishme seaniçase që nga fazat e hershme të antikitetit. Ekzistenca e kësaj lagjeje është vërtetuar nga zbulime të shumta arkeologjike që, për fat të keq, në shumicën e rasteve janë bërë pre e piratëve nënujorë.

Sidoqoftë vazhdon të mbizotërojë mendimi që Struga është një lagje pararomake, gjë që është dëshmuar me zbulimin e mjaft lokaliteteve dhe materialeve arkeologjike. Këto materiale arkeologjike të zbuluara gjatë gërmimeve në shtratin e Drinit të Zi, i përkasin periudhës helenike[32]. Më konkretisht fjala është për një lagje emri antik i së cilës ende nuk është zbuluar. Kjo lagje ka fituar rëndësi për arsye të komunikimit me prapavijën gjatë rrjedhës së Drylonit si dhe për praninë brenda saj dhe në rrethina të lokaliteteve arkeologjike dhe fortifikatave të përmendura. Faktet që po rendisim më poshtë na bindin edhe më tepër për vendosjen e drejtpërdrejtë të këtij stacioni në trasenë e Via Egnatias.

- Në kishën Sv. Gjorgji, është zbuluar një milatregues nga koha e perandorit Karakala (211-217) në të cilin është shënuar distanca prej 8 MP (12 km) nga Lihnidosi [33], (fig. 19).

- Mbeturina të gurëve mbështetës të Via Egnatias gjenden pjesërisht deri në Strugë dhe më pas vazhdojnë të shfaqen pa ndërprerje deri në Shen Erazmo në fshatin Podmole, (fig.20).

- Ekzistenca e pjesëve të trasesë së rrugës "së vjetër" është dëshmuar edhe nga informatat që banorët e Strugës dhe Kalishtës u kanë dhënë hulumtuesve [34]. Një pjesë e këtyre studiuesve u udhëhoqën gjithashtu nga të dhënat e princeshës

DO NOT COPY



Fig. 19



Fig. 20

bizantine Ana Komnena sipas së cilës burimi i Drinit dhe një pjesë e qytetit paraqisnin moçal e për pasojë shtronin detyrën e ndërtimit të urëzave[35].

Duke kaluar lumin e vogël Siteska dhe më pas duke e braktisur bregun e liqenit në fshatin Podmole, traseja e Egnatias duke bërë një hark të vogël i drejtohet Shën-Erazmos. Në këtë pjesë, pas shumë ndërhyrjeve ndërtimore, rruga është dëmtuar aq shumë saqë mund të njihet vetëm në sajë të blloqeve mbështetëse. Ndërsa rruga i drejtohet qytetit më të njohur dasaretas-Lihnidosit (fig.21), ajo humbet çdo gjurmë pasi është shkatërruar plotësisht. Sidoqoftë ne



Fig. 21

mendojmë se rruga ka hyrë në qytet nga veri-perendimi duke kaluar së pari në lokalitetin "Kozluk" nëpërmjet urës mbi lumin Koselska. Pasuria arkeologjike e Lihnidos-it ashtu si edhe e kaluara e tij kulturore dhe historike janë bërë objekt i studimeve të shumë arkeologëve maqedonas. Duke u nisur nga Lihnidosi, traseja e Egnatias besohet të ketë vazhduar përmes Debello Pole drejt fshatit Kosel ndoshta në një drejtim të përafërt me atë të komunikacionit bashkëkohor. Duhet thënë se kjo është një hipotezë, vërtetësia e së cilës nuk është konstatuar në terren jo vetëm për shkak të gjendjes problematike të kësaj pjese të rrugës, por edhe

DO NOT COPY

për faktin që realizimi i punimeve kërkon kohë të gjatë dhe mjete të shumta.

Sipas një alternative tjetër rruga drejtohet për nga Petrinsko Pole dhe rrafshnaltat e malit homonim, për të arritur më pas në basenin e Prespës, pranë njësisë fortifikuese "Kale"[37]. Kjo alternativë gjithsesi nuk është e pranueshme kur bëhet fjalë për Via Egnatian, por mbetet interesante gjatë shqyrtimit të rrugës së vjetër ballkanike të karvaneve nga periudha pararomake[38].

Nga komenti që studiuesi i njohur i gjeografisë antike Nikolla Vulis[39] i bën informacionit të Strabonit (marrë nga Polibi) mësojme se mbi Via Egnatian, ndërmjet Lihnidosit dhe Heraklea Linc ka qenë kufiri i provincave romake të Maqedonisë e Ilirisë. Kjo pikë kufitare e përfaqësuar nga lokaliteti Pilon, përmendet së bashku me Barnuntin fqinj, i cili në Via Egnatian duhet kërkuar ndërmjet Resnjes dhe Ohrit. Sipas mendimit tonë, lokaliteti Pilon që me siguri ka qenë mutatio, si dhe karakolli i këtyre provincave romake, kanë ekzistuar në rajonin e fshatit të sotëm Kosel. Lokalizimi i Pilonit është bërë i mundur pas zbulimit të nekropolit helen[40] dhe para së gjithash në bazë të shqyrtimit të gjeomorfologjisë së zonës. Ky lokacion, në këtë kuptim, paraqet një natyrale të Lihnidosit korniza e së cilës përbëhet nga malet hijerënda Jasika në anën veriore dhe Martula në anën jugore. Nëpër grykën e ngushtë të këtyre maleve rrjedh lumi Openiçka i cili para se të hyjë në fushën e Ohrit kalon në lumin Koselska.

Duke kaluar nëpër kanionin e Openiçka Rekas në largësinë prej 4 MP nga Lihnidosi, në zonën e deltës së lumit të vogël Mokresh, pikërisht në lokalitetin "Prentov Most" janë konstatuar mbeturina të dy themrave të urës mbi Openiçka Reka. Mbi këtë urë traseja e Egnatias ka kaluar në bregun e djathtë të lumit duke zbritur më pas në tokat malore rreth fshatit Bukovo (fig.22). Themra e majtë është ndërtuar me blloqe krejtësisht të rregullt dhe të latuar imët në skaje



Fig. 22

me dimensione 0.50x0.45x0.35m. Mendohet se ky ndërtim i takon ndonjë riparimi të mesjetës së vonshme. Përsa i përket themrës së djathtë, ajo është ndërtuar me blloqe guri të dimensioneve 0.90x0.45x0.3m të punuara ashpër dhe të lidhura me llaç të fortë hidraulik përzier me tuf vullkanik ose brekçë opalike. Kjo themer i takon periudhës romake gjë që e lidh atë në mënyrë të padiskutueshme me Via Egnatian. Nga themra janë ruajtur shtatë rrjeshta të blloqeve të përshkruara pas të cilave gjendet mbushje e zeze e shkrirë në përzierje të pasur të llaçit në llojin opus incertum. Themra është pak e lakuar drejt bregut dhe i takon urës me arkitrarë me konstruksion druri. Në bazë të njohurive të deritanishme rajoni i "Prentov Most"-it paraqet një basen mineralogjik. Në këtë rajon janë zbuluar miniera të shumta të periudhës romake në të cilat hasen gjurmë të hekurit, plumbit, argjendit dhe floririt. Disa nga këto miniera janë: "Madem"[41], "Stareqki doll" [42], "Raleica" [43], "Storenska Tumba" [44], "Stari doll" [45], si dhe lagjia romake "Llazhishte-Vilipec" [46]. Të gjitha këto mbetje minierash na japin shkas për t'i atribuar këtij rajoni ekzistencën e mutatio Barnuntos, i cili nga burimet e përmendura antike vendoset gjithashtu përgjatë Via Egnatias në brezin kufitar të provincave romake të Maqedonisë e Ilirisë[47].

DO NOT COPY

Traseja e Via Egnatias vazhdon në bregun e majtë të Openiçka Rekas. Në këtë pjesë si pasojë e riparimeve të mëvonshme makadamase, rruga është rishtresuar dhe pajisur me mure të larta që e mbronin nga karakteri i vrullshëm i rrjedhës së lumit. Në këtë mënyrë rruga ngjitet diku në zonën ndërmjet kalimit të vjetër dhe bashkëkohor, në rrafshnaltën "Bukovo". Via Egnatia mbërrin kështu në territorin e fshatit Bukovo në të cilin Itinerarium Hiercolymitanum vendos mutatio Brucida, finis Macedoniae et Epiri[48]. Sipas mendimit tonë një përputhje e tillë është krejtësisht e pranueshme. Nga ky vend, dalja ne basenin e Prespës bëhet e mundur nëpërmjet Sv.Spas në zonën e fshatrave Krushje, Izbishte dhe Jankovec. Më pas rruga kalon nëpër rrjedhën e Golema Reka-s dhe kanionit të saj, nëpërmjet ose diku pranë Resnjës në lokalitetin "Poroj" deri në lokalitetin "Makazi" në fshatin Kozjak, nën luginat jug-perëndimore të malit Pelister. Mes të tjerash ideja për këtë shtrirje të rrugës është bazuar në zbulimin e disa lokaliteteve arkeologjike siç janë: "Gimbabica" [49] dhe "Jamishte" [50] në fshatin Izbishta.

Edhe pse në rajonin e Resnjes nuk janë zbuluar mbetje të rrugës Egnatia, ne arrijmë në përfundimin që kjo rrugë e ka përshkuar këtë zonë, duke u bazuar në zhvillimin e madh të bujqësisë, rritjen e aktivitetit njerëzor si dhe përforcimin e urbanizimit në ditët tona.

Baseni i Prespës është qendër dhe udhëkryq i rrugëve të shumta rajonale dhe lokale në të kaluarën. Ndër to mund të përmendim rrugën nga Korça deri në basenin e Ohrit nëpërmjet malit Petrinska. Njëkohësisht gjeografia dhe topografia antike gjatë interpretimit të burimeve antike në rajonin e Resnjës përmendin shumë qytete si: Vrigion, Atakos, Kostancion, Vasilida, Skirtiana, etj.[51]. Sidoqoftë saktësimi i këtyre qyteteve në terren mbetet jashtë temës së studimit tonë.

Lokaliteti "Makazi" që në fushën e arkeologjisë njihet me emrin "Gorna malla"-"Makazi" në fshatin Kozjak, për mendimin tonë, mund të pranohet si një nga stacionet e Via Eganatias me largësi prej 14 MP nga Brucida, e cila në Itinerarium Antonini përmendet me emrin Scirtiana[52]. Nga Scirtiana traseja e rrugës vazhdon të hapet drejt rajonit malor të Gjavatos me një lartësi prej 1000m mbi nivelin e detit. Më pas rruga zbret dhe duke kaluar lumin Shemnica (fig.23), hyn në kastrumin romak që mban dy emra. Ne Itinerarium Hierosolymitanum njihet



Fig. 23

si mutatio Parambole dhe në Itinerarium Antonini si Castra. Këtë stacion e ndajnë XIII mila passum nga Heraklea Linkestite. Këtu, para se t'i afrohemi kastrumit të lokalitetit arkeologjik "Kale", pikërisht nën mbeturinat e urës antike bizantine mbi Shemnicë, si dhe ndërmjet kastrumit dhe stacionit Nicea janë konstatuar trase më të shkurtra të Via Egnatias. Këto trase janë mjaft të dëmtuara. Rreth 2km në lindje të Castra – mutatio Parambole, në lokalitetin "Tumba" - "Gramdishte", në trekëndëshin ndërmjet fshatrave Dolenci, Ramna dhe Gorno Serpci, shtrihet Nikea, stacion i Via Egnatias[53]. Në favor të tezës që vendos pranë njëri-tjetrit Nikean dhe mutatio Parambolen flet edhe fakti që Tabula Pojtingeriana dhe Itinerarium Antonini i vendosin këto stacione në një largësi të tillë nga Heraklea që përputhet me distancën reale ndërmjet tyre.

DO NOT COPY

Myler ka vërejtur njëfarë dualiteti në trasenë e Egnatias në rajonin e Caparsko Poles, gjë që ne nuk mund ta kalojmë pa e vënë re. Kalimi i rrugës Egnatia në rajonin e Gjavatos është bërë kështu. Fillimisht rruga i është ngjitur drejtpërdrejt izohipsit në lartësinë e fshatit Capari (varianti i sipërm) si dhe, sipas variantit të poshtëm, ka kaluar nëpërmjet stacionit Nikea për të përshkuar më pas territorin e fshatit Gjavato deri pranë kishës dhe varreve. Të dy variantet e përshkruár janë dëshmuar me mbeturina të kalldrëmit dhe mureve rrethuese të cilët u janë nënshtruar riparimeve të mëvonshme. Në zonën e Paramboles mendohet të ketë qenë udhëkryqi në të cilin rruga që vinte nga lugina e lumit Treska për në Uskanë, nëpërmjet Demir Hisarit dhe rrugës periferike jugperëndimore të Pellagonisë, është lidhur me Via Egnatian. Që këtej është nisur rruga e përmendur malore Nikea Parambole e cila nëpërmjet fshatit Mallovishte dhe Sv.Ana në Markova Kulla mbërrin në bregun e Prespës. Një propozim tjetër lidhur me drejtimin e Via Egnatias e kalon atë nga Nikea drejt fshatit Rotino, nga lokaliteti "Prevalec" nëpër periferinë lindore të Caparsko Pole-s [54]. Ky drejtim nuk ka arritur të vërtetohet për arsye se shfrytëzimi që ka pësuar rruga ka nisur më vonë nga fillimet e ekzistencës së Via Egnatias.

Për të mbërritur nga Nikea në Heraklea, Via Egnatia përshkon sipas Tabula Pojtingeriana-s 9 MP. Nga Nikea traseja e Via Egnatias niset drejt juglindjes dhe vazhdon ngjitjen për të arritur bregun e majtë të Caparska Reka-s. Kur mbërrin në periferinë perëndimore të fshatit Capari, në lartësinë prej rreth 1000 m mbi nivelin e detit, traseja kalon Caparska Reka-n. Gjatë gjithë kësaj pjese traseja e identifikuar është e pandërprerë. Ajo është e ndërtuar pjesërisht me kalldrëm dhe ka një gjerësi që arrin deri në 5 m. Kjo gjerësi iu dedikohet, kryesisht, mureve rrethues që gjenden në njërën ose tjetrën anë të rrugës. Këto mure kanë karakter kiklopik dhe janë ndërtuar me gurë të mëdhenj drejtkëndësh, romboike ose trapezoide (fig.24). Përveç këtyre, janë zbuluar gjithashtu



Fig. 24

kanale shkarkimi paralele dhe diagonale që kanë shërbyer për mbrojtjen e trasesë nga vërshimi i fuqishëm i ujërave. Erozioni fluvial i tokave në fshatrat Capari, Rotino, Tërnovo dhe Dihovo deri në Manastir (Heraklea) në pjesët më të ulëta, ka kthyer një numër të madh luginash në zona krejt të papërshtatshme për ndërtimin e rrugës. Në këtë mënyrë mund të shpjegohet ngjitja e rrugës deri ne izohipset e mesme të këtyre fshatrave duke



Fig. 25

arritur lartësinë 1000 m. Në fshatrat Capari, Rotino dhe Ternovo traseja e Egnatias është identifikuar kryesisht në bazë të mbeturinave të mureve rrethuese dhe disa gurëve të mëdhenj. Në pak vende hasen mbeturina të shtresës së sipërme të rrugës e cila ka humbur nën ndikimin e erozionit dhe riparimeve të mëvonshme (fig.25).

DO NOT COPY

Mendojme se në këtë pjesë, Via Egnatia ka shfrytëzuar trasenë e rrugës së vjetër maqedonase (ballkanike). Nga fshati Ternovo traseja e rrugës zbret në territorin e fshatrave Bratin Doll dhe Dihovo duke kaluar në periferinë jugperëndimore të Manastirit (Heraklea). Në këtë pjesë të luginës së Pellagonisë në tokat e fshatrave të përmendur gjenden shumë lokalitete arkeologjike që mbështesin sa kemi thënë në lidhje me trasenë e Via Egnatias. Të tilla janë:

- Fshati Gjavato: "Sv Bogorodica" - nekropol, "Kale" - fortifikatë;
- Fshati Dolenci: "Suvi Livadi" - kompleks sakral, "Beli Kamenja" - lagje;
- Fshati Dollno Sërpci: lagje, kisha "Sv. Arhangel" - nekropol, kisha "Sv. Todor" - kompleks sakral;
- Fshati Kazhani: "Studena Çeshma" dhe "Jasharova Kulla" - lagje;
- Fshati Capari: "Shuma" - nekropol, "Patrica" dhe "Gerani" - lagje, "Kale" - fortifikatë;
- Fshati Rotino: "Staro Sello" - lagje, "Arnaudski Pat" - trase e rrugës së vjetër;
- Fshati Ternovo; "Ternovski Llozja" - lagje dhe nekropol,
- Fshati Bratondoll: "Magareshko Movçe" - mbeturina të rrugës së vjetër dhe në të njëjtën kohë mbeturina të kalldrëmit të Egnatias, "Stari llozja" - lagje;
- Fshati Dihovo: "Ograge" - lagje dhe nekropol, "Bratindollska Reka" - lagje.

Këto lokalitete u përkasin periudhave të ndryshme të antikitetit[55].

Filipi II – babai i Lekës së Madh, e ndërtoi Heraklea Linkestis në shek IV p.e. s me qëllim që të siguronte mbrojtjen e Maqedonisë nga depërtimi i fiseve llire[56]. Ky rajon numëron mjaft objekte të restauruara të arkitekturës sakrale të krijuara gjatë antikitetit të vonë ose bizantit të hershëm (fig.26).

Via Egnatia e braktis Heraklenë pasi kalon lumin Suva Voda për të përshkuar më pas izohipset më të ulëta të luginave lindore të



Fig. 26

Pelisterit. 15km më tutje, në fshatin Dragosh rruga del nga territori i Maqedonisë dhe hyn në Greqinë fqinje. Stacioni i parë i Via Egnatias në Greqi është mutatio Melitonus (në Florina) i cili sipas Itinerarium Hierosolymitanum ndodhet 13 MP larg Heraklea Link[57]. Prej këtej Via Egnatia zgjatet për në stacionin Grance, del në jug të liqenit të ishujve dhe më tej përshkon pikat Vodën (Edessa), Enxhe (Pella) dhe Selanik (Thessallonice). Në këtë mënyrë Via Egnatia duke përshkuar bregun verior të Detit Egje arrin në Vizantion (Costantinopol - Carigrad).

Gjatë rrugës së saj nga Heraklea deri në kufirin me Greqinë, Egnatia kalon nëpër fshatrat Bukovo, Kerstoar, Bistrica, Oleveni, Bareshani,

DO NOT COPY

Kanino, Velushina, Porodin, Llazhec, Graeshnica dhe Dragosh gjithë duke iu përmbajtur rrugës më të vjetër të asfaltuar Manastir – kufiri Maqedoni - Greqi. Për fat të keq, një pjesë e madhe e mbetjeve të këtij komunikacioni antik janë shkatërruar gjatë ndërtimit të kanaleve ujitëse. Një rast i tillë qe ai i vendosjes së sistemit të tubave ujitës "Strezhevo" (fig.27). Në këtë aspekt vlen shumë për të dëshiruar shërbimi kompetent për mbrojtjen e vlerave kulturore.



Fig. 27

Sidoqoftë, në pjesën e përshkruar të rrugës janë konstatuar dhe dokumentuar këto mbetje të Via Egnatias:

1. "Bukovski pat" - Në vendin ku kjo rrugë fshati bashkohet me rrugën e asfaltuar Manastir – kufiri maqedono-grek, gjatë riparimit të sistemit të lartpërmendur të tubave ujitës, janë zbuluar elemente të shtresës së sipërme të rrugës. Ndër këta elemente mund të përmendim pllakat e gurta dhe blloqe të mëdha siguruese nga muri anësor dhe i poshtëm mbrojtës. Nga këto pjesë u arrit në konkluzionin se rruga kish pësuar një dëmtim të rëndë që zgjatej për shumë kilometra dhe se të vetmet fragmente të paprekura të saj, qoftë edhe mjaft të shkurtra, mund të gjendeshin ndoshta nën rrugën e asfaltuar.

2. "Bistriski Most" – urë në fshatin Bistrica (fig.28). Të dy themrat e zonës së poshtme të kësaj



Fig. 28



Fig. 29

DO NOT COPY

ure mbi lumin e vogël me të njëjtin emër, janë ndërtuar me blloqe guri me përmasa 0.40x0.25x0.20 m. Hapësirat ndërmjet këtyre blloqeve janë mbushur me gurë të vegjël. Themrat dhe serklazhet e hekurta të zonës së sipërme i takojnë ndonjë riparimi të bërë gjatë mesjetës, kurse ato të zonës së poshtme janë antike dhe i takojnë Via Egnatias (fig.29). Në zonën e urës, nga ana perëndimore e saj, ndërmjet shtëpive të fshatit të ndërtuara në bregun e majtë të lumit, janë gjetur pjesë të kalldrëmit të kësaj rruge si dhe blloqe të mëdha guri të përdorura për sigurimin anësor.

3. Ndërmjet fshatrave Vellushina dhe Dragosh, menjëherë nën urën Konjski, në largësinë 13.5 km nga Manastiri pranë rrugës së vjetër të asfaltuar që çonte në Greqi, janë zbuluar mbeturina të një ure romake (fig.30). Bëhet fjalë për një përzierje të llaçit gëlqeror me rërë kokëmadhe lumi dhe lidhës çimentoje. Kjo



Fig. 30

përzierje i ka takuar shtyllëzës së bregut të majtë të lumit. Në shtratin e lumit shihen mbeturina të disa riparimeve të urës ndërsa përreth hasen blloqe guri që kanë qenë pjesë e rrugës Egnatia.

4. "Dragosh" - rreth 500m në jug të urës Konjski mbi lumin Llazheçka (fig.31), duken pjesë të konstruksionit të Via Egnatias dhe kryesisht blloqe të mëdha guri, të zhvendosur nga pozicioni i tyre fillestar gjatë punës në pemishte (fig. 32.).



Fig. 31



Fig. 32

. Ashtu si në segmente të tjera të trasesë, edhe në këtë zonë janë vendosur lokalitete të ndryshme arkeologjike të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e nje tabloje sa më të plotë të Via Egnatias. Ja disa nga këto lokalitete:

- Fshati Kërstoar: "Miroj Oranici" – kompleks sakral;
- Fshati Bistrica: lagje, kisha "Sv. Gjorgjia" – kompleks sakral, "Selishte" – lagje, nekropol dhe objekt sakral;
- Fshati Bareshani: "Sllatina" – lagje, "Vasharenica" – lagje;
- Fshati Vellushina: "Vellushka Tumba" – lagje, "Sadevi" – lagje,

DONOTCOPY

- Fshati Graeshnica: "Markoica" – nekropol, "Kale" – lagje dhe fortifikatë, "Vakavsko Mesto" – lagje dhe nekropol.

I gjithë informacioni i paraqitur më lart është marrë nga Harta Arkeologjike e Maqedonisë[58].

Së fundi mund të bëjmë një përmbledhje të karakteristikave të konstruksionit të rrugës Egnatia për territorin e Maqedonisë dhe Shqipërisë:

– Shtresa e sipërme: kalldrëm prej pllakash të mëdha guri në pjesën e mesme, me dimensione 0.30 x 0.15 x 0.20 m dhe në pjesën e skajeve me dimensione 0.60 x 0.50 x 0.40 m. Pjesa skajore mbështetet në gurë të mëdhenj amorfe me dimensione 0.70 x 0.50 x 0.40 m. Gjerësia e përgjithshme e rrugës shkon nga 3 deri ne 5 m. – Mure rrethuese të pranishme në njërën ose të dy anët e rrugës, që shërbenin për mbrojtjen nga erozioni fluvial. Këto mure janë të ndërtuar me gurë të thyer pjesërisht të gdhendur me përmasa të mëdha, me formë drejtkëndëshe, trapezoide dhe romboide. Trashësia e mureve arrin 1m dhe vende-vende lartësia është mjaft e madhe.

– Kanalet paralele ose diagonale të përmasave të ndryshme që shërbenin për të mbrojtur rrugën nga ujërat kapilare dhe atmosferike.

Po t'i shtojmë kësaj liste urat, milatreguesit, si dhe pikat përgjatë rrugës: speculae, mansia, mutaciones dhe së fundi qytetet si destinacionet përfundimtare të kësaj rruge, fitojmë tërësinë e një komunikacioni tepër të njohur dhe të rëndësishëm jo vetëm në periudhën e antikitetit, por edhe gjatë gjithë shekujve të mëtejshëm të shfrytëzimit të saj.

3. Komunikacioni rrugor i Ballkanit të vjetër (*Rruga Kandavija dhe Rruga e vjetër maqedonase*)

Sipas mendimit tonë është e pamundur të flitet dhe të shkruhet për Via Egnatian dhe të lihet pa përmendur komunikacioni rrugor i Ballkanit të vjetër i cili është shtrirë paralelisht ose pothuajse paralelisht me Egnatian, duke iu afruar shumë asaj në vende të caktuara. Megjithëse nuk mund të përcaktohet me siguri të plotë koha e ndërtimit, mendohet se kjo rrugë e ka patur zanafillën në periudhën e kalimit nga prehistoria e vonshme në një nga fazat e hershme të kohës së hekurit në Ballkan.

Në territorin e Shqipërisë kjo rrugë njihet me emrin "Kandavia". Këtë emër ajo e ka marrë nga masivi homonim nëpër të cilin kalon. Kjo rrugë duke u nisur nga Deti Adriatik lëviz drejt liqenit të Lihnidës, Pellagonisë dhe Gjirit të Termajit për të mbërritur në Morseusin e Bosforit. Deri në kohën e ndërtimit të kësaj rruge, banorët e Ballkanit kanë komunikuar me viset e largëta duke shfrytëzuar "hapjet" natyrore siç ishin kurora e Kandavise, rajonet e Ohrit, Prespës dhe Pellagonisë. Në sajë të këtij komunikimi realizohej këmbimi i vlerave materiale dhe kulturore.

Emri ilir i kurorës malore Kandavia është përmendur fillimisht nga Polibi [59] i cili jetoi nga viti 63 p.e.s deri në vitin 20 të erës së re. Ky autor antik nuk e ka njohur terrenin e Ilirisë edhe pse ai paraqitej në Via Egnatian. Për këtë arsye pjesa e ruajtur e librit të tij VII në të cilën flitet për Via Egnatian është mjaft e skematizuar[60].

Një tjetër burim i rëndësishëm në analizimin e kësaj rruge na ofrohet nga ekspedita e Cezarit në vitin 54 p.e.s. Itinerari i kësaj ekspedite përmend emrin Kandavia duke na lënë të kuptojmë se kjo rrugë ka ekzistuar në kohën e pushtimit romak. Në këtë mënyrë duket qartë se nuk bëhet fjalë për një rrugë lokale ose rajonale, por për një rrugë që ka lidhur shumë rajone të banuar nga njerëz me origjina dhe kultura të ndryshme. Kjo rrugë në të njëjtën kohë ka bashkuar kontinentin e Evropës me Azinë duke kaluar nëpër një terren vështirësia e të cilit krijohej nga rrjedha e Shkumbinit dhe masivi malor Kandavia. Dëshmia më e mirë për ekzistencën e rrugës është materiali arkeologjik i shpërndarë kudo përgjatë trasesë së saj. Këtu një

DO NOT COPY

rëndësi të veçantë marrin monedhat maqedonase të gjetura në territorin ilir si dhe monedhat ilire të zbuluara në Lihnidos[61] dhe në rajone akoma më lindore.

Nga sa u tha mund të përfundojmë se kjo rrugë e vjetër ilire me lartësi rreth 1000m mbi nivelin e detit, e njohur me emrin Kandaviasë, dhe e shtrirë kryesisht përgjatë bregut të Shkumbinit, ka luajtur rol aktiv që nga fazat e vona të periudhës së hekurit deri në dhjetëvjeçarët e parë të helenizmit. Fakti që kjo rrugë, nën emrin Kandavijasë, përmendet në burimet më të vjetra[62], flet për lidhjen e kësaj rruge me ngjarjet historike më të rëndësishme të rajonit. Në këtë rrugë kanë lëvizur legjionet romake rreth mesit të shek. II p.e.s gjatë pushtimit të tokave ballkanike[63]. Aktiviteti i rrugës Kandavijasë në këtë kohë dëshmohet gjithashtu nga ndërtimet e mëdha ose të vogla, një pjesë e të cilavë kanë qenë dhe fortifikatat. Këto ndërtime janë bërë në mënyrë të tillë që të ndiqnin qarkullimin dhe lëvizjen që bëhej në rrugë dhe që ti arrinin në të njëjtën kohë mbrojtjen e duhur. Në këtë kontekst me rëndësi janë: Shënlliu afër Elbasanit dhe Qyteza në Qukës-Skënderbej nga kohët parahistorike; Kalaja e Lleshanit, ndërtimorja mbi Dumre dhe kalaja e Dorsit të cilat vrojtojnë pikëprerjen e trasesë kryesore me rrugët dytësore nga jugu e veriu; Shënlliu, kalaja e Saragut dhe ajo e Zibrakes në jug, kalaja e Vilës në Petrele, kulla e Gracenit, Dorsi në anën veriore si dhe Gradishta, Kamunaku, Lleshani dhe Valëshi të cilët paraqesin pika periferike dhe kontrollojnë kufijtë e trasesë kryesore.

Ekspedita shkencore e viteve 1988-1989 e realizuar nga kolègët tanë – ekspertët nga Shqipëria[64], bëri identifikimin e mbetjeve të rrugës Kandavijase, Via Egnatias, si dhe të restaurimeve bizantine dhe mesjetare mbi rrugë, përgjatë bregut të majtë të Shkumbinit në këtë renditje: rrethi i Librazhdit, në vendin ku ndahet rruga për në Dibër, mbi urën e Haxhi Beqarit në Mirakë, deri në fshatin Qukës – Kandavija antike. Ekspedita, në të cilën mori pjesë dhe një nga autorët e këtij libri kishte si qëllim realizimin e disa detyrave. Së pari duhej bërë evidentimi dhe dokumentimi i plotë i teknikës së përdorur në fazat e ndryshme të rrugës, duke përfshirë shtresën e sipërme (kalldremin), muret rrethuese, kanalet e ndryshme të kullimit dhe muret mbështetëse. Ky dokumentim është realizuar në sajë të përgatitjes së skicave inxhinierike dhe hartimit të hartës topgrafike me legjendë komplekse. Kjo hartë paraqet të gjithë shtrirjen e elementëve të lartpërmendur në kurorën malore të Kandavisë përgjatë bregut të majtë të Shkumbinit. Në këtë zonë gjurmë të rrugës Kandavijase janë vërejtur në Gurrat e Zeza midis Dardhës dhe Xhyrës, ose më saktësisht në bregun e Kostanilit, ku gjendet një serpentinë e madhe në rrugën e mëvonshme Egnatia (fig.33).



Fig. 34

Ky trakt në një distancë rreth 30 m nga ura e drunjtë është ruajtur për një gjatësi prej 80 m dhe ka një rënie prej rreth 20%. Gjerësia e kësaj rruge, në varësi të konfiguracionit të terrenit shkon nga 1.2 deri në 1.8 metra (fig.34).

Duke bërë një krahasim të kësaj rruge me Egnatian mund të themi se kjo rrugë karakterizohet nga një gjerësi më e vogël, rënie më të mëdha, shtresë e sipërme me gurë të mesëm deri në të mëdhenj dhe vende-vende nga lartësi

DO NOT COPY



Fig. 34

papërpunuara dhe ka një lartësi që vende-vende i kalon 2 m. Muret kiklopike tregojnë se teknika e përdorur i përket kohës së hekurit. Mbeturina të një muri të tillë janë identifikuar në traktin e rrugës që kalon në Gurrat e Zeza. Këto mbetje, ashtu si edhe muri fortifikues i Marsheit e Gajtanit në veri dhe Gjono Madhit e Bellovodës në Korçë, i takojnë periudhës pararomake. Periudhës antike i takon gjithashtu mbeturina e murit me gjatësi prej 55 m të Kroi i Shelgut në Qafë Thanë, i cili është ndërtuar pothuajse në opus kvadratum dhe në disa vende arrin lartësinë prej 3 m, (fig.35). Disa pjesë të rrugës në shqyrtim ngjajnë me muret e fortifikatës së Lisit e cila daton



Fig. 35

të mëdha. Në rrugën e vjetër ballkanike në ato vende ku rrugës i mungon pjesa e sipërme gjejmë mbushje prej dheu dhe shkrepi të pastër. Kjo gjë është vërejtur në traktet e përmendura në territorin e Shqipërisë. Karakteristikat e mësipërme sidomos ngushtësia dhe rëniet e mëdha flasin për një rrugë që shërbente kryesisht për kalimin e karvaneve me kafshë, ndërkohë që Via Egnatia, duke qenë më e gjerë dhe duke patur rënie më të vogla, krijonte mundësi për lëvizjen e karrocave të lehta bartëse.

Pjesa anësore e rrugës Kandavijase është e pajisur me një mur prej blloqesh masive të

në periudhën e ndërtimeve ilire në shek IV-III p.e.s, kohë kjo kur pjesa e rrugës Kandavijase që lidhte Gurrat e Zeza me Qafën e Thanës ka qenë aktive. Karakteristika të njëjta morfologjike dhe ndërtimore me rrugën Kandavijase në Shqipëri hasen te Vejusha e Gruemires, kurse analogjitë me Malin e Zi e Jugosllavinë gjenden në rrugën Salthua-Cotor. Rruga e vjetër maqedonase ka qenë vazhdimësi e natyrshme dhe logjike e Rrugës Kandavijase. Kjo rrugë është nisur nga rajoni i Ohrit drejt basenit të Prespës dhe Pellagonisë për të arritur, nëpërmjet tokave të Helladës, në bregun aziatik.

DOKTORSKI

Gjithçka u tha për Rrugën Kandavijase në kuptimin historik vlen edhe për Rrugën e vjetër maqedonase e cila ashtu si Rruga Kandavijase, ka shërbyer për lëvizjen nga perëndimi në lindje dhe anasjelltas të mallrave dhe vlerave kulturore. Nga historia shumëvjeçare dëshmitare e së cilës ka qenë Rruga e vjetër maqedonase, mund të veçojmë disa momente që kanë patur një rezultat fatal mbi Maqedoninë e atëhershme. Kështu në vitet 200-199 p.e.s, gjatë mbretërimit të Filipit V në Maqedoni, për të mbërritur në fushëbetejën e Heraklea Linkestit legjionet romake të udhëhequra nga konsulli Sulpicie Galba[65], kanë përshkuar Rrugën Kandavijase dhe rrugën e vjetër maqedonase. Të njëjtin itinerar ka përshkuar edhe ushtria romake e udhëhequr nga Apie Klaudi në vitet 170-169, për të luftuar kundër ushtrisë së mbretit maqedonas Perseut në Lihnidos, gjatë pushtimit të territoreve të reja sipas linjës Lihnidos-Uskana[66].

Pavarësisht nga bllokimi i kërkimeve në lidhje me identifikimin e plotë të trasesë së Rrugës Kandavijase, kjo rrugë e cila siguron burime të tërthorta edhe për Rrugën e vjetër maqedonase, është bërë objekt studimi për arkeologjinë bashkëkohore. Në këtë mënyrë Fanula Papazoglu mendon se, edhe pse mungojnë të dhënat, Via Egnatia ka lëvizur duke ndjekur kryesisht një rrugë të vjetër maqedonase[67]. Gjithashtu K. Mylcr hedh idenë se ndërmjet Lihnidosit dhe Herakleas kanë ekzistuar dy rrugë paralele[68]. Shpjegimi i kësaj ideje qëndron në faktin që Via Egnatia është ndërtuar pjesërisht mbi trasenë e rrugës së vjetër ballkanike e cila në kohën pararomake ka qenë lidhja e vetme më e shkurtër ndërmjet brigjeve të Adriatikut dhe Egjeut. Ndërtimi i Egnatias është bërë pikërisht, atëhere kur mundësitë funksionale të Rrugës së vjetër ballkanike nuk kanë mundur të realizojnë për romakët atë lloj qarkullimi që ata kërkonin. Vetëm një rrugë e re mund t'u siguronte romakëve plotësimin e pretendimeve politiko-ekonomike në Ballkan dhe më tej. Qytetet pranë të cilave kalonte Via Egnatia u kthyen në pika të fuqishme të romanizimit dhe janë karakterizuar nga një shkallë e lartë e zhvillimit ekonomik veçanërisht gjatë periudhës së hershme mbretërore. Ky zhvillim ka patur në bazë të tij lulëzimin e zejtarisë, tregëtisë dhe mjaft fushave të tjera të ekonomisë. Në këtë kohë morën zhvillim të veçantë inxhinieria dhe shkencat e tjera matematikore. Për arsyet që u përmendën më lart, ndërtimi i rrugëve është bërë me intensitet të madh kështu që është parë si më e udhës vendosja e trasesë së re mbi shtresën e sipërme të rrugës së vjetër. Nga ana tjetër ndërtuesit romakë kanë ndërhyrë në Rrugën e vjetër ballkanike (që paraqitej nga rruga maqedonase dhe Kandavijase) duke e zgjeruar atë, për të lehtësuar kalimin e karrocave, duke ndërtuar ura të rrafshëta me shtylla druri (si tek "Openiçka Most") dhe me harqe të muruara guri ose tulle, (si tek ura e Haxhi Beqarit) si dhe duke vendosur milatregues dhe mbishkrime të tjera. Këto mbishkrime shërbenin për të dhënë informata të rëndomta. Të tilla mbishkrime hasen në tabulat mbi rrugën romake të ndërtuar nëpër limësin përgjatë Gjerdapit në Danub.

N.q.s. marrim parasysh të tëra këto shpjegime mund fare lehtë, të arrijmë në përfundimin se dyzimi i supozuar i rrugës ose në disa vende ekzistenca paralele e dy traseve të Via Egnatias në territorin e Maqedonise, i dedikohen vetëm modernizimit dhe racionalizimit të Rrugës së vjetër maqedonase gjatë kohës së ndërtimit të Via Egnatias. Kjo rrugë mendohet gjithashtu të ketë pësuar rikonstruksione dhe riparime të shumta gjatë mesjetës, kryesisht në rajonin e Caparsko Pole-s.

Me qëllim që të krijojmë një tablo sa më besnike të Rrugës së vjetër ballkanike në kohët e lashta, duke e vënë theksin mbi faktin që kjo rrugë ka shërbyer për të lidhur Adriatikun me Egjeun, po shfrytëzojmë legjendën e Kadmosit. Ky hero dhe hyjni njëkohësisht (gjysmëperëndi) u nis nga Teba dhe kur mbërriti në vendin e barbarëve

DO NOT COPY

i Stare, Srbije III, Beograd 1901, p. 700-701; D.Koço, Nekolnite Zhivealishtau Ohridskoto Jezero Kraj Struga, Godishen zbornikna Filozofskiot Fakultet-Skopje, kuj.4, 1956, p.4.6.8.e vazhdim; M.Ivanovski,Rimskije komunikacije u Makedoniji, Skopje 1972, vo rakopis, iscipno ja apsolvira problematikatan Via Egnacija, pri shto vo pogracjeta na Ohrid Strushkiot region, inicira sosema provilni i ispran Ohridsko-Strushkiot region, inicira sosema pravilni i ispravni reshenija, bez ogled na vo tod vreme razheçkite sprotivni mislenja.

35- Vizantiski izvori za istorije naroda Jugoslavije III, Beograd 1966,p.393,394

36- F.Papazoglu, Gradovi___p.222, i mnogi drugi, a vo najnova vreme:V.Malenko "Od arheoloshkoto Bogastvo na C.P. Makedonija" Skopje 1980, p.368-376, kako i 411-415.

37- V.Malenko, N.Kuzman, Kartoni za Arheoloshkata karta na Makedonija arh, lok. "Kaleu 1981.

38- B.Pupalevski, Kartoni za Arheoloshkata karta na Makedonija, "arh. Lok." Koustantio".

39. N.Vuliç, Severna granica antiche Makedonije Strena Buliciana, Bulicev Zbornik, Zagreb 1924, p.237-247.

40- V. Lahtov, Arheoloshko iskopuvanje na "Trebenishko Kale", kaj selloto Trebenishte-Ohridsko 1953-54, Lihnid II, III, Ohrid 1959,p.43

41-A.Keramitciev, Kartoni za Arheoloshkoto karta na Makedonija, 1975

42- P.Lisiçar, O,C.! Mihalçiç, TIR, K-32, Sofija-Naissus-Serdica-Thessalonica, Ljubljana 1976, p.94.

43. P.Lisiçar, o.c.; I.Mikulçiç, TIR, K-32, Sofija – Naissus – Serdica – Tessalonica, Ljubljana 1976, p.94.

44- A. Keramitçiev, Kartoni za Arheoloshkata karta na Makedonija, 1975.

45- A. Keramitçev, ibidem.

46- N.Vuliç, Antiçki spomenici nashe zemlje, Spomenik Srpske Kraljevske akademije 75, drugi razred 58, Beograd 1993, br. 179p. 59.

47- F. Papazoglu, Gradovi ... p.179, N.Vuliç Severna Granica ... p. 237-247, V. Dragojeviç-Josifovska Barnus, TIR, K-34, Sofija-Naissus-Serdica-Thesalonike, Ljubljana 1976, p.22.

48- B. Dragojeviç Josifovska, O,C, so iscrpna bibliografija.

49- B. Pupalevski, Karton za Arheoloshkata karta na Makedonija.

50- S. SArxhovski i V.Sanev, Karta za Arheoloshka na Makedonija.

51- B. Pupalevski, Karton za Arheoloshkata karta na Makedonija.

52. N.Vuliç, Geografija Junzhe Srbije u antico doba "Glanik skopskog nauçnog drushtva XIX, Skopje 1929,5,9;15 F. Papazoglu Gradovi ... p. 195; G.Kacarov, Peonija, Sofija 1921, p.35.

53- T. Janakievski, Prillog kon prashanjeto za ubikacija na antiçkata nasellba Nicea-stanica na Via Egnatia, Macedonice acta Archeologica 2, Prilep 1976, p. 192.

54- T. Janakievski, i bidem.

55- G. Filipovska i T. Janakievski, kartoni za Arheoloshka karta na Makedonija.

56- Strabon 7, 323; Ptolemej, 3, 12 i 30; Tab. Peut. 7; Itin, Ant, 319; Itin, Burd, 606 i drugi, postaj; F. Papazoglu, Herakleja i Pelagonija, Zhiva Antika 4, Skopje 1954, p. 308 e vazhdim, njëlloj, Gradovi... p. 188-194; M.Grbiç, Umetniçki Pregled 8, Beograd 1939, p. 231-235; G. Tomasheviç Cvetkoviç, Heracleja III, Bitola 1967, p.5,64 i drugi antiçki izvori prezemeni od B.Dragojeviç Josifoska.

57-Agjeliqi Kois – Tantakopullu, Istoriqi Geografia Tes MAkedonias, Giannena 1986, p. 286.

58- I. Mikulçiç, D.Simoska, G.Filipovska i T.Janakievski, Kartoni za Arheoloshka karta na Makedonija.

59. Polibi, Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, V.I, Tiranë 1965, p.47.

60. F. Papazoglu, Gradovi ... p.19.

61. Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, shek. X-XV, Tirana 1975, p.34.

62. Historia e Shqipërisë, vI, Tirana 1967, f.67 e vijim.

63. Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë shek.VIII-XV, Tirana 1962, p.47.

64. V.Shtylla – L.Papajani. Të dhëna teknike mbi rrugën e luginës së Shkumbinit në antikitet dhe mesjetë, Monumentet, 1/1990/39.

65- Tit Livie, knj, 31, poglav 33-39 (N.Vuliç – Geografija ... p.2); F. Papazoglu, Gradovi... p. 220 e vazhdim.

66- Tit Livie, knj, 43, poglav 10 e vazhdim (N. Vuliç, Geografija ... p,3)

67- F. Papazoglu, Herakleja i Pelagonija ... str;2.

68- K. Muller, Itineraria Romana ... p.528 e vazhdim.

69- P. Lisiçar, Legenda o Kadmu i Veze Lihnidas Egejom i Jadranom, Zhivo Antika 3, Skopje 19.., p.245-260; njëlloj; Tabula Peuntigeriana...; 219.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

THE TRACK OF THE VIA EGNATIA WITHIN ALBANIA AND MACEDONIA

The Via Egnatia as a road of the Roman Empire which descended from the Apenin Peninsula, after leaving the Adriatic Sea behind, started to enter the Belcan Peninsula through the well-known city of the ancient-Illyria Durratio (today known as Durres). The Via Egnatia reached Costantinopolis after stretching within the illyrian territory through the Shkumbini valley and-further within the greek and macedonian territories. Thus this road represented one of the most important axes which linked Europe to Asia Minor.

The city of Durres, founded in 627 BC on, the lands of the ancient Illyrian tribe-the Taulants-dur ing the antiquity was known as Epidamn and Dyrrach. This city during - the last centuries before Christ witnessed an ostensible development and in the third century BC in Epidamn the famous coin-the Illyrian drachma-was being used. After 229 BC Epidamn became a part of the Roman Empire but it still preserved an interior autonomy. During the reign of Augustus in 20 BC the city became a roman colony. Epidamn turned into an active trade centre and it represented the most important harbour of the eastern Adriatic Coast during the first centuries of our era. The famous greek historian Polybus (200-120 BC) mentions the Shkumbini Road as a road which linked Epidamn to Hellada. During the expeditions of Caesar (54 BC) this road is known with the ancient illyrian name "Kandavi" by the famous greek scholar Strabo (63 BC-20 BC). The fragment of the road within the Illyrian territory along the Shkumbini river is considered as a part of the long road of Egnatia. Again at the end of the fifth century during the influx of Goths within the Illyrian territories, the palestinian scholar Malch (fifth and sixth century AD) mentions the Shkumbini Road with the famous illyrian name "Kandavia". In antiquity this was the name of the mountain today known as Polisi. Beside the historical facts we have mentioned so far, to the existence of a preroman road for caravans within the illyrian territory of the Shkumbini valley point also traces of the material culture. In Librazhd, at the mountainous region to the left of Shkumbini,between the villages of Dardha and Xhyra, at the Gurrat e Zeza stream a fragment of the ancient track of Kandavia is preserved. This fragment is as wide as 1.8 m and it must have been used for the movement of caravans with pack animals and not for carts used by the romans during later periods of the existence of the road. The pavement of Kandavia, laid with big flat stones, has been enforced with sustaining owalls of big uncarved stones on the side of the stream. This technique is similar to the one used in the walls of the first phase of the Iron Age and at the fortifications of Marshei and Gajtani in the North and Gjonomadh and Bellovoda in Korça. The habitation site of Shenlliu near Elbasan and the town in Qukës- Skënderbej controlled the Kandavi. Road since the first phase of the Iron Age. The fortress of Lleshan, the habitation site of Gradishta in Dumre and the fortress of Dorsi were situated at the southern and northern branches of this ancient road. Shenlliu, the fortress of Saragu, the fortress of Vila in Petrela, the towers of Gracen and Dorsi in North and

DO NOT COPY

Gradishte, Kumanak, Llesha and Valsh in the South controlled the branches of this road during this period. The archaeological material that has been found in this region points to the commercial relations between Dyrrach and Macedonia during the hellenistic period.

An important source of information about the roads of the roman Empire were the so-called itineraries which presented lists of roads and graphic maps on which on which the directions of the roads, the stations and the distances between them were marked. These itineraries compiled for economical, commercial, postal and strategical-military purposes became widely used especially during the reigns of Trajan, Hadrian, Antonini, Karakela etc., when the road system was well – organized and fully operative. The Antonini itinerary, compiled after a map of the Antonini dynasty, probably during the reign of Karakala (212-218 AD) and the Burdigalensis or Hiercolymitanum itinerary compiled in 333 from a scholar from southern France are two of the most important itineraries. Another significant itinerary is the Tabula Peutingeriana which apart from the distances between the stations of the road presents also rivers, mountains etc. Tabula Peutingeriana is a roll of pergamena dating to the twelfth century which presents the roads of the ancient world. This itinerary made up of 12 parts was named after Konrad Peutinger (fifteenth century) who was the owner of the library where the map was kept before it became a property of the Viena Library where it can still be found today. The complitation and editing of this map have been done during the second, third and fourth centuries.

Itinerarium Antonini presents the distances between the stations of the road, given in mila passum (1 MP equals 1,5 km) as well as a picture of the road from Dyrratio through Macedonia and Thrace up to Costantinopolis. The Burdigalensis itinerary again in mila passum presents the stations from Heraclea to Aulona (Vlora) with a branch toward Peqini. This itinerary marks also the mansio-s (inns for the accomo dation of travelers) and mutatio-s (places for changing horses). While presenting the Via Egnatia which came into existence after the occupation of Illyria by Rome in the second century BC, along the Shkumbini valley from Dyrrach up to Qafe Thana, Tabula Peutingeriana gives detailed information about the stations and the distances between them. Investigations on the terrain at these stations have brought into light many objects of the material culture of this road.

We should mention the fact that along the Shkumbini valley the romans found a paved road – the ancient road of Kandavi. The romans took over and improved this road by making it flatter, by widening the pavement to ease the movement of carts, by building wooden bridges and bridges with stone and brick arches, by building retaining walls, by placing milestones or inscriptions in different parts of the road and by making many other changes to help the movement of military expeditions.

Beginning at Durres, we encounter the first traces of the Via Egnatia in the village of Qerret in Kavaja. These traces appear at a depth of 0.5m and pertain to a 4-5m wide pavement with big flat stones. Further, according to Tabula Peutingeriana 20 miles or 29,6 km away from Qerret we find the station of Clodiana-today Peqini. Before entering Scampis – Elbasan - in the village of Bradashesh the station Ad Quintum Is situated. In this station a roman bath of the second century is still preserved. The track of the Via Egnatia at 7 MP or 10.3 km from Scampis comes across Genesis Flumen (the Shkumbini river) at the Hadji Beqari bridge. In the right support of this bridge we observe several phases of construction the first of which belongs to a raman bridge. The wall of the support of the bridge built in "opus incertum" belongs to the second and third centuries. This roman bridge, ruined by the Goths in 479 when they were followed by the romans, has been repaired later during the byzantine period.

After crossing the river the Via Egnatia entered the Polisi mountain. Here, the road stretched along the right side of the Shkumbini river. The first station of the road was Ad Dianam 9 MP or 13.3km from the Hajdi Beqari bridge, today known as Babja. Following the track of Egnatia we can observe the first traces of the pavement at the quarter of Cekrez in Dardha. The fragment is 50m long, 5.5-6m wide and paved with big flat stones. At the place

DO NOT COPY

called Gurrat e Zeza the road crossed the stream through a wooden bridge from which the supports at the river-side have remained. The road reached the place called Bregu i Kostanilit with a serpentine with a well-preserved pavement. Further, at the Hoxha and Xhyra inns the traces of the Via Egnatia are more visible. The road here is as wide as 3.4 m. The flat stones of the upper layer of the road, as loag as 100 cm in some places, create regular borders at the side of the road. The profile of the road points to the technique of the Via Egnatia - flat stones as thick as 30-40 cm laid over a layer of small stones. 9 MP or 13.3 km from Ad Dianam (Babje) the Via Egnatia reaches the Shkumbini river at the station. In Candaviaor Tres Tabernas on the other itineraries (today Qukes). The road crossed the river through a bridge with three stone arches and spaces of 15-16 m. The total length of the road was 70m and the width 3.7m. In the right support carved stone blocks from the arch have been preserved. This technique has been used in the bridges of the first century AD. The road across the Shkumbini valley within Illyria known as the Kandavi Road in antiquity and as the Via Egnatia after the roman occupation preserves one of its most representative fragments in Qafe Thana. At the place called Kroi i Shelgut a retaining wall 55m long and 3m high can be observed. This retaining wall as a significant document of the Kandavi Road which embodies the technique of the illyrian fortifications of the fourth and third centuries BC and the fragment of the road at the Gurrat e Zeza present two strong supports the existence of the illyrian road of Kandavi before the constructin of the Via Egnatia.

The Via Egnatia continued to operate even during the middle ages within the Illyrian territory. Th documentary sources mention the fact that this road served for the movement of different military expeditions in various historiral periods. During the fifth and sixth centuries the barbarian hordes moved along this road. In the eleventh century the Normans and the crusaders went this way. In the same century the Byzantine Emperor Basil. II marched along this road to resist the Bulgarian invaders. At the end of that century Alexis Komneni marched east by this route resting for a short time at Babja in Albania. The Byzantine commander George Acropoliti moved along this road in 1257-58AD to crush the Albanian uprising. There are few constructions of the byzantine period along the Via Egnatia since the pavements and works of art frorn the roman period were well-preserved. Next to the turkish bridge at the Vilza stream in the village of Xhyre-Mal a fragment of pavement with the retaining wall-repairs of the byzantine period-have been preserved. Byzantine repairs can also be seen at the Hadji Beqari and Qukesi bridges.

The ancient road of Kandavi-Egnatia-along the Shkumbini valley remained active even after the turkish ottoman orcupation. The Shkumhini road has been mentioned during the reconstruction of the fortress of Elbasani in 1466. Along this road marched Sultan Mehmet II on his way to the siege of Kruja. The same itinerary has been traversed by Sultan Suleyman in the summer of 1537 on his way to Elbasan and Vlora. In 1591 the venetian ambassador Bernard, after leaving Prrenjas and Dardha behind, crossed the Shkumbini river on a wooden bridge. This bridge must have the Qukesi bridge which byzantine arches were destroyed by this time. In the mid seventeenth century Elbasan carried out a voluminous commercial activity with Korca with the use of caravans. After the turkish occupation many villages of the Shkumbini valley were assigned the task of debexhi - protectors of' the mountain gorges and maintainers of the road. Such villages were Polisi, Babja, Xhyra, Rajca etc. In Qukes, Xhyre, Dardha and Babja inns for the caravans and hirers of the horses were built. Along the Shkumbini road traces of repairs of the turkish period have been preserved here and there. While counting these repairs we can mention fragments of pavement, rretaining walls, tombino-s, wooden or stone bridges etc. The turkish constructors along the Via Egnatia improved the slope of the road and widened the track thus bringing into existence new variants of the road. Turkish fragments can be seen at Qershiza, Spatar, Xhyre etc. The turkish phase of the Hadji Beqari bridge, according to Bue, was a construction of three stone arches built in the middle of the nineteenth century. The last turkish phase, nineteenth century, is the track as wide as 6 m which presents technical features similar to those of ' contemporary roads.

DO NOT COPY

The Via Egnatia after leaving behind the last station In Candavia and pons Servili (today Uraka-28 km from Qukes) before entering the region of Ohrids, comes acroos its first station on the Macedonian territory- the well-known city of Lychnidos, today Qhrid situated 23. 6 km from Pons Servili or Uraka. Following the line of the hills in the vicinity of Lin and not near the contemporary road of Qafe Thana, the Via Egnatia after crossing the Albanian-Macedonian border, runs within the stations Zavoj – Llazovo, Polje - Izvor and Duhurit thus reaching the place called Kalldrem above the village of Radozhda at Struga. Here probably the best preserved fragment of the Via Egnatia within the Balcans has been presrved. The fragment of Radozhda, 70 m long and 2.5-3,5m wide, is laid with big stones at the sides of the road and with smaller stones along the middle axe. The pavement is bordered on both sides with retaining walls of middle-sized stones. After crossing the Kalishta village, where stone blocks can be seen along the road, the Via Egnatia enters the picturesque city of Struga. At this fragment of the road we have found interesting the retaining wall along the lakeside. This wall which protected the road was built with not-very-well-carved stone blocks. Traces of the pavement have been preserved along the lakeside and below the byzantine church of Erasmo, built in the thirteenth century. At the entrance to Lychnidos-Ohrid the Via Egnatia passed within the ancient habitation site of Erasmo which appeared in the fourth century BC. Important elements of the Via Egnatia are three milepointers with latin inscription on them, discovered in the region of Ohrid. One of them is exposed at the museum of the city. These milepointers pertain to the period of the roman emperors Adrian, Antonini and Karakala. From Lychnidos to Bitola the Via Egnatia followed more or less the physical-natural line of the contemporary road. At 15 km from Ohrid over the Koselska river remains of the supports of a roman bridge have been preserved. This bridge which was a part of' the road was constructed with carved stone blocks over which wooden beams were placed. After leaving the Krudhje village, the place called Qafa e Bukoves and Resunja right after crossing the Qafa e Gjavatos region Via Egnatia reached the station of Nicea in the vicinity of the roman fortress Castrum. Leaving Nicea, the road enters the Capari village. Here the road can be traced by following fragments of pavement, typical surrounding walls which havs been well preserved and drainage canals. The station of Heraclea (Bitola)-a famous ancient center of the fourth century BC, represented a signifirant station of the Egnatia Road.

From Heraclea up to the village of Dragosh at the Macedonian-Greek border one can observe traces of two roman bridges at the villages of Bistrica and Velushina. After leaving Heraclea, the Via Egnatia stretched further within the greek territory passing through the stations of Cella 66 km f rom Heraclea, Edessa 66 km from Cella and Pella 40 km from Edessa. Further to the east the Via Egnatia entered Thessallonice were even today the main boulevard carries the name of Via Egnatia.

According to Tabula Peutingeriana the Via Egnatia from Dyrratia to Costantinopolis is as long 264 roman miles or 390.7 km thus being the shorteus road which linked western Europe to Asia.

The Via Egnatia laid over the track of the ancient Kandevi Road operated through different historical periods. In spite of its military function, it is mostly considered important because it operated as an economical arter between West and East. The stretching of' this road within the territories we have described was not a mere coincidence or a military conditioning. The geographical and climatic conditions of these countries were very optimal thus presenting very little difficulties during the construction of the road. The investigation on the terrain within the Albanian territory has been done during 1988-1969 whereas within the Macedonian territory in 1994-1995. During 1994 and 1995 joint expeditions of the two countries carried out investigating activities. These Activities were made possible due to the cooperation between the institutes for the preservation of the monuments of the two countries. The actualisation of this ancient highway presents an important step in the relations between the countries of the Balcans.

Luan PËRZHITA

DO NOT COPY

KËSHTJELLA TË PERIUDHËS ANTIKE TË VONË PËRGJATË RRUGËS LISSUS - NAISSUS

Veçimi i fortifikimeve në zhvillimin e përgjithshëm të kulturës së vonë antike padyshim është ndihmesë me rëndësi jo vetëm në studimin e formimit historik të tyre, por dhe në pasqyrimin sa më të plotë të një konceptimi të ri që lidhet me zhvillimin kulturor të asaj kohe. Shekujt IV-VI kanë periudhën e inkursioneve të fiseve të ndryshme barbare, të cilat më nj'anë ndikuan në thellimin e krizës së Perandorisë Romake, por njëkohësisht edhe bënë të domosdoshme ngritjen e një sërë fortifikimesh pranë arterieve kryesore të komunikacionit. Studimi i tyre është i rëndësishëm pasi ato ruajnë vlera të veçanta historike, shpesh unikale, lidhur me urbanizimin e trevave të ndryshme.

Kërkimet kryesisht janë kryer në qendra të periudhës antike të vonë gjatë rrugës Lissus-Naissus. Materiali i mbledhur për këto qendra është frut i një pune disavjeçare ngulmuar nga studiuesit A. Baçe, B. Jubani, N. Ceka, L. Papajani etj. Në këtë kontekst veçojme gjurmimin nga ekspeditavet përnjohëse në rrethet Pukë, Tropojë dhe Kukës të A. Baçes dhe L. Papajanit (1), si dhe punimin e B. Jubanit për disa plotësime të hartës arkeologjike të Shqipërisë së Veriut (2). Parë në tërësinë e tyre, botimet e mësipërme krijuan një bazë me rëndësi për qëmtimin dhe gjurmimin e monumenteve të kësaj periudhe duke dhënë njëherazi një vlerësim të ri për një pjesë të mirë të fortikimeve te panjohura gjer atëherë, çka u pasqyrua edhe në dokumentacionin e tyre përkatës.

Një fazë tjetër kërkimesh do të përkonte me gërmime arkeologjike të ndërmarra në një pjesë të fortifikimeve të kësaj traseje si në Vig (3), Rosujë (4), Bushat, Pecë, Bardhocë, Domaj (Ujmisht) (5), dhe në disa vendbanime përreth tyre.

Megjithë këto arritje, ende mungojnë botimet për fortifikimet e rrjedhjes së poshtme të Drinit të Zi, ku i vetmi burim për shtrirjen gjeografike është ai që botuan një grup autorësh në Historinë e Arkitekturës Shqiptare (6).

Tabloja e gjurmëve rreth këtij problemi nuk do të qe e mjaftueshme pa kërkimet që janë zhvilluar në Kosovë, pasi siç dihet, një pjesë e mirë e trasesë Lissus-Naissus, kalonte në këtë areal gjeografik. Gërmimet e kryera në Ulpjanë dhe Soçanicë (7) ofrojnë të dhëna me rëndësi për këtë trevë qendrore ballkanike, por nuk janë pa interes dhe gjurmimet e fortifikimeve të tjera. (8).

Qëllimi i këtij punimi do të jetë grupimi i kështjellave të ndërtuara në funksion të rrugës Lissus-Naissus së bashku me përcaktimin kohor, saktësimet planimetrike dhe lidhjet mes tyre të nxjerra rishtas në pah nga gërmimet arkeologjike që u kryen në kështjellat e Drinit të Bardhë e të Zi. Njëkohësisht do të veçohen monumentet e

DO NOT COPY



Fig. 1. Harta e rrugës Lissus - Naissus

kësaj periudhe, të ndara në dy faza ndërtimore siç janë shek. III-IV dhe VI. Vëmendje do t'i kushtohet dhe pasqyrimit sa më të hollësishëm të kësaj traseje së bashku me degëzimit e saj.

Veprimtaria ndërtimore e rrugëve të rëndësishme, zënë fill që në kohën e Augustit për të arritur më pas kulmin gjatë sundimit të Trajanit dhe Hadrianit, përveç trasesë së rrugës Egnatia dhe asaj bregdetare u shtri edhe në aksin perëndim-lindje me qëllim lidhjen e bregdetit Adriatik me Ballkanin Qendror, gjithë nëpërmjet rrugës Lissus-Naissus, e cila shfrytëzonte luginën e Drinit (fig. 1). Burimi më i rëndësishëm për intinerarin e kësaj rruge është "Tabula Peutingeriana "(10) ndërsa njoftimet e tjera përmbajnë vetëm emrat e disa vendbanimeve ose koordinatat e disa qyteteve (11).

Përveç burimeve të shkruara, gjurmimet arkeologjike të kryera kanë fiksuar të dhëna interesante mbi ekzistencën e fragmenteve ndërtimore të kësaj traseje të zbuluara në Lezhë, Kabash, Flet, Dobrunë, Krumë, Bardhocë etj.

K. Miller në "Tabula Peutingeriana" ka dhënë stacionet së bashku me largësitë midis tyre që janë: Lissus (Alessio) XXX-Ad Picaria (Pukë), XXX-Creveni (Spas-Drin) XVII - Gabuleo XXX-Theranda (Duljen-Prizren)XXV - Viciano (Ulpjana) XII – Veclanum (Prishtinë) XIX - Vindenis (Podujevë) XX –Ad fines (Kushumli) XX-Hammeo (Prokupje) VI – Ad Herculem –Naisso (Nish) (12) (fig. 2).

Lissus (Lis-Lezha) është stacioni i parë i shënuar në "Tabula Peutingeriana" i cili në shek. IV paraqitet mjaft i përshtatshëm si pikënisje, pasi në këtë periudhë eksistonte një skelë detare me rëndësi për bregdetin Adriatik (Nymfeu-Shëngjini i sotëm), (14). I sjellë me fytyrë nga deti, pikëkalimi rrugësh të rëndësishme tokësore dhe detarë, me prapatokë të pasur me xeherorë sidomos me bakër, qyteti i Lisit u bë një qendër e rëndësishme ekonomike politike e kulturore (15), që përfaqësonte në intieraret e kohës të vetmen pikëlidhje të pjesës kontinetale me Adriatikun. Për rëndësinë e veçantë strategjike të kësaj qendre dëshmojnë burimet historike dhe kërkimet arkeologjike. (16). Përkujdesja që i është kushtuar gjatë periudhës së hershme të pushtimit romak,



Fig. 2. Tabula Peutingeriana

shtrirë kjo kryesisht në rifortifikimet që u kryen në shek. II-I p. e. s. (17) dhe më pas në shek. I e. s, kohë kjo që përkon me kthimin e Lisit në një municipium. Në periudhën e shek. IV-VI, Lisi na paraqitet një qendër me rëndësi të veçantë administrative në provincën e sapokrijuar të Praevalit. Në përbërje të tij tashmë ekzistojnë seli peshkopatash dhe nga pikëpamja ekonomike është kthyer në një qendër me veprimtari zejtaro-tregtare (18).

Pas pushtimit të qytetit në fund të shekullit VI vërehet një tkurrje e ndjeshme në urbanistikën e Lisit, dhe qyteti asokohe vjen e përqëndrohet në lagjet buzë Drinit. Autorët kanë konstatuar se nevojat e qytetit ende plotësohen nga disa godina kulti e publike, siç janë bazilikat paleokristiane të ndodhura "intra et extra muros", të mëdha në përmasa dhe të pasura në elemente arkitekturore (19).

Pas shkëputjes që bënte rruga nga trungu Scodër-Lis-Dyrrah, mbas Lisit duket se traseja ndiqte intinerarin e sotëm Lezhë – Vau i Dejës dhe sipas të dhënave të "Tabula Peutingenaria "stacioni vijues XXX milje pasum është Ad Picaria

DO NOT COPY

DO NOT COPY

(20). Pikërisht përgjat kësaj traseje, në nyjen ku bashkohen Gjadri, Voma dhe Kaftalli, luginat e të cilave hyjnë thelle në zonën malore, ndodhet kështjella e Vigut (21). Ajo zotëronte një pozitë të rëndësishme strategjike, në rajonin ku kryqëzohen disa rrugë siç fjala vjen arteri Vig-Korthpulë – Pukë – Vau i Spasit – Gjakovë dhe Vig-Kalivaç-Rrëshen.

Kështjella ka planimetri në formë trapezi të çrregullt më sipërfaqe 0, 65 ha (fig.3). Muret rrethuese të saj kanë gjerësi 2, 35-2, 45 m.



Fig. 3. Planimetria e Vigut

Në ndryshim prej një sërë fortifikimesh të tjera këtu kurtinat bashkëlidhen organikisht që në themel me kullat. Teknika e ndërtimit të mureve është "opus mixtum", me muraturë guri dhe breza tulle. Në vendet e ruajtura vërehet llaçi i përhapur në formë suvaje që mbulon sipërfaqen më të madhe të gurit, duke lënë në dukje vetëm mesin, dukuri e përhapur dhe në fortikimet e kësaj periudhe në luginë të Drinit.

Kështjella përforcohej prej 12 kullash të fuqishme, të cilat ndërlidhen organikisht me murin rrethues duke paraqitur një ndërtim monolit, veçori që, siç konstaton autori, vërehet pas shek. III (22).

Kullat kanë planimetri drejtkëndëshe në meset, me ballë të harkuar afër hyrjeve dhe sektorialë në anët. Tradita e fortifikimeve fushore të periudhës së vonë antike është se në skajet e tyre kullat kanë forma kuadratike, freskore dhe shumë rrallë rrethore, siç kemi ndeshur kohët e fundit në kështjellën e Bushatit (Kukës) (23).

Një element i rëndësishëm i kështjellës së Vigut është oborri i fortifikuar (propugnaculum) që paraqet një variant të veçantë, të pranishëm dhe në kështjellat fushore të Scampisit dhe Bushatit. Ky konceptim që lidhet me mbrojten e hyrjes me dy kulla në anë të një oborri të fortifikuar zë fill në periudhën antike e vazhdon deri në shek. IV, në periudhën e sundimit të Kostandinit (24).

Kërkimet e kryera treguan se sipërfaqia relativisht e vogël e kështjellës së Vigut (0, 65) ishte e destinuar për qëndrimin e një kohorte. Ajo ka luajtur rolin e një stacioni kontrolli ushtarak në rrugën Lis-Ratinaria. Nisur nga një mbishkrim votiv, kështjella e Vigut identifikohet me statio Adpicaria. Sipas A. Baçes, Vigu përputhet me largësinë në milje ose 44 km, pikërisht gjatësia e itinerarit Lis-Vig. Një e dhënë tjetër është dhe fakti që në kozmografinë e anonimit të Ravenës, shek. V-VI (25), stacioni rrugor Adpicaria nuk shënohet duke kaluar nga Lisi në Crevenium, gjë e cila lidhet me braktisjen e kështjellës së Vigut si pasojë e invazionit got.

Gjatë trasesë së rrugës Adpicaria-Crevenium vërehet disa fortifikime me sipërfaqe të kufizuar të tërhequra nga aksi kryesor siç janë kështjellat e Micajve, Kabashit dhe Fletit (fig.1). Nga vëzhgimet e bëra nga këto fortifikime rezulton se ato janë ndërtuar në pikat më të larta të terrenit, në funksion të një poste vrojtimi.

Gjurmët e rrugës Lissus-Naissus, pas stacionit Adpicaria janë zbuluar rrëzë kështjellës së Fletit. Fragmentet e kësaj traseje janë 2, 30 m të gjera, të hapura në shkëmb dhe të shtruar më zhavorr

DO NOT COPY

Degëzimi lindor i kësaj traseje do të ndiqte vijën: Vau i Spasit-Kostur-Helshan-Qafë Prushi-Gjakovë.

Të tillë rol kjo qendër e ruajti deri në periudhën mesjetare si pikë e rëndësishme doganore, përmendur në dokumentat e sek. XIV. (37). Njëkohësisht Vau i Spasit në shek. XVII ishte një vendbanim me 1000 shtëpi, një xhami, një han dhe dhjetë dyqane (38).

Përgjatë rrugës që kalonte nga Vau i Spasit në Helshan e më pas në Gjakovë, afër rrjedhjes së Drinit në bregun e majtë të tij është ngritur kështjella e Kosturit, vendosur në dy maja shkëmbore (39). Teknika e punimit të mureve rrethuese që ende ruhen (40), është me gurë shkëmborë të papunuar, të lidhur me llaç të fortë. Nisur nga qeramika e zbuluar mbi sipërfaqe, kjo kështjellë datohet në periudhën e vonë antike.

Nga Creveni rruga do vazhdonte në drejtim të Shën Mërisë ku në një kodër trajtë konike me zgjatim jug-veri janë zbuluar gjurmët e një kështjelle, e cila njihet me toponimin "Qafa e qytezës". Ajo kufizohet në perëndim dhe në lindje nga përrenjtë e Seriqës dhe Shënmërisë. Vëzhgimet sipërfaqësore të kryera e datojnë fortifikimin në shek. IV-VI. Së këndejmi rruga do të vazhdonte përgjatë Drinit pranë "Kodrës së Babçorrëve" (Kalimash) ku mendojmë se ruhet një kullë vrojtimi e tipik benefic, e cila shërbeu si pikë ndërmjetëse e kalimeve nga Shënmëria për në Brut, në të cilin kërkimet e kryera pasqyrojnë ekzistencën e një vendbanimi të periudhës romake. Me interes nga materiali arkeologjik i zbuluar, i cili nuk mungon, veçojmë një figurinë prej bronzi të hyut të Mërkurit (fig.6). Në këtë statujëz, Mërkuri paraqitet lakuriq, në lartësi 5. 6 cm (41). Këmba e djathtë është në ecje, e nxjerrë pak përpara, kurse e majta e përkulur lehtë me qëndrim pak prapa. Perëndia krahun e djathtë e ka të lëshuar, ndërsa me dorën e majtë, me sa duket, shtërngon kerykerionin, duke e kapur atë në fund. Në krah është mbështjellë dhe pjesa e klamisit që varet poshtë. Klaudia e hedhura mbi supën e majtë e cila mbështjellet mbi krahun e majtë, i jep statuetës atributet e Mërkurit.



Fig. 6. Mërkuri nga Bruti

Trajta e trupit lakuriq, si gjoksi dhe barku, janë përshkuar nga disa vija që tregojnë muskulaturën. Flokët i ka të dëndur me linja të përdredhura, të shkurtër, të krehur përpara, ndërsa mbi kokë është vendosur petasis. Sipërfaqja e lëmuar e saj është karakteri stikë në prodhimet romake të figurinave prej bronzi (42).

Kjo statujëz ruan një cilësi shumë të mirë dhe përfaqëson artin e kultivuar romak. Pozicioni i trupit, muskulatura etj., të kujtojnë skulptorin e shek. VI, Polikletin. Stilizmi i të gjitha detajeve, modelimi delikat, etj., ruajnë me rreptësi parametra të saktë të simetrisë. Cilësia dhe trajtimi stilistik në këtë figurinë, na shtyn të supozojmë se kemi të bëjmë me një objekt të importuar të një tipi mjaft elegant të artit romak të figurinave prej bronzi, që përfshihen në stilin greko- romak të shek. I. (43).

Padyshim, zbulimi i statujëzës së Mërkurit në fshatin Brut, është tregues që pasqyron zhvillimin e rrjetit rrugor në zonën ku kalonte traseja Lissus-Naissus (44), e cila së bashku me figurinat e tjera të këtij hyu të zbuluara në Kosovë

(45), flet për një rritje të aktivitetit tregëtar të kësaj kohe.

Nëqoftëse për stacionet e tjera është dhënë identifikimi i tyre me qendra banimi duke arritur kështu të përcaktohet drejtimi i rrugës Lissus-Naissus, për statio Gabuleo, mendimet janë të ndryshme. Tomaschek e verdos fillimisht Gabuleon në afërsi të Prizrenit, por më vonë është i mendimit se ndodhet pranë Gjakovës (45). E. Çerskov, duke përcaktuar drejtimin e rrugës, e cila dilte në të majtë të Drinit të Bardhë shprehet se"stacioni tjetër Gabuleo, 30 milje romake nga Theranda, gjendet pikërisht në kufirin shqiptaro-jugosllav (46). Edhe stacionet e tjera që janë shënuar në "Tabula Peutingeriana"mund të kërkohen vetëm në territorin e Shqipërisë(47). Ndërsa Tomashek shfaq mendimin se stacionet Theranda dhe Gabuleo duhet kërkuar në territoret midis Piranës dhe Nashecit (Kosovë), gjë që do të shkaktonte zhvendosjen e të gjitha stacioneve të tjera (48). Majer e lidh Gabuleon me qytetin ilir Cibalea, që do të thotë "krye"ose "majë"(49), pra kuptojmë se këto vendbanime ndodhen në udhëkryq ose aty ku ndahen rrugët apo lumenj. Z. Mirdita, duke folur për përcaktimin e kufirit perëndimor të Dardanisë, e vendos Gabuleumin në pikëderdhjen e Drinit të Bardhë e të Zi, pikërisht në Kukës (50). Pozita gjeografike e Kukësit, në vendin e bashkimit të Drinave, si dhe përputhja e plotë e largësisë prej 30 milje me Therandën, na shtyn të mendojmë se ky vendbanim mund të identifikohet me Gabuleon. Mungesa e një bashkëpërshtatje etimologjike në mes të Kukësit dhe Gabuleot shpjegohet me faktin se shumë stacione ose qendra të rëndësishme lokale, me kalimin e kohës nuk ruajtën emrin e tyre, siç ndodhi dhe me qendra të tjera të kësaj traseje. (51).

Nga Statio Gabuleo shkëputet një degë e rëndësishme e trasesë me drejtim jugor për në Grazhdan (Dibër). Ajo ndjek pothuajse me përpikmëri luginën e Drinit të Zi (fig.7) dhe dallohet për dendësinë e fortifikimeve që ndodhen



Fig. 7

në të dyja anët e saj, gjurmët e së cilës i gjejmë sot në Domaj, Vilë, Dodë, që njihen nga vendasit me toponimet "Udha e Pashës" dhe "Udha e dervenit". Përveç lidhjeve të ndërsjellta Kosovë-Dibër, këtu realizohej njëkohësisht komunikimi me trevat juglindore të Shqipërisë.

Aksi i rrugës trase Lissus-Naissus kalonte nëpër pjesët e buta në të djathtë të rrjedhjes së

DO NOT COPY

DO NOT COPY

poshtme të Drinit të Zi, pranë fshatrave Ramhas dhe Kënetë (52). Më pas, nëpërmjet qafës së Gostilit vijonte për në Nangë, ku në shek. II-III ishte krijuar një latifund romak (53). Pikërisht, në këtë areal gjeografik, mbi një kodër me lartësi 350 m është ndërtuar kështjella e Bushatit, e njohur me toponimin "Kalaja e Gjenovizit". Fortifikimi me një pozitë të rëndësishme strategjike, kontrollonte rrugën që kalonte nga kështjella e Pecës, në qafën e Kolesianit e më tutje nëpërmjet fortifikimeve të Damajve, Çepës, Vilës, Dodës etj; përfundonte në Dibër (fig.8).



Fig. 8

Gërmimet arkeologjike të kryera në vitet 1983 dhe 1985, treguan për praninë e dy shtresave kulturore që u takojnë periudhave të ndryshme kohore: antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme (54). Kështjella e Bushatit ka formën e një elipsi me perimetër 395 m që shtrihet afërsisht në një sipërfaqe prej 0. 70 ha. Teknika e ndërtimeve të mureve është ajo me gurë të punuar mesatarë e të vegjël, mbushur me llaç të bollshëm, përzier me copa tullash si dhe "opus mixtum", realizuar në kullën nr. 11, me gurë e dy breza tulle me fugaturë sa 1/3 e trashësisë së tullës. Përgjithësisht, muret rrethuese janë ngritur mbi një xokolaturë me gurë të punuar, teknikë kjo e përhapur dhe në kështjella të tjera si në Pogradec, Berat, Durrës, Korçë etj. (55).

Hyrja kryesore e kështjellës është ndërtuar me disa veçori dalluese nga fortifikimet e tjera të kësaj periudhe, e ndarë në dy pjesë: a) oborri i jashtëm ose paraporta; b) hyrja me fortifikimin e saj (fig.9). Ajo përforcohet nga dy kulla në trajtë "U"-je që gjënden 3, 20 m larg nga njëra-tjetra(56).



Fig. 9

Ndërtimi i hyrjes së kështjellës së Bushatit gjen përngjasime me hyrjet e fortifikuara me oborr të tipit "propugnaculum", i cili ndeshet pothuajse në të gjitha kështjellat fushore ushtarake, deri në periudhën e Konstandinit, e pikasur në Shqipëri kryesisht në Kështjellën e Skampisit (57), ndërsa jashtë vendit tonë gjejmë ngjashmëri me Ulpjanën

DO NOT COPY

(Kosovë), në "Portën Veriore" të Abritusit, me "Portën Jugore" të Kampit të Aktivikumit, që datohet në shek. IV (58).

Bushati nga pikëpamja e trajtimit arkitektonik dhe ndërtimor siç është vërejtur, futet në grupin e castrave fushore ushtarake së bashku me Vigun, Skampisin, Paleokastrën dhe Grazhdanin (59) e destinuar për stacionin e një kohorte cohors equitata quingenaria. Materiali arkeologjik i zbuluar, ku mund të veçojmë disa fragmente enësh të prodhimit provincial romak, pjesët e një mbishkrimi latin etj. të bën të mendosh se Bushati është një ndërtim që më së shumti i përket gjysmës së dytë të shek. III.

Nga këtu traseja jugore merrte drejtimin për në Qafë të Kolesianit dhe kalonte fshatin Domaj



Fig. 10

(Ujmishit) ku ndodhet një kështjellë mbi një kodër që njihet me emrin "Kepi i Kalasë". Ajo ka një pozitë të rëndësishme strategjike në zonën që shtrihet nga qafa e Kolesianit deri në Skavicë (fig.10).

Gërmimet arkeologjike që u kryen në këtë qendër u përqëndruan në anët më të ruajtura të kështjellës, në një sipërfaqe prej 325 m2, me qëllim zbulimin e plotë të mureve rrethuese, të hyrjes dhe të kullës. Në ndryshim nga fortifikimet e tjera të pellgut të Drinit të Bardhë, muret rrethuese të Domajve nuk ndjekin vijat rrushkulluese të kodrës, por vijojnë duke krijuar kënde të drejta, veçanërisht në pjesët veriperendimore, gjë që i japin planimetrisë së kështjellës një formë të çrregullt. Muret rrethuese janë punuar me gurë të përmasave mesatare të lidhur me llaç të një cilësie shumë të mirë. Në ndërtimin e tij vërehet prirja për një vendosje horizontale të gurëve, ku fugat ruajnë trajta të rregullta me trashësi 2-3 cm (fig.11), ndërsa në faqet anësore të hyrjes në kështjellë është kryer dystimi me llaç të bollshëm në formën e suvasë,



Fig. 11

teknikë kjo e përhapur në Pecë, Bushat (Kukës) dhe në disa fortifikime të shek. IV-VI në Shqipëri (60). I gjithë muri rrethues ka një gjatësi prej 165 m dhe trashësi që luhatet nga 1,10-1; 45-2, 10m.

kënde terrenit. Ato janë punuar me gurë të madhësive mesatare e të palidhur me llaç, teknikë që haset ne Bardhoc dhe Vilë. Gjithë fortifikimi ka një kullë në pjesën veriore me përmasa 7x9 m, ndërsa muret ruajnë gjerësinë prej 1,55 m. Ashtu si në Bardhoc dhe në Vilë, në pjesët më pak të mbrojtura natyrore, muret janë ndërtuar me llaç. Kjo vërehet në anën veriore pikërisht tek kulla ballore. Në anët e tjera fortifikimi ka mure në të thatë, të palidhur me llaç, të cilat ruajnë gjerësinë 1,40 m. Ndërtimi i mureve në të thatë është kryer me blloqe të madhësive mesatare. Autori mendon që lartësia e tij nuk duhet të ketë qenë e madhe, mbase deri në nivelin e një gjoksmbrojtje (63). Vëzhgimet në këtë qëndër, nuk kanë konstatuar gjurmë të qeramikës. Veçoritë teknike të ndërtimit të mureve rrethuese dhe të kullës, e vendosin kështjellën e Dodës në një grup me Bardhocin e Vilën, të cilat përfshihen në shekullin VI.

Pasi kalon kanionin e Skavicës, rruga vijon në drejtim jug-perëndimor, duke prekur fortifikimet që ndodhen përgjatë saj siç janë Suhadolli, Hoteshi etj. (64). Kërkimet e kryera në Suhadoll kanë zbuluar disa objekte, siç është një banesë, dyshemeja e së cilës është shtruar me pllaka mermeri, kapitele dhe bazamente prej guri. Vërehen njëkohësisht dhe gjurmë muresh të lidhura me llaç. Po ashtu në afërsi të kështjellës së Volës (Suhadoll), ruhet një vendbanim i fortifikuar, përgjatë rrugës që shkon për Borovjan. Në gjatësinë e trasesë që shkon për në kështjellën e Videnit janë zbuluar gjurmë rruge në Hotesht (65), ku dallohet qartë shtrimi i saj me kalldrëm. Në këtë mjedis, në zonën e ndërmjetme të vijës Qidhna-Shupezë, ndodhet një fortifikim që krahasohet nga teknika e ndërtimit me Rosujën. Nisur nga materiali arkeologjik i zbuluar, kjo qendër datohet në shek. III-IV.

* * *

Aksi kryesor i rrugës do të ndiqte intenerarin Gabuleo-Theranda, në të majtë të rrjedhjes së Drinit të Bardhë. Pikërisht, në një gjuhëz kodrinore me zgjatim nga verilindja, përballë Kullës së Lumës, ngrihet kështjella e Pecës. Gërmimet sistematike të kryera në këtë qendër (66) sqaruan sistemin fortifikues të kështjellës dhe periudhat kohore të zhvillimit historik të këtij vendbanimi (67) i cili u fortifikua me mure në fund të shek. III dhe fillim të shek. IV, duke fituar kështu një rol të rëndësishëm strategjiko-ushtarak në pellgun e Drinit të Bardhë. Gjatë kësaj periudhe, Peca u plotësua me banesa, kullë, taracime të ndryshme, kishë etj. Nisur nga teknika e punimit të mureve, forma planimetrike e kështjellës dhe kryesisht nga lënda arkeologjike e zbuluar është vërejtur se këto ndërtime u përkasin dy fazave: a) shek. III-IV, në të cilën përfshihen muret rrethuese, kulla, banesat dhe taracimet; b) shek. VI që përfshin kishën me mjediset e saj. Muret rrethuese të kështjellës ndjekin vijat rrushkulluese të kodrës duke i dhënë asaj një formë të çrregullt e të ndërvarur nga terreni. Ato përfshijnë një perimetër prej 445 m, me sipërfaqe prej 1 ha, por gjurmë të vendbanimit janë vërejtur dhe jashtë sistemit fortifikues të kështjellës (Fig. 14). Muri është ndërtuar me gurë gëlqerorë kuadratikë të përmasave mesatare, lidhur me llaç të një cilësie të dobët (Fig. 15) me trashësi që luhatet 1.20-1.80-2.20 m. Në pjesë të veçanta të sipërfaqes së gurit, veçanërisht në ato të brendshme, vihet re një dystim i lehtë në trajtë suvaje, teknikë kjo e njohur në Bushat, Vig dhe Pogradec (68). Teknika e ndërtimit të murit me llaç të dobët, si dhe shtresa kulturore mbi të cilën janë ngritur këto mure, flasin qartë për fundin e shek. III dhe fillimin e shek. IV. kjo nisur dhe nga krahasimet që mund të bëjmë më Bushatin apo me fortifikimet e tjera të kësaj periudhe të B. Currit, të pellgut të Dibrës, të Korçës, të rrugës Egnatia dhe të Mallakastrës (69).

Sistemi fortifikues i kështjellës është përforcuar nga një kullë në trajtë "U"-je vendosur në kuotën më të lartë të kodrës ndërtuar me planimetri të rregullt që e siguron nëpërmjet një harku të lehtë në pjesën ballore.

DO NOT COPY



Fig. 14



Fig. 15



Fig. 16

Njëkohësisht një element i ri i arkitekturës së kështjellës në këtë periudhë janë muret e tarracimit (Fig.16), që shtrihen në hapësirën ndërmjet kullës dhe kishës. Qëllimi kryesor i ndërtimit të tyre qe ulja graduale e pjerrësisë së kodrës, duke mundësuar lidhjet midis kullës dhe mjediset përreth. U ndërtuan gjithsej pesë shkallare në formë tarracash të përmasave 5x1m.

Banesat në Pecë janë të vendosura në anën lindore të vendbanimit. Kanë planimetri katrore me përmasa 6 x 5 m, me mure të ruajtura në lartësinë 0. 60-0. 70 m. Hyrjet, të cilat hapen në anën veriore, janë 0. 80 m të gjera, ndërsa në qoshet janë të punuara me kujdes. Dyshemetë i kanë të shtruara me kalldrëm, mbi të cilin është vënë një cipë e hollë llaçi (0, 07 m), teknikë që

DO NOT COPY

DO NOT COPY

ngjason me ndërtimet e shek. IV në Bushat dhe Krujë (70). Nisur nga gjetjet e shumta të tjegullave, mendojmë se çatitë e banesave kanë qenë të mbuluara me këtë material. Përsa i përket konstruksionit të tyre, duke u mbështetur në mbetjet arkitektonike, mendojmë se ato kanë qenë të ngritura me mure në një lartësi që nuk i kalonte 1. 5 m, ndërsa pjesa tjetër e kësaj lartësie është plotësuar me lëndë, me çati të mbuluar me tjegulla.

Shekulli i VI në kështjellën e Pecës përmban në vetvete përveç kulturës materiale dhe ndërtime të reja. Në qendër të vendbanimit u ndërtua kisha së bashku me mjediset e saj, sipas një arkitekture që është karakteristikë për këtë periudhë. Në kohën e dyndjeve sllave, në perandorinë bizantine u shtua shumë aktiviteti në fortifikimet e luginave nga ku depërtimet ishin më të mundshme. Ky proces u ravijizua dhe në Dardani, dëshmi të të cilit kemi listën e Prokopit të Cezaresë "De Aedificiis", i cili përmend një sërë kështjellash që u ndërtuan ose u rindërtuan nga Justiniani. Kështu, kështjella e Pecës mendojmë se mund të identifikohet me emrin e një kështjelle të rindërtuar në Dardani, të quajtur PENTZA (71).

Nga Peca vinte e shkëputej një degëzim rrugor, i cila ndiqte anën e majtë të Lumës. Nga zbulimi i rrënojave të një kulle në Grykën e Vanave (72), me gjatësi të ruajtur 18 m, me trashësi muri 2 m, punuar me gurë lumi mesatarë dhe të mëdhenj, lidhur me llaç të bollshëm me përmbajtjen e të cilit vërehet shumë gëlqere, datuar në shek. III-IV, mendojmë se kjo duhet të lidhet me ekzistencën e një poste kontrolli të tipit "benefic", pasi kjo luginë bënte të mundur komunikimin në mes të rajoneve të Drinit, e si rezultat edhe lëvizjet tregtare në mes të Shkodrës dhe Maqedonisë. Një e dhënë tjetër me interes është ngritja në Novosej e një fortifikimi (73), i cili i përkiste shek. III-IV dhe kishte për detyrë të vëzhgonte pikërisht këtë trase sekondare që nisej nga Peca, nëpërmjet Grykës së Vanave, duke kapërcyer në Bjeshkën e Shishtavecit, nga ku një degë tjetër lidhej me zonën e Prizrenit nëpër fshatrat e Opojës, ndërsa vija tjetër rrugore do të kalonte në Shishtavec, Novosejë për në Tetovë (Maqedoni). Kjo rrugë vazhdoi të funksionojë deri në pushtimin otoman, dëshmuar kjo nga një sërë monumentesh të kësaj periudhe dhe nga zbulimi i një thesari monedhash të Komnenëve në Borje.

Pas vendbanimit të Pecës, përgjatë rrugës Gabuleo-Theranda, është rë ndërtuar mbi një kodër konike me lartësi 517 m, në rrjedhjen e poshtme të Drinit të Bardhë, Gradishta e Bardhocit (74), e cila kufizohet në lindje me fshatin Bardhoc, që shtrihet rrëzë malit të Koretnikut, ndërsa në anën perendimore me lumin Drin i Bardhë. Në veri ka përpara pellgun e Drinit deri në Vërmicë (Kosovë), kurse në jug kufizohet me përroin e Resnikut (Fig.17).



Fig. 17

Kështjella zinte pjesën më të lartë të kodrës, pikërisht anën verilindore të saj. Rrëzë saj, në "Kodrën e Brakajve" janë gjetur gjurmë kalldrëmi të një rruge 6 m të gjatë dhe gjerësi (të ruajtur) 3 m, që me sa duket i përkiste trasesë së rrugës Lissus-Naissus (75). Ajo njihet me toponimet "Udha Pukë" dhe "Rruga e Kerreve".

Duke u mbështetur në analizën e materialit arkeologjik dhe në elemente fortifikuese të kështjellës u vërejt se Gradishta e Bardhocit ka kaluar tri periudha me dallime të mëdha kohore. Vlen të vihet në dukje se lënda arkeologjike e zbuluar në shtresën Bardhoc I, duke u mbështetur në disa gjetje me interes kronologjik, qoftë të materialit të imët qeramik ashtu dhe nga teknika e punimit të mureve rrethuese, përcakton si periudhë të parë, fillimin e hekurit të hershëm. Të dhëna më të plota kemi për fazën e dytë, që përkon në kohë me periudhën e vonë antike, që si rezulton nga analiza e materialit të zbuluar, fortifikimi u ngrit pjesërisht mbi ndërtimet e periudhës së parë dhe se gjurmët e banimit janë të pranishme në të gjithë sipërfaqen e kështjellës. Ato zënë hapësirë prej 0, 54 ha, pasqyruar kjo në ndërtimin e mureve rrethuese me perimetër 585 m; dhe të pjesëve të tjera të arkitekturës së kështjellës, siç janë kulla, porta, banesat etj.

Tipologjia teknikisht e ndryshme në muraturën e Bardhocit mendojmë se nuk ka të bëjë me ndasi kronologjike, pasi kjo dukuri është e përhapur dhe në fortifikime të tjera të luginës së Drinit të Zi dhe të Rrafshit të Dukagjinit, datuar në periudhën e vonë antike (77), (Fig. 18,a,b).

Të dhënat e përftuara nga gërmimet e kryera në Gradishtën e Bardhocit, materiali i imët arkeologjik ku mund të veçojmë ojnohetë e pikturuara me shirita vertikalë, me ngjyrë të bardhë mbi sfond kafe të mbyllur, çka gjen pika takimi me enët e këtij tipi të zbuluara në varrezat arbërore të Krujës dhe Lezhës, datuar në shek. VI-VIII; gjithë kjo sa u tha e vendos këtë kështjellë në shek. VI.



Fig. 18, a



Fig. 18, b

Krahasuar me qëndra të tjera të fortifikuara të pellgut të Drinit të Bardhë, Bardhoci bën pjesë në fortifikimet me planimetri të thjeshtë me një kullë. Në ndryshim nga fortifikimet fqinje të këtij pellgu, këtu vërehen dy teknika në ndërtimin e mureve. Nga pikëpamja e trajtimit arkitektonik, Bardhoci hyn në grupin e kështjellave që janë fortifikime të mirëfillta ushtarake, por ndryshon dukshëm nga Bushati i cili është ndërtuar me karakteristikat e një kastre fushore. E vendosur në kuotën më të lartë të kësaj zone, Gradishta e Bardhocit kontrollonte rrugën Lissus-Naissus që vinte nga Peca për në thellësi të trevës dardane.

DO NOT COPY

Pas Gradishtës së Bardhocit, rruga do të ndiqte itinerar: - "Trojë" Morin (78) – Qafë e Marinit-Vermicë-Qafë e Zhurit-Vlashnjë (79) – Prizren" duke kaluar kështu në territorin e Kosovës.

Përhapja gjeografike e fortifikimeve të vona antike në Kosovë është e larmishme. Ato shtrihen në pikat strategjike të rrugëve siç është rasti i fortifikimeve të Karashëngjergjit (Zym), Vlashjes e Prizrenit në aksin Gabuleo-Theranda, apo "Hisari"-Suharekë, në pellgun Grevenium-Viciano, Bellaqevcit dhe Verbovcit në vijën Therandë-Ulpjanë. Një fortifikim tjetër përgjatë trasesë Pejë-Mitrovicë-Mun është ai që ndodhet pranë Rudnikut, ndërsa në aksin jugor Ulpjanë-Scup, vërehet ngritja e fortifikimeve të Cërnicës dhe Vitisë (Fig. 1).

Karakteristikë e përgjithshme e tyre është se ato janë të ndërtuar në kodrat përreth luginave të lumenjve mbi konstruksionet e hershme, të cilat funksionuan dhe gjatë periudhës romake dhe bizantine. Ndonëse kërkimet në fortifikimet e periudhës së vonë antike janë të pakta, është mbërritur të vërehet se në këtë krahinë nuk ndeshen fortifikime të tipit të Vigut apo Bushatit, por të tilla të përafërta me Bujanin, Pecën, Bardhocit, etj. (80), që shikohen si ndërtime vendase të lidhura ngushtë me traditën e hershme ilire (81).

Një ndër këto qëndra të fortifikuara është "Hisari" i Kastercit afër Suharekës (82), i cili ndodhet në gjatësinë e rrugës Therandë-Viciano-Mun DD (fig.19).

Kërkimet e kryera kanë sqaruar se ky fortifikim ka kaluar nëpërmjet tri fazave ndërtimore: a) Faza e parë do të përfshinte ndërtimin e një ledhi prej dheu nën të cilin është hapur një lug si përforcim i sistemit mbrojtës së qytezës, që kohësisht lidhet me shek. VIII-V p. k. e ngjashme me Bellaqevcin, "Hisarin" në Gadimjen e Epërme, etj. b) Si fazë e dytë përcaktohet ngritja në anën lindore dhe veriore e mureve me trashësi 1,30 m ndërtuar me blloqe



Fig. 19

guri të papunuar të palidhur me llaç, teknikë kjo që ka një shtrirje të gjatë kohore e ndeshet që në periudhën e hekurit e deri në antikitetin e vonë. Datimin e kësaj faze të dytë autori e le të hapur, pasi kjo do të mundësohet pas kërkimeve të tjera arkeologjike; c) Në fazën e tretë, vërehet një zgjerim i hapësirës së fortifikuar. Teknikisht muret janë të ndërtuara me gurë të lidhur me llaç dhe njëkohësisht iu përkasin periudhës së vonë antike dhe mesjetës së hershme (83).

E gjithë sipërfaqja e fortifikuar është 13. 000 m^2 mbi të cilën vërehen konturet e disa godinave të vogla që ruajnë trajta katrore. Material tjetër i zbuluar janë tjegullat antike dhe pjesët e kulmeve të godinave (imbrekset) Njëkohësisht me shumë interes është zbulimi i dy kryqeve prej ari si dhe monedha të perandorit Arkad (395-408) dhe të hershme bizantine.

Autori mendon se kjo qytezë e fortifikuar gjatë gjithë jetës së saj ka shërbyer si një qendër me rëndësi për zhvillimin e blegtorisë dhe shfrytëzimin e mineraleve që ndodheshin në afërsi të kësaj kështjelle (84).

Do not copy

Stacionet e rrugës Lissus-Naissus që takohen në territorin e Kosovës janë, Theranda, Vicianum, Vindenis dhe Ad Fines. Mendimet për identifikimin e tyre janë të ndryshmer (85). Kështu, Theranda është vendosur nga Miller në fshatin Drenovc të Duhlës (86), ndërsa studiues të tjerë e kanë përcaktuar në Gjakovë, Prizren dhe Suharekë (87). Një panoramë e njëjtë mendimesh na paraqitet dhe për stacionin tjetër Vicianum, të cilin Miller e identifikon me Lipianin ose Ulpianën antike, që është mbështetur dhe nga autorë të tjerë (88), ndonëse ekziston dhe mendimi për vendosjen e këtij stacioni ne Çagllavicë (89).

Përgjatë trasesë Lissus-Naissus(90), Miller ka shënuar dhe një stacion me emrin Veclanum në mes të Vindenit dhe Vicianit, që do të ishte pranë Prishtinës së sotme. Domashevsk e përmend këtë stacion gjatë rrugës Lissus-Naissus, duke e identifikuar me Viciano dhe Beclano (91).

E. Dobruna mendon se është e pamundur që një rrugë me rëndësi si Lissus-Naissus të mos kalojë në Ulpianë, një ndër qytetet më të mëdha të Dardanisë (92). Nëpërmjet kësaj qendre lidhen Ballkani Qendror e Jugor me bregdetin Adriatik duke kaluar nëpër trevën e sotme të Kosovës, si dhe në dy qytetet e rëndësishme të kësaj periudhe Naisi me Skupin (93).

Është hedhur mendimi se kur u ndërtua rruga Lissus-Naissus kjo qendër (Ulpianë) mbante emrin e mëparshëm Ulcianum (94), por më vonë u shënua gabim në trajtën VICIANO dhe jo VLCIANO.

Ulpiana një qytet që shtrihet nga periudha antike e më vonë është zbuluar pranë Graqanicës (95), ndërtuar në udhëkryqet ku kalonte traseja kryesore e rrugës Lissus-Naissus si dhe aksi verior që nëpërmjet luginës së Ibrit lidhej me territorin perendimor të Gadishullit Ballkanik. Ajo u ngrit mbi shtresën e antikitetit ilir, dëshmuar kjo dhe nga Prokopi i Qezaresë i cili thotë se "... në Dardani ka ekzistuar një qytet i vjetër, i cili është quajtur Ulpjanë" (96). Në kohën e Hadrianit ajo u bë një municipium dhe stacion doganor, për të arritur kulmin në shek. III-IV ku u quajt dhe "urbus splendidissima". Në shek. IV, Ulpjana ishte një qendër peshkopale, përmendur në burimet historike të v. 342, kur peshkopi i këtij qyteti merr pjesë në kuvendin e Serdicës (Machedonius e Dardania de Ulpianis).

Pas sulmit të gotëve, në vitin 472 dhe tërmetit të 518, Ulpjana pothuajse u shkatërrua, së bashku me 24 kështjella të tjera, ku në mes tyre burimet përmendin dhe Scupin (98), për t'u rindërtuar përsëri tashmë si një qytet me rëndësi gjatë periudhës së Justinianit me emrin Justiniana Secunda (99).

Stacionet e tjera, Vindenis dhe Ad Fines janë identifikuar respektivisht në fshatin Gllamnik, në jug të Podujevës (100) dhe në Banjska (101).

* * *

Rruga Lissus-Naissus, siç u vërejt, iu nënshtrua në këtë periudhë një veprimtarie intensive ndërtimore, kjo veçanërisht në pjesët qendrore dhe jugore të saj, areal gjeografik që mundësonte kalimet e ndërsjellta Adriatik-Ballkan Qendror. Një situatë e tillë ndërtimore solli krijimin e një tablloje të re, që për rastin tonë nuk ka të bëjë me ngritjen e kështjellave të mëdha, por me rrethime të thjeshta e deri diku komplekse që zotëronin nyjet e rëndësishme strategjike të luginave ku depërtonin arteriet parësore dhe dytësore të trasesë. Vendosja e fortifikimeve nxjerr në pah lidhjet midis tyre, të cilat pasqyrohen në krijimin e disa sistemeve mbrojtëse që janë të diferencuara përsa i përket funksionimit dhe kronologjisë kohore të tyre. Ato shfrytëzuan trasenë antike Labiano-Dardane, në shumë raste dhe fortifikimet e periudhës pre dhe protohistorike ilire, nga ku një pjesë e tyre pas ndërtimit të rrugës Lissus-Naissus, morën një rëndësi të veçantë siç mund të përmendim Lisin, Ulpjanën, Mun DD., etj.

Tabloja pas depërtimit romak, pasqyron krijimin e disa municipeve siç janë Lisi në Bregdetin Adriatik, Mun. DD afër Soçanisë dhe

POKOPOKA

Ulpjana në brendësi të trevës dardane. Lisi, një qendër me origjinë ilire, përmbante në këtë periudhë dy kategori qytetarësh "negotiatores" e "mercatores". Ai shfaqet si një oppidum civium romanorum. (102). Situatë të ngjashme me Lisin kemi dhe në krijimin e municip DD afër Soçanicës, i cili kufijtë e shtrirjes administrative i ka pasur, në lidhje buzë rajonit të Naissusit, në perëndim ndiqte kufirin e kësaj ane të provincës dardane, ndërsa kufijtë verior dhe jugor janë ende të paidentifikuar mire (103).

Karakteristikë themelore e kësaj qendre është bashkekzistenca mes municipiumit dhe kolonisë, në të cilën kishte prona perandorake dhe municipale, vërtetuar kjo nga zbulimi i disa mbishkrimeve (104).

Krahas qendrave municipale, u krijua një rrjet i gjerë stacionesh beneficiare si në Kalimash, Vana, Zhur (Prizren), Mitrovicë, Kaçanik, etj., vendosur në pikat strategjike dhe qendrore të komunikacionit. Njëkohësisht, kërkimet e kryera, kanë treguar se në këtë periudhë u formua një latifund romak në arealin Nange-Gostil, ku shfaqen për herë të parë mbishkrimet latine që flasin për lirinë e skllevërve dhe që ruajnë antroponiminë ilire (105). Krijohen prona konsullore në Dobruzhd (Kosovë) (106), rritet qarkullimi monetar i perandorëve Dioklician, Anastas dhe Kostandin, zbulohen një sërë deposh të veglave bujqësore, furra për pjekjen e qeramikës etj. (107). Krahas tyre, vërehen vendbanime të hapura dhe të fortifikuara që ruajnë traditën autoktone, ku mund të veçojmë Pecën, Rosujën, Vilën dhe një sërë qendrash të tjera të përhapura në Dardani si "Hisari" në Kastera, Bellaqevi etj.

Fundi i shek. III dhe fillimi i shek. IV, ndryshuan pamjen urbane të këtij pellgu gjeografik, pasi siç dihet filloi të ndihet rreziku i dyndjeve të njëpasnjëshme barbare. Kjo përkon me fillimin e një veprimtarie ndërtimore që për mendimin tonë shtrihet në kohë në dy faza të mëdha: a) Faza e parë, do të përfshinte kështjellat e shek. III-IV siç janë Peca, Rosuja, Bushati, Vigu, Vau i Spasit, Çepa, Hoteshti (108) etj.

Drejtimet kryesore në të cilat u krye kjo veprimtari do të ishin: rifortifikimi i kështjellave me origjinë ilire dhe ndërtimi i kështjellave të reja. Gjurmimet e deritanishme kanë zbuluar se fortifikimet e fazës së parë kanë si karakteristikë të përgjithshme planimetritë e thjeshta, të përforcuara me një ose më shumë kulla, me sipërfaqe që luhatet nga 0, 2-1 ha. Përgjithësisht ruajnë forma që i përshtaten kontureve të terrenit ku ato janë ndërtuar, por megjithatë në disa raste, atje ku është e mundur, vërejmë një tendencë për kurtina të drejta. Në një pjesë prej tyre dallohet qartë ndjekja e vijave rrushkulluese, ndërsa në pikën më të lartë me anë të një muri ndarës krijohet një akropol, siç është shembulli i Pecës. Planimetritë e kështjellave të kësaj faze janë të ndryshme – ovale, katrore, trekëndore, të çrregullta, të cilat gjejnë analogji me fortifikimet e kësaj periudhe në rrugën Egnatia, Pellgun e Korçës, me kështjellat përreth Durrësit etj.

Teknika e ndërtimit e përdorur në muraturën e fortifikimeve të fazës së parë është: a) "opus mixtum" (Bushat, Vig); b) me muraturë guri e llaç përgjithësisht të dobët (Pecë, Rosujë etj.).

Përgjithësisht fortifikimet malore kanë funksionin e një poste kontrolli përgjatë luginave të thella. Shumë prej tyre përmbajnë një numër të kufizuar banesash, kryesisht njëdhomëshe, gjë qe flet për mjedise të përdorura nga garnizone ushtarake. Kjo i përgjigjet pasazhit të Prokopit të Qezaresë, i cili thotë se "... atëhere barbarët nuk dinin të bënin fare rrethimin e fortifikimeve, shumë prej këtyre (fortifikimeve)ishin me një kullë dhe një numër të vogël ushtarësh. Kjo mjaftonte për të ndalur kalimet e fiseve barbarë" (109).

Përveç grupit të parë, gjatë kësaj faze u kryen ndërtime të reja, të cilat janë në konceptimin e një kastre romake duke iu përshtatur terrenit ku ato shtriheshin. Siç u vërejt, këto ndërtime u vendosën në nyjet kyçe të rrugës Lissus-Adpicaria

DO NOT COPY

(Vigu) dhe të degës jugore të kësaj traseje (Bushati), që lidhte trevën dardane, përkatësisht Ulpjanën me Grazhdanin. Ato në ndryshim nga fortifikimet e tjera u ndërtuan me një planimetri komplekse dhe të ndërlikuar që nga pikëpamja e trajtimit arkitektonik radhiten me grupin e "Castrave" të ngjashme me Scampisin, Paleokastrën, ngjashmëri që vërehet në elementët e përgjithshme fortifikuese (kullat), teknikën e ndërtimit, planimetrinë etj., që gjejnë pika takimi me disa fortifikime të provincës së Mëzisë së Poshtme, etj. Ndërsa për pjesë të tjera të arkitekturës, si shtrimi me llaç të hollë i dyshemesë së kullave (Bushat), prirja drejt një suvaje në faqet e brendshme të murit rrethues, teknikë kjo e pëlqyer dhe Vig, Pecë e Bardhoc, shtrimi i dyshemesë me tegula mammatae, ndërtimi i hyrjeve me teknikën "opus mixtum" (Bushat) dhe fortifikimi i saj me dy kulla në trajtë "U"-je (Bushat) ose katrore (Vig) që bëhej nëpërmjet oborrit të fortifikuar "propugnaculum", formë e cila takohet deri në periudhën e Konstandinit në Iliri dhe në provincat e tjera ballkanike, ju japin atyre karakteristikat e fortifikimeve të mirëfillta ushtarake. Nga vrojtimet e deritanishme Bushati dhe Vigu përfaqësojnë dy kastra të ndërtuara përgjatë trasesë Lissus-Naissus. Sipërfaqet e kufizuara të tyre, përcaktojnë destinacionin për stacionin e një kohorte.

Faza e dytë ndërtimore përkon në kohë me shek. VI ku vërehet një ngritje në shumë drejtime, e pasqyruar kjo kryesisht në ndërtimin e kështjellave të reja siç mund të përmendim Bardhocin, Domajt, Micaj, Kabashin; rindërtimet në Pecë, Kasterc (Kosovë), si dhe një sërë vendbanimesh të hapura që morën një zhvillim të rëndësishëm përreth fortifikimeve.

Është për t'u theksuar se një pjesë e mirë e fortifikimeve të grupit të parë, vazhduan të funksionojnë dhe në periudhën e dytë.

Në ndryshim nga faza e parë, ndërtimet e shek. VI ndryshojnë dukshëm përsa i përket cilësisë së lartë të llaçit, i cili përmban sasi të mëdha gëlqereje si dhe vërehet përpjekja për një vendosje sa më të rregullt të fugave.

Muret e fortifikimeve ngrihen mbi shkëmb (Peca, Domaj, Bardhoc) ose mbi themele të buta (Ulpjana). Përgjithësisht janë të përforcuara me një kullë, ku dëshirojmë të veçojmë atë të Domajve, e cila paraqet evoluimin e kullës trajtë katrore në atë trekëndore.

Përhapja e fortifikimeve në këtë periudhë përkon me strategjinë ndërtimore të Justinianit, i cili në mes të dy linjave fortifikimesh paralele siç janë vija kufitare dhe ajo e kështjellave të mëdha (Ulpjana, Lisi, Skodra, Dyrrahu, Skampis), ngriti një sërë postash të vogla që u shërbenin trupave si strehim dhe pika mbështetje. Prokopi i Çezaresë në veprën e tij "De Aedificiis" nënvizon një sërë kështjellash që u ndërtuan nga Justiniani. Me interes për këtë periudhë është përputhja e të dhënave arkeologjike me ato të burimeve të shkruara historike siç ishte shembulli i kështjellës së Pecës me Pentza.

Duke bërë një vështrim të përgjithshëm të tablosë urbane në këtë areal të gjerë gjeografik për shek. VI, vërejmë se në disa zona të veçanta ishin formuar njësi administrativo-ekonomike dhe fetare që do t'i përkisnin organizimit të ri administrativ midis këtyre territoreve dhe kryeqendrave provinciale. Kështu, qendra të tilla të vogla të vendosura në pikat streategjike të rrugëve kalimtare janë: - Peca, e cila gjatë shek. IV-VI luajti rolin e një njesie të rëndësishme ekonomiko-fetare në rajonin Prizren-Vau i Spasit; Rosuja për territoret malore midis Gjakovës e Shkodrës; Vau i Spasit për rajonin Gjakovë-Rosujë; Vila në pellgun e Drinit të Zi si një qendër që lidhte këtë rajon me Grazhdanin.

Një tregues tjetër me vlerë është se, pavarësisht se në shek. VI, fortifikimet dhe qendrat e tjera shtrihen në provincën e Prevalit dhe Dardanisë, nga analiza e bërë qoftë kjo arkeologjike apo arkitektonike rezulton se këtu na pasqyrohet një kulturë unitare gjë që dëshmon

DO NOT COPY

se në kuadrin e perandorisë Bizantine, ndarjet provinciale nuk përbënin dhe ndarje apo veçime kulturore. Qendrat administrative, fortifikimet e përhapura në zonat e thella malore, larg rrugëve kryesore do të shërbenin njëkohësisht dhe si tregues i depërtimit dhe pranisë bizantine në këtë areal gjeografik.

DO NOT COPY

1. A. Baçe, L. Papajani, Kështjella dhe monumente të tjera në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës, "Monumentet"1, 1983, f. 125-144.

2. B. Jubani, Plotësime për monumentet arkeologjike në Shqipërinë e Veriut, "Monumentet" 1, 1986, f. 126, 156.

3. A. Baçe, Kështjella e Vigut, arkitektura, rikonstruksioni dhe restaurimi i saj, "Monumentet"14, 1977, f. 75-100.

4. B. Jubani, N. Ceka, Gërmimet në qytezën ilire të Rosujës (Rrethi i Tropojës), "Iliria" 1971, I., f. 49-68.

5. L. Përzhita, Kështjella e Bushatit "Iliria" 1986, 2, f. 187-208. Po ai, Kështjella e Pecës gjatë antikitetit të vonë dhe mesjetës (rrethi i Kukësit), "Iliria" 1990, 2, f. 201-241; po ai, Rezultatet e gërmimeve në Gradishtën e Bardhocit, "Iliria" 1990, 2,; po ai, Raport i gërmimeve të vitit 1990, Arkivi i IA Tiranë.

6. A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, P. Thoma, Historia e arkitekturës shqiptare, Tiranë 1980, f. 139, fig. 4.

7. E. „erškov, Rimljani na Kosovu i Metohiji, Beograd 1969; E. „erškov, Lj. Popoviç, Ulpiana, kratak izvesaj o arheoloskim istrazivanjima u 1957. g., "Glasnik Muzeja Kosova i Metohiji" (më tej GMKM), III, 1958, f. 275-280; E. „erškov, Municipium DD kod Soconice, Pristina, Beograd, 1970.

8. E. Shukriu-Hoti, Kërkime arkeologjike përgjatë Drinit të Bardhë, "Iliria" VII-VIII, v. 1977-1978, f. 191-196, po ajo, Fortifikata "Hisar" në Kasterc të Suharekës (Të dhëna nga gërmimi arkeologjik I vitit 1985), "Gjurmime albanologjike, (Seria e Shkencave Historike)" 16, Prishtinë 1986, f. 7-17.

9. E. Dobruna, Mbi disa toponime të kohës antike në Kosovë, "Shqiptarët dhe trojet e tyre" Tiranë 1982, f. 168-169.

10. K. Miller, IR., col. 555-559, shih: "Ilirët dhe Iliria te autorët antikë", Tiranë 1965.

11. I. Schnetz, Itineraria romana, vol. III; Ravenatis Anonymi Cosmographia, Leipzig 1940, 54; K. Miller, Claudii Ptolemaei geographia, Paris 1883.

12. K. Miller, vep. cit., f. 555-557.

13. Po aty, f. 557-558; Ptolem. II, 14, 3; Hieroel. XVII, 656, Lissos, Rav. IV, 15; V, 14-(Lisson-Lissum).

14. Caes. B. civ. III, 26, 3; 29, 1 e 3; Në këtë pasazh thuhet: "Si gjetën limanin e quajtur Mymfe, tremijë hapa larg nga Lisi, hynë këtu me gjithë anije...".

15. F. Prendi, K. Zhegu, Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike, "Monumentet" 2, 1971, f. 16-17; po ata, La ville illyrienne de Lissus, son origine et son systeme de fortifications, "Iliria" II, 1972, f. 219-238.

16. Po aty, f. 228.

17. Autorët kanë konstatuar gjurmë rindërtimi në Lis të cilat përputhen mjaft mirë me mbishkrimet latine të zbuluara dhe me konfirmimin e dhënë nga Jul Cezari në veprën "Mbi luftrat civile" që u përkasin shek. II-I p. k.

18. F. Prendi, K. Zhegu, Lisi në dritën..., f. 16.

19. Po ata, Vazhdimësia etno-kulturore iliro-arbërore në qytetin e Lisit, "Iliria" 1983, 1, f. 203-208, 1983.

20. Ptolem. II, 16, 7 (Apicaria); TP Miller IR col. 555-559 (Adpicaria-Puka).

21. A. Baçe, Kështjella e Vigut, arkitektura, rikonstruksioni dhe restaurimi i saj, "Monumentet" 14, 177, f. 76-100.

22. Po aty, f. 90; shih dhe cit. Nr. 10.

23. L. Përzhita, Kështjella e Bushatit, f. 187-208.

24. A. Baçe, vep. cit., f. 94 dhe citimet prej tij.

25. Rav. IV. 15 tek "Ilirët dhe Iliria..." (206, 2-6). Të dhënat e autorit anonim nga Ravena, në të shumtën e rasteve janë të gjymtuara dhe të shkruara në formë

jo të drejtë. Një pasaktësi të tillë, siç është mungesa e statio Adpicaria do t' vërejmë përgjatë trasesë Lissus-Naissus dhe në stacionin tjetër Viciano.

26. A. Baçe, L. Papajani, vep. cit., f. 128. Sipas autorëve kjo trase zbriste rrëzë Fletit (fortifikimit) në drejtim të fshatit me të njejtën emër, kalonte përroin e Marka-Palit dhe nëpërmjet një ure të vogël, 3 m të gjerë, me dy këmbë të ulëta dhe shtroje dërrase shkonte në vijën Ulzat e Xathit – Hani i Sakatit.

27. B. Jubani, N. Ceka, Gërmime në qytezën ilire të Resujës (Rrethi i Tropojës), "Iliria" 1971, f. 49-65.

28. Po aty..., f. 65.

29. B. Jubani, Plotësime për monumente arkeologjike..., f. 130.

30. A. Baçe, L. Papajani, vep. cit., f. 130.

31. Po aty..., f. 131.

32. Po aty..., f. 132.

33. T. P. Miller IR col. 555-559 (Creveni-Vau Spas mbi lumin Drin); Shih Rav. IV, 15 (Crebenis-Spas në lumin Drin), stacion që ndodhet XVII m. p. larg Adpicarias.

34. E. „erškov, Rimjani... f. 27.

35. Një informacion më i zgjeruar është dhënë në "Iliria" VI, f. 110 nga D. Komata dhe A. Koka.

36. A. Arpad. Regeszeti Kutatar Allanialan, "Dolgozatok ab edetyi nemzeti Muzerum erem-es regizogtaral II, Kolozvar 1918.

37. V. Shtylla, Të dhëna mbi rrugët dhe urat e vjetra në Kosovë, "Monumentet" 1983, 1, f. 25.

38. I. Adams, Rrugët e Shqipërisë gjatë pushtimit turk, Buletini Shkencave Shoqërore", III, 1953, f. 24; V. Shtylla, vep. cit., f. 25.

39. D. Komata, A. Koka, vep. cit...f. 411. Autorët kanë zbuluar një trakt muri 2. 5 m të gjatë dhe 1 m të lartë.

40. Po aty..., f. 411.

41. Figurina është një gjetje rasti dorëzuar në v. 1977 në fondet e IA Tiranë nga A. Hoti.

42. "Bronzes figures de l'epoque romaine", Musee d'histoire et d'art Luxenbourg, 1971, f. 7.

43. "Bronzes romaine de Suisse", Musee contonal d'arheologie et d'histoire, Lausanne, 8mai-18 juin 1978, f. 64.

44. K. Miller, vep. Cit., f. 556-557.

45. Mërkuri në Kosovë përmendet në një mbishkrim nga Koshi, ndërsa në Ulpianë është zbuluar statuja e mërkurit prej bronzi me gjithë atributet. Shih: E. Cerskov, Rimljani... f. 136, fig. 32.

46. K. Miller, Claudi..., str. 315, 451, 455.

46. E. „erškov, Rimljani...f. 32.

47. Po aty..., f. 27.

48. Po aty..., f. 27

49. Mayer, "Die Sprache" I, f. 147 dhe II, f. 60-61.

50. Z. Mirdita, Mbi kufirin perendimor..., f. 210.

51. M. Radovanovif, (GMKM Glasnik Muzeja Kosovo I Metohiji), VII-VIII, Prishtinë, 1962-1963, f. 71.

52. Fshatrat Ramhas dhe Kënete janë përmbytur nga ujrat e liqenit të Fierzës.

53. A. Baçe, Banjot e shekujve të parë të erës sonë në Shqipëri, "Monumentet", 1980, f. 51-87.

54. L. Përzhita, Kështjella e Bushatit, ..., f. 190.

55. S. Anamali, Kështjella e Pogradecit, "Iliria" IX-X, 1979-1980, f. 222; H. Spahiu, Gërmimet arkeologjike të vitit 1973 në kalanë e Beratit, "Ilira" III, 1974, f. 483-487; A. Baçe, Kalaja e Durrësit dhe fortifikimi përreth saj në antikitetin e vonë, "Monumentet", 9, 1975, f. 91-103; Gj. Karaiskaj, P. Lera, Fortifikimet e vona antike në rrethin e Korçës, "Monumentet" 8, 1974, f. 103.

56. Një përshkrim të zgjeruar mbi arkitekturën e Portës së Bushatit është botuar në "Iliria" 1986, 2, f. 195-196.

57. Gj. Karaiskaj, Kalaja e Elbasanit..., f. 61-67.

58. E. „erškov. Lj. Popovïc, vep. cit., f. 275-280; T. Ivanov, Abritus..., f. 48 A. W. Lawrence, A. skeletal history of Byzantine fortifications, The annual of the British School at Athens, nr. 78, 1983, f. 174 krh. Kastrën e "Pagnik Orenit".

59. S. Anamali, Proçese shndërrimi në trevën ilire të shekujve I-IV, "Iliria" 1986, 1, f. 25.

60. Po ai, Kështjella e Pecës.., f. 204; Po ai Kështjella e Bushatit. F. 186. N. Ceka. Fortifikimet e vona antike.., fig. 84; S. Anamali, Kështjella f. 227; Gj. Karaiskaj, P. Lera, vep. cit. f. 91-103.

61. A. Baçe, L. Papajani, vep. cit. f. 137.

DO NOT COPY

62. Planimetritë e kështjellës së Vilës dhe të Dodës u botuan për herë të parë nga A. Baçe, L. Papajani, vep. Cit., fig. 37.

63. Po aty.. f. 135.

64. B. Jubani, Plotësime..., f. 141.

65. Po ai, vep. Cit. F. 141.

66. L. Përzhita, Kështjella e Pecës..., f. 201, 241.

67. Gërmimet arkeologjike të kryera gjatë viteve 1986-1989, të përqëndruara në tre sek. A, B dhe C mundësuan përcaktimin e këtyre periudhave:protoqytetare ilire, romake, antike të vonë dhe të hershme mesjetare. Shih po aty, f. 203.

68. Po ai, Kështjella e Bushatit..., f. 190-191; A. Baçe, Kështjella e Vigut..., f. 75-100; S. Anamali, kështjella... f. 222.

69. B. Jubani, Plotësime...f. 130. 142. Autori është i mendimit se Kështjella e Shoshanit, Bujanit, Volës dhe "Maja Xhytet" e Hoteshit janë ndërtime të shek. III-IV; Gj. Karaiskaj, P. Lera, vep. cit.., f. 173. N. Ceka, Fortifikimet e vona antike..., f. 84; S. Muçaj, Vendbanime të antikitetit të vonë në krahinën e Mallakastrës, "Iliria" IX-X, f. 291-292.

70. L. Përzhita, Kështjella e Bushatit... f. 192; D. Komata, Të dhëna..., f. 225.

71. P. Cezaresë, "D. Aedificiis" tek "Ilirët...", f. 444.

72. B. Jubani, Plotësime..., f. 139.

73. Aktualisht ky fortifikim nuk ruhet pasi vite më parë është dëmtuar nga punime të kryera për ndërtim. Gjurmimi në sipërfaqe ka sjellë zbulimin e pak fragmenteve rë qeramikës, të cilat u përkasin shek. III-IV.

74. Gradishta e Bardhocit u bë e njohur në literaturën arkeologjike nga disa vëzhgime sipërfaqësore të kryera në të në periudha të ndryshme. Për herë të parë ajo është vizatuar nga I. S. Jastrebov, në fund të shek. XIX, i cili na njeh me pozicionin e kështjellës dhe toponimin e saj; shih: J. S. Jastrebov, Stara Srbija i Albania, Beograd 1904, f. 80. Më pas në v. 1970, nga B. Jubani është bërë përpjekja e parë për përcaktimin kohor të këtij monumenti, i cili datohet në dy periudha të ndryshme kohore, B. Jubani, Rrethi i Kukësit; f. 200. Në vitet 1980, nga A. Baçe, L. Papajani, u botua për herë të parë planimetria e kështjellës. Ato shprehin mendimin se ky monument bën pjesë në ndërtimet e shek. VI. Shih A. Baçe, L. Papajani, vep. Cit. 130-138.

75. M. Bela, L. Përzhita, vep. Cit. F.

76. E. Çabej, Problemi I vëndit të formimit të gjuhës shqipe. "K. I. S. I. " Tiranë 1974, f. 7-26. Autori sqaron etimologjinë e emrit pukë si më poshtë: "Pukë pranë udhë e pukë-publica via".

77. A. Baçe L. Papajani, vep. cit. f. 136, E. Shukria, Fortifikata "Hisar" Në Kastrec të Suharekës, "Iliria" 1989, 1. F. 80.

78. M. Bela, L. Përzhita, Harta... f. Këtu janë zbuluar gjurmët e një vendbanimi që shtrihet në një sipërfaqe afro 6 ha të rrethuar me mure 1, 80 m të gjërë. Materiali arkeologjik I gjetur në "Trojë" Morin, e daton këtë qëndër në shek. III-IV.

79. Gjatë punimeve bujqësore në fshatin Vlashnje (v. 1992) janë gjetur gjurmët e një ujësjellësi në afërsi të xhamisë.

80. B. Jubani, Plotësime..., f. 143.

81. Kosova dikur dhe sot..., f. 101.

82. E. Shukri, Fortifikata "Hisar" në Kasterc të Suharekës (Të dhëna nga gërmimi arkeologjik i vitit 1985". Gjurmime albanologjike, (seria e Shkencave Historike) 16, Prishtinë, 1986, f. 7-17. Toponimin Kastrec, autori e shpjegon nga emërimi i fortifikimeve të përiudhës romake: castrum.

83. Po aty, f. 9.

84. Po aty, f. 17.

85. Një përmbledhje për kërkimet e bëra në lidhje identifikimin e stacioneve në territorin e Kosovës është bërë nga E. Dobruna, vep. Cit., f. 163-168.

86. K. Miller, vep. Cit.., f. 558.

87. E. Dobruna, vep. cit. 170, shih cit. Nr. 76.

88. K. Miller, vep. Cit., f. 557; F. Papazoglu. Srednjbalkaniska plemena u predimsko doba, Sarajevo, 1969, f. 154.

89. E. Dobruna, vep. Cit., f. 167.

90. K. Miller, vep. Cit., f. 557.

91. A. Domaszewski, vep. Cit., f. 146.

92. E. Dobruna, vep. Cit., f. 168-169.

93. E. „erškov, Rimiljani..., f. 46, po ai Municipium DD, f. 69-79.

DO NOT COPY

94. Po aty, f. 46.

95. E. „erškov –L. Popoviç, Ulpiana, f. 319-326.

96. Kosova dikur dhe sot, Beograd 1973, f. 101.

97. Po aty, f. 102.

98. M. Comes, Chronicon..., f. 451-452.

99. P. Cezaresë, vep. Cit., f. 444.

100. E. „erškov, Oko problema komunikacija i prozaja naselja na Kosovu i Metohiji u rimskom periodu, "GMZ", Prishtinë 1997, f. 68.

101. E. Dobruna, vep. Cit., f. 168.

102. F. Prendi, K. Zhegu, Lisi në dritën..., f. 18.

103. E. „erškov, Municipium DD..., f. 62-68.

104. Mbishkrimet latine të zbuluara në këtë qendër flasin se Mun. DD ka qënë: "procuratores metallorum Augusti", "procuratores metollorum municipu". Shih E. „erškov, Municipium..., f. 62-68.

105. S. Anamali, Procese shndërrimi..., f. 25.

106. E. „erškov, "Rimljani..., f. 134.

107. B. Jubani, "Plotësime..., f. 137; po ai, "Rrethi i Kukësit..., f. 100.

108. Për klasifikimin kohor të ndërtimeve jemi nisur në bazë të materialit arkeologjkik të zbuluar nga gërmimet në Pecë, Bushat, Bardhë, Domaj, Rosujë dhe Vig, pasi në fortifikimet e tjera të kësaj traseje ato mungojnë.

109. P. Cezaresë, vep. cit. F. 144. Bëhet fjalë për dyndjet harkore para shek. V. e. s.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

LATE ANTIQUITY CASTLES ALONG THE LISSUS-NAISSUS ROAD.

The fortifications separation has a great contribution to the development of the late antiquity culture, not only for their historical formation structure, but also to a full reflection of a new conception related to the cultural development of this period. The IV-VI centuries have the content of a époque where are present the incursions of different tribes that influenced to the worsening of crises of Roman empire, buat at the same time they brought out the building of a number of fortifications near the major roadway of communication. The study of the fortified centers is very important because they contain particular historical values, often unequal, over the urbanization on different regions. We think that this is possible because the studies are done over the major parts of the late antiquity regions for the Lissus-Naissus and have created a new and important table about their military-commercial function.

The investigations to date reflects a wide defender building activity that begin in the end of the III century and the beginning of the IV century, that will continue later on, catching the most important parts, cities and the major roadway, with major density at the basin of Drini I Zi and Bardhe, that at the same time is a testimony of a well developed life, which is clearly seen at the fortifications architecture.

Differently from the other regions of Albania, the main material collected for the fortified centers comes from the systematical excavations (Vigu, Rosuja, Bushati, Peca, Bardhoci, Domaj.). With all the work done up to now and the continuous publications from B.Jubani, A.Baçe and L.Papajani, this large area needs other new excavations, because the material for a part of monuments is being collected in the framework of the observations on the terrain. They are of a special importance because help to a new evaluation. This has been reflected with the proper documents of the fortifications creating in this manner a new acknowledgment over the urbanization for the deep mountainous regions.

The framework of our excavations to the late antiquity fortifications would have a lot of gaps without the excavations done to the same field in the Kosova region, because as we know a good part of the track way that we are studying belongs to this geographical area. Thanks to the research work done by the scholars as; E. Çershkov, Z.Mirdita, E.Shukriu, etj for the most important centers of this period as Ulpiana, Soçanica etc., fortifications and road stations, has been enable a general urban presentation for this center Balkan area and its cultural reports that it have with the Adriatic coast during the roman invasion and later in the Byzantine period.

All these researches taking together make a particular and detailed picture about the development of the fortifications during the centuries IV-VI, but at the same time make difficult the inclusion in a detailed way of the particular elements of architecture within the limits of this work.

Anyway we think that the grouping of the castles and the description of some dwelling places around them, the reflection of reports that has to do with the Lissus-Naissus track way, will fulfill at some extends the particular gaps that have to do with the exact time definition of the fortification buildings, their physiognomy and character, that will contribute to the urban picture for an important period of our history. This is mainly for the areas that are little known in today literature, where we can separate the fortified systems of the Drini I Zi and Bardhë valley, area that historically has had a particular importance in the linking of Center Balkan with the Adriatic coast, as the only linking bond of this regions. From the archeological point of view, helped by the existence of a widespread road network are numbered around 36 fortified centers and road stations also three army check points, discovered in our territory and in that of Kosova. The fundamental directions in which developed this building activity, were the fortification of centers by Illyrian origin and the construction of new castles, that relate in time with the emperors Constantine the Great, Valentin I, (365-367) and Justin I (527-565), who are present in the "De Aedificies" work of Procop of Qezare.

The geographical distribution of the castles (fig.1) reflects their construction along the main road Lissuss-Naissus, mainly around the Drin valley where passes the track way which insure the linking with the coastline. In the same time we noticed that not only the important road bonds are fortified but also this activity was extended to the second hand roads. Such constructed activity explains that in particular regions are already created defensive and observation systems, at areas of Bardhe and Zi Drin valley. Of particular importance in this period were the maintaining and the surveillance of the most important traditional and communicational roads and strategic points of this track way which exploit the valley of Drin, to penetrate to the region of Kosova and through the Kocanic and Toplic valley it reaches up to the valley of Morava and Vardar.

The constructed activity of the most important roads started at the time of August reached its peak during the Trajnan and Hadrian invasion. The roman itinerary including geographical writings, give few data for the road and for the dwelling places. The most important source is "Peuntingeriana tabula". Other announcements contain only the names of some dwelling places, or the geographical coordination of some cities.

One of most important lines of this period has been the trans Balkanic Lissuss-Naissus. K.Miller in the " Peuntingeriana tabula" has given stations together with the distances between them which are; Lissus (Alessio) XXX-Ad Picaria (Puka) XXX- Creniuni (Spas-Drin) XVII-Gabuleo XXX-Theranda (Dulje-Prizren) XXV - Viciano (Ulpjana) XII-Veklanum (Prishtina) XIX - Vindenis (Podujevi) XX-Ad fines (Kushumli) XX-Hammeo (Prokupje) VI – Ad Herkulem - Naisso (Nish), (fig 2).

This road canalized the circulation not only to the coastline from Lisi and Shkodra, but of a wider territory that lays from Tivar to Dyrrah. The main road communication that connected Adriatic with the depths of continent passes along Drim and through Kukes valley and it connected northern parts enabling to make passages from Drin I Bardhë to Egean.

Lissus-Naissus road subdued in this period an intensive constructive activity, and this in particular in the center and southern parts; a geographical area that enables the mutual passages Adriatic- Center Balkan. Such a situation brought the creation of a new picture that in our case has to do with the building of big castles, but with simple surroundings and at some extends complex that possesses the most important strategic bonds of the valleys where penetrate the primary and secondary lines of the track way. The establishment of fortifications brings into evidence the connection between them, which are reflected in the creation of some defending systems that are distinguished according to their function and time chronology. They exploited the ancient track way Labian –Dardan in many ways and fortifications of pre and prehistoric Illyrian period, from where a part of them after the construction of Lissus-Naissus road took a particular importance as we can mention Lis, Ulpiana, Munn DD etc.

DO NOT COPY

The picture after the roman penetration reflects the creation of some municipals such as Lis, in the Adriatic coastline, Munn DD near Soconice and Ulpjana in the depth of Dardan region. Lis, a center with Illyrian origin, contains in this period two categories "negotiators" and "mercators". It appears as an opidium civium romanorum. A similar situation we can see at the creation of municipal DD near Socanice, with its boundaries; in east close by the region of Naissus, in west follows the boundaries of the dardan province, whereas north and south boundaries are still unidentified.

A fundamental characteristic of this center is the coexistence of municipal and colony, where were imperial and municipal properties, verified by the discovery of some inscriptions.

Besides the municipal centers, was created a wide network of beneficial stations as in Kalimash, Vana, Zhur (Prizren), Mitrovica, Kacanik etc., placed in the strategic and center points of communications. At the same time the researches have shown that in this period was created a latifund in the Nangë-Gostil area, where appear for the first time Latin inscriptions that talks about enfranchisement of slaves, that maintain Illyrian anthroponomy. There are created consular properties in Dobruzhd (Kosova), it is increased the monetary circulation of the emperors Dioklician, Anastas and Constantine, and are discovered a number of storehouses of agricultural equipments, furnaces for the baking of ceramics etc. Besides these are seen open and fortified dwelling places that maintain autochthon traditions, where we can mention Peca, Rosuja, Vila and a number of other centers widespread in Dardani as "Hisari" in Kastere, Bellaqevec etc. The end of the III century and the beginning of the IV century changed the urban view of this geographical basin, because as we know it started the risk of the continuous invasion by the barbarians. This coincides with the beginnings of a constructive activity that in our opinion it is divided into two large phases:

The first phase will include the castles of the III-IV century as Peca, Rosuja, Bushat, Vig, Vau I Spasir, Cepa Hoteshti etc.

The main direction in which proceeds this activity will be refortification of the castles by Illyrian origin and the construction of new castles. The up to now investigation have revealed that the fortifications of first phase have as a general characteristic the simple plans strengthened by one or more towers, with a surface around 0,2-1 ha.

In general they maintain forms that fit the terrain framework where they are build, but even though in some cases where it is possible, we noticed a tendency for right lines In a part of them it is clearly seen the following of oval lines, whereas in the highest point by a dividing wall it is created an acropolis, as it is the example of Peca. The plans of the castles of this phase are different, oval, square, triangular, irregular, which find analogy with the fortifications of this period in Egnadia road, Korca basin with the castles around Durrës etc. The used construction techniques in the walls of the first phase fortification is an "opus mixtum" (Bushat- Vig); b) with stone and mixture but frail Pecë, Rosujë etc.). Generally the mountainous fortifications function as a control point along deep valleys. Some of them contained a limited number of residences mainly single rooms, areas used by military garrisons. This answers the Prokop's statement that says: at that time the barbarians did not know the fortification surroundings, a lot of this fortifications were with a tower and a small number of militaries. This was enough to stop the passages of barbare tribes.

Besides the first groups, during this phase were made new constructions which are like a roman caster fitting the terrain where they lays as it was seen. These constructions were placed in the main bonds of Lissus Adpicari (Vigu) road and the south branch of this track way (Bushati) that connected the Dardan region, respectively Ulpjana and Grazhdan. They in difference from the other fortifications, were build at a complex plan that from the architectonic view point line up with "castres" group similar with Scampis, Paleokastra, in Illyri territory, similarities that are seen at the general fortification elements (towers), construction techniques, plans etc. They have similar points for particular elements with some fortification of Lower Mezia. Whereas the other architectonic elements that come across as the laying of

DO NOT COPY

thin mixture of tower's floor (Bushat), the tendency for a plaster at the inner faces of the surrounding wall, likeable also in Vig Peci and Bardhoc, flooring with tegula mamatae, the constructions of entrances with "opus mistum" technique (Bushat) and its fortification with towers like "U" (Bushat) are square (Vig) that is done through the fortified court "propugnaculum" a form that is seen up to the period of Constandine in Illyri and on other Balkan regions, give them the characteristics of reliable military fortifications. From the up to now observations Bushat and Vig represent two castra constructed along Lissuss- Naissus track way. Their limited surfaces, determined the destination of the station of a cohort. The second constructive phase coincides with the IV century where it is seen a growth in many directions, reflected this mainly in the construction of some castles, like Bardhoc, Domaj, Bicaj (Micaj), Kabashin; reconstructions in Peca, Kastrec (Kosova) and a number of open dwelling places that took an important development around fortifications.

It is better to emphasize that a good part of first group fortifications continued to work in the second period.

In difference from the first phase, the constructions of VI century are clearly different concerning the high quality of mixture, which contain large quantities of limestone and where are noticed tendencies for a regular placing of fugs.

The fortification walls are raised over rocks (Peca,Domaj, Bardhoc)or over softly foundations. Generally they are strengthened with a tower, where we like to mention the Domaj's tower. Which represents the development of square and triangular tower.

The widespread of fortifications in this period coincides with the constructive strategy of Justian, who raised a number of small posts that are used as sheltering and supporting points placed between two parallel lines of fortifications, the boundary line and that of big castles (Ulpjana, Lisi, Shkodra, Dyrrahu, Skampis).Prokop in his work "De Aedificius" emphasized a number of castles constructed in this period from Justinian. With great interest is the conformity of archeological data with that of written historical sources like the example of the castle of Peca and Pentza.

Casting a general glance to the urban picture in this wide geographic area for the VI century we noticed that in some particular regions were shaped administrative-economic and religious units that will belong to the new administrative organizations between these territories and provincial metropolis. So, such small centers placed in the strategic points of the roads are; -Peca, which during the IV-VI century played the role of an economic-religious unit in the region Prizren_Vaspas; Rosuja – villa in Drin I Zi basin as a center that connected this region with Gradishta, another city after Durrah that is in the center of the large basin of Drini I Zi.

Even though at the VI century, the fortifications and other centers lay in Preval province of Dardania, from the archeological or architectonic analyze it is reflected a unitary culture, which gives evidence that in the framework of Byzantine Empire the provincial divisions does not make divisions of the cultures. The administrative centers, the open fortifications at the deep mountainous areas far away main road will serve at the same time as the indicator of Byzantine penetration and presence in this geographical area.

DO NOT COPY

Kasem BIÇOKU

DO NOT COPY

PORTRETI I MARIN BARLECIT DHE NJË SAKTËSIM PËR SHQIPONJËN E KASTRIOTËVE

Për jetën e Marin Barlecit, themeluesit të historiografisë shqiptare, përfaqësuesit më të shquar të saj dhe njërit prej personaliteteve më të fuqishme të kulturës sonë kombëtare dihet fare pak dhe vetëm aq sa mund të nxirret tërthorazi prej veprave të tij, sepse mungojne dokumentacioni dhe nuk janë bërë kërkime arkivore sistematike në këtë drejtim. Vetëm në vitet '80 të shek. XX u zbuluan prej Jahja Drançollit disa dokumente në arkivat italiane, që kanë sjellë të dhëna të panjohura. Në një dokument të muajit janar të vitit 1497 ai përmendet si rektor i kishës së Shën Stefanit në fshatin Plovenar të Padovës dhe si abat në kishën Shën Justina të Padovës. (1)

Me shkallën e ulët të njohurive të trashëguara për jetën e M.Barlecit, ashtu si edhe për jetën e personaliteteve të tjera shqiptare të Mesjetës, me ndonjë përjashtim, lidhet edhe me mosnjohjen e pamjes së tyre fizike. Prandaj çdo zbulim në këtë drejtim merr një rëndësi të dyfishtë, si për zgjerimin e rrethit të njohurive për jetën e personaliteteve përkatëse, ashtu dhe për plotësimin e panteonit të korifejve të kombit tonë me portretet e tyre autentike. (2)

Me veprën "Historia e jetës dhe e bëmave te Skëndërbeut", M.Barleci ka ngritur një përmendore madhështore e të përjetshme për heroin tonë kombëtar e bashkë me të, tërthorazi, edhe për personalitetin e vet. Kjo vepër është një burim historik i dorës së parë dhe i pazëvendësueshëm për të hulumtuar dhe studiuar jetën dhe epokën e Skëndërbeut, prandaj edhe është ribotuar, përkthyer dhe përshtatur shumë herë gjatë shekujve në vende e gjuhë të ndryshme.

Në fushën e kërkimeve ndodh rëndom që veprat studiohen e përkthehen prej botimeve që janë më të përdorshme. Kështu ka ndodhur edhe me botimin e parë latinisht të veprës së M.Barlecit për heroin tonë kombëtar, botuar në Romë e që nuk e ka të shënuar datën e botimit, por dihet se i përket viteve 1508-10, atëherë kur shtypshkruesi venedikas, Bernardinus de Vitalibus, ushtroi përkohësisht veprimtarinë e tij në atë qytet. Meqenëse ky botim është mjaft i rrallë dhe leximi i tij është i vështirë dhe i lodhshëm për shkak të shkurtimeve shumë të shpeshta, mungesës së ndarjeve në paragrafë të vegjël etj., studiuesit e përkthyesit janë mbështetur kryesisht në botimet e mëvonshme të tij. Prandaj botimi i parë i veprës së M.Barlecit është njohur dhe është shfrytëzuar pak nga studiuesit e shumtë të figurës së Skëndërbeut dhe epokës së tij.

Kur pata marrë përsipër të hartoja Bibliografinë e Skëndërbeut, shumë vite më parë kisha kaluar nëpër duar Historinë e Skënderbeut te M.Barlecit, botuar në Romë në vitet 1508-10. Një kopje e këtij botimi gjendet në Bibliotekën Kombëtare të Tiranës.

Rrethana të veçanta më detyruan në nëntor të vitit 1997 të ribëja ilustrimet që shoqërojnë vëll.I të Bibliografisë së Skëndërbeut (1454-1835) dhe të merrja sërish nëpër duar botimin e parë të veprës së M.Barlecit. Gjatë vështrimit të ilustrimeve të kësaj vepre, më tërhoqën vëmendjen figurat e frutave, të luleve e bimëve që ka petku i portretit të Skëndërbeut (foto1) si dhe miniaturat e bordurës së frontespicit të librit (foto 2) që, sipas studiuesve, kanë episode nga historia e vjetër e Romës (3). Këto më nxitën që më 22 nëntor ta kaloja edhe një herë nëpër duar botimin e parë të veprës madhore të M.Barlecit dhe të qëmtoja me kujdes miniaturat e shkronjave të para që, sipas traditës, shtypshkruesit e hershëm të librave i vendosnin në çdo libër, si emërtoheshin në atë kohë kapitujt.



foto 1

Dihet që miniaturat e shkronjave të para kanë qenë standarde dhe përdoreshin nga botuesit në të gjitha librat që nxirrnin, pavarësisht nga përmbajtja e tyre. Kështu p.sh. shtypshkruesi i veprës së M.Barlecit, Bernardinus de Vitalibus, kishte transportuar pajisjet tipografike në Romë, sepse pati përdorur për tekstin e veprës të njëjtat gërma dhe miniatura, si në veprën e parë të M.Barlecit "Rrethimi i Shkodrës", që ka 144 faqe të formatit të mesëm (21 x 15,5 cm) dhe që është botuar në Venedik, në janar të vitit 1504 (sipas kalendarit të atij qyteti, prandaj i përket vitit 1505)(4) ashtu edhe në veprën e dytë monumentale "Historia e Skëndërbeut", të botuar në Romë pas disa vitesh (5) (foto 3). Vepra e dytë


HISTORIA
DE VITA ET GESTIS
SCANDER BEGI
EPIROTARVM PRIN
CIPIS.

foto 2



foto 3

e M.Barlecit është e vëllimshme dhe ka 326 faqe të formatit të madh (31 x 21 cm) prej të cilave, 4 fletët e para janë të panumërtuara, kurse faqet në vijim janë të numërtuara si fletë me shifra romake. Në katër fletët e para të panumërtuara gjendet frontespici i veprës (fl.Ir) bashkë me dy poezi, përkatësisht të Petër Regulit e të Domenik Alcenjanos, treguesi i përmbajtjes së veprës (fl. Ir-IVr) si dhe një portret i Skëndërbeut (fl.IV). Vendosja e këtij portreti larg frontespicit të librit haset rrallë në botimet e tjera dhe është vendosur

Fotocopy

aty që të bëhet lidhja me përmbajtjen e faqes vijuese (foto 4) që është fleta e parë e numërtuar e librit. Në fletët e numërtuara me shifra romake,



foto 4

krahas tekstit të veprës kushtuar Skëndërbeut, janë edhe dy parathënie (Prefatio) të hartuara po nga M.Barleci. Parathënia e parë (fl.I), që paraprin librin (kapitullin) e parë dhe vetë tekstin e veprës, M.Barleci ia ka drejtuar Ferrant Kastriotit, në të cilin ka dhënë motivet që e kanë shtyrë në një ndërmarrje të tillë dhe vështirësitë që ka përfundimi i saj. Këto shqetësime aï i ka shprehur më me optimizëm në Parathënien e dytë (fl. LXXXIII) që vjen e vendoset thuajse në mes të tekstit, pasi përfundon së rrëfyeri vdekjen e sulltan Muratit II (që mbyll librin VI) dhe para fillimit të librit VII, me të cilin fillon periudha e luftës së Skëndërbeut kundër sulltan Mehmetit II.

Gjatë qëmtimit të miniaturave të shkronjave vura re se kishte edhe minatura të krijuara nergut për këtë libër dhe në përshtatje me përmbajtjen e tij. E tillë është miniatura e gërmës I, e vendosur në fillim të librit V, ku janë paraqitur sulltan Murati II dhe i biri, sulltani pasardhës Mehmeti II gjatë luftës së tyre për rimarrjen e Stefigradit më 1448. Miniatura ka përmasa të vogla (3,2 x 3,2 cmm), sepse paraqitja e portreteve të tyre është imagjinare (foto 5). Qysh në fillim ma tërhoqi vëmendjen njëra prej miniaturave, me të cilën fillon parathënia e parë që M.Barleci ia ka kushtuar nipit te Skëndërbeut, Ferrant Kastriotit, dhe që ndryshon si nga përmbajtja ashtu edhe nga përmasat në krahasim me të tjerat. Menjëherë arrita në përfundimin se kjo miniaturë kishte një përmbajtje befasuese që kishte mbetur e panjohur nga të tjerët prej më se 500 vjetësh. Kjo është miniatura e parë e shkronjës Q e vendosur në fletën I recto të numërtuar përballë portretit të Skëndërbeut (foto 6) dhe që është më e madhe se të tjerat (5,4x5,3 cm.) Kjo ndryshon tërësisht nga përmbajtja e miniaturave të tjera të shkronjës Q, të cilat janë dy herë më të vogla (2,7x2,7 cm), si edhe nga përmbajtja e çdo miniature të shkronjave të tjera.



foto 5



foto 6

Në miniaturën e madhe të shkronjës Q jepet portreti i një burri të pashëm e trupmadh, me tiparet e një malësori shqiptar, të veshur me petkun e një kleriku, i cili mban në dorën e djathtë një libër dhe gishti tregues i dorës së majtë i është drejtuar portretit të Skëndërbeut. Në sfondin e portretit të miniaturës është vënë, siç kuptohet nga

BOTIMET

kambanarja, ndërtesa e një institucioni fetar, ndoshta e një manastiri, në të cilin mund të ketë banuar M. Barleci gjatë qëndrimit të tij në Romë. Në këtë miniaturë, po ashtu si edhe në petkun e portretit të Skëndërbeut, është përdorur gjuha e simbolistikës.

Simbolet e miniaturës së shkronjës Q tregojnë qartë se burri i paraqitur në të është një klerik (petku i klerikut dhe ndërtesa fetare në sfond) dhe autor i një libri (libri në dorën e djathtë), që i kushtohet heroit shqiptar (gishti tregues i dorës së majtë drejtohet nga portreti i Skëndërbeut). Të gjitha këto elemente simbolike tregojnë bindshëm se kemi të bëjmë me portretin e autorit të librit të M. Barlecit. Vendosja e portreteve të autorëve në gërmat e para të librave ka qënë një praktikë e njohur në botimet e hershme dhe që bëhej për personalitetet e shquara. Kështu p.sh. portreti i papës Piu II është dhënë i pikturuar në miniaturën e gërmës së parë të veprës së tij "Mbi Kuvendin e Mantovës", të botuar në vitin 1473 në Milano (6). Kurse në botimet e mëvonshme portretet e autorëve kanë zënë vend më të madh në faqet e librave të tyre, siç është p.sh. portreti i Pjetër Bogdanit te vepra e tij "Çeta e Profetëve"(7). Ky ka qenë i vetmi portret autentik i autorëve të vjetër shqiptarë. Gjuha e simbolikës është përdorur edhe për identifikimin e portretit të P.Bogdanit dhe të Papës Piu II.

Në miniaturën e shkronjës Q, portreti i M.Barlecit është paraqitur në gjysëm profil e në toraks, gjë që lejon deri diku të rroket shtatlartësia e tij. Në duar i janë vënë simbole që lehtësojnë identifikimin e personazhit të paraqitur në të, siç janë libri në dorën e djathtë dhe gishti tregues i dorës së majtë, shtënë në drejtim të portretit të Skëndërbeut. Të dy portretet janë të vendosur në dy faqe që gjenden përballë njëra-tjetrës për të bërë lidhjen ndërmjet tyre, prandaj portreti i Heroit tonë Kombëtar nuk është vendosur në fillim të librit, pranë frontespicit, por disa faqe më pas. Këto faqe janë të panumërtuara dhe kanë treguesin e përmbajtjes së lëndës. Portreti i Skëndërbeut është dhënë në profil e në përmasa të mëdha (25,8 x 17,4) dhe është vendosur në faqen e anës së majtë të librit të hapur dhe me shikim në drejtim të faqes së djathtë, që i përket fletës së parë të numërtuar me shifra romakë (fl. I recto).

Në faqen e miniaturës së gërmës Q, që ka portretin e M.Barlecit, zë fill Parathënia që autori, jo rastësisht, ia ka drejtuar nipit të Skëndërbeut, Ferrant Kastriotit; ky i fundit pa dyshim ka qenë një nga nxitësit që M.Barleci të shkruante kryeveprën e tij për Heroin tonë Kombëtar dhe ndoshta ka mbuluar edhe shpenzimet e këtij botimi të kushtueshëm. Vendosja në këtë Parathënie e gravurës me portretin e M.Barlecit përbën një element identifikimi për të treguar personazhin e portretit. Për këtë qëllim, fjala e parë e Parathënies, e bashkë me të fraza përndjekëse, është zgjedhur e ndërtuar me kujdes, që të fillojë me shkronjë të rrumbullakët (Q), ku të brendashkruhej portreti i M.Barlecit.

Për identifikimin e personazheve të dy portreteve, që janë në librin e M.Barlecit "Historia e Skëndërbeut", janë përdorur mjete të ndryshme. Për identifikimin e portretit të Heroit Kombëtar është shënuar emri i tij "Signor Scander Bego" në pjesën e poshtme të portretit, ndërmjet vijave kufizuese që janë përdorur si kornizë katërkëndëshe e tij. Kurse për identifikimin e portretit të M.Barlecit, siç kemi shënuar më parë, është përdorur gjuha e simbolikës, prandaj portretet janë vendosur pranë njëri-tjetrit (shif foto 4). Mjetet e ndryshme që janë përdorur për përqasjen e personazheve të portreteve si dhe ndryshimet e theksuara në përmasat e tyre dëshmojnë për vlerësimin e lartë që M.Barleci ka pasur për Heroin tonë Kombëtar si dhe për modestinë e thellë të tij ndaj punës vetjake monumentale. Botimi i dy portreteve në të njëjtin libër, pranë njëri-tjetrit rrit shkallën e autenticitetit të tyre.

Portreti i Skëndërbeut, që gjendjet ne veprën e M.Barlecit, është padyshim autentik, sepse kur

FOTOCOPY

PHOTOCOPY

është botuar vepra jetonin ende në Itali disa nga bashkëluftëtarët e Heroit dhe familjarë të tij, siç ishte p.sh. Ferrant Kastrioti, të cilët, jo vetëm e kishin nxitur të shkruante këtë vepër, por, siç shprehet në fund të Parathënies që ia ka kushtuar nipit të heroit, "Unë nuk kam shkruar trillime, por ato që më kanë treguar me kujdes më të mëdhenjtë dhe ato që kanë parë me sytë e tyre disa që kanë marrë pjesë në luftë". Veç këtyre, në paraqitjen sa më saktë të profilit të Skënderbeut nuk mund të mos ndikonte edhe vendosja pranë tij e portretit të M.Barlecit, tiparet fizike të të cilit janë dhënë fort saktë, sepse librin ia botonte në Romë në të gjallë të tij i njëjti shtypshkrues, që disa vite më parë i kishte shtypur në Vendik veprën e parë "Rrethimi i Shkodrës". Kjo vepër ka pasur jehonë pozitive, e ka afirmuar M.Barlecin si historian të shquar, e ka nxitur atë më pas të shkruajë kryeveprën e tij "Historia e Skënderbeut", gjithë duke forcuar bashkëpunimin e miqësinë e ngushtë të tij me shtypshkruesin venedikas, Bernardinus de Vitalibus. Gjatë viteve 1508-1510 M.Barleci ka qëndruar disa kohë në Romë, ka shoqëruar shtypshkruesin venedikas dhe, sipas zakonit të kohës, për të bërë korrekturat e saj. Vendosja e portretit të M.Barlecit në veprën e dytë të tij tregon se ai tashmë konsiderohej nga bashkëkohësit si një nga personalitetet kulturore më të shquara.

Nëpërmjet këtij portreti zbulohen tiparet fizike kryesore të M.Barlecit. Ai duhet të ketë qenë shpatullgjerë, trupmadh dhe i shëndetshëm. M.Barleci ka pasur duar të mëdha, gishta dore të gjata dhe tipare të bukura. Flokët i kishte me onde e të prera në mënyrë uniforme, të cilët i zbrisnin gradualisht deri në fund të qafës. Floku zbriste edhe mbi ballin e gjerë, duke mbuluar pjesën e përparme të kokës, ku i kishin rënë flokët. Ballin e gjerë M.Barleci e kishte pak të rrudhur, si vertikalisht, në pjesën ndërmjet syve (ku i janë shënuar tri rudha, që dëshmojnë edhe për pamjen serioze e të menduar të tij - *shih vështrimin e syve*), ashtu edhe horizontalisht (ku i ravijëzohet edhe një rrudhë në anën e majtë të ballit). M.Barleci ka pasur sy të mëdhenj, vetulla të trasha e me hark të theksuar, hundë të gjerë e me pak kurriz, kurse faqet i ka pasur me mollza të mëdha, me gropëza e pak të rrudhura në pjesët pranë hundës e buzëve. Gjithashtu ai ka pasur buzë të trasha e të harkuara dhe me gropëza si në drejtim të hundës ashtu dhe të mjekrës. Tiparet e mësipërme tregojnë se, kur është bërë portreti i tij, M.Barleci ishte në moshën 50-vjeçare (në kufijtë ndërmjet 48 dhe 52 vjeç sipas mendimit të disa piktorëve) çka është në përputhje me moshën që ai ka pasur në kohën kur i botohej vepra "Historia e Skënderbeut"

Pamja e hijshme e portretit të M.Barlecit është në përputhje të plotë me madhështinë e shpirtit e të veprës së pavdekshme të tij. Ky portret i korifeut të historiografisë shqiptare do të zerë vendin e vet në bibliografitë dhe fjalorët enciklopedikë, në botime të ndryshme, në muzeume e biblioteka, si dhe në mjedise të tjera kulturore e publike.

Pasuria ikonografike e veprës së M.Barlecit "Historia e Skënderbeut" është me interes dhe pritet të studiohet më tej nga specialistët përkatës



foto 7

për të zbërthyer gjuhën e simbolikës që është përdorur në petkun e portretit të Skënderbeut si dhe në miniaturat e bordurës së frontespicit të librit. Në të është edhe një shqiponjë dykrenare (foto 7).

Për të njohur sa më mirë mendimin e M.Barlecit për shqiponjën dykrenore të Kastriotëve dhe flamurin e tyre, si dhe për një varg problemesh të tjera, provojmë të krahasojmë përkthimin shumë të mirë në shqip të "Historisë së Skënderbeut", bërë prej Stefan Priftit, me

origjinalin latinisht. Nga ky krahasim doli se përkthimi ka disa mangësi e çështje të diskutueshme, që mund e duhet të shmangen në ribotimet e tjera të kësaj vepre. Po përmendim disa nga këto dobësi. Përkthyesi ka gabuar, me sa duket nën ndikimin e historianit rumun F.Pal, sepse përkthimin e veprës e ka bërë jo mbi bazën e botimit I të vitit 1508-1510, por mbi bazën e botimit II latinisht, të vitit 1537 (9), pas vdekjes së M.Barlecit. Nga krahasimi që i kam bërë teksteve latinisht të të dy botimeve del se mangësitë e gabimet e botimit të dytë janë shumë më të mëdha nga ato që ka pasqyruar F.Pali(10). Gjithashtu treguesi i përmbajtjes dhe shënimet anësore që shoqërojnë tekstin e botimit të dytë ndryshojnë jo pak me ato të botimit të parë, të cilat çuditërisht kanë mbetur të papërkthyera prej S.Priftit. Lëkundje vërehen nga përkthyesi edhe në shqipërimin e termave latine, prandaj pjesa e stema si dhe prej reparteve ushtarake në majë të shtizave; *gens*, që e ka përdorur në nuanca të ndryshme kuptimore dhe që për këtë rast, më i përshtatshëm është shqipërimi i Frang Bardhit me fjalën *gjindje* (11) që e ka edhe fjalori i K.Kristoforidhit (12); *distinctus* që M.Barleci e ka përdorur për *i dalluar, i shënuar*. Padilione (13) dhe të tjerë, nën ndikimin e tij, fjalën *distinctus* e kanë kuptuar gabimisht *si i hapur e i ngritur* dhe, në kundërshtim me mendimin e M. Barlecit (që e ka treguar edhe nëpërmjet formës që ka shqiponja dykrenore e Kastriotëve në gravurën e bordurës së frontespicit të librit) kanë arritur në përfundimin se gjoja, sipas përshkrimit të librit, shqiponja e Kastriotëve i ka pasur krahët të ngritura lart. Për njohjen e mendimit që ka shprehur M.Barleci për flamurin dhe shqiponjën ndihmon shumë shënimi anësor që ai i ka vënë frazës në tekstin e veprës (foto 8). Shënimi anësor


Attẽ.q̃ erant uexilla/& in ſignia Caſtri orę gentis & familię.

aut iampridem ſublati fuerant/aut aufugerant/Incolę & reliqui Epirotici generis mox abiecta Amurathis memoria nouũ ducem/& nota olim ſigna/ aquiláq; (nã rubea uexilla nigris/& bicipitibus diſtincta aquilis (id gẽtis inſigne erat) gerebat Scanderbegus) uel non inuitati ſequebantur. Tum ex iis in alia/& alia loca nunc mitis/nunc terribilis irrumpens cotidie aliqd impio ſuo addebat/ordinabat ſemp aliqd per prouinciam diſponebat pręſidia/cuſtodias collocabat. Reuiſebat crebro Croiam/ac cętera loca/oppidáq. Nunc hac/nunc illac oberrabat ſedulus/pluſtra/

foto 8

tekstit ku flitet për flamurin e Skëndërbeut dhe shqiponjën dykrenore, nuk del fort e saktë në botimin shqip të "Historisë së Skëndërbeut".

Termat dhe fjalët kryesore që ka përdorur M.Barleci për frazën ku përmenden flamuri dhe shqiponja dhe që lejojnë të kuptohet saktë mendimi i tij janë *signum*, që e ka përdorur shpesh e kryesisht për *flamur e flamurth, shenjë* etj.; *vexillum,* që e ka përdorur rrallë për flamur; *insignia* që e ka përdorur rrallë e zakonisht për *shenja (simbol),* që vendoseshin në flamuj, në dallon qartë se në frazën për flamurin, fjalët *vexillum* dhe *insignia* nuk janë përdorur nga M.Barleci si sinonime, siç ka kujtuar S.Prifti (14), por si dy terma të ndryshme: *"Tregohet se cilët ishin flamujt dhe shenjat (simbolet) e gjindjes dhe të familjes Kastrioti"* (15).

Termat e mësipërme, janë përdorur nga autori edhe me nuanca të tjera kuptimore dhe në ndonjë rast edhe si sinonime ndërmjet tyre. Duke u mbështetur në sa u tha, përkthimi i frazës latinisht që është në librin "Historia e

DO NOT COPY

Skëndërbeut", lidhur me flamurin dhe shqiponjën e Kastriotëve, mund të saktësohet si vijon: "Me të hequr qafe Muratin dhe pa i ftuar kush, banorët dhe të tjerë prej gjindjes epirote i shkonin pas prijësit të ri, flamurtheve dhe shqiponjave të njohura prej kohe (sepse Skëndërbeu mbante flamuj të kuq, të dalluar me shqiponja dykrenore të zeza. Kjo [*shqiponja – K.B.*] ishte shenja (simboli) i gjindjes së tij)".

Qysh në njoftimin e parë për zbulimin e portretit të M.Barlecit kam shkruar se "miniaturat e bordurës kanë subjekte e simbole.... të jetës politike shqiptare (shqiponja dykrenare e Kastriotëve)" (16) dhe këtë fakt e kam vënë edhe te shënimi, me të cilin kam pajisur veprën e M.Barlecit te vëll. I i Bibliografisë kushtuar Heroit tonë Kombëtar (17). Prandaj nuk qëndron pretendimi i M.Zeqos se ai qenka zbuluesi i shqiponjës (18). Ky pretendim i tij, për gravurën e shqiponjës së Kastriotëve, është një përvetësim i vetëdijshëm i zbulimit tim, sepse në artikullin tij ka dhënë edhe portretin e M.Barlecit, duke e shënuar si zbulim timin. Ky zbulim njoftohet po aty ku unë kam përmendur edhe shqiponjën. Në artikullin e tij M.Zeqo ka vijuar të thellohet në gabimet duke shkruar se shqiponja e bordurës së frontespicit të librit "është më e vjetra dhe mbase e vetmja që i afrohet figurës reale dhe të vërtetë të heraldikës së Skëndërbeut". Së paku janë dy dëshmi të tjera më të hershme e më autentike se "zbulimi" i M.Zeqos, që kanë si objekt figurën e shqiponjës dykrenore: është vula e Skëndërbeut (19) dhe stema në varrin e Konstantin Kastriotit (20), (foto 9 dhe 10).



foto 9



foto 10

Shqiponja dykrenore është objekt qëndror në vulën e Skëndërbeut. Midis krenave të saj ishte një yll me gjashtë cepa. Vula kishte rrethin monografik "GEORGIUS CASTRIOTIVS SCENDARBIC". Në krye të rrethit të vulës ishte shenja e diellit me tetë rreze që ndante fillimin dhe mbarimin e emrit të Heroit. Shenja e diellit me tetë rreze ka qenë simbol shtetëror i Aleksandrit të Madh të Maqedonisë, emri i të cilit te osmanët kishte përgjegjësen Iskander dhe në gjuhën shqipe Skënder. Shenja e diellit në vulën e Skënderbeut dhe përdorimi prej tij si emër i dytë vetiak përgjegjësen osmane (në formën shqipe të emrit) të emrit të Aleksandrit të Madh nuk janë të rastit. Në hapësirat ndërmjet krerëve dhe flatrave të shqiponjës gjenden inicialet "DAL" të titullit zyrtar të Skëndërbeut - *Dominus Albaniae* (zot i Shqipërisë). Përmasat e vogla të vulës (diametri i rrethit të shqiponjës është 29 mm.) dhe vështirësitë e mëdha që ka pasur gdhendja e saj në metal nuk kanë lejuar paraqitjen sa më autentike të shqiponjës, të yllit me gjashtë cepa (21), çka është shprehur edhe në ndonjë pasaktësi në paraqitjen e emrit të tij: CASTRIOTIVS e SCENDARBIC në vend të CASTRIOTVS e SCANERBEGVS, siç janë përdorur në shkresat e dala prej kancelarisë së tij.

Figura e shqiponjës dykrenore dhe e yllit me gjashtë cepa janë paraqitur në formën më autentike të tyre në stemën e Kastriotëve, e cila gjendet e gdhendur dy herë në varrin e Konstandin Kastriotit. Ky varr monumental, që

DO NOT COPY

ndodhet në kishën "Santa Maria la Nova" të Napolit, u ndërtua për nipin e saj në vitin 1500 nga gruaja e Skënderbeut, Donika Kastrioti. Donika ka qenë jo vetëm njeriu më i afërt i Skënderbeut, por ajo ka qenë edhe shumë aktive në jetën politike, si në veprimtarinë e shtetit shqiptar, ashtu edhe më pas pranë oborreve të shteteve italiane e të Spanjës, gjatë viteve të mërgimit të saj. Prandaj, pas vdekjes së Skënderbeut, askush tjetër më mirë se ajo nuk mund t'i shprehte simbolet shtetërore të Kastriotëve. Kurorat mbretërore të vendosura mbi krerët e shqiponjës duhen marrë si shtesa të bëra nga Donika e nga pasardhësit e Skënderbeut, duke u paraqitur në Itali e në Spanjë me gjak mbretëror e perandorak. Prandaj edhe Donika ka përdorur në epigraf mbiemrin e saj atëror, *Cominata*, për të treguar se rridhte nga familja perandorake bizantine e Komnenëve. Në varrin e Kostandin Kastriotit është shkruar latinisht me shkronja kapitale: "Këtu prehet Konstandin Kastrioti, dinjitar peshkop i Izernias, i ndritur prej gjakut e prejardhjes mbretërore dhe perandorake, si dhe i dalluar për virtytet e rralla, i paharruar



foto 11

do të mbetet, megjithëse vdiq parakohe. Këtë e ngriti për nipin e shkëlqyer gjyshja atërore, Donika Komnena, më 1500 (22). (foto 11).

Shqiponja e vulës së Skënderbeut dhe shqiponja e stemës së Kastriotëve, e skalitur dy herë në varrin e Kostantin Kastriotit, kanë vlera autentike, sepse u përkasin subjekteve të tilla, si Skënderbeut dhe Donika Kastriotit, që i kanë krijuar dhe përdorur ato. Kurse shqiponja e Kastriotëve, që gjendet në bordurën e frontespicit të librit të M. Barlecit, nuk mund të ketë autenticitetin e pretenduar nga M.Zeqo, sepse subjektet që e kanë krijuar atë, nuk mund të jenë më të besueshme se Skënderbeu dhe Donika Kastriotit. Shënojmë me këtë rast se shqiponja dykrenore e librit të M.Barlecit nuk është grafikë, siç shprehet M.Zeqo, por gravurë. Për më tej shqiponja dykrenore e Kastriotëve, bashkë me gravurat e tjera, që janë në bordurën e frontespicit të librit të M.Barlecit, kanë karakter dekorativ dhe si gdhendje të bëra në përmasa të vogla në dru (shqiponja është 2 x 1,5 cm.) figurat e tyre nuk mund të dinin të sakta, siç e dëshmon edhe gravura e grupit të mirënjohur skulpturor me ujkonjën etruske, e cila gjendet në kolonën e bordurës të librit ballë shqiponjës së Kastriotëve.

---

1. J. Drançolli, Të dhëna të reja për jetën dhe veprën e Marin Barlecit "Gjurmime arkeologjike, seria shkencore filologjike", Prishtinë, 1988, 18.

2. M.Barletius, Historia de Vita et Gestis Scanderbegi Erirotarum Principis, Romae, per B.V.

3. F. Pall, Marino Barlezio uno storico umanista, Bucuresti, 1938, f.10, shën.2. Pali kritikon mendimin e shprehur nga studiues të tjerë se një miniaturë e kornizës së portretit tregon episodin e vetëvrasjes së Lukrecias, kurse, sipas tij, është vdekje e Virxhinias.

4. M.Barletius, De Obsidione Scodrensi, Venetiis per Bernardinum Venetum de Vitalibus, MDIIII.

5. Miniaturat e gravurave që ka De Obsidione Scodrensi (fl. 5r., 7v. dhe 61v.) janë përdorur edhe te Historia Scanderbegi (fl. 122r., 41r. dhe 13r.). Në foton nr.3 miniaturat e gërmave që i përkasin De Obsidiedione Scodrensi janë vënë në anën e majtë, kurse në të djathtë ato të Historia Scanderbegi.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Paraqitje tipografike e veprës së dytë të M.Barlecit është më e arrirë se vepra e parë e tij. Ndër të tjera p.sh. ndryshojnë disi hapsirat ndërmjet rrjeshtave edhe pse janë përdorur të njejtat shkronja. Hapsira prej 13 cm, në faqet e librit De Obsidione Scodrensi ka 22 rrjeshta, kurse te Historia Scanderbegi ka 23 rrjeshta.

6. AE. S. Piccolomini, Pii Secundi Pont Max. Epistolae. De Conventu Mantono, Mediolani, M.CCCCLXXV.

7. P.Bogdanus, Cuneus Prophetarum, Patavii, MDCLXXXV.

8. M.Barleti, Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut, Tiranë 1964.

9. M.Barletius, De vita moribus ac rebus praecipue adversus Turcas, gestis Georgii Castrioti... Argentorati, M.D.XXXVII.

10. F.Pall, vep.cit., f. 141-144.

11. F.Blanchus, Dictionarum latino epiroticum... Romae, 1635, f.29

12. K.Kristoforidhi, Fjalor shqip-greqisht... Tiranë, 1961, f.127, 128, 227.

13. C.Padiglione, Di Giorgio Castriota Scanderbeg e de suoi discedenti, Napoli, 1879, f.54.

14. M.Barleti, Historia e jetës...f.89: "Banorët dhe të tjerë prej fisit epiriot, me ta hequr qafe Muratin, i shkonin pas, edhe pa i grishur kush, prijësit të ri, flamurëvet e shqiponjavet të njohura prej kohe, sepse Skënderbeu mbante flamurë të kuq, të qëndisur me shqiponja të zeza e dykrenore (ky ishte flamuri i fisit të tij)".

15. M.Barletius, Historia Scanderbegi, fl. XVv. Attentio quae erant vexilla et insignia Castriotae gentis et familiae". "... Incolae et reliqui Epirotici generis mox abiecta Amurathis memoria novum ducem, et nota olim signa aquilasque (nam rubea vexilla nigris, et bicipitibus distincta aquilis (id gentis insigne erat) gerebat Scanderbegus) vel non invitati sequebantur".

16. K.Biçoku, Zbulohet portreti autentik i Marin Barlecit në gaz. "Albania", 29 nëntor 1997; po ai Portreti autentik i Marin Barlecit, në gaz. "Rilindja", 18 janar 1998.

17. K.Biçoku & J.Kastrati, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu Bibliografi, I, Tiranë, 1997, nr.17.

18. M.Zeqo, Skënderbeu si emblemë e kulturës, në gaz. "Koha Jonë" 18 janar 1998.

19. T.Geci, Mbi sfragjistikën e Kastriotëve, në "Simpozium për Skënderbeun", Prishtinë, 1969, f. 229-247.

20. G.Schiro, Gli Albanesi e la Questione Balkanica, Napoli, 1904, f.560

21. T.Geci, vep. cit: f.238.

22. CONSTANTINVS CASTRAYOTVS HIC TEGITVR. SANGVINE ET COGNATIONE REGIA AC CAESAREA CLARVS: MORVM CANDORE INSIGNIS: DIGNITATE PONTIFEX ESERNIENSIS: DVM PROBE VIVIT INTEMPESTIVE MORITVR. ANDRONICA COMINATA PATERNA AVIA NEPOTI OPTIMO POSVIT. M.D.

Ky epigraf është përkthyer italisht qysh në shek. XIX (C. Padiglione, vep..cit., f.15). Mbi bazën e këtij përkthimi epigrafi është shqipëruar si më poshtë: "Kostandin Kastrioti këtu asht varrosë, i cili qe vërtetë i gjakut dhe farefisnisë mbretërore dhe perandorake, e kështu nga shkëliqimi i vetivet bujare... ndërsa ai jeton gjithnjë në zemrat tona. Andronika Kominiata ndërtoi këtë vorr në vjetin njëmijë e pesëqind". (Buletin shkencor, Vjeti III, nr.6, Shkodër, 1966, f.163).

Epigrafi është shtypur me pasaktësi grafike nga G.Schiro (vep.cit. fl.il.pas. f.560) dhe është shqipëruar më 1961 si vijon: "Këtu është varrosur Kostandin Kastrioti, me gjak dhe me fis të përmendur mbretëror, i shquar për pastërtinë e dokeve nga nderimi pontifikal. Jetoi i virtutshëm, vdiq në tronditje. Kominata gjyshja e tij atëhere ia vendosi nipit shumë të mirë 1500" (D. Radeshi, Principata e Kastriotëve në "Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore", Tiranë 1961, nr. 4, f.29). Epigrafi bashkë me fotografinë e varrit janë botuar me këtë rast në formë montazhi, duke i marrë nga vepra e sipërpërmendur e G.Schiro-it.

Shënim: *Fotot janë realizuar nga Naim Kasapi.*

DO NOT COPY

THE PORTRAIT OF MARIN BARLETI AND A PRECISE DESCRIPTION OF THE KASTRIOTS' BICEPHALOUS EAGLE

On November 22nd, 1997, Kasem Bicoku discovered the only and real portrait of Marin Barleti, found on his monumental work "The History of Skenderbey" and that was until then, totally unknown to scholars. This work was published dates to Latin in Rome but does not indicate the year. However, it is known that work dates to 1508-1510, when Bernardino de Vitalises, its editor from Venice, practised in that city.

The portrait of Marin Barleti is of miniature dimensions, 5.4cm x 5.3cm and composed inside the letter Q. It is placed on the first page of the book and on the opposite side of Skenderbeu's portrait. The characters of both portraits, are identified by different means. The written name of "Signor Scanderbego" identifies the portrait of the National Hero, whilst symbolism is used to identify the M. Barleti portrait.

On the letter Q miniature is shown a man's portrait, dressed in clergyman's clothes, who has a book in his right hand and with the index finger of his left hand is gesturing towards Skenderbey's portrait. All this description is used to show that the portrait belongs to a clergyman (clergyman's clothes) who is the author of a book (the book in the right Hand) written about our National Hero (the index finger of the left hand gesturing towards Skenderbey's portrait).

The symbolism used in identifying the M. Barleti portrait, has placed it opposite that of Skenderbey and also adds veracity to the portraits by showing the real features of our National Hero and his biographer, who is also the founder of Albanian historiography. The portrait inside the Q-letter miniature, has accurately shown the physical features of M. Barleti, for he was present at the printing preparatory process of his work.

The "History of Skenderbey", has iconographical properties that are not studied yet. Among them is a graph with the miniature portraits that are not studied yet. Among them is a graph with the miniature portraits of the sultans Murati the 2nd and Mehmeti the 2nd and also the Kastriots' Bicephalous eagle.

The graph of the Kastriots' eagle is also discovered by Kasem Bicoku who mentioned this fact in November 1997 when he announced the discovery of the M.Barleti portrait. The author, in reference to the shape of the Kastriots' eagle, considers the eagle of the official seal of Skenderbey and that of the Kastriots' emblem, which was found on the grave that Donika Kastrioti built for her nephew Konstantin Kastrioti in 1500 in Naples, as the most authentic ones.

In this article, the author, K.Bicoku, pays attention to what M. Barlet's opinion is regarding the Kastriots' flag and eagle. He takes the occasion to correct the false interpretation by different scholars, such as K.Padilione, of M.Barleti work and also corrects the translation made by S.Prifti of M.Barleti opinion of the flag and eagle.

DO NOT COPY

Dr. Ark. Latif LAZIMI

SHKOLLA E SHQIPTARËVE NË VENECIA

Në qershor 1995, më qe krijuar mundësia për të ndjekur një kurs specializimi në Venecia të Italisë, që Qendrën Europiane të përgatitjes së mjeshtrave të restaurimit.

Venecia, siç dihet tashmë, është monument kulture që mbrohet nga UNESCO, për pasurinë e madhe kulturore dhe për veçantitë e saj ndërtimore unikale në botë.

Ky shkrim i shkurtër, ka si qëllim të na njohë me një fakt interesant, në lidhje me kontributin modest që kanë dhënë dhe mjeshtrit shqiptarë, kryesisht në krijimin e veprave artistike të punuara në dru dhe gur, në monumentet kulturore të qytetit të Venecias. Në një libër të botuar në Venecia[1] përmenden shkollat dhe studiot në të cilat janë përgatitur mjeshtrit që kanë ndërtuar monumentet e kulturës dhe veprat artistiko-arkitektonike të këtij qyteti të mrekullueshëm. Në të bëhet fjalë për rreth 70 shkolla dhe studio. Nga këto pjesa më e madhe kanë qenë studio, ndërsa ajo e shqiptarëve emërtohet "Shkolla e Shqiptarëve", e cila bën pjesë në numrin e shkollave që kanë pas ekzistuar në mjedisin venecian gjatë shekujve XII-XIX, ku përgatiteshin mjeshtrat, të cilët ndërtuan monumentet e shumta, duke përmendur afërsisht 150 kishat, njëra më interesante se tjetra, pallatet e panumurta dhe veprat e shumta të artit, pa lënë mënjanë mënyrën specifike, atë të ndërtimit me palafite, mbi të cilën është mbështetur qyteti i Venecias. Për të treguar më saktë aktivitetin e shkollës së mjeshtrave shqiptarë, mendojmë që të japim të përkthyer, atë çka thuhet në librin "Shkolla e mjeshtrave në Venecia (Lo scuola dei maestri in Venecia)"[2].

Shkolla e Shqiptarëve

Shqiptarët me qëndrim në Venecia, të bashkuar në shoqatë, tashmë nga 1442, ishin kryesisht tregtarë të leshit, mbulesash, vaji. Në fillim i mbanin mbledhjet e tyre në Kishën e San Mauricios, ku kanë patur altarin dhe vendvarrimin. Pas rënies së Shkodrës ndodhi një emigracion i madh i shqiptarëve në Venecia dhe më 1491, u vendos të blihen dy harqe të Shën Xhovani dhe Paolo, duke mos qenë më të mjaftueshme vendvarrimet në Shën Maurizio (foto1). Më 1498 tashmë ishte ngritur një ndërtesë, në krah të kishës, e përshtatur për qendrën e tyre sociale, ku në qendër të ndërtimit ishte një oborr i vogël me një pus dhe galeri prej druri përqark. Pamja (1531) e dukshme akoma sot në rrugën e Piovanit (foto 2) nr. 1762, paraqet një pllakë mermeri me stemat, dikur të lara me ar, të familjes Laredan e Lezze dhe në mes luani i San Marcos në moleca, një lloj mauzoleu dhe shkrimi "ASEDIO LXXIII SECONDO MCCCC"; nën pllakën e mermertë, ndërmjet dy dritareve të katit

DO NOT COPY



Foto 1



Foto 2

të parë, shihet një basorelief (foto 3) i cili paraqet Shkodrën në formë të një kështjelle, mbi një shkëmb të thepisur me rrethuesit, Sulltan Muhameti i dytë dhe veziri i madh[3] (foto 4).

Sulltani ka në dorë një shpatë dhe dallohet nga çallma; më poshtë janë paraqitur mbrojtësit e shoqatës, San Gallo, la Vergine dhe San Mauricio. Për reliefet, Ludwing-Molmenti (1906) thotë: "... realizuar me finesë të admirueshme, kanë gjurmët e elegancës dhe pastërtisë të stilit lombardez dhe janë në frymën e veprave të skulptorit grek Zuan Zorizi Lascari, i quajtur Pirgotele... Por nuk janë sigurisht të Pirgoteles, vdekur më 1528", në përgjithësi, nga kritika ato i atribohen artistëve lombardez të paidentifikuar mirë, me përjashtim të Zorcit ku shihet dora e Pirgoteles. Mbi sfondin e skemës është gdhendur shkrimi: SCODRENSED EGREGIALE, SV. AE, IN VENTAM. REM. P. FIDEI. ETI. SENATUS. IN ETI VENETI BENEFICENTIALE SINGULARIS AETERNI HOC MONIMENTUM. P.

Portali dhe dy dritaret, të punuar në hekur të rrahur janë mbuluar nga një arkitra, mbi të cilin lexohet: SCOLA S.TA MARIA SAN GALLO DI ALBANESI.

DO NOT COPY



Foto 3



Foto 4



Foto 5

Në katin përdhe gjendej një sallë me një altar prej guri i ndërtuar më 1532, një shkallë të çonte në katin e sipërm, ku ishte salla e kreut me një litar të lartë. Ndërmjet 1501 dhe 1502 ishin ndërtuar dyshemeja dhe tavanet e dhomave. Në 1504 i ishte porositur Karpaçios, cikli me historitë e Virgjereshës për sallën e katit të parë. Pikturat paraqesin Lindjen e Marias [4] (foto 5). Paraqitja e Marias në tempull[5] (foto 6), martesa e Marias me San Xhiusepen[6] (foto 7), lajmërimi, vizita e Marias në Santa Elisabeta dhe vdekja e Marias. Asnjë nga ato nuk gjendet më në vendin e tyre origjinal; Lindja gjendet në Bergamo, pranë



Foto 6



Foto 7

Akademisë Karrara, paraqitja dhe Martesa gjenden pranë Pinakotekës së Brerës në Milano, vizitueshmëria është pranë muzeut Venecian Korrer, vdekja e Virgjëreshës dhe Lajmërimi janë pranë la Ca d'Oro a Venezia. Më 1780 shoqata ishte shpërbërë dhe në ndërtesën zuri vend shkolla e Pistorit. Pas 1810 godina ishte qendra e litografisë Kirchmayer dhe tani është ndërtesë private.

(1) Scuola dei maestri in Venecia, 1974, fq. 52, 18/A.
(2) Vep. cit.
(3) Vep. cit. f. 52, foto 36.
(4) Vep. cit. fq. 52, foto 37.
(5) Vep. cit. fq. 53, foto 39.
(6) Vep. cit. fq. 53, foto 38.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

THE ALBANIAN SCHOOL IN VENICE

In june 1995 I was in Venice Italy attending a specializing course in The Europian Centre, for the preparation of restauration specialists. Venice is one of the sites of the world under the protection of unesco for this great cultural heritage and its unique constructions in the world.

The purpose of this short article is to acknowledge you with an interesting fact that has to do with the contribution given by the Albanian constroction specialists, mainly in the creation of artistic works in wood and stone in different buildings or constructions in the city of Venice. In a publication edited in Venice (1) are mentioned different schools and studios, which prepared construction specialists who build those wonderful artistic and architectonic works of the city. It describes about seventy schools and studios, most were studios and one of them was known as "The school of the Albanians" *("La scuola dei albanesi")* as a part of many schools existing in the Venetian environment during 12th and 14th century, mentioning about 150 churches numerous buildings and works of art specifically speaking about *"the palifit"* constructions over which the city of Venice was build. For a better understanding of the activities carried out by "La scuola dei Albanesi" I have extracted and translated for you some parts of the book "La scuola dei maestri in Venezia".

The school of the Albanians

The Albanians resident in Venice united in an association since 1442 were mostly merchants of wool blankets and oil. At the beginning they kept their meetings in the church of San *Severo.* In 1447 they started meeting *in San Mauricio's Church* where they had their altar and the graveyard. After the fall of Shkodra (City 80 miles north of Tirana, Albania) under the Turkish occupation a wave of migration took place and many of them were settled in Venice, because of that there were no more places left in the graveyard of *San Mauricio* (fig.1) in 1491 they bought two arches, *San Giavani's, and San Paolo's.* A building, close to the church, was constructed in 1498. In the center of the building were a yard and a well surrounded by a wood gallery. The front view (1531) still visible today in Piovani's road (fig.2) no.1762, has a marble plate with the symbols of Laredan's and Lezze's families with the Lion of San Marco placed in *moleca* (some kind of mausoleum) and the script *"ASSEDIO LXXIII SECONDO MCCCC"* under the marble plate between two windows of the ground floor. A bas-relief (fig.3) where Shkodra city, represented by a fortress over a steapy rock, surrounded by the warriors, Sultan Mohamed The Second and The Grand Vezir (fig.4).

Sultan was sword in hand distinct by his turban. Below him were the association protectors, *San Gallo, The Virgine* and *San Mauricio.* Speaking about the bas-relief Ludwig Molmenti (1906) comments.... Realized in admirable fines, where the elegance of the Lombard style inspired by the Greek sculptor Zuan Zorizi Lascari nicknamed Pirgatele... but for sure they are not his works; he died 1528. By the critics they are attributed to unidenti-

fied Lombard artists except Zorci where Pirgotele's hand is easily recognized.

Overhead the scene is written the script:
SCONDRENSD EGREGIALE, SV.AE, IN VENTAM. REM. P. FIDEI ETI. SENATUS. IN ETI VENETI BENEFICENTIALE SINGULARIS AETERNI HOC MONIMENTIUM. P.

Above the portal with its two iron windows is written:

SCOLA S.TA MARIA SAN GALLO DI ALBANESI

In the ground floor you'll find the stone altar build in 1532; the stair will bring you in the upper main chamber with a higher altar in the center, the floor and the ceiling were built between I501-1502. In 1504 was ordered to Karapacio to paint the cycle of the story of The Virgin in the ground floor. The picture shows the birth of Maria (fig. 5), Maria in the temple, Maria's marriage with San Giuseppe, her visit to Santa Elisabeta and the death of Maria. None of them is on its original place today. "The birth of Maria" is placed in The Academy of Carrara in Bergamo; "The Marriage of Maria" is in the pinacotec of Brera in Milan; "The visit of Maria" is in the Correra Venice Museum; "Maria's death is in CA d'ORO in Venice. In 1780 the association was dismissed and on their building was placed the school of Pistori; after 1810 that building was used by the center of lithography "Kirchmayer", now it is a private owned building.

(1) Scuola dei maestri ia Venecia. 1974, p, 52, 18/A
(2) Works
(3) Works, p.52, photo-36.
(4) Works, p.52, photo-37.
(5) Works, p.53, photo-39.
(6) Works, p.53, photo-38,

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Mustafa ARAPI
(*Piktor restaurator*)

ANALIZË MBI DY IKONA TË PIKTORIT DAVID SELENICA

Veprat e David Selenicës zenë një vend të rëndësishëm në ikonografinë shqiptare dhe sidomos në atë të shek. XVIII. Ai u mbështet në pikturën murale të shek. XIV kryesisht në kishat e Ristozit (Mborje – Korçë), Maligradit (Prespë – Korçë), e Apollonisë (Fier) e Shën Triadhës (Berat) dhe në trashigiminë e pikturës së shkollës së Beratit e veçanërisht tek Onufri. Ai paraqitet si ripërtëritës dhe konsolidues i shkollës së Korçës me pasues piktorë të tjerë të mëdhenj si vëllezërit Kostandin e Athanas Zografi, Kostandin Shpataraku, Çetirët etj. Për periudhën kur ai krijoi, arti ikonografik kishte pësuar një rënie, por është një veçori e David Selenicës, me gjithë se të pakta në numër ai sjell edhe një herë ngritjen e tij.

David Selenica shkëputet nga krijimtaria e piktorëve të kësaj periudhe duke rizgjuar artin e periudhës më të shkëlqyer të mbretërimit të Paleologëve. Veç kësaj ai nuk i shpëton dot rrezatimit të asaj kohe artit perëndimor të Rilindjes veçanërisht atij italian, siç do të shohim nëpërmjet analizës që kemi realizuar në dy nga veprat e tij.

Në këtë kumtesë dëshiroj të përqëndrohem në dy ikonat të cilat i atribohen këtij autori[1] si "Shpërfytyrimi" dhe "Vajtimi i Mbivarrshëm". Janë pikërisht këto dy vepra të cilat me tematikën e tyre më japin shkas për të ndaluar e zbërthyer llogjikën kompozicionale të këtyre skenave nga pikëpamja ndërtimore.

Të dy ikonat ruajnë traditën e vjetër Bizantine për nga rekuizita e përdorimit dhe e tematikës, por vendosja dhe renditja e tyre na japin kompozime originale e shumë të ekuilibruara. Ato vërtetojnë se skemat e përdorura në ndërtimet kompozicionale janë ndërthurje e llogjikës subjektive me simbolikën e fenomeneve shqirtërore e natyrore, gjithashtu tregojnë se artisti ka përdorur dhe mbështetur në gjeometrinë Bizantine e cila i ka shërbyer në eliminimin e koncepteve realiste.

Në çdo vepër arti, për mendimin tim, ekzistojnë dy fenomene të cilat janë të lidhura ngushtësisht me njëra – tjetrën dhe që ekzistojnë brenda saj. Pra kemi të bëjmë me fenomenin që duket dhe ajo që nuk duket. Në zbërthimin e skenave të ikonave të realizuara nga David Selenica do të paraqesim elemente që fshihen pas atyre që duken, të cilët kanë luajtur rolin kryesor në konstruksionin dhe ndërtimin në të dy ikonat. Skena "Vajtimi" hyn në mes të çvendosjes nga kryqi deri tek varrosja. Kjo skenë u duk në shek. e XII nën ndikimin e mistikeve dhe e frymëzuar thjeshtë nga riti popullor i vajtimeve mortore[2]

Foto 1. Rreth Krishtit të vdekur janë Josifi i Arimatesë dhe Nikodhimi, në anën tjetër vajtojnë Virgjëresha, Shën Gjoni dhe Madalena. Në artin

DO NOT COPY





Foto 1. "The Brwailing"

bizantin në përgjithësi Krishti është i vendosur mbi një copë të quajtur Epitafios kurse në atë latine mbi një katërkëndësh guri horizontal. Skena bazohet mbi traditën e vjetër Bizantine. Në këtë skenë Davidi, mendojmë se, duke patur parasysh fenomenin dhe dinamikën e zbritjes apo të rënies, si dhe anën vizuale e simbolike, fillimisht ka ndërtuar diagonalen kryesore e të fuqishme AB, ku në rastin e dukshëm është brinja e siluetës së malit, e cila shoqërohet dhe ndihmohet nga linjat paralele të tre siluetave të kodrave, ku mbi të cilat ngrihen 3 kryqe, duke forcuar akoma më shumë idenë e lëvizjes në kohë e hapësirë të imagjinatës mbi rrugën e zhvendosjes së Krishtit nga kryqi deri në tokë. Fill pas përfundimit të segmentit AB, lind segmenti BC i cili nga rëndësia vjen pas AB dhe përshkon në mes trupin e shtrirë të Krishtit. Segmenti BC nuk është gjë tjetër veçse rënie e segmentit AB në pozicionin horizontal. Pra, kemi etapën e dytë të vajtimit. Del që segmenti AB dhe BC përbëjnë boshtin qëndror dhe armaturën e kompozimit. Për të vazhduar më tej, paraprakisht ka mënjanuar katërkëndëshat PAQR e cila ka për kufi siluetën e maleve dhe

DO NOT COPY



Foto 3. "The key delivery"



DO NOT COPY





Foto 4. "The Marriage of the virgin"

(1) HASAN NALLBANI "Disa vepra të reja mbi veprimtarinë e David Selenicës". Jemi me të njëjtin mendim që veprat i përkasin këtij aurori.

(2) LOUIS REAU. Iconographic de L 'art Chretien (Vouvea testament).

(3) LOUIS REAU. Iconographie de L'art Chretien

(4) LOUIS REAU. Iconographie de L'art Chretien

DO NOT COPY

ANALISYS REGARDING TWO ICONS OF THE PAINTER DAVID SELENICA

David Selenica has an important place in the Albanian iconography and particularly in that of the 18th century. He is relied on the frescos of the 14th century, mainly in those of the churches of Ristozi (Mborje, Korca), Maligradi (Prespa, Korca), Apollonia (Fieri) Saint Triadha and also on the painting heritage of the Berati School and that of Onufri, and it is introduced as the renovator and consolidator of the Korca School which was followed by other wellknown painters such as: the Zografi brothers, Konstantin Shpataraku, the Katro brothers etc. We could mention among Selenica's few pecularities, his contribute on boosting the iconographic art, which had a fall during Selenica's period of creation. We are also going to realize during the analisys of these two works, that he reflects a strong 1ink with the old tradition and on the other hand, an original exploitation of the Revival western art achievements, ecpecially those of the Italian art. In these communication, I'd like to be concentrated on the two icons, respectively the "Transfiguration" and the "Mortal Bewailing", which are both attributed to this author. There is the theme of these two works that yushed me analyse from a constructive point of view, the composing logic of these scenes. Their placing and ordering, create original composings, but talking about the requisite of theme and usage, they still preserve the old Bisantine tradition. They demonstrate that the schemes used in these composings, present a conection between the subjective logic and the natural, spiritual simbolic and also demonstrate that the artist is strongly relied on the Bisantine geometry, whieh helped him on eleminating the realistic concepts. There are two phenomenons strongly linked with each-other, that in my opinion exist in all the art works; the visible and the invisible phenomenon. During the analisys of the icon scenes, realized by Selenica, we'll introduce elements that are behind the visible phenomenons which have had an in portant role in romposing the two icons. The "Bewailing" scene takes place in the midst of the movement from the cross to the burial process. This scene appeared on the 12th century under a mystical iinAuence and also inspired from the folk rite of the mortal bewailing (fig. I). Around the dead Christ are wailing on one side the Joseph of Aritimea and on the other one, the Virgin, Saint John and Madlain. These scene is based on the old Bisantine art, where Jesus is placed on the Epitaph, while in the Latin one, is on a horizontal, rectangular piece of stone. We presume that in this scene, David has primarily created the fundamental digonal AB, taking in consideration the dynamic of descending and also the visual and symbolic side, but in our case, this diagonal represents the mountain silhouette, accompanied with other parallel lines, which represent the silhouette of three hills where are placed three crosses that help on stressing the idea of moving in time and space, and create a better idea over the movement of Christ from the cross to the earth. Once the AB segment is ended, starts the segment BC that is less important the AB one and goes through the lain body of Christ. The BC segment is only the fall of the segment AB on a horizontal plan. We have entered this way, the second phase of bewailing, where the segments AB and BC, form

the central axis of the composition. The author has first put aside the two rectangulars that border on both ends, two other main blocks that represent respectively the scenes of the decending and that of bewailing, which are also bordered with each – other from the segment DE. The rectangular DEFC1 is formed by two squares, where each of them is crossed from two diagonales that create respectively the points 1 and 2. These two points represent exactly the two extremities of the Christ's body and also are the key points where is concentrated the compassion of the bewailers through dramatic and emotive scenes. We can see Saint Mary at point I, shriveled next to the head of her son, and at the point 2, Joseph is bowed on the effort to kiss the Christs' feet. The Transfiguration scene (fig.2) looking at the gospel text, is introduced as an event in the life of Jesus, which has happened during his mission in Galilea and since the 16 century, it can be set in the twelfth row of the big holidays. This scene, together with that of bewailing, represent two of the four phases such as: "Crucifixion", Bewailing", "Ascension", and "Transfiguration". The word "metamorphosis", was used by Greeks and "transfiguration", by Latins. The event shown in the this icon, doesn't have a defined address, that helps the author create the relief, according to his purpose. We think that Selenica before creating his compositions, takes in consideration the essence of the event, putting together the most essential part with the symbolic one. He is also based on the geometrical structures and has made geometrical surveyings, in order to achieve harmonious compositions among volumes, spaces and figures. David Selenica emphasises the symbolic and dramatic unity of the theme, putting in the same picture two evident episodes: the Transfiguration and the miracle of the epilepsy. The composition is divided in two areas that correspond respectively to the moments of confession. The icon is divided in equal parts by two diagonales MJ dhe NI, the central axis AB and segments CD, EF dhe GH. We also have the creation of two big, equal, triangulars but with opposite directions. The upper triangle includes the main theme with three main figures, that represent the prophetic aspect, with equiposed movements of Jesus and of two other prophets, Ilia and Mose. The Jesus figure, if we see carefully the icon, is treated with light and bright colours, which creates an a1tractive element for the viewers. The lower triangular simbolises the space of reaction, the ascension, the separation and the transfiguration. The area that is created by the arch GH with the center at the point K, has the most dramatic accent in the whole icon. The arch GH, the segment KG and KH, border this way, the upper triangle that shows the ascension of Jesus towards heaven. The lower triangle, through the saints figures with their lower heads, in the opposite with the other triangle, brings more dynamism in the scene. The point K represents the moment where the Jesus' feet have had the last touch with the earth, the detachment and the ascension in Heaven. Here we have the center of the composition and the dogmatic center. This is also a referring point in placing all the plans, objects and figures. David has chosen this moment as the center of his composition, as well as the Revival painter Perugini,on his work "The key delivery" (fig.3), has put the keys at the center of his composition and also Raphael on his work "The marriage of the Virgin", (fig.4), where the center of the composition is the final act of the ring delivery. David hasn't used in his works the perspective, as we can see in the above mentioned authors, but, however, he has used the same geometrical scemes as the authors of the Italian Revival of the 15th –16th century.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Kand. Dr. Skënder MIHALCKA

TË DHËNA MBI DISA VEPRA IKONOGRAFIKE ARTI NË SHQIPËRI

Arti ikonografik në Shqipëri ka pasur një zhvillim të pandërprerë që nga Mesjeta e gjer aty nga shek. XIX, çka tregon për një traditë të kultivuar, përcjellë nga bota antike në atë bizantine dhe postbizantine. Dëshmi të kësaj kulture janë monumentet e ruajtura, ikonat, gdhendjet artistike në dru e praruar në ar, kodikët, objektet liturgjike dhe relikat e shumta.

Historiani i shquar rumun (me origjinë shqiptare), N. Jorgo, pohonte se "një monument, është gjithmonë një dokument historik që na transmeton në mënyrë më bindëse se një dokument i shkruar, informacione që i përkasin të vjetërve tanë, mënyrës së tyre të të jetuarit, mundësive të tyre dhe aspiratave të tyre".

Duke e gjykuar veprën e artit si të tillë, gjatë studimit dhe restaurimit të monumenteve të kultit ne kemi pasur parasysh dy aspektet: vlerën artistike dhe vlerën historike që përbëjnë në unitet forcën e saj. (1)

Meditimi i lirë, metoda e sondazhit, raporti artitekturë - afresk si dhe proceset restauruese ndër monumente kanë dhënë rezultate që dëshmojnë për vlera artistike dhe pasurojnë njohuritë tona në këtë fushë, duke shërbyer njëkohshëm si të dhëna të historisë së artit shqiptar.

Afreskat e kishës së Manastirit të Profet Ilisë, në fshatin Bual pranë qytetit të Përmetit rezultojnë si ndër më të vjetrat jo vetëm në këtë krahinë, por në krejt vendin tonë.

Salla qendrore me absidën i përket tipit të kishës me planimetri njënefshe kurse në një fazë të mëpastajme, si rrjedhojë e dëmtimeve që ka pasur ndërtesa, kisha ka ndryshuar strukturën e saj me rënien e arkadave dhe zëvendësimin e mbulesës me tavan druri, shtesën e narteksit dhe të hajatit përsëgjati anës jugore. Duke u mbështetur në tipin e arkitekturës dhe të dhënat teknike, specialisti A. Meksi e rreshton këtë monument mes ndërtimeve të shekullit XII duke e krahasuar me objekte të tjera përreth si me kishën e Kosinës që është brenda kësaj krahine, në kishën e Perondisë në rrethin e Beratit (shek. XIII) si dhe shembuj të tjerë të përafërt, fjala vjen me kishën në fshatin Cerskë afër Leskovikut dhe me atë të Labovës së kryqit në Gjirokastër (shek. XIII) (2).

Gjatë rilevimit grafik dhe sondazheve të bëra në këtë kishë u shquan dy shtresa suvaje të pikturuara (fig.1). Shtresa e parë, ajo zanafillëse, përkon tamam aty ku ngjitjet me murin e ndërtesës së shek. XII-XIII. (3) Afreskat e pikasura në faqen e murit verior, në faqen e murit jugor dhe në ambjentin e altarit poshtë nikes së protezisit rezultojnë si më të vjetrat; ato kanë qenë mbuluar nga një lyerje e hollë suva gëlqereje (5mm), e cila i përket një periudhe të vonë

DO NOT COPY



Fig. 1. Manastiri i Profet Ilisë (shek. XII-XIII). Bual. Identifikimi i dy fazave piktorike.

historike, fillimit të shek. XIX e pikërisht vitit 1815. Këto afreska u dhuruan nga Ali Pashë Tepelena për nder të mjekut (xherahut) të tij personal, i cili qe me origjinë nga fshati në fjalë. (4). Piktura është trajtuar me një stil krejtësisht popullor, që gjithsesi përçon nivelin artistik të asaj kohe. Të dhënat teknologjike dhe artistike të afreskave të vjetra japin trashësinë e llaçit (2-3cm) si dhe përbërjen e tij (2 pjesë gëlqere dhe 1 pjesë rërë, e ashpër kjo dhe e përzier me kashtë, fizikisht mjaft e fortë dhe e lidhur mirë me murin çka dëshmon për ekzistencën e saj në të gjithë ansamblin kishtar). Përmes sipërfaqeve të zbuluara vihet re shtjellimi i programit, monumentaliteti i figurave, vizatimi linear, gama e kursyer kromatike dhe tonalitetet e përdorura. Në majë të qoshit jug-lindor, skena "Lindja e Krishtit" çel programin ikonografik (fig.2) që përbën regjistrimin e parë në sipërfaqen e murit, për të mbërritur më tej te skenat dhe regjistrimi i dytë e pikërisht te brezi i medalioneve me profetët, ndërsa në bazë të murit hasim figurat e shenjtorëve më këmbë, gjithë vendosur sipas sistemit të vjetër bizantin.



Fig. 2a. Skena: Lindja e Krishtit (shek. XII-XIII)



Fig. 2b. Skena: Lindja e Krishtit (shek. XII-XIII) grafik.

Skena "Lindja e Krishtit" përbën kompozimin tradicional, thuajse të pandryshueshëm, që do të përcillet edhe gjatë shekujve të mëtejmë si në ikonografinë kristiane në përgjithësi, ashtu edhe

DOKTORATURË

në kishat e vendit tonë. Megjithëse të dëmtuara nga koha dhe nga çukitjet që mistria e mjeshtrit të mëvonshëm ka lënë mbi shtratin piktural, afreskat shquhen për vlerat që kanë. Në faqen jugore figurat e shenjtorëve asketë janë pikturuar sipas tipeve ikonografike që njeh tradita, por më të zymtë e të përvuajtur, me mjekra të gjata dhe veshje të thjeshta karakteristike të pikturës së vjetër. Më interesantja në këtë ansambël është figura e shenjtorit luftëtar, e cila gjendet në murin verior. Afresku ka mbërrirë pothuajse i plotë, i vizatuar në mënyrë të stilizuar, por ekspresiv për nga qëndrimi dhe shprehja e fizionomisë të fytyrës. Shpërpjestimi disi tek shpatullat dhe duart e vogla e bën këtë figurë ca naive e tërheqëse. Për nga fytyra rinore plot jetë, vështrimi i përqëndruar, mburoja metalike stolisur me luspa si të peshkut si dhe për nga arma që mban në duar, na vjen ta përqasim me Shën Mitrin; ky i fundit mund të krahasohet me prototipin e tij në Kishën e Shën Mërisë së Maligradit (viti 1345).

Duke parë monumente të zonës në shqyrtim, por edhe gjetiu si fjala vjen afreskat e ekzonarteksit në Kishën e Kosinës (pak të zbuluara nga gëlqerja) e që janë afërsisht të një kohe, gjejmë shënja gati të përbashkëta në elementet teknologjike të llaçit, teknikës së pikturimit të siluetave, figurave dhe ngjyrave. Përgjasime të zbehta për nga prototipet dhe shprehja vihen re dhe tek shenjtorët pleq në pikturën e kishës eremite të Kostarit në Sarandë. Ndërkohë, afresku ornamental poshtë nikes së protezisit ngjason me atë të kishës së Çetës në afërsi të Kavajës (shek. XII). Gjurmimi i mëtejshëm në monumentet e asaj epoke, siç qe ta zemë pastrimi i afreskave nga lyerja e gëlqeres në absidën e kishës së Kosinës në Manastirin e vjetër të Mesopotamit, do të zbulonin të tjera gjëra duke nxitur kësisoj interesin e historianit të artit.

Shekulli XVI hapte një faqe të re në zhvillimin e artit, por kësohere në të tjera kushte ekonomike, shoqërore dhe kulturore; kjo do të njihej si periudha e artit postbizantin. Në këtë zhvillim vihet re imitimi i stilit të vjetër, përshtatjet dhe adoptimet ikonografike, spikasin individualitetet artistike dhe origjinat e tyre, krijohen shkolla dhe vlerësohen talente. Në rrjedhë të shekujve XVI-XVIII-XIX, në Shqipërinë e mesme dhe të Jugut përhapen ndërtime monumentesh kulti kryesisht të ritit orthodoks çka shpjegohet me ruajtjen e traditës lindore të Bizantit dhe influencave ideologjiko-fetare që mbërrinin nga Greqia. Studjiuesit tanë V. Puzanova, Th. Popa, Dh. Dhamo, H. Nallbani, A. Meksi dhe P. Thomo me studimet e tyre kanë krijuar një bazë të mirë për hulumtimin dhe shqyrtimin e mëtejshëm të pikturës dhe arkitekturës së kultit të kësaj periudhe tonën.

Nga ndërtimet e shek. XVI vlen të përmendim kishën e Shën Sotirit në fshatin Tremisht të rrethit të Përmetit, ngritur në vitin 1560. (5) Monumenti është i tipit njënefësh me naosin (5x6m) dhe absidën trekëndëshe. Në anën perëndimore atij i është shtuar narteksi. Brendia e kishës ndriçohet dobët nga një dritare e vogël në murin verior. pasurinë e kësaj kishe e përbëjnë një tavan dekorativ dhe ikonostasi prej druri. Paçka se në përmasa të vogla, kisha shpalos një dekoracion mural sa intim aq edhe interesant, realizuar në një mënyrë pikturale të veçantë, ndryshe nga stili i këtij shekulli në vendin tonë; kjo mund të lidhet me shijet e bashkësisë arumune që jeton në këtë fshat. Në faqen lindore dhe në absidë është pikturuar gjysëm tors Shën Mëria Platiters me Krishtin e vogël dhe nën të një skenë apokaliptike. Etërit e kishës janë vendosur në të dy anët e absidës, ndryshe nga rregulli i programit ikonografik. Dekoracioni ruan nga tradita dy radhë regjistrash me brezin e medalioneve dhe të shenjtorëve, vendosur më këmbë mbi bazë të mureve. Skenat janë të ndara me bordura të kuqe, por të zvogëluara, të cilat ngjasojnë me pano të vogla si në pikturën e kavaletit. Kompozimet e ngjeshura nga personazhet që veprojnë sipas përmbajtjes biblike paraqiten në lëvizje të gjalla

dhe shprehje të theksuara. Imtësia e pikturimit me penelata të holla, ndriçimet tek mjekrat e Etërve, vlerësimi i detajeve dhe trajtimi i palave janë karakteristika të teknikës së kavaletit. Në skena ndërthuren elemente të veçanta si kapelet e jaudive, vërtet të rralla këto në ikonografinë tonë. Gjallëria që përshkon fytyrën e Shën Mërisë e bën këtë figurë më vërtetësore, kurse flokët e dredhura që bulojnë jashtë cohës që mban në kokë e largojnë cazë nga tipi tradicional.

Me kohë piktura ka pësuar retushe në disa nga figurat dhe fragmentet e trajtuara në formë artizanale duke i ndryshuar veprës së artit unitetin e saj stilistik. Megjithë vlerat që bart, piktura e kësaj kishe zbulon dorën e një autori çuditërisht të paidentifikuar ende në shek. XVI.

Në fshatin e bukur të Leusës mbi qytetin e Përmetit ngrihet Kisha bazilikale me kupolë, (fig.3) kushtuar Shën Mërisë. (6) Shoqëria aristokrate e këtij fshati, e lidhur me kurbetin, kishte marrëdhënie tregtare me Stambollin dhe



Fig. 3. Bazilika e Shën Marisë ngritur në vitin 1785. Leusë.

Janinën çka i rriste ndjeshëm të ardhurat. Përpos kësaj, të rinj nga ky fshat studiuan në gjimnazin "Zosimea" të Janinës duke u kthyer të nxënë në vendin e tyre. Kjo shoqëri investoi po ashtu për sistemimin urbanistik të fshatit, për shtrimin me kalldrëm të rrugëve, rregullimin arkitekturor të çesmave dhe ndërtimin me gurë të shtëpive dykatëshe. Por investimi më i rëndësishëm mbetet ai i ndërtimit të kishës dhe veprave të artit. Kisha është ndërtuar në vitin 1785 dhe pikturuar më 18 Prill 1812 nga piktorët Mihal dhe Gjergji (fig.4). Ndërtesa përbëhet nga naosi me përmasa 20x12m, si dhe narteksi e portiku i hapur në anën



Fig. 4. Mbishkrimi i pikturimit të kishës në faqen perëndimore

veriore. Struktura e saj e brendshme zhvillohet në sistem kupolash në mesin e trupit të kishës e të nefit qendror dhe gjysëm kupolash të nefeve anësore. Gjithë këto vijnë e lidhen me harqet dhe qemeret që mbështeten në të dy radhët e kollonave (fig.5). Në katin e dytë ngrihet mafili prej druri, ballkoni i të cilit është pikturuar mbi suvanë e ngjitur. Përveç pikturave murale, të cilat mbushin hapësirat e arkitekturës tok me vlerat artistike që ato bartin, s'do lënë pa përmendur ikonostasi, amvoni, proskinitari dhe froni i dhespotit me gdhendjet mjeshtrore, të rralla të kësaj gjinie në vendin tonë.

DO NOT COPY



Fig. 5. Nefi qëndror. Sistemi i harqeve dhe qemerëve që lidhin kollonat.

Përmbajtja e pasur e programit ikonografik përbën një numër të madh kompozimesh me personazhe të Dhjatës së Re dhe Historisë së Shenjtorëve. Ky dekoracion ndërthuret natyrshëm me fasadat e mureve, kupolat, harqet, pendativat dhe tamburin, duke e lehtësuar disi peshën e rëndë të arkitekturës. Në faqen lindore dhe në absidë është pikturuar Shën Mëria - Platitera me Krishtin Emanuel dhe Etërit e Shenjtë, ndërsa në niket anësore që përbëjnë ambientin e altarit janë pikturuar Krishti përpara kryqit dhe ignot Theofori me luanët, kompozim i trajtuar më parë nga Zografët te kisha e Shën'e Premtes në Përmet (viti 1808).

Në nefin qendror, përmes skenave të veçanta, zhvillohet historia e Krishtit: Lindja e Tij, Pagëzimi në lumin Jordan, Ngjallja e Llazarit, Hyrja në Jeruzalem, Puthja e Judës, Gjyqi i Pilatit, ndërkohë që në anën veriore vijohet me ciklin e Mundimeve: Përqeshja, Kryqëzimi, Zbritja nga Kryqi, Vajtimi mbi varr etj. Këto ngjarje përkojnë më poshtë me të tjera episode tradicionale nga fëmijëria dhe mrekullitë. Në kupolat e nefit qëndror janë pikturuar Perëndia, Zoti, Krishti Pantokreator, Shën Mëria me Krishtin rrethuar nga Engjujt që fluturojnë mbi re, peshkopë shenjtorë, që profetizojnë duke i dhënë këtij kompozimi një atmosferë solemne. Në nefin jugor, gjithë duke iu përshtatur gjysmëkupolës së tij, spikat tema e rrallë biblike "Adami dhe Eva", e trajtuar nga afër e në një tjetër version. Në këtë ansambël një vend të rëndësishëm zënë edhe kompozimet kushtuar jetës së Shën Mërisë në të ri të saj si Përshëndetja e Marisë me Elisabetën dhe Nisja e Josifit, mjaft interesante këto për nga tematika. Duke plotësuar kalotat, piktorët vendosin Ungjillorët në skrivaninë me shkrimet e shenjta dhe Engjujt që i himnizojnë. Në nefin verior, te njëra nga gjysmëkupolat paraqitet në tors Shën Nikolla bashkë me ciklin e ndodhive nga jeta e tij. Shenjtorët me objektet liturgjike ndër duar jepen në fasada sipas radhës dhe, mbi to, medalionet e profetëve qe gërshetohen me njëra-tjetrën nga dekoracioni ornamental i luleve dhe gjetheve.

Motive me buqeta lulesh në vazo në fundet e mureve pasurojnë me tej gamën e ngjyrave. E gjithë fasada e jashtme e portikut është e mbuluar me afreska që shtrihen lirshëm. Gjyqi i Fundit me personazhet dramatike që marrin shpagë në lumin e zjarrtë dhe një Deisis me Apostujt mbërrijnë të formojnë një frizë në këtë fasadë. Mbi portën e hyrjes, brenda arkitekturës së kornizës së lakuar, është pikturuar Fjetja e Shën Mërisë - një nga realizimet më të mira të këtij ansambli. Piktura e Leusës dallohet për pasurinë tematike dhe ndërthurjen e mirë me arkitekturën, koloritin e veçantë dhe freskinë e teknikës, poezinë në kompozimet, ëmbëlsinë e trajtimit të velaturave dhe nuancat delikate të toneve dhe gjysmëtoneve, dritën e bukur që e përshkon duke e ngopur interierin e sallës me një atmosferë të ngrohtë dhe qetësuese. Ndonëse piktura e Leusës është kryer në stilin dhe teknikën e shek. XVIII, ajo, për konsideratat që sapo shprehëm, spikat në pikturën e kësaj periudhe.

Një panel druri me format 19x50x5 cm u importua nga manastiri i Zvërnecit në Vlorë. Megjithëse e mbuluar nga dheu, nën veprimin e lagështirës dhe me vernik të dekompozuar, ikona e ruante imazhin piktural. Qysh në sondazhet e

DO NOT COPY

para u pikas cipa e hollë e arit dhe pas restaurimit u shfaq ikona e një Deisis (fig.6). Ikona është pjesa qendrore e regjistrimit të një ikonostasi të zbërthyer në këtë objekt, rastësisht e vendosur në fundin e tij. Në qendër ka figurën e Krishtit në



Fig. 6. Manastiri i Zvërnecit. Ikona "Desis" pas restaurimit (shek. XVI)

pamje ballore, ndërsa bekon me njërën dorë e në dorën tjetër mban të hapur librin evangjelik. Po në të njëjtin plan, më të djathtë të Tij e në qëndrim gjysëm të kthyer nga Krishti, qëndron Virgjëresha, kurse në të majtë Joan Pagëzori. Këtij triptiku i janë shtuar në të dy anët kryeapostujt Petri e Pavli. Në arkitekturën e kësaj ikone mungojnë harqet e përdredhura, të cilat duhej të rrethonin portretet e që janë zëvendësuar me retushime. Në ndryshim nga kompozimi tradicional i kësaj teme përgjatë shek. XVI-XVII e më tutje, madje duke e krahasuar me Deisisin e Onufër Qipriotit (shek.XVII), kompozimi ka një ndryshim në konceptimin e figurave ngase barazon dhe vendos në një plan me figurën qëndrore të Krishtit si Marinë, Joanin, edhe Petrin e Pavlin për të vijuar më tej në të dy anët me figurat e apostujve. Megjithëse e dëmtuar, vepra përmban vlera artistike. Kujdesi i treguar për trajtimin e figurave në volume të mëdha, ku piktori përdor për hijet ngjyrën kafe umbro, kalimet e buta në gjysmëtonet me ngjyrë të kuqërremtë, ndriçimet e bardha në mollëza, ballë dhe hundë, i japin fytyrave plasticitetin dhe shprehjen e duhur. Po ashtu kaligrafia e Shkrimeve dhe trajtimi i detajeve tregojnë për një dorë mjeshtërore, e cila e ngre këtë vepër në nivelin e pikturave të ikonostaseve të shek. XVII.

Fusha e Myzeqesë, e pasur me kisha dhe manastire, paraqet një pejsazh të larmishëm vlerash arkitektonike dhe artistike, ku spikasin individualitetet krijuese që punuan në kishat e kësaj zone. (7) Gjatë gjithë shek. XVIII Manastiri i Ardenicës me kishën e tij do të influencojë në këtë pellg si për tipin e ndërtimit të kishave ashtu edhe për ansamblet piktorike. (8) Në këtë manastir afreskat janë pikturuar nga Zografët korçarë Kostandin dhe Athanas, kurse ikonat nga mjeshtri i Ikonografisë, K. Shpataraku (në vitet 1743-1744).

Punimet restauruese e të programuara, ndërmarrë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës për ruajtjen e veprave të artit dhe arkitekturës, gjurmimin e mëtejshëm dhe zbulimin e vlerave të humbura, e pasuruan edhe më historinë e këtij monumenti të rëndësishëm. Sondazhet e kryera në afreskat si dhe ato arkeologjike në themelet e mureve (9) kanë ndihmuar për të rrokur bindshëm ndryshimet që kanë ndodhur në shekuj. Sipas mbishkrimit në ndërtesën ekzistuese të kishës, ajo është ngritur më 1743-shin mbi themele ende më të vjetra. Në faqet e gurëve të këtyre themeleve u gjetën fragmente afreskash të ngjitura, çka tregon se këta gurë të përdorur në këtë ndërtim qenë marrë nga një tjetër kishë më e vjetër, ndoshta e shek. XIII.

Mbishkrimi i Zografëve dhe skena "Fjetja e Shën Mërisë" në faqen e murit perëndimor të kishës ekzistuese si dhe gjithë ansambli i sallës përbëjnë fazën e parë dhe origjinale të pikturimit (viti 1744). Në një fazë të dytë, duke qenë se ndryshoi arkitektura e murit perëndimor; u hapën katër dritare, dy lart e dy poshtë dhe u ndërtua narteksi në anën perëndimore, i erdhi radha një lyerjeje të dytë të pikturuar, por gjithsesi pa mbuluar mbishkrimin e autorëve dhe skenën "Fjetja e Shën Mërisë". Kjo u bë jo vetëm për

DO NOT COPY

pasojë të hapjes së dritareve, por edhe për rregullimitn e programit ikonografik, i cili u prish gjatë ndryshimit. Në këtë fazë të dytë të pikturimit u realizuan edhe afreskat në anën e narteksit me Gjyqin e Fundit dhe Apokalipsin.

Në të dy fazat shohim po të njëjtin stil të Zografëve, po të njëjtat modele, po atë teknikë e frymëzim.

Intervali kohor ndërmjet këtyre dy fazave të pikturimit mund të jetë i diskutueshëm, por mbetet sidoqoftë brenda asaj periudhe kur këta piktorë punuan për herë të fundit në Kishën e Shën Gjergjit në Libofshë (vitin 1782) si dhe kur u ftuan sërish në Manastirin e Ardenicës.

Gjatë një ekspedite informative në vitin 1986 në Manastirin e Kolkondasit, një informacion i dërguar nga Muzeu Historik i qytetit të Fierit ku thuhej se në rrënojat e kishës së përmbytur nga lumi Seman qenë zbuluar afreska të vjetra, na



Fig. 7. Manastiri i Kolkondasit. Afreskat në faqen e murit verior të kishës.

detyroi të bëjmë sondazhet e para dhe verifikuam kësisoj ekzistencën e afreskave, por pa arritur ndonjë përfundim të qartë mbi vlerat, kohën dhe autorësinë (fig.7). Megjithëkëtë, kjo qe një shtytje për të rrëmuar në historinë e këtij ansambli manastiror, në të cilin, përveç kishës së përmbytur, gjendej edhe kisha me kupolë kushtuar Shën Kozmait (ngritur në vitin 1813), gjendeshin po ashtu ndërtesat me hajatin për banim, një pus dhe trakte të tjera në formë rrënojash (fig. 8). Kujdestari i këtij objekti, Rr. Saqellari, na ofroi të dhëna gojore (10) mbi emërtimin e manastirit dhe themelimin e tij në



Fig. 8. Manastiri i Kolkondasit. Kisha e Shën Kozmait, viti 1813.

shek. XV (?!). Popullsia e ardhur nga Shpati i Elbasanit me në krye një prift që quhej Kol dhe gruan e tij që quhej Konda, u vendos në këtë zonë dhe bashkimi i dy emrave të tyre bëri që edhe vendi të quhej Kolkondas. Emërtimi i këtij manastiri Shën Kozma kryhet goxha më vonë; ky emërtim lidhet me varrosjen aty të Shenjtit në fjalë dhe më pas ngritjen e kishës kushtuar këtij shenjti nga Ali Pashai i Janinës. Duket që lidhjen midis këtyre dy burrave e përbënte ideja për pavarësinë e vendit nga Perandoria Osmane.

Në vitin 1997, punimet për restaurimin e këtij manastiri, drejtuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, në bashkëpunim me Kishën

DO NOT COPY

Autoqefale të Shqipërisë, nxorrën në pah nevojën për trajtimin dhe restaurimin e veprave të artit. Zhvendosja e dherave në kishën e Shën Mërisë (11) përcaktoi planimetrinë katërkëndëshe me përmasa 19x8 m, e cila përfaqëson edhe tipin bazilikal të saj. Ky lloj tipi është i përhapur në të gjithë Myzeqenë, duke pasur parasysh madhësinë e barabartë që ka me Kishën e Shën Gjergjit në Libofshë (1782), me Kishën e Shën Kollit në Vanaj (1795) dhe atë gati të njëjtë me kishën e Manastirit të Ardenicës.

Nga mbulimi i ndërtesës ruhet muri verior deri në gjatësinë 18,5m dhe gjysma e murit lindor me absidën e rrënuar (6,50m). Afreskat në faqen veriore ruhen deri në lartësinë e kokave të shenjtorëve si dhe pjesët fundore me këmbët. Ruhet nikja me afreskat e saj dhe motivi nën të. Afreskat e këtyre faqeve paraqesin brezin e shenjtorëve më këmbë, shenjtoret femra, pleq, strategë, asketë etj. Në faqen e murit lindor ruhen afreskat në niken e protezisit me kompozimin "Kryqëzimi i Krishtit" dhe sipër ruhet vizatimi me sinopio të kuqe i skenës "Ngritja e Krishtit në Qiell". Në absidën e gërryer nga erozioni dallohen gjurmët e figurave të Apostujve dhe, nën ta, të Etërve të Kishës.

Në përfundim të pastrimit nga mbivendosjet si shtresa dheu, grumbullime myshqesh, kripëra etj. u mbërrit të shquheshin më qartë imazhet e figurave.

Duke e krahasuar këtë pikturë me pikturën e asaj zone, u vu re se ajo ka një farë manierizmi që ndeshet në qëndrimin e hijshëm të figurave me veshjet luksoze dhe palat elegante, ndeshet po ashtu dhe në modelet e tipat e përdorur nga piktorët e kësaj kohe, fillimisht nga Kostandini dhe Athanasi në manastirin e Ardenicës, e më pas nga piktorët Grabovarë (Çetirët). (12) Ngjashmëria e afreskave të zbuluara, niveli i tyre artistik, gjithë duke e krahasuar me veçoritë e pikturës së kësaj zone si dhe viti 1825 i ndërtimit të kësaj kishe që shënohet nga një mbishkrim i gurtë, dëshmojnë për dorën e piktorëve grabovarë(13), të vetmit artistë që zhvilluan veprimtarinë e tyre në Myzeqe deri në gjysmën e parë të shek. XIX.

Gjatë gërmimit në anën veriore të kësaj kishe, ngjitur me murin e saj në vendin e kenotafit (varrit) të Shën Kozmait, u zbulua dhoma-kishë ku, sipas zakonit, priftërinjtë kryenin ritet fetare. Në faqen ballore të murit ishte pikturuar figura e shenjtit "Kozma hieromonak" Afresku me përmasa 1. 60 m paraqiste figurën në pamje ballore, veshur me petkun e zi të murgut. Fizionomia e fytyrës së plakur me mjekër të



Fig. 9. Afresku i Shën Kozmait (pas restaurimit) 1977.

DO NOT COPY

bardhë shoqërohet me dorën që bekon, ndërsa në dorën tjetër mban shkopin baritor ku varen një palë rruaza. Kjo figurë është paraqitur po me të njëjtin pozicion edhe në gravurë (viti 1828), por këtu rrethohet nga skenat kronologjike të jetës së tij, motiv ky mjaft i përhapur në kishat përreth. Murgu Kozma është pikturuar edhe në manastiret e malit Athos, por ne mendojmë se ky afresk do të jetë më afër figurës reale për vetë faktin se piktori do ta ketë njohur këtë njeri, i cili, falë predikimeve të tij, qe bërë mjaft popullor. Afresku, ndonëse nuk mban datë ose mbishkrim, duhet të jetë realizuar pas vdekjes së këtij shenjti (fig.9).

Të dhënat që na mbërrijnë për mjaft vepra arti tonat, që prej shek. XII-XIII deri në fillimet e shek. XIX, dëshmojnë për një krijimtari të pasur dhe cilësore, e cila do marrë në shqyrtim nga specialistët e artit. Mjaft prej këtyre veprave, të pazbuluara ende apo të dëmtuara nga koha, presin dorën e restauratorit për t'u ekspozuar më tej.

DO NOT COPY

1. *Objekti i këtij shkrimi është gjurmimi, gërmimet arkeologjike dhe punimet restauruese në disa objekte të vendit, kryer në etapa të ndryshme (1981-1982-1984-1997).*

E. Riza, Historia e arkitekturës dhe restaurimi - dy disiplina plotësuese *"Monumentet" Tiranë 1984.*

S. Mihalçka, Gjurmimet dhe evidentime vlerash artistike në monumente kulti të vendit tonë *(kumtesë) "Ditë të trashëgimisë Europiane" Korçë 1996.*

2. Arkitektura mesjetare në Shqipëri. *Tiranë 1983.*

3. S. Mihalçka : Ekspeditë informative dhe dokumentuese në rrethin e Përmetit *1981.*

A. Zajmi. Ekspeditë konservuese – restauruese, *1982-1983 Përmet.*

4. Nga burimet faktike dhe gojore njihet tashmë kontributi që ka dhënë Ali Pasha për ndërtimin e tempujve të krishterë.

5. A. Meksi, P. Thomo, "Monumentet" *Tiranë 1980.*

6. A. Meksi, P. Thomo, Arkitektura postbizantine në Shqipëri (Bazilikat) *"Monumentet", Tiranë 1981.*

7. S. Mihalçka, Berati dhe piktura në krahinën e Myzeqesë në shek. XVIII-XIX *(kumtesë) "Monumentet" Tiranë 1990.*

8. S. Mihalçka, M. Beçi, Rezultate të ekzaminimit dhe të punimeve restauruese në pikturën murale të Manastirit të Ardenicës gjatë viteve 1984-1985 *"Monumentet" Tiranë 1986.*

9. R. Gega, Arkitektura dhe restaurimi në Manastirin Fjetja e Shën Mërisë në Ardenicë *"Monumentet" Tiranë 1987.*

10. Rr. Saqellari, Historiku i fshatit Libofshë *1978.*

11. Në kujtesën popullore kjo kishë mbante emrin Shën Mëria e Kolkondasit.

12. Th. Popa, Piktorët mesjetarë shqiptarë *Tiranë 1961.*

13. S. Mihalçka. (Kumtesë) *Korçë.*

DO NOT COPY

DATES ABOUT SOME ARTWORK OF ALBANIAN ICONOGRAPHY

(*In the text following you can read some dates of Iconography Artwork, the style and the history of the Churches builded from different times in Albania. You have read for sure about our Artwork of painting, but those carver in the Churches from the ancient times are of special value and the most beautiful Artwork*).

The iconography Art in Albania has had an uninterrupted development from the Middle Ages till end of XIX century. It tells for an cultivated tradition of the antic world, since the byzantinian and post-byzantinian period of time. The famous historian N. Jorga, of Albanian origin, emphasized that a monument is a historic document, which transmit information coming from our old generation, and reflex how they lived their life and their aspirations, etc. During studding and the rehabilitation of the religion documents, attention has been directed mostly in two aspects: the historic and artistic value.

The free meditation and the different methods of the rehabilitation, gave as results which tell for the artistic value and serve as information for the history of Albanian art. The afresc in the Monastery church of Ilious prophet near Permet city, results as one of the oldest not only in this aria, but also in all our country.

The main hall of the church is rehabilitated and covered by a wood ceiling in accordance with the style of the church. This monument, compared with the other of same epoch, is created in the XIII century. The mural paintings belong to the XIII century, and they are covered by another painting of popular style of the XIX century (fig.1). The discovering of the scheme "Born the Christ's" tells for the old style of painting (fig.2). An very interesting figure in this style is that of an unidentified fighter, who has a similarity with Saint Dimitris in the Saint Mary church of Maligrad, dated 1345.

Showing other monuments of these aria, and further the afresc of Kosina church, century XIII-XIV; in Çeta church, century XI; and the old Monastery of Mesopotam, you have to discover some other values and can stimulate the interest of the historian.

The XVI century will open a new page in the art development, – but in some other economical, social and cultural circumstances, they take the name "period of post-Byzantine Art".

It referees to the XVI-XVIII-XIX centuries, the time when the religious buildings were spread mostly in Middle and South Albania, which have been of the orthodox art. It is explained with the presentation of the East Byzantinian tradition and the religion ideological influences have come from Greece.

From the building of XVI century we can mention the church of Saint Sotiris in Tremisht village in the year 1560.

The small dimensions of the church restrain a very intimated and interesting mural decoration.

In the very nice village of Leusa by Permet district is situated the Basilica church of Saint Mary (fig. 3). The aristocratic society of this village, which have been linked with the immigration, developed at that time business relation with Constantinopol and Janina. The young people of this village have studied in Zosimea gymnasium of Janina, and after study they came back in their country, with a lot of knowledge's.

The church was build in I 785 and have been painted on April 18, 1818 by painters Mihal and Gjergj (fig.31). The painting of Leus, compared with the other monuments of the country, constitutes the style of XVIII-XIX century. An icon by wood has been imported from the old Monastery of Zverneci.

The rehabilitation of this church brought in light a "Deisis" (fig.5), with the value of an XVI century icon.

The church of Ardenica great Monastery is rehabilitated in the year 1743 and painted 1744 from zografs Kostandin and Athanasi.

But the archaeological sounding took out the old structures of XVI century and the paintings were made in different period of times.

The Kolkandasi Monastery is located near Semani river. In the center of it there is the main church devoted to Saint Kozma of the year 1813 (fig.6). But except this church, there have been discovered even the ruins of Saint Mari's church and its afresc of XVIII century (fig.7).

A very interesting discovering in this Monastery is the afresc devoted Saint Kozma. This afresc has been painted after his death (fig.8).

The dates given about some Artwork in our country during XIII-XIX centuries are as witness of a very reach art activities in Albania. But all of them are in need of a new rehabilitation, just to be put in an evidence.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Maks VELO

STUDIM MBI ELEMENTE TË ARKITEKTURËS FUNERALE MYSLYMANE NË SHQIPËRINË E MESME

Ky studim përfshin zonën e Tiranës dhe fshatrat përreth, Yzberisht, Vaqar, Mullet, Petrelë, Pezë, Kërcukje, Ndroq treg, Ndroq lagje e re, Ndroq kala, si dhe disa zona të Durrësit: Ramanat, Manzë, Pjeshkëz, po ashtu kam parë zonat e varreve në dalje të Kavajës deri në Peqin.

Materialin e kam mbledhur gjatë 20 vjetëve në periudhën kohore 1957-1977, kjo më duket e rëndësishme të shënohet se mbas kësaj periudhe ndryshimet urbane sollën me vete dhe zhvendosje të vorreve.

Deri në fillim të shekullit vorret në Tiranë kanë qenë rreth Xhamisë së Vjetër dhe asaj të Haxhi Et'hem Beut. Nga viti 1914 u shpunë në lindje të qytetit tek varri i Bamit. Thuhej se emri ka ardhur nga njeriu i parë që është varrosur. Deri nga vitet gjashtëdhjetë si vorezat myslymane, po ashtu dhe ato të krishtera ishin pra këtu në zonën lindore të Tiranës. Pastaj për efekte ndërtimi ajo zonë u përfshi brenda vijës së verdhë të qytetit, dhe kështu vorrezat u çvendosën në Sharrë dhe Shtish-Tufine.

Tek Vorret myslymane të Bamit rruga kryesore duhej të ketë qenë në perëndim, ku ish dhe një Xhami e vogël e rrethuar me kangjella hekuri, kurse shumica e steleve ishin të vendosura mbi një bazament të ulët. Gurët e vorreve i përgatisnin mjeshtra gurrgdhendës të cilët zakonisht banonin afër vorreve. Këtu ish i njohur gjatë viteve pesëdhjetë Musa Tagani i cili dhe banonte afër vorreve.

Si material më i mirë përdorej guri i bardhë i Shtish-Tufinës. Ky gur punohet lehtë dhe me kohë merr një patinaturë në ngjyrë krem-okër.

Ka dhe stele të punuara në gurë shtufi, që me kohë kanë marë një patinaturë gri të errët. Ky Iloj guri punohet fare lehtë se shkalla e tij e fortësisë është e ulët.

Tek vorret e Bamit kish dhe shumë stele të punuara në mermer, të importuara të cilat mbishkrimet i kishin në gjuhën Arabe.

Në fshatin Mullet varrezat e vjetra kanë qenë në mes të fshatit, në një pllajë të vogël, në anën e poshtme të së cilës është teqeja. Tani fshatarët e Mulletit varrosin në vorret e reja që janë më lart.

Gurët e vorreve i blinin në fshatin Carcabez (rrethi i Elbasanit), poshtë Kërrabës që njihej nga fshatarët e tërë zonës. Po këtu blinin gurët e vorreve dhe fshatarët e Petrelës. Tani vorret e vjetra në Mullet janë të braktisura, një pjesë e steleve janë thyer, kurse të tjerat janë mbuluar thellë në tokë. Këtu pamë si stele guri, po ashtu dhe dy stele druri me një gdhendje të thjeshtë (të njëjta me të tabelës 13).

Në fshatin Yzberish vorrezat ishin rreth Xhamisë. Gurët që ruhen mirë janë të gdhendur me forma e dekoracione si ato të vorreve të Tiranës.

Më në veri të Yzberishtit është fshati Mëzez. Këtu varet kanë qenë në katër-pesë vende. Në Shtish-Tufinë fshat në veri-lindje të Tiranës, vorrezat e vjetra ndodheshin në anën e djathtë të rrugës, afro 500 metra para se të hyje në fshat.

Në Ndroq gurrët e vorreve i quajnë "gurrë të gatit" (gurët e punuar me daltë). Nga vitet gjashtëdhjetë u fut dhe prodhimi i steleve prej betoni, të cilët nga sipër dekoroheshin me bojë vaji jeshil të errët dhe të kuqe.

Rojtari i vorreve në Ndroq-treg stelet i lyente me gëlqere të bardhë.

Varret më të pasura në forma dhe dekoracione janë dy varret anash hyrjes së Xhamisë së Haxhi Et'hem Beut (Tab. 1). Sikurse shihet dhe nga fotot këto stele janë tërësisht të konceptuara dhe prodhuara simbas estetikës orientate të arkitekturës funerare, dhe duhet të jenë sjellë nga jashtë dhe nuk janë të prodhuara në Tiranë. Shkrimet janë arabisht dhe dekori është tipik i varreve Turke dhe nga mbishkrimi. Janë të fillimit të shekullit XIX.

Këto Iloj stelesh janë përdorur më shumë në varret afër xhamive apo tyrbeve. Format e steleve që janë përdorur për njerëzit e thjeshtë janë më të vogla dhe jo kaq të ngarkuara me omamente.

Në stelet që do të shohim në foto (Tab.2.3.) të tërheq vëmendjen një trajtim plastik i volumeve ku dallohen qartë dy pjesë trupi me bazë katrori dhe koka e steles në formë callme. Në shumicën e rasteve nuk kanë mbishkrime. Në tetë variante vetëm njëri (Foto 4 Tab.2) ka mbishkrime arabisht. Lartësia e steleve mbi tokë arrin 60-65 cm. ku koka zen deri një të tretën e lartësisë totale. Bazat katrore të shtyllës janë 14 cm kurse formet e sipërme zgjerohen deri 25 cm.

Këto stele janë si skulptura të vogla me forma të punuara artistikisht dhe variojnë nga njëra-tjetra.

Një analizë grafike për këto katër variante kam bërë në Tab.4.

Në një grupim tjetër do të klasifikonim tetë stelet në fotot (Tab.5.6). Si zgjidhje voluminore kanë në trup pllakë-guri që mbaron me një fund piramidal hark, rreth, ose katër-këndësh.

Sikurse shihet qartë format janë akoma në stade fillestare, por mendoj se ky është grupimi më i rëndësishëm. Këtu kemi të bëjmë me forma të dekoruara me elementë të traditës pagane.

Tre janë elementet përbërës artistikë të këtyre steleve. Forma e përgjithshme, dekori dhe mbishkrimi.

Dhe këto tetë variante që paraqitëm më lart janë nga Pjeshkëza e Durrësit. Kjo vorrezë, për mendimin tim, duhet të mbrohet e të ruhet me ligj, në rangun e monumenteve të kulturës.

Elementet kryesore dekorative janë thellime të gdhendura: zig-zake, rombe, rrathë, spirale në formë kërmilli me dy koka, yje gjashtë, shtatë e tetëkëndësh të futur në fusha rrethore të thelluara, vijëza të thelluara radiale, dhe rrathë koncentrikë të dhëmbëzuar radiale.

Të gjitha këto skema dekorative i gjejmë dhe në dekoracionet e objekteve të punuara në dru, baltë, hekur si fyej, furka, djepa, poce, lugë, tasa etj. Dihet që këto janë motive astrale dhe janë përdorur gjerësisht në objekte të epokës pagane.

Këto stele kanë një ngjyrë lokale dhe ndërrojnë nga stelet orientate, si nga zgjidhja e formës, po ashtu dhe nga dekori dhe kompozimi i shkrimeve shqip.

Stelet në vorret myslymane janë dy, njëra vihet tek koka dhe është ajo që mban mbishkrimin me datat e lindjes dhe vdekjes, dhe stelja tjetër tek këmbët e cila është më e thjeshtë për nga forma dhe nuk ka mbishkrime.

Në Tab.7 kam dhënë dy stelet e një varri në Ndroq-treg.

Stelja kryesore është 28 cm në bazë dhe 63 cm në lartësi me një shkallëzim volumi që mbyllet me një volum paralelpiped.

Dekori në qendër është një rreth i madh i nënvizuar dhe një spirale e valëzuar. Stelja e dytë e vendosur në këmbët është më e ulët 24x5O cm dhe ka një dekor të gjelbër floreal.

DO NOT COPY

Në Tab.8 dhe 9 po jap tetë variante stelesh, gjashtë të sipërme me mbishkrime e dekorime dhe dy të poshtme (tek këmbët) me dekorime dhe zbukurime.

Këto stele janë të një periudhe të mëvonshme, të prodhuara në vitet gjashtëdhjetë dhe duke i ruajtur disa forma primare e disa dekore elementare, janë thjeshtëzuar duke arritur në disa panele betoni të parafabrikuara, dhe duke u larguar nga materiali tradicional: guri.

Në Tab. 10 po jap dy stele prej betoni tek një varr në Ndroq-lagje e re. Stelet kanë dimensionet 28 cm në bazë dhe 120 cm në lartësi.

Megjithatë është interesant fakti se dekori është prapë se prapë i bazuar në skema primare të hershme zig-zake, radiale, spirale dhe të kompozuara. Fshatarët e Ndroqit më treguan se gurët e Vorreve i blinin në Krujë ose Tiranë dhe i sillnin ngarkuar mbi kafshë.

Në Tab.11 po jap të vizatuar dy stele të një varri. Sikurse shihet kemi të bëjmë me një vepër të vërtetë arti për nga trajtimi i formës, vendosja dhe ekzekutimi i dekoracioneve. Dhe këtu janë përdorur po ato skema dekorative. Bien veçanërisht në sy tri rrathë të mëdhenj me rathë koncentrike që vijnë duke u zmadhuar. Brenda sipërfaqeve janë ravijëzuar dhëmbëzime trekëndore. Rrathët kanë diametra 18-21 cm. Kurse lartësia e steleve shkon 63-72 cm me bazë 23-26 cm. Në Tab. 12 kemi dy stele masive me dekoracion fantastik të pasur. Në Tab.13 po jap të vizatuar gjithashtu formën më të thjeshtë që kam takuar dy stele druri 28 cm me bazë 6 cm. Megjithatë kanë në kërkimin e formës diçka nga forca e gjetja e përkryer që u arrit vetëm në artin modem.

Në fund përpilova (Tab.14.15) një përmbledhje, ku klasifikova tërë elementet dekorative që i takova në dekorin e steleve. Janë 27 raste që vijnë duke u zhvilluar nga më i thjeshti tek më të komplikuarat.

Fillojnë me vijëza të shkurtëra paralele si një theksim, pastaj me vijëza të gjata paralele të baraslarguara, paralele dyshe, zik-zake me theksime anash, zigzake të futura në mes të dy paraleleve, kompozite pirapide-hark, spirale të thjeshta, spirale dyshe, rreth i thjeshtë me qendër, rreth me diagonale, rreth me shenja periferike, rrathë me fushë të dekoruar, spirale dyshe vertikale, spirale zemër e ndarë, trifil spirale zemër, spirale të stilizuara e të kompozuara (gjashtë raste) dhe në fund pesë raste kompozitash me rrathë e spirale. Këto dy tabela na lejojnë të shohim evoluimin e dekorit.

Stelet e varreve janë një nga realizimet më të plota dhe artistike që ka arritur arkitektura myslymane tek ne.

Shënim: Fotot, rilevimet dhe vizatimet janë të autorit.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



◂ 1)



◂ 2)

Tab. 1

DO NOT COPY



◂ 1)



2) ▸



◂ 3)

4) ▸



Tab. 2



◂ 1)



2) ▸



◂ 3)



4) ▸

DO NOT COPY

Tab. 3

DO NOT COPY



1) 2) 3) 4)

Tab. 4

DO NOT COPY



◂ 1)



2) ▸



◂ 3)



4) ▸

Tab. 5

DO NOT COPY



◂ 1)

2) ▸



◂ 3)



4) ▸



Tab. 6

DO NOT COPY



1)



2)

DO NOT COPY



1)



2)



3)



4)

Tab. 8

DO NOT COPY



◂ 1)



2) ▸



◂ 3)



4) ▸

Tab. 9

DO NOT COPY



1) 2)

Tab. 10



1) 2)

Tab. 1

DO NOT COPY



1)



2)

Tab.

DO NOT COPY



A B

Tab. 13

DO NOT COPY



Tab. 14

DO NOT COPY



Tab. 15

DO NOT COPY

STUDY ON THE ELEMENTS OF THE FUNERAL IN ISLAMIC ARCHITECTURE OF MIDDLE ALBANIA

This study is based on the Tirana area and its surrounding villages of Yzberisht, Vaqar, Mullet, Petrela, Peza, Kercukje, Ndroq-market, Ndroq-new quarter, Ndroq-castle, some of the Durresi districts of Ramanat, Manza, Pjeshkez, and also the cemetery area in the periphery of Kavaja City and up to that of Peqini. The provided material dates between 1957-1977.

The Tirana cemetery, until the beginning of this century, was situated around the Old Mosque and the Mosque of Haxhi Et'hem Bey. In 1914, the locations were displaced to the eastern part of the City and, during the 1960s, were again relocated to Sharra and Shtish- Tufine.

The stars, which are usually placed on a low basement over the tombs, were carved by stone masters. The white stones of Shtish-Tufina were preferred, but the Pumice stone was also used. Marble stars were common, which had Arabic inscriptions. Wooden stars were also used.

Among the best carved stars are those of the two tombs by the Mosque of Haxhi Et'hem Bey in Tirana, which are conceptualized according to the oriental esthetics with imported resemblance. These stars do not have any inscriptions and appear like small size sculptures (Table 4).

Another group are the eight stars at Table5 and 6. In this group, we find decoration elements of the pagan tradition, which we encounter in several ornamented objects and tools of different materials. These stars have characteristic local colors, which differ from the Oriental ones. On the muslim tombs, we find two stars: one is placed at the head where the date of birth and death are written, the second is simple and divested and is placed at the feet (Tables 8 and 9).

Concrete stars appeared recently (Table 10).
The classification of the stars' decorative elements is considered of a creat interest.

Fatbardha SHKUPI

DO NOT COPY

ZBUKURIMORJA E SKALITJES NË GUR TË VARREVE SHKËMBORE TË SELCËS SË POSHTME

E përqëndruar mbi kodrën ranore, në Pllajën e Malit të Jamës, ndodhet qyteza e Selcës, ku dikur pati lulëzuar një qendër banimi ilire.

Kjo qytezë lidhej me krahinën e Vardarit nëpërmjet Qafës së Thanës e Grykës së Çervenakës dhe arrinte lehtë në pellgun e liqenit të Ohrit, me vështirësi në drejtim të Korçës dhe rihte rrugën e Shkumbinit, faktorë të cilët jepnin mundësi për lidhje kulturore me Maqedoninë.

Arsyeja që na shtyu të merreshim me zbukurimoren e varreve të Selcës qe ngjashmëria e saj me artin e objekteve arkitekturore të popullit, të cilat i hasëm gjatë gjurmimit të vendit tonë për njëzet vjet rresht. Ne vendosëm t'i analizojmë këto dekore dhe në funksion të kësaj pune, përshkruam disa qendra arkeologjike antike si Durrësi, Apollonia, Butrinti, Bylisi dhe disa qendra mesjetare si Berati, Voskopoja, Shkodra. U njohëm, gjithashtu me monumentet e Shkupit, të Tetovës, vizituam dhe disa qendra bizantine në Bullgari e Turqi si dhe qendrën homerike, Trojën e paharruar.

Sigurisht studjuam me hollësi elementet mitologjike përkatës të shoshitur nga historianë, si Edmond Saglio në enciclopedinë greko-romake dhe Leon Heuzey, dhe i krahasuam mandej ato me elementët e varreve të Selcës, me qëllim që t'u jepnim shqiptarëve një pasqyrë të saktë të asaj mrekullie që përcolli ndër shekuj shpirtin e vet pellazgjik.

Jemi të bindur për identitetin ilir të Selcës, por nuk përjashtohet rasti që mbreti, i cili u vendos në këtë varrezë të përdorur disa herë, të ketë qenë një diadok në vartësi të mbretërisë maqedone, ose një ilir, i cili, për të ngritur këtë varr shkëmbor, pati thirrur ndërtues maqedonas, me në krye një arkitekt të quajtur Meko, ndofta vendas apo pelionas. Afiniteti i madh i këtyre dy fiseve lë të kuptohet se maqedonët e asaj kohe ishin stërnipa të pellazgëve, ashtu sikundër ilirët dhe besonin të njejtat perëndi.

Duke vështruar brezin e artë, që u gjet në varrin e mbretit shihet se që të dy grupet ndërluftuese kanë të njëjtat veshje. Janë maqedonas që luftojnë kundra ilirëve dhe që të dy palët kanë helmeta e mburoja të njëjta. Njëren palë e mbron një gjarpër, kurse tjetra duket si e mundur. Tek ana tjetër duket një zog që fluturon.

Si qëndron atëhere çështja e Selcës? Zbuluesi i parë i Selcës me varret shkëmbore qe arkeologu Hasan Ceka më, 1948, i cili përcaktoi karakterin qytetar të vendbanimit dhe rolin si kryeqendër e të gjithë krahinës. Mbi bazën e zhvillimin të brendshëm ekonomiko-shoqëror në shekujt VII-V p.e.s u krijuan vendbanimet protourbane.

Në vitet 1969-1970 arsimtari Vangjush Manastirliu nga muzeu i Pogradecit gjeti dy varre të tjera, por kërkimet sistematike janë zhvilluar në vitet 55-65 nën drejtimin e arkeologut Neritan

DO NOT COPY

Ceka, i cili zbuloi një ndërtim funerar, një tempull dhe një varr tjetër monumental duke theksuar se ndërtimi qe kryer në dy mënyra: E para me zbatim të drejtëpërdrejtë në shkëmb dhe e dyta mbi plloça guri të nxjerra nga guroret vendase. Sipas tij u gjetën tri faza zhvillimi. Faza e parë, fillestare, paraqytetare, që nga shekulli VI-V p.e.s. sipas qeramikës. Faza e dytë qytetare, me ekonomi prodhuese nga shek.IV-I p.e.s. dhe e treta kështjellore nga shek. I p.e.s. deri në shekujt IV e përfundimisht VI të erës sonë si pasojë e ndërtimeve të Justinianit. (1)

Studimi i botuar i arkeologut Neritan Ceka mbi Selcën e Poshtme ka zbërthyer shumë probleme që i përfshin tema e tij, si lidhja me krahinën e Belshit, të Shkumbinit, të Devollit me Maqedoninë perendimore ose krahinën e Vardarit dhe Epirin e Sipërm që nga koha e Hekurit. Ne deshëm vetëm të plotësojmë anën ornamentale të kësaj vepre madhore të arkeologut Neritan Ceka për qëllimet që përmendëm më sipër.

Përparësia e varreve maqedone dëshmon mbi përvetësimin e përvojës së mjeshtërve maqedonas nga ata ilirjanë, si ndodh dhe në ditët tona me ndërtuesit e rrethit të Dibrës. (2).

. Për mendimin tonë problemi i varreve shkëmbore duhet të jetë më i ndërlikuar. Çfarë përfaqësonin këto varre nga pikëpamja mitologjike, cila është simbolika e zbatuar në zbukurimet dhe çfarë rëndësie pati zbulimi i tyre për artin e sotëm të ndërtimtarisë shqiptare, janë pika të cilat dalin nga sfera e temës së arkeologut të më sipërm. Një studim mbi artin e të ndërtuarit, të zhveshur nga mitologjia dhe simbolet e saj përkatëse, për shekujt gjatë të cilëve është zbatuar, do të qe i dëmshëm dhe agnostik, prandaj insistojmë që kjo çështje të ketë përparësi sepse një gabim i këtij lloji mund t'i kushtojë rëndë interesave etnike të vetë kombit tonë. Ne për çdo hipotezë jemi bazuar tek ekzemplarët e argumentuar prej studjuesve botërorë dhe nga të dhënat gojore të familjeve ndërtuese në të gjithë Shqipërinë. Duke i ballafaquar njëra me tjetrën kemi sjellë përfundimet tona.

Për këtë arsye jemi thelluar në të gjitha fushat, që nga neoliti ballkanas, duke parë periudhën e bakrit, bronzit, hekurit, stilet klasike para e pas erës sonë. Studiuam artin mesjetar në tërësi dhe veçanërisht atë shqiptar.

Gjatë kësaj rruge kuptuam se ilirët e më vonë arbërit e mesjetës, motivet e dashura të stërgjyshërve i fshehën në orenditë dhe veshjet që të mos krijonin turbullira në raport me kishën kristjane e cila më vonë i ka përvetësuar këto motive dhe në repertorin e saj. (3).

Këto motive rifilluan të zbatoheshin pas fuqizimit të dinastisë Bizantine Komneni, me interesimin direkt të perandorit Aleks Komneni, dhe lulëzuan plotësisht gjatë sundimit osman, të përkrahur nga toleranca e tyre, sepse ata ndihmoninm artin dekorativ të popujve në dëm të figurës, prandaj nuk janë huazime nga bota, por të trashëguara brez pas brezi në vatrat tona.

Duke pasur si pikësynim banesën e Selcës dhe jo banesën popullore të rrethit të Pogradecit ne nuk mund të zhvillonim një studim retrospektiv të dekoracionit të sotëm e ta çonim atë deri tek Selca duke kaluar nëpër mesjetë. Ne përcaktuam vetë motivet e huazuara sipas stilit dhe vendit të cilit i takonin. Rëndësia e njehsimit të varreve të Selcës me "nekropol tempull" të kultit paragrek te Demetrës nuk qëndron aspak jashtë temës sonë, përkundrazi ajo hedh dritë të fuqishme mbi problemin pallazgjik. Prandaj, ne i kushtuam vëmëndje të posaçme këtij problemi që lidhet me tokën nënë (Demeter-Dhemiter-dhe është toka, mitera, është nëna greqisht).

Varret shkëmbore për të parën herë i gjejmë në luginën e mbretërve në Thebe të Egjyptit si fazë e tretë zhvillimi (4). Tek frigasit që janë brykët thrako-ilirë, siç u-njohëm së afërmi me ta, kur vizituam Kapadokian dhe pamë kokat gjigande prej guri të malit Nemrut, në muzeun e njeriut në Ankara, me qeleshe të tipit kosovar. Ne pamë motivet e tyre me spirale e svastika si

DO NOT COPY

në vendin tonë. Duket se dasaretët e përvetësonin këtë kulturë më ndërmjetësinë e ndërtuesve maqedonas të arkitekturës duke patur parasysh varret e Pydnas (5). Për frigasit ne pyetëm me hollësi arkeologun Selim Islami i cili na bindi për analogjinë e tyre me brygët ilirë. Pra tek frigasit varret shkëmbore zhvillohen në tri etapa:

1. Të parët paraqiten si porta e luanëve mykenas.

2. Të dytët, me figura gjeometrike kryqëzuese si tek varri i Midas Lavalta, mbretit legjendar të Frigisë VII-VI para e.s. (fig.1 (4a) e (4b)).



Fig. 1. Varri i Midas Lavalta - mbretit të Frigisë me Svastika në ball në Eskishehir.

3. Të tretët, në trajta tempullare ose si banesa të zbukuruara me portikë, shtylla jonike dhe kamera lutëse. Ashtu si në Frigi këto varre u-zbatuan në Maqedoni (fig.2) dhe Etruri gjatë shekujve VI-V p.e.s, (4c) e (4d).



Fig. 2. Varr maqedon i Pydnas.

4. Rruga nga frigasit për te Etruskët natyrisht ka kaluar nëpër iliri. Varret shkëmbore të qytezës së Selcës mbetën ekzemplar i vetëm në Shqipëri deri sot, se nuk gjenden tipa të tillë nga periudha para helene.

Ndërtimi i tyre u përcaktua në shekujt IV-III para erës sonë, dhe nuk u vunë re shenja pushtimi të huaja. Ky fakt na bind për ecurinë e pavarur të mjeshtërisë së ndërtimit tek popullsia vendase, që përdori guroret e afërta për këtë qëllim. Por,

bashkëpunimi me mjeshtërit e ardhur nga zona e Dibrës dhe Ohrit është i dukshëm, si dhe në shekujt XVIII e XIX kur gurskalitësit mokrarë udhëtonin bashkë me dibranët për të ndërtuar nëpër Perandorinë osmane. Duke qenë shiste ranore, natyra e gurit, u shkatërruan mbishkrimet, mozaikët, afreskët, kështu na u kufizua thellimi i studimit.

Ndërkohë ne e konsiderojmë të drejtë polemikën e zotit neritan Ceka, me epigrafistin Freng Lui Rober (Louis Robert) mbi emrin Mekos ose Meko, që ky i fundit e quan njësi matëse. Ky emër është i përdorshëm dhe sot në Shqipëri, pastaj prania e mjeshtërve ilirë ishte e pamohueshme atëhere, si dhe sot në Mokërr. Guri i mullirit në mbarë vendin quhet mokërr se andej ka dalë. Këta mjeshtër kanë qenë të organizuar në esnafe që përbënin shtresën artizanale të qytetit.

Sipas kolegut tonë, arkeologut Neritan Ceka, varret me qemer, trajtat e stilit jonik, reliefi e mozaiku qenë përvetësuar me kohë nga qytetet e tjera. Ato përcaktuan fytyrësinë jonistike të artit të ndërtimit në Iliri. Kështu, na del rasti i Selcës, qytetërimi i së cilës është me përmbajtje ilirjane, me një shkallë të lartë zhvillimi të elementëve jonikë. (Për nga stili elenistik ilirjan i mbuquajtur iliriku jonistik, nga personalitete të Akademisë shqiptare, si profesorët Kristo Frashëri e Stefanaq Pollo, për pjesën e territorit ku jetuan ilirët dhe epiriotët).

Dasaretët artdashës, që banonin mbi këto pllaja, lanë gjurmët e tyre tek veprat e artit rreth liqenit Lihnid (Lyhnid). Si të gjithë ilirët, ata ruanin pikëpamje ideografike në paraqitjen e zbukurimit të figurshëm, ndryshe nga grekët adhurues të portretit realist. Këto pikëpamje lidheshin me adhurimin e forcave të natyrës së nëndheshme, të zjarrit dhe forcave qiellore, që pasqyronin pjellorinë e tokës e të racës njerëzore, të përfaqësuar nga Demetra (Magna Mater), Kora e Apolloni, Vesta dhe Hefesti. Simbolet e kultit të Demetrës janë Pishtari, mburoja me shenja diellore, spektri, kalliri, topuzi, shporta me lule e pemë, arka e mistereve, kryelopa ose kryedemi, gjarpëri, broka ose vazo. Një pjesë e këtyre simboleve vendoset mbi ballorin (fronton) e tempullit të saj në Lefsina (5) (Eleusinion) (fig.3).



Fig. 3. Altari i Demetrës në Eleusinia të Greqisë (Lefsina).

Sipas rastit për të therej një dem ose lopë. Studjuesi Ugo Xhianeli (Ugo Giannelli) e lidh demin me Apollonin në disa monedha antike.

Frize të ngjashme me atë të Eleusinias gjejmë tek metopet e ballorit të Teatrit të Apollonisë, që sot janë ekspozuar në muzeun e kishës Shën Mëri të Manastirit të Apollonisë dhe një altar ndodhet në Muzeun e Fierit.

Nga studimet e vazhdueshme na rezulton se lopa e bardhë i kushtohej perëndive të qiellit, lopa e kuqe perëndive të zjarrit dhe lopa e zezë atyre të nëntokës sa dhe demi.

Një veti e dytë e artizanëve ilirë e maqedonas ishte skeuomorfia që do të thotë paraqitja e një simboli me anë të një sendi çfarëdo, për shembull: bisku spiral, litari i valëzuar dhe degëzimi i hardhisë, të cilët duke u përdredhur paraqesin brirët e veshët e demit, lakimet e gjarpërit, dallgët e detit, kashtën e kumtrit. Sendi i përdorur nga artisti skeuomorfist mund të jetë dhe prodhim artizanal si shkuli me pejna, shporta hasri, kallinjtë e thurur, me anë të cilëve sajohen gjeometrikisht shumë lloje motivesh. Duke gërshetuar kashtën krijoheshin svastikat e helikat, duke luhatur shkulet lindnin spiralet e kashtës së kumtrit dhe duke përdorur thonjëzat,

DO NOT COPY

DO NOT COPY

gishtëzat dhe luspat mbi kufizat e stelave, arkave e rafteve të murit, te djepave e frizeve të ikonabaetësve kujtonin gjarpërin ktonik. Ne i jemi përkushtuar motivit të thonjëzave, gishtëzave dhe luspave, duke u këshilluar me mjeshtrit më të moshuar të ndërtimit si dhe me etnografët Rrok Zojzi e Mark Tirta. Cila qe arësyeja që u përdorën këto motive në vend të spiraleve e luleve. Këtë e kuptuam pas hulumtive tona se thonjëzat e luspat kishin veti ruajtëse hyjnore për krishtin, banesën dhe fëmijën në djep, pra veti apotropaike, sepse paraqisnin trupin e një gjarpëri të padukshëm që për ilirët e shqiptarët ka pasë fuqi të pakufishme mbrojtëse nga forcat e këqija.

Solomon Reinak (Solomon Reynach), në veprën *"Kulte, mite e besime"* (Cultes, Mythes et Religions) përmend vazhdimisht këtë fakt: "*Po të gjeni një figurë ideografike që ju intereson, kërkoni me këmbengulje edhe sozinë e tij reale se do ta gjeni patjetër"* dhe ne vepruam sipas udhëzimeve të këtij historiani të mirënjohur të artit botëror.

Mjeshtrit popullorë të guroreve, tërhoqën me vete, brez pas brezi motivet e trashëguara për t'i vendosur mbi mozaikë, krejsa (kapitale), tavane, tymtarë mbi kamaret të cilat shërbenin si altar për të ndezur qirinj ose si grella për të vendosur filxhane. Trajtat ndërtimore të varrezave si brezat ndarës të valëzuar në frontone klasike dhe flegrat e dyerve me kunja kovaçi, arrijtën tek ne deri në shek.XIX, po të kemi parasysh Portat e Shkodrës, të Beratit, Voskopojës e Gjirokastrës.

Nekropoli i Selcës mund të quhet denjësisht "shkëmbi i prijsave për nder të Bardhylit të ri". Arkeologu Neritan Ceka e njëson Selcën me Pelionin që sipas Spiro Kondës na kujton pellazgët, pyllorët ose pellgasit e përqëndruar në këtë zonë me gurore të buta, që më vonë do të quhen dasaretë ose deshër për hir të jetës së tyre. (6).

Theksojme se flija e demit (Taurobolia) shoqërohej me atë të dashit (Criobolia) si vëmë re në lapitet ose buzmet e muzeut të Durrësit. Ka shumë mundësi që emërtimi "dem" të lidhet me emrin Demeter, pra simbol i dheut nënë. Diku në jug demi quhet dhe "ter" për hir të tokës që është e terur e jo me lagështirë si deti.

Në këtë nekropol u gjetën gjashtë varre. i pari qe ndërtuar nga mesi i shek. IV p.e.s., kurse pesë të tjerët gjatë gjithë shekullit III p.e.s. Duke analizuar sejcilën prej tyre, nga pikëpamja e zbukurimores arkitekturore, e duke i krahasuar me pjesëzat e muzeut të Durrësit dhe Apollonisë, të kësaj periudhe, që afrohen me monumentet jonike të Greqisë, si tempulli i Artemisës dhe erekteu i Athinës dhe pas njohjes me frizet e Lapitet e Trojës dhe varret etruske (7) dallojmë këto tipare:

Tek varri i parë ndërtohet një faqe e ndarë prej katër shtyllëzash me bazë të gjërë; në mes tyre është skalitur dera e jashtme ku diktohen dy pjesë të kërcyera që shërbenin për të mbërthyer flegrat me teknikën e derdhjes së plumbit të shkrirë, që u zbatua ndër shekuj nga mjeshtrit dibranë në vend të betonarmesë, për të ngujuar shkallaret spirale te dy xhamive të kryeqytetit, Sylejman Pashë dhe Haxhi Etëhem bej. Plumbi është derdhur aty ku krijohej boshti i ngjitjes së pjesëve të shkallares. Pas përfundimit të varrimeve u vendos porta e palëvizur, nga e cila ka mbetur pjesa ku shihet trajta e një gozhde rrumbullake, si kunjë kovaçi. Në të dy anët e portës renditen shtyllëza gjysmë cilindrike me krejsa jonikë e dy këndrejta me krejsa të thjeshtë. Krejsat jonikë paraqesin lule në mes. Panotë e ndërmjetme qenë pikturuar me afreska (Fig.4).

Varri i dytë ku ndodhet tempulli rrethor mban gjithashtu një sheshore të mbuluar me pllaka të ngujuara në plumb, ku ndjehet përdorimi i kazmës, daltës së gjërë dhe limuesit, me një teknikë të ashpër punimi.

Për varrin e tretë do të flasim gjërësisht më poshtë.

Varri i katërt ka një derë e cila rrethohet prej brezit shpatullor të kufizuar nga një rryp i dytë i lakuar. Sipër derës përshkohen bedena vezakë. Shtyllat mbajnë intablementin e përbërë nga trau

DO NOT COPY



Fig. 4. Zbukurimorja e skalitjes në gur të varreve shkëmbore të Selcës së Poshtme ku shihen afreska dhe kapitele të lulëzuar.

këndrejtë, dyfishbrezi i lakuar tip S që bartin ballorin (frontonin). Pjesët e tij të veçanta janë zhdukur. Ky lloj intablementi (trabeazione) është i thjeshtë për stilin jonik që zbukurohej me motive të pasura dhe për stilin dorik që mbante metope e triglife, ku metopet paraqisnin figura luftëtarësh ose simbole shtazore të një riti të caktuar. Përkundrazi ai i Selcës pasqyrohet i thjeshtë (fig. 5).

Varri i pestë nuk përmban ndonjë gjë të veçantë nga ai i katërti nga pikëpamja arkitekturore. Do të flasim më poshtë për dekoret e tij. Varri i gjashtë në trajtë këndrejtë ruan flegrat e dyerve, të paprekura, të cilat ngjajnë me dyert e Shqipërisë të shek. XVIII. Njera flegër është e ndarë në dy pjesë nga tri breza horizontalë. Në brezin e sipërm shihen gjashtë kunja kovaçi, në brezin e mesëm tri kunja dhe në brezin e poshtëm, gjashtë të tilla (fig.6).

Varri i tretë, më i rëndësishmi i skalitur në jug të varrit të parë, paraqet punime artistike më të shquara. Përbëhet nga dy hapësira të mbivendosura, ndër të cilat, e nënteshmja është



Fig. 5. Varri i katërt me intablement mbi krye

përdorur si varr. Faqia e tij shkëmbore përbëhet nga dy pjesë të rrafshta, që kufizojnë një sipërfaqe të lakuar si drapër. Mbi të është sajuar portiku me tetë shtylla cilindrike, gjashtë nga të cilat paraqiten si gjysma shtylla me kanelyra, dy anësoret e sipërfaqes së lakuar që lidhen me të rrafshtat janë çerek shtylla.

Krejsat (kapitelet) e tyre janë skalitur veçmas mbi lëndë të fortë dhe janë ngujuar me plumb mbi shtyllat, paraqesin trajta jonike më të përsosura të një lloji të veçantë (suigeneris) që përmban disa tipare lokale.

DO NOT COPY



Fig. 6. Varri i gjashtë me flegra të ngujuara me kunja kovaçi



Fig. 7. Platforma e varrit 3



Fig. 8. Krejsi jonik me spirale

Kapuçi paraqet dy shtjellëse anësore që bashkohen në një ulluk të përkulur, ndën të cilin përshkohen brezi i lakuar gjysmë rrethor. Ky kapuç i cili quhet (Pulvinum) është monolit me mbikrejsin (abakus). Ndën të mungon nënkrejsi (ikinum) që është zëvëndësuar prej brezit të lakuar nga baza e të cilit zbresin 11 kanelyra (fig.7). Në mes të dy shtjellësve të krejsit jonik shihet luletaçja (anemoni) e cila quhet tek ne dhe lule zhabina, me gjashtë petla, nga të cilat përhapen rreze. Anash shtjellset sajojnë gjysmëçoktha (astragal), sipas vizatimit që kemi realizuar (fig.8) dhe (fig.9).

Në të kundërt krejsi jonik i Durrësit mban pllakën mbështetëse të arkitraut sipër dhe nënkrejsit rrotullor (ovuli) ndën të. Poshtë ullukut rreshtohen vezoret, ndërsa çokthi i anës (astragali) ndahet prej një kordoni, duke sajuar figurën e bipenit (bipenne-armë me prerëse dy anësore) që lidhet me kultin e Zeusit (fig.10). Kështu e gjejmë në artin grek sipas historianit Xhovani Patroni (Giovanni Patroni) (8).

DO NOT COPY



Fig. 9. Vizatimi i krejsit jonik të Selcës, Ballori, bazamenti, profili (kapiteli).



Fig. 10. Kapitel ose krejs i muzeut të Durrësit

Skica e krejsit të Selcës është një figurë skeuomorfike ku dallohen qartë brirët nga këndet e Pulvinumit. Në ball lulja tauroborike, sytë e krijuar nga dy shtjellëset anësore dhe turinjtë tek ulluku i përkulur. Ky motiv vazhdon gjatë mesjetës dhe vlen të trajtohet si motiv i veçantë. Lulja e ballit na kujton shprehjen popullore të Dibrës e Dukagjinit "I ra lules së ballit" kur dikush qëllon në ball dikë për vdekje. Kjo tregon trajtën e kafkës tek sinuset ballore të cilat i ngjajnë nji luleje tri petlash, që sipas zakonit është caktuar për t'u goditur me shpatë për flijim. Kjo shpatë mund të jetë dhe sopatë dyprerëse, si ajo që çau kokën e Zeusit për të lindur Pallas Atena. Pjesa e poshtme e shtyllës përfundon me një bazë mbështetëse të shkallëzuar. Po ta plotësojmë me hamëndje çokthin anësor, të përgjysmuar të krejsit, të Selcës do të përftojmë ideografinë e një topuzi me dy anë goditëse që zëvendëson sopatën dyprerëse, e cila lidhet me kultin Zeus-Rrufe.

Për ta përforcuar bindjen tonë, po përmendim gjilpërën kapse trojane, të gjetur nga Henri Shliman (Heinrich Schlieman) (9), e cila paraqet një kokë skematike demi me sy e brirë spiralë, që mban mbi portret lulen e diellit (fig.11) ashtu si tek xhamadani i Drenicës, ku në vend të lules, fytyra e demit mbulohet me dyfish spirale diellore.



Fig. 11. Kapse Trojane

Çfarë kishin ndërmend të krijonin mjeshtrit pelionas me krejsin jonik të varrezës? Mendoj që udhëheqësit e punimeve kanë qenë vendas. Ne nuk mund të gjejmë të përcaktuar në artin botëror, me qëllimin fisnik të lartësimit të një populli barbar, sipas tyre, mbi kulturën greko-romake. Mendojmë kështu sepse asnjë historian arti, nuk ka dashur të thellohet në zanafillën e stileve jonike e korintike. Kjo detyrë i mbetet si barrë tashmë studjuesve shqiptarë që të hulumtojnë në rrugë tërthore për të gjetur të vërtetën e mohuar dhe kjo përpjekje nuk i largohet temës së artit të ndërtimit, si gabon dhe televizioni ynë hera-herës.

Mbi faqen e sheshtë, djathtas hyrjes kryesore, të varrit shkëmbor nr.3 të Selcës është modeluar një edikola (edicola) e tipit kamare vdeksore necrozothecula) taurobolike, brenda së cilës gjendet një kokë e skalitur demi ose lope që mezi dallohet nga erozioni, ndërsa sipër kamares është zbatuar helmeta tipike maqedonase si ajo e Filipsit të II-të me kryet e shqypes në ball (fig.12). Helmetën origjinale të mbretit Filip II, babait të



Fig. 12. Edikola djathtas hyrjes së varrit nr.3

Aleksandrit të madh, me shqipen mbi krye, e gjetëm mes materialeve të zbuluara në Virgina pranë Selanikut (fig.13). Mbi të na flet Manolis Andronikos. (Shif referencën 22). Që në lashtësi, kamaret e këtij lloji janë vendosur mbi altarët taurobolikë (taurus latin, = është demi) që i kushtoheshin vrasjes së demave për hir të Sibelës e Atit (Cybele et Atys), nëna e ati tek frigasit, ku hyjnesha "Nana" i përket nënës së tokës, kurse "Ati" përfaqëson herë birin, herë babanë. Nga këto dy fjalë që lidhen me dialektin gegë, çdo shqiptar mund të kuptojë shumë gjëra që nuk i ka ditur. Kudo këto lloje kamaresh shfaqin atributet e të dy hyjnive, me shpatat si vrasëse të demave e njëkohësisht karakterin luftarak të tauromakut. Demi tek popullsitë që banonin Mesdheun paraqitet si kafshë e shenjtë që në mijëvjeçarin V p.e.s. Në Dunavec u gjetën qeramika taurobolike të kësaj periudhe, në Maliq nga mjv. i dytë p.e.s. dhe në Dimal gjatë periudhës jonik-ilirike (elenistike) (fig.14). Demi në këtë rast është modeluar në mënyrë realiste. Në qytetin e Durrësit mjeshtrit ilirë skalitën disa altare taurobolikë, ndër të cilët ai i demit të zbukuruar me anake (guirlandes) gjethesh e pemësh, pranë lule taçes (anemoni) gjashtëpetlash, që na kujton tempullin e Demetrës Eleusine. Altarët e tjerë janë grabitur nga misionet e huaja. Njëri prej tyre në mes të Demetrës e Korës Shek. III-II p.e.s. (fig.15) i parqet kokën e demit të stolisur me anake



Fig. 13. Helmeta e mbretit Filip II

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 14. Kryedemi i Dimalit



Fig. 15. Demetra e Kora anash Kryedemit



Fig. 16. Altari i Dionizit në Apolloni

dafine dhe lulen e njohur në të djathtë të kryedemit (10). Një altar të ngjashëm me anake pemësh e boçe pishe, që i kushtohet kultit të Dionizit e hasim në Apolloni (fig.16) Jashtëzakonisht interesante qenë skulpturat qeramike të kryedemit të vendosura mbi murin e vatrës të një banese hitite, të gjetur në Çatall Ejyk (Çatal Eyuk) që i përkisnin neolitit të hershëm në Turqi, të para nga autorja.

Motivet e këtyre altarëve, veç kokës së demit, ndryshojnë nga simotrat e tyre të Italisë dhe Francës të shek. VIII-VII p.e.s. që i përkushtoheshin perëndive frigase si Ati, që mbante një qeleshe të tipit trojan të ngjashme me qeleshet shqiptare (fig.17). Pranë atit fshihet një helmetë e tipit Maqedon dhe një dem, në altarin e parë të perigë (Perigueux). Këto altare i kishin ndërtuar etruskët (11).

Po të vërejmë altaret e Klosit, i shekujve të përafërtë, figura e lules gjashtë petlash është i vetmi simbol i tyre siç i pamë dhe në realitet.

Nga këto atribute, në Selcë u gjetën vetëm koka e demit, helmeta që nuk është qeleshe frigase dhe shpata e vendosur në varrin e katërt.

Nekrokamarrja (Necrozothecula) e Selcës është ndërtuar, si të tjerat, por i kushtohet



Fig. 17. Altare etruske të ndërtuar në jug të Francës

demetrës, dhe prijsi ushtarak i varrit të tretë si pjesëtar i familjes fisnike, është në të njejtën kohë një tauromak, që ka goditur një dem, motiv të zbukuruar me lule. Për këtë arsye tempulli i varrit të dytë duhet t'u ketë shërbyer miteve të mësipërme dhe varreza e Selcës nga shenjat duhet të ketë qenë një lloj panteoni, me karakter disa perëndish si Demetra, Apolloni, Vesta. Mburoja ilire, e skalitur mbi faqen e rrafshët të anës së majtë përforcon bindjen për sa thamë më sipër, sepse ajo paraqet motivin e svastikës të përsëritur katër herë, nga të cilat tre prej tyre janë prishur (fig. 18). Duke e plotësuar me imagjinatë vizatimin



Fig. 18. Mburoja ilire e varrit të Selcës

e saj, në pjesën e prishur, krijohet një mburojë e tipit ilirjan. Aty dallojmë tri rathë bashkëqëndrorë, që rrethojnë katër gjysmë elipse të pajisur me svastika, duke krijuar kështu kryqin e gjërë në mes, i cili na paraqet një figurë ideomorfe të mirënjohur si nëna e madhe që në neolitin e hershëm (fig.19). Sipër saj shihet kordha.



Fig. 19. Vizatimi imagjinar i mburojës së Selcës

Sipas Lehler (Lechler), motivi i svastikës përfshihet në simbolet qiellore, megjithëse kritika e disa studjuesve evropianë e ka skualifikuar Lehlerin. Arsyeja e këtij veprimi lidhet thjeshtë me bindjet, pra me krishtërimin. Përkundrazi Lehleri e vendos atë në periudhën neolitike trojane dhe ballkanase, ku ajo lindi si pasojë e hulumtimeve të para primitive të qiellit ku njerëzit panë diçka në kupën qiellore. Ajo ishte harta e boshtit të qiellit që ekspozon Lehleri. Ka mundësi të jetë dhe kostelacioni i Orionit gjuetar, sepse kur përshkruhet mburoja e Akilit në Iljada, thuhet se në qëndër të saj ndodhet gjuetari Orion, kurse skica e mburojës në pikturat e qeramikave

DO NOT COPY

DO NOT COPY

të lashta paraqet në mes një svastikë. Në ndonjë rast mund të ketë qenë ndonjë kometë ose ndonjë tufan rrethshtjellës. Kjo dukuri nuk është vërtetuar ende, por pllakat qeramike të neolitit Maliq-Kamenik, të zbuluara nga arkeologu. Françesk Prendi, flasin për kostelacionin e orionit, më shumë se të gjitha hipotezat tona. Svastika trashëgohet tek ne, pra që nga mijëvjeçari III p.e.s. dhe gjendet gjithashtu tek dardanët e Trojës, në peshëzat e avmendit (12).

Svastika e gërshetuar u zbatua në mozaikun e Linit, me motive zogjsh brenda katrorëve. Ne i zhveshëm me imagjinatë zbukurimet, duke zbuluar kështu trajtën e gërshetuar të mozaikut, i cili paraqet dyfish svastika (fig.20). Gjatë mesjetës svastika u daltua mbi pllakat e gurta të kishave e qemerët e dyerve, si në kishën e Peshkëpisë pranë Gjirokastrës dhe në dantellat e grave. Gjatë shekujve XVIII-XIX svastika përfshiu, pothuaj, të gjithë tymtarët.



Fig. 20. Mozaiku i Kishës së Linit

Musandrat e dyert e brendive shqiptare si do ta vëmë re mbi flegrën e një dere shkodrane të mbërthyer me copëzime (dograma) druri (fig.21) Shenjat e varrit te Selcës dëshmojnë për një mbret ilir dhe prift njëkohësisht, i cili është bërë aleat ose diadok i mbretërise Maqedonë Alekasndrit, qoftë ky dhe Bardhyli i Ri, siç thamë pak më përpara.



Fig. 21. Derë shkodrane e shek. XIX.

Sheshorja para portikut të varrit shkëmbor ka qënë zbukuruar me mozaikë të cilët janë zhdukur. Varri i vërtetë ndodhet ndën sheshore dhe paraqitet me qemer si galeritë e nëndheshme të kalasë së Elbasanit. Në këtë varr u zbuluan dy sarkofagë (Bisellium) që duhet t'i takonin prijsit dhe të shoqes së tij. Mungesa e flegrave të derës dëshmon për një grabitje që në kohët antike. Më vonë ky varr u ripërdor. Një personalitet i shquar

DO NOT COPY

në sarkofagun e dytë dhe u mbulua me një pllakë guri, të sjellë rishtas, mbi të cilën dallohen motive të njejta me pllaka e të dy sarkofagëve të mëparshëm, të vendosur pingul mbi dysheme. Kjo pllakë është ruajtur më mirë dhe paraqet një shtrat, i cili sipas vizatimit i takon stilit jonik.

Shtrati mbahet prej dy këmbalesh të skalitura si orenditë e gdhendura në dru. Mbi bandën anësore është vendosur një brez e mbi të shtrati i përbërë nga shtatë shtresa. E sipërmja hidhet mbi këmbalin e parë dhe zbret poshtë. Pas saj vjen nënkrejsi (cuscini) i parë që mbulohet me një të linjtë. Sipër kësaj vendoset nënkrejsi i dytë mbi të cilin shtrihet mbulesa me tri pala rrëshqitëse (fig.22). (Në këtë rast nënkrejsi është jastëku e jo ikinumi që ndodhet ndën kapitalet).Nga ana tjetër ndodhet vetëm një nënkrejs.Të tri shtretërit kanë tipare taurobolike dhe ngjajnë me shtratin



Fig. 22. Shtrati jonik i Varrit të Selcës

teoksenik të Dioskurëve (Theokseni-Sofër e Shenjtë) si na e paraqet studjuesi Albert. Një shtrat të tillë e gjejmë tek varri i Filipit të II-të Maqedonas, me një ndryshim se në vend të pëlhurave të palosura të shtratit shihet një kompozim me 19 figura në qëndrim parade (fig.23). Shtretër (Bisellium), me motive të ngjashme ndeshen mbi sarkofagët e Pidnas (Pydna), të shoqëruar me luanë dhe këmbale me spira jonike (fig.24) në Maqedoni. Përkundrazi në Etruria sarkofagët paraqesin bashkëshortët e vdekur të mbështjellë me mbulesë mëndafshi, nënkrejsa, shtresa të palosura, këmbale të dekoruara me figura taurobolike, njëlloj si tek



Fig. 23. Varri i Filipit të II-të maqedon.



Fig. 24. Shtrati i Sarkofagut të Pydnas.



Fig. 25. Sakrofagu i çiftit etrusk.

shtrati i Selcës dhe varri i Filipit II (fig.25) Për këtë sarkofagë na flasin disa studjues. Andronikos përshkruan varrin e Filipit II (13). Kaen (cahen)

paraqet varrin etrusk të quajtur "Tomba lydia" (14). Kurse Hëzej (Heuzey) na flet për varrin e Pydnas me simbolin e luanit (15). Këtë repertor e plotëson varreza e Selcës.

Për të arritur një farë përfundimi mbi këtë çështje jemi këshilluar me historinë e artit të arkitekturës antike dhe elementët e dekoracionit jonik (16).

Mbi reliefin e shtratit vëmë re dy elementë të rëndësishëm, lidhur me totemet e ilirëve të lashtë: Demin e vizatuar me bisqe në trajtë ideografikë, skeumorfikë dhe gjarpërin të paraqitur vetëm nga shiriti i luspëzuar, që të dy simbole të nënës tokë. Në krye të këmbalit bisqet sajojnë sytë e brirët e demit, ndën to shihet goja këndrejtë, e cila duket sikur mban pseudo kapitalin me sy e brirë që na kujton bipenin. Në mes të ballit të demit është modeluar lulekëmbana me tri sepale si tek mozaiku i Bukuroshes së Durrësit, i cili ndodhet në Muzeun historik, në vend të lules gjashtëpetlash, që modelohet zakonisht (fig.26). Në mes të këmbalit skalitet një palmetë me dyfish ankora në kahe të kundërta dhe dy kokrra anash si sy. Palmeta njihej në artin e Mesopotamisë, ajo u përvetësua nga grekët, ilirët e thrakasit dhe sejcili popull e kompozoi sipas pikëpamjeve të veta. Po këto motive shihen dhe në varrin e Filipit të II-të, të zbuluar në Virgina. Këmbali përfundon mbi një vazo tip krateri. Po ajo që ne na ka preokupuar aq shumë është pikërisht motivi i gjarpërit totemik dhe simbol bashkëngjitës (adiacent) i Demetrës pallazgjike. Shpesh në vend të gjarpërit ne kemi hasur në gjurmët e tij. Për shembull lidhur me motivin e luspave, ne kemi biseduar gjërësisht me popullsinë e krahinave të ndryshme. Ata na kanë thënë se thonjëzat, gishtëzat dhe luspat janë trupi i gjarpërit, siç e kemi theksuar në fillim, gjatë analizës së motiveve. Kështu, brezi i sipërm i pllakës së varrit të Selcës është dekoruar me tri radhë luspash, si kurrizi i gjarpërit që nuk shtrihen deri në fund të brezit. Të njejtat luspa ne i hasëm tek gjarpërimet e frizit të ikonabartësit të shekullit XVII, në kishën e Shën Mëhillit të Shalësit të Kolonjës. Tek



Fig. 26. Fragment dekorativ nga varri Jonik i Selcës.



Fig. 27. Brezi i atikës në ikonabartësin e kishës së Shën Mëhillit në Shalës të Kolonjës.

DO NOT COPY

"Kultura Popullore" është botuar një material i tillë (fig.27). Shiritat gjarpërues krahas këmbehen me lule tetëpetlash. Ne, problemin e këtij ikonabartësi e kemi diskutuar dhe me etnografët (17).

Kureshtje të posaçme na përfton rafti i shek. XVIII, tek një banesë shkodrane, i përshkuar prej brezit me luspa tri radhëshe. Flegrat e ndara në tri pjesë, paraqesin tri dyfish palmeta. Dy anësoret e sejcilit flegër, me lulen taurobolike në mes na kujtojnë ballin e demave për therror, kurse ato të mezit përsërisin motivet e këmbalit jonik të Selcës me dyfishspira, që përfshijnë palmetat (fig.28). Këto motive kanë arritur në zbukurimoren shkodrane e korçare gjatë dy shekujve të parafundit, pas një vazhdimsije nga dita në ditë pas 2000 vjetësh, sipas supozimit të disa individëve keqnjohës të faktit se motivet janë trashëguar jo vetëm në ndërtimet, por dhe në kostume, qëndisje, enë bakri, qylyma, dantella. Ekzistenca e tyre pa ndërprerje dallohet në djepat e Matit, arkat e Shkodrës e të Dibrës, ku brezat e luspëzuar ose thonjëzat zhvillohen krahas hënës, diellit e Selvisë. Kemi parasysh një djep matjan, ku radhiten dy-tre deri katër radhë thonjëzash rreth 4 figurave rrethore të shoqëruara me nga 5 pikëza (fig.29). Për të identifikuar luspat e vargëzuara që përfshijnë shekuj me radhë



Fig. 28. Raft i shekullit XVIII i gjetur në qytetin e Shkodrës



Fig. 29. Djepi i daltuar nga Mati.

zbukurimoren shqiptare të brendive, u bazuam tek brezi i artë i Thesarit të Selcës, studimi i të cilit, si pjesë e veshjes së luftëtarit të varrosur ndihmoi për identifikimin e varrit të tij.

Dragoi mbrojtës i ushtarëve, i egërsuar, me trupin e mbështjellë 2 herë kular, qëndron në gjendje sulmi. Në mes të kularëve shihen kunjat e hekurta të dy boshteve që eventualisht duhet të kishin qenë dy rrota të cilat, gjarpëri i rrotullon duke ecur (fig.30). Autorët Ceka e Stipçeviç, duke e krahasuar këtë brez me paftat e Costiljes e Momshiqit, supozojnë se dragoi është Kadmi dhe një grua që i rrin pranë është Harmonia, (18). Një grua që mund t'i rrijë afër gjarpërit kolos është vetëm Demetra. Me gjithë respektin që kan për autorët e më sipërm, disa çështje të simbolikës i shpëtojnë arkeologjisë. Ikonografia e Kadmit dhe Harmonies duhet kërkuar në tjetër aspekt. Gjarpëri dragua i Selcës lidhet në kompleks me motivet taurobolike. Para se të analizojmë brezin e Selcës, theksojmë se Leon Hëzej (Leon Heuzey)

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 30. Gjarpëri i Paftës së Artë e gjetur në varrin e Selcës.



Fig. 31. Varri i Kurinos në Maqedoni me figurën e gjarpërit dhe shtyllëzën jonike.

na paraqet varrin e Kurinos në Maqedoni (fig.31). Ku është skalitur një gjarpër i mbështjellë njëherë brenda kularit nuk disponon boshtin e rrotës si tek i Selcës. Pranë gjarpërit shihet këmbali me kryedemin, e dyfishpalmetën, (19).

Si do ta argumentonim identitetin e gjarpërit të brezit të artë të Selcës : Tek një krater i gjetur në varrin e Filipit II, gjarpëri me tri radhë luspash mbi vegjët anësore (fig.32) rrethon kryet e Asklepit (Eskulapi) dhe pranë tij shihet koka kanonëse e gjarpërit taurobolik (20).

Në një ekzemplar tjetër, duke studjuar legjendën e frizit Eleusinian, mbi grabitjen e Prozerpinës, shohim dy gjarpërinj që lëvizin me bisht rrotat e karrocës së Demetrës (fig.33). Mbi boshtin e rrotës së djathtë, dallohet koka e Asklepit, në vend të kunjave, që është variant I Apollonit mjek dhe i bashkëngjitet panteonit të Demetrës me cilësinë e Perëndisë sherues dhe ndihmues të rikrijimit (21). Tek ilirët gjarpëri ka qenë motiv me rëndësi, menjëherë pas demit. Gjatë mesjetës paraqitet mbi afreskat dhe mbi ikonabartësit e daltuar, sidomos në periudhën postbizantine, e cila ka mbërritur e pa prishur. Krishtërimi e ka identifikuar më forcën e së keqes, të goditur prej Shën Gjergjit. Ndryshe nga kisha, populli e paraqet gjarpërin të shoqëruar me simbole pagane. E shohim mbi qemerin e një dere matiane, me bishtin e dredhur, pranë çerek hënës (Croissant), përsëri duke na kujtuar kultin e Demetrës dhe të rikrijimit, (fig. 34). Në Gollobordë e gjejmë me çerek hënë në gojë si dy brirë që na kujton gjarpërin Zagreus, nji motiv të Dionizit si prodhues i vreshtarisë.

Po i rikthehemi varrit të katërt që për madhësinë e tij pandehet të ketë qenë vend varrimi i Bardhyliut të Ri. Ky varr është trajtuar me shkallëzime anësore pa zbukurime mbi ballorin harkthyer, por ruan një karakteristikë të fuqishme, e cila plotëson kuadrin e përgjithshëm të tezës sonë.

Tek ky varr shihet tehu i një shpate të skalitur mbi faqen shkëmbore majtas hyrjes (fig.35). Veç

DO NOT COPY



Fig. 32. Kryet e Asklepit të rrethuar me gjarpër të luspëzuar me një krater të varrit të Filipit të II.



Fig. 33. Legjenda e grabitjes së Prozerpinës, ku karrocën e Demetras e tërheqin dy gjarpërinj



Fig. 34. Gjarpëri bishtdredhur dhe çerekhëna në një shtëpi matjane.



Fig. 35. Shpata e skalitur në faqen shkëmbore të varrit të katërt.

shpatës mban katër kamare të vendosura në të dy anët e saj. Tek altarët taurobolike shpata përfshihet brenda kamares. Në rastin tonë kemi një kordhë mbi mburojën me motive svastikoide dhe një shpatë të sajuar në sipërfaqe të lirë, duke dëshmuar, me fuqinë e saj luftarake, mbrojtjen e tokës nënë dhe armën taurobolik për hir të Demetrës. Simboli i shpatës dallohet gjatë

shekujve ndër ikonobartësit e Jugut, tek kulla e sahatit të Kavajës, mbi qemere portash në krujë e Shkodër e disa buzme varresh të Tërnovës, Reçit e Shkodrës si kordhë e lakuar ose si bajonetë, me karakter vetëmbrojtës. Këto shpata kanë qënë dhe shenja juridike, përfaqësuese të një esnafi të caktuar. Në muzeun e Shkodrës gjejmë stelën e mermertë të një varri të shek.XVII me një kordhë në krye të saj (fig.36). Pas shpatës, bri shkëmbit të plasaritur ndën një hark të kërcyer struket një



Fig. 36. Stele varri në mermer me simbolin e kordhës në muzeun e Shkodrës.

tjetër kamare edikola këndrejtë, me ballor klasik, harkthyer, si stelë helenistike, e kufizuar prej shtyllash të thjeshta, me krejsa korintikë. Ballori mban tri toptha si akroterë, ka mundësi të ketë qenë altar i dytë taurobolik ose mbishkrimor (fig.37). Kamarja e dytë, përmbi të në trajtë katrore zakonisht përdorej si lararium, ku vendoseshin reliket e stërgjyshërve (fig.38).

Mjeshtrit arbër këto kamare i kanë ndërtuar gjatë mesjetës në absidat e faltoreve dhe nëpër banesa. Pas pushtimit osman, sidomos gjatë shekujve XVIII-XIX i shohim pranë portave të Gjirokastrës, Beratit e Shkodrës me emërtimin "Mirsevjen" si mbrojtëse të vatrës familjare. Kemi parasysh kamaren mjaft interesante të Portës së Gjylajve në Shkodër (fig.39).



Fig. 37. Kamare edikola, me shtylla e krejsa korintikë.

Kamarja e tretë që vjen radhazi pas tyre qartëson problemin e rëndësishëm nga pikëpamja etnike të nënës së madhe e cila njisohet herë me Demetrën e tokës, herë me Dheztën e zjarrit (Hestia-Vesta) sipas De Radës (21). Në faqen e brendshme të saj thadrohet një hulli me bazë të gjërë, ku dikur qe vendosur një skulpturë gruaje në trajtë kryqi (fig.40). Kjo figurë ngjante me "nënën e Kamenikut" (23) të zbuluar nga arkeologu Frano Prendi (fig.41).

Për një nënë të ngjashme si malësore Franc Nopça (Eranz baron von Noptscha) (24) kurse për një figurinë gjetur në Gllasinac me simbole svastike mbi kostumin e malësores na flet

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 38. Pranë edikolas shihet një kamare, që ka shërbyer si lararium.



Fig. 39. Kamarja "Mirsevjen" pranë Portës së Gjylajve në Shkodër.



Fig. 40. Figura e nënës së madhe në trajtë hullije si kryq i gjerë.

Aleksandër Stipçeviç (25). Tradita e paraqitjes së nënës së madhe me svastika, ose shënjesa të tjera diellore, vazhdoi ndër mijëvjeçarë deri tek ne. Ajo gjendet në çdo vendbanim ilir të ballkanit, ruhet si kukull druri gjatë mesjetës. Tek malësorët e gjen diku të fshehur si kukulla e zbuluar në njerën nga kamaret e urës kryesore të lumit Osum. Mbi një stelë varri të shek. XIX në Tiranë, figura e nënës së madhe sajohet me tre sy, njeri i tipit çiklopik, në ball, e dy sy anash. Më tej një gjysmë diell mbi horizontin detar, dhe një varëse në trajtë çerek-hëne me 3 toptha. Poshtë tyre, së gjati në

DO NOT COPY



Fig. 41. Figura e nënës së madhe nga Kameniku.



Fig. 42. Stele varri e gjetur në varrezat e Tiranës.

anën e djathtë, vizatohet një motiv gjarpëror (fig.42). Figura të afërta me tri toptha në qafë janë gjetur në kroaci. Kjo hyjneshë u përjetësua në tymtarët e shekujve XVIII-XIX kudo në Shqipëri, ku dallohet si nëna e pellazgëve, ilirëve e shqiptarëve, e zbukuruar me drethka, bedena e bisqe të lulëzuar. Ballori i tymtarit i trilobuar (trivalëzues), veç bedenave e zbukurimeve , në të dy anët paraqet dy rozone si "okulus dei" (sy perëndije), të sajuar me dyfish helika, (fig.43). Ky tymtar është njeri nga 20 ekzemplarët e gjetur në qytetin e Shkodrës. Poshtë tamburit modelohet flaka e pashuar e cila pohon për një hypostasë (variant) të perëndeshës së zjarrit.

Në varrin e pestë kanë mbetur vetëm disa shenja afresku, ndërsa në varrin e gjashtë, diktohet një këmbal shtrati si putrër egërsire, të cilën e gjejmë dhe sot në këmbalet e arkave të nuseve të shekujve të fundit, ndërsa flegra e derës ngjan me dyert e shekujve XVII-XVIII të mbërthyera me 15 kunja kovaçi. Zbukurimorja e Selcës na hapi horizontin mbi prejardhjen e shumicës së motiveve të trashëguara nga lashtësia, duke përfshirë dhe kostumet kombëtare, nga Kosova deri në Janinë, ku motivi i demit taurobolik qëndiset mbi kostumet e

DO NOT COPY



Fig. 43. Tymtar shkodran që paraqet perëndinë e vatrës me dy sy spiralë rrethues.

luftëtarëve e xhamadanët "për dekë" (veshje që përdorin luftëtarët të cilët shkojnë me dëshirë drejt vdekjes, për mbrojtjen e atdheut).

Mund të themi se mbarë zbukurimorja e arkitekturës shqiptare përshkohet prej frymës së jonikut ilirik, me tipare lokale të ripërtëritura dhe të përshtatura stileve të kohës: barok, rrokoko, direktorat, perandorak, të inkluduara në botën pas bizantine dhe osmanide. Ky fakt na bën të besojmë se zbatuesit e këtij arti, në arkitekturën e periudhës antike në trevën e Ballkanit; e ndofta dhe të Turqisë, qenë kryesisht mjeshtër maqedonë e ilirianë, prej të cilëve mësuan brez pas brezi, mjeshtrit arbër e shqiptarë. Pasi vizituam Turqinë në qershor të vitit 1996, kuptuam nga afër punën e madhe të mjeshtërve ballkanas të cilët turqit i quanin rumë, ose banorë të Rumelisë (Tokë e perandorisë romake). Në të njëjtën kohë u njohëm me kulturat frigase, hitite, dardane, trojane, bizantine, selçukide e osmanide, sidomos kryeqendrën e mbretërisë Selçuke Konjën (Iconium) dhe Sofranbollin (Zaferanopoli) qytetin e shek.XVIII. Vizituam pallatin Top Kapë, simbolin e kulturës osmanide. Në këtë mënyrë mundëm të dallonim çfarë na takonte ne, çfarë kemi huajtur nga osmanët dhe çfarë kanë marrë ata nga Bizanci, sipas njohurive që kemi përvetësuar prej arkitektit Orlandos, disa vite më parë. Kemi qënë pra një urë kalimi në mes të Perëndimit e Lindjes, duke çuar shpirtin tonë aty e duke marrë nga shpirti i tyre, sidomos prej hititëve e Selçukëve.

Lidhja me maqedonasit dhe epirotasit kryhej në mënyrë të organizuar, si në ditët tona, sepse kuptohet që të treja popullsitë flisnin të njejtën gjuhë, visheshin njëlloj dhe qethnin flokët në të njejtën mënyrë, kishin të njejtat doke e zakone sipas Strabonit (26). Kështu ndodh dhe sot me banorët e krahinës së vardarit. Gjetja e helmetës së Filipit II në Virgina në vitin 1977 na ka ndihmuar për të njohur se shqiponja ka qenë simbol i madh për maqedonët, të cilët e kanë vendosur atë në ballin e helmetës, siç e shohim dhe në helmetën e Selcës. Për besimin tonë ndaj flijimeve taurobolike (therja e demit) e kriobolike (therja e dashit) në qytetin e Selcës (Pelionit) na bind çitati i Kurt Rufit "Kur maqedonët vajtën në Pelion, panë një gjë të tmerrshme në këtë vend: "Tre djem të rinj dhe tri çupa të reja, të shtrirë të vdekur në tokë bashkë me tre desh të zinj, gjaku e trupat e të cilëve ishin përzier. Barbarët u kishin bërë fli perëndive të tyre, sipas një besimi të shenjtë, për t'u dhënë guxim njerëzve të tyre që do të luftonin (27). E përsërisim se ngjashmëria e Helmetës se Filipit të II-të të Maqedonasve, babait

DO NOT COPY

të Aleksandrit të madh, me helmetën e Selcës tregon qartë se kur Maqedonët sulmuan Pelionin, me në krye Aleksandrin panë atë flije të llahtarshme, që lidhej me kultet e njëjta të maqedonëve dhe Ilirëve. Këto nuk ishin të panjohura për Maqedonët, ishin të çuditshme për Kurt Rufin. Duke gjykuar fjalët e latinit Kurt Rufi ne po i përgjigjemi relatorit romak pas 2000 vjetësh, me qëllim që të kuptojnë të gjithë ata studiues, që i pasojnë këto njoftime pa u thelluar, gjithmonë duke pasur parasysh identifikimin e Selcës së Poshtme me pelionin antik, se : "Vrasja e tre deshërve të zinjë është rit kriobolik për perënditë nëntokësore (Ktonike) ku hyn dhe Prozerpina ose Kora, e bija e Demetrës, si dhe kulti i bipenit (28). Ndërsa për vrasjen e tre të rinjve e tri të rejave kjo hyn në ritet e vetësakrifikimit, për të cilin fakt populli ynë ka dhënë shumë shembuj. Po përmendim me radhë : gratë e Istërve dy mijë vjet më parë u hodhën nga ledhet e kështjellës mbi kryet e romakëve, 90 vajzat e krujës, 500 vjet më parë u përmbysën, sipas një riti diellor, tek Shkëmbi i Vajës; në çastin kur lindi dielli, mes dy majave të Malit të Kavanjesë, në ora 6 të mengjesit pasi gjithë natën ishin lutur tek Tempulli i Diellit. Në këtë vend në mesjetë do të ndertohet një kishë e Shën Spiridhonit, e cila në shek.XVII do të bëhet teqe bektashi e Sarisalldikut. Këto vajza u vetëvranë për të shpëtuar Atdheun e jo për të mos rënë në dorë të armikut. Po të ishte kështu, sejcila prej tyre do të vritej në shtëpin e vetë. Gratë e Sulit u hodhën në greminë sipas të njejtit rit, 200 vjet më parë. Trimi Mic Sokoli mbuloi topin me gjoks, Selam Musai nga Salaria zuri topin nga gryka, Isa Boletini u hodh para serbëve i veshur me xhamadanin taurobolik dhe sot po atë kuptim ka therrorizimi i bijve të Drenicës dhe Deçanit, të cilët mbrojnë tokat e tyre pa lëvizur nga llogoret.

Gjatë ekspeditave kemi pyetur popullsinë e Dibrës, Oparit e Kolonjës lidhur me flijimin e demave e të deshërve. Ata na treguan se flijimet e kafshëve që në lashtësi nuk bëheshin me dhunë. Po të ikte kafsha ajo nuk therrej, kurse njeriu vetësakrifikohej për perënditë duke u lutur për shpëtimin e vendit prej pushtuesve. Nuk kishte arsye që romakëve t'u vinte keq për të flijuarit, në një kohë kur konsulli Paulus Emili dogji 70 qytete ne Epir (Shqipëri).

Kjo ide e keqe sipërfaqësore për një popull nga më të lashtit e Evropës, vazhdoi për shekuj, se arrivistët që u kanë rrëmbyer me dhunë popujve të vjetër çdo gjë dhe i paraqesin si të tyret, nuk durojne dot ringjalljen e këtyre popujve.

Një problem tjetër është qartësimi i opinionit mbi sopatën dyprerëse të quajtur bipeni. Sopata e tillë, simbol i Zeusit dhe rrufesë, shihet në dorën e personazheve të ciklit bakik (Bacus-zoti i rrushit e i verës). Ka qenë arma e tmerrshme e therrorit, që shërbente me vra kafshët e përkushtuara ndaj perëndive që zëvendësuan vrasjen e njerëzve të "Agrionive" primitive. Zoti Hefesti (Vullakni) me këtë armë çau kokën e Zeusit nga ku doli Pallas Atena (Minerva) si përmendëm në përshkrimin e krejsave të Selcës.

Selca ose Selica, që sërbisht don të thotë fshat i vogël, gjatë pushtimit serb në shekujt XI-XII, ka mbuluar emrin legjendar të këtij qyteti ilir Pelion, që don të thotë pellazg, ashtu si fshati Starje i Kolonjës mbulon emrin përcaktues të lashtësisë së tij Plakovë. Jemi të mendimit që me pak vullnet të ndryshojmë të gjitha toponimet sllave të vendit tonë. Me kalimin e kohës njerëzit do të mësohen me këto ndryshime dhe nuk do të habiten.

I u përkushtuam këtij studimi për t'ia bërë të qartë studjuesve shqiptarë dhe të huaj, si dhe për të bindur popullin shqiptar se dy copa guri që gjejmë diku në territorin e Ilirisë, të trashëguara nga lashtësia hedhin aq shumë dritë mbi kulturën tonë, sa mund të zhdukin pretendimet e gabuara mbi ekzistencën e këtij populli. Për këtë arsye monumentet dhe vlerat e tjera materiale duhet të ruhen me fanatizëm dhe të kërkohen e të gjinden kudo që ato janë fshehur ose dërguar. Për këtë çështje duhet të mbajë përgjegjësi morale e

faktike secili prej drejtuesve dhe hulumtuesve të kulturës materiale shqiptare.

Arsyeja e dytë e rëndësisë së artikullit është njohja nga ana e krijuesve skulptorë, të rinj, të Shqiperisë e këtij monumenti i cili është kompozuar në mënyrë të shkëlqyer, duke harmonizuar, arkitekturën me skalitjet në gur të simboleve të ndryshme dhe dekoracionin e ushtruar mbi shtretërit e tipit Biselium. Zbukurimorja e gurtë zbatohet shumë pak nga skulptorët tanë, të cilët preferojnë skulpturën rrumbullake. Njohja me elementët dekorativë të varreve të Selcës do të ketë vlerën e vet për t'i ndihmuar artistët në krijimet e tyre, duke vënë në jetë harmoninë e motiveve përkatëse.

DO NOT COPY

1. Neritan Ceka "Qyteti ilir pranë Selcës së Poshtme" Tiranë 1985.

a. Pozita gjeografike e qytetit faqe 5-12.

b. Arkitekti Meko, faqet 7,44,56, 107 dhe guri i skalitur me emrin e tij faqe 270, Tabela LXV.

c. Louis Robert për fjalën Mekos si njësi matëse faqe 103.

2. Fatbardha Shkupi - "Mjeshtër shqiptarë drugdhëndës të ikonabartësve ballkanas" – në gazetën "Drita" të 6 Tetor 1996; faqe 6-7 marrë nga sesioni shkencor i Korçës 8-10 shtator 1996, në bazë të sesionit shkencor ku mbajta Kumtesën në Pllovdid më 1994.

3. Louis Reau-Emprunts au paganisme gréco-romain (ndërtesa, festa, motive) në "Iconographie de l'art chrétien" Vol I Paris 1955, faqe 49-54.

4. Giuglio Farina –

a. Godfrid de Jarphanion "Frigia" – Varri i Midas Lavalta, në Treccani, Vol XVI, faqe 83.

b. Orhan Bayrak – Varri i Midas në Eskishehir, në "Panorama der Turkey", faqe 122.

c. "Egitto Faraonico" - Varret shkëmbore të luginës së mbretërve të Thebes në Egjypt, tek Enciklopedia Treccani - Vol. VIII, faqe 553-571.

d. Leon Heuzey - Varret shkëmbore të Pydnas, në Maqedoni në "Mission archéologique de Macédonine" Paris 1876, tabela XVIII.

5. Fédéric Lenormant – Eduard Pottier – "Eleusinia" – frizi i altarit të Demetrës në Eleusis, në "Dictionnaire des Antiquités grécques et romaines". Vol II-faqe 561, figura 2633.

6. Spiro Konda – Pelioni ose Piluri don të thotë pyll, dhe ka lidhje me fjalën pellazg; shqiptarët dhe problemi pellazgjik – Tiranë 1964 – f.353-354.

7. Edmond Saglió- Bisellium honorifique, shtrat etrusk në Dictionnaire... Vol I-faqe 712, figura 863.

8. Giovanni Patroni - Kapiteli Ionik në Treccani, Vol VIII, faqe 856-857.

9. Heinrich Schlieman - Kapse taurobolike me lulen 12 petlash në ball, në Ilios, Stad und land der Troianer" Leipzieg 1881, faqe 616, fig.839.

10. a. Leon Heuzey – ne Mision archeologique III-II p.e.s. Altar i Demetrës e Korës në Durrës

b. Fatbardha Shkupi. Një hipotezë për Durrësin, Epidom në Shkenca e Jeta Nr. 1 1986, f.41, 42 43, 66.

c. Vedat Idil – Demi në një banesë hitite, i botuar në "Sites antiques et musées" Ankara 1993, f.32.

11.a. Emanuel Esperandieu Taurobolie – ku shihen altaret taurobolike të Périgueux, në jug të Francës, në Dictionnairo Vol. II, faqe 49, figura 6749.

b. Llazar Papajani – Disa monumente te arkitekturës në qytetin antik në Klos ku shihen altarët e Nikajës pranë Klosit, në Monumentet" n.11 1976, faqe 23-33.

12.a. Jörg Lechler Svastika, në "Geschichte eines symbols" "geschichte das Svastika" Leipzieg 1921 – Tabela I e II, faqe 37.

b. Skënder Anamali – Svastika e paraqitur në mozaikët e Linit tek "Mozaikët e Bazalikës paleokristjane të Linit, Pogradec – në Iliria III, Tiranë 1974, faqe 329-342.

13. Manolis Andronikos – varri i Filipit II, i gërmuar më 1977 në Virgina, në "Royal Tombs" Athens 1984, faqe 101 dhe Biselliumi faqe 122.

14. Emile Cahen – Sarcophagus, ku shihet sarkofagu etrusk, i quajtur Tomba Lydia në Dictionnaire – Vol 10, faqe 1070, figura 6108.

DO NOT COPY

15. Leon Heuzey – idem – Sarkofagu i Pydnas me luan, Tabela XX.

16. Germain Bazin – Arti Jonik tek "Les civilisations classiques de la méditérranée" në "Histoire de l'art" – Paris 1953, faqe 64-67.

17. Fatbardha Shkupi- Motivi i sofistikuar i gjarpërit tek "Dëshmi të zbukurimores në monumente kulti të rrethit të Kolonjës" në "Kultura Popullore" Nr.2, 1985, faqe 98-99.

18. Neritan Ceka – idem për dragonjtë Kadmi e Harmonia, faqe 120-121.

19. Leon Heuzey – ibiden – Varri i Kurinos me gjarpër, Tabela XXI.

20. a. Manolis Andronikos dhe grupi i autorëve – Vazo Krater me motivin e gjarpërit i cili mbështillet rreth kokës së Asklepit që shërben si vegjë, në "Filippos Vasileus Makedonon" Athina 1982, faqe 158-159; brezi i artë i ngjashëm me atë të Selcës, faqe 219.

b. Emile Cahen - Proserpina – Ku shihen disa figura domethënëse. Gjatë grabitjes së saj, dy gjarpërinj tërheqin karrocën e Demetrës, dhe boshti i rrotave në vend të kunjave, paraqet portretin e Asklepit. Kjo në Dictionnaire Vol.IX, faqe 700, figura 5824.

21. Jeronin De Rada – Dhezta ose Vesta, Ifestos, në "Antichità della nazione albanese e sua affinità con gli elleni e i latini" Napoli 1864, faqe 4-10.

22. Manolis Andronikos – Ku paraqitet helmeta e Filipit II, të cilën e krahasojmë me atë të varrit të Selcës, tek Nekrokamarja "edicola" në Filippos Vasileus Makedonom – idem – faqe 227.

23. Frano Prendi – Skënder Aliu – Figura e nënës së madhe të Kamenikut tek "La station néolithique a Kamenik de Kologne" në Iliria I-1971, Tabela IX, figura I.

24. Franz baron von Noptscha – Nëna e Klishevacit tek "Albanien Bauten, trachten, und geröte Nordalbaniens" Berlin, Leipzieg 1925, faqe 217, fig.130.

25. Aleksandër Stipçeviç – Nëna e madhe e periudhës para erës sonë; Kukasti kriz kod starih ilira, në 1000 vjet para kësaj ere, tek "Gjurmime albanologjike" Prishtinë 1971, faqe 112, foto 1.

26. Straboni – Në një pasazh flitet për dukuri të njëjta në mes të Epirotëve e Maqedonëve, si gjuha, veshja e zakonet, por duke përshkruar ze në gojë dhe fise ilire, tek libri VII, pasazh 7, "Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë" Vol. I – Tiranë 1965, faqe 160.

27. Curt Rufi – Kur maqedonët vajtën në Pelion panë një gjë të tmerrshme në këtë vend... Suplement i Librit I, pasazh 12, në Ilirët dhe Iliria idem, faqe 186.

28. Edmond Saglió – Ku flitet për simbolin e Taurobolis – tek Bipenne, në Dictionnaire Vol. I – Paris 1877, faqe 712.

DO NOT COPY

THE STONE CARVING DECORATION OF THE ROCK TOMBS AT LOWER SELCA

The subject of this article are the rock tombs in the Lower Selca area; an area that was inhabited by the Dasarets. These rock tombs were first discovered by the archeologist Hasan Ceka in 1948. His work was continued by his son Neritan Ceka during the period from 1955 until 1965. This discovery was seen through the socio-economic conditions that prevailed during the phases 7th-5th, 5th - 4thand4th – 1st century BC For a more comprehensive study of this subject, one should analyze the monolithic tombs of Fregia, Macedonia, France and Etrurya. However, for this study to be more accurate, we had to take into consideration some other archeological centers such as Dürresi, Apollonia, Butrinti, Bylis, and other medieval cities such as Berati, Voskopoja, Shkodra, Dibra, Skopje, Tetova and also some cities in Bulgaria and Turkey.

We studied a large amount of literature on Mediterranean culture and became familiar with the respective technical literature. We became acquainted with the opinions of many specialized authors such as Edmond Saglio, Emile Cohen, Frederic Lenormant, Louis Reau, Giovani Patroni, Leon Heuzey, Spiro Konda, Aleksander Stipcevic, Frano Prendi, Skender Anamali, Mark Krasniqi, Zija Shkodra, and we consulted many of our colleagues. During our research, the name "Meko" was pointed out, which, according to the archeologist Neritan Ceka, was a human name and not a measurement unit as it was assumed by Louis Robert. Neritan Ceka also illustrated the roads connecting Epiri and Macedonia, and he pointed out the Shkumbini River as being the main connection.

We could understand from Master Meko that the Illyrians had cooperated with the Macedonian builders and, looking at the rock tombs, we could notice the influence of the Macedonian Jonic decorative art without diminishing peculiar native features. Six tombs were found. A polytheist temple was found at the second tomb, whilst in the upper part of the third tomb, a cenotaph (a fake tomb), was found and the real tomb was underneath.

In that last tomb, a decorated, well preserved, sarcophagus was found, followed by some other sarcophagus with illegible decorations. The sarcophagus motifs are drawn in an ideograph way, according to the Jonic style which repeats ancient well known motifs such as the bucranion (bullhead), which can also be noticed at the "niche" on the right of the door. A typical Macedonian helmet is shown above this "niche," with an eagle on the top of it, which reminds one of the helmet of Philip the 2nd.

On the sarcophagus, one can notice some scale tracks of a snake body that represents a motif which was used until recently in both laic and religious buildings. Everywhere, the intluence of the Pelazgic Demetra Cult, including the golden belt found at the third tomb, can be seen.

Referring to Curt Rufit, when Alexander together with his Macedonian Army entered to Pelion saw there something tremendous. Three young boys and three young ladies were murdered together with three black rams, that the barbarians had sacrificed to their gods.

Bardhyl the Junior is buried at the fourthtomb. After the death of Alexander the Great, is supposed to have made peace with the Macedonians. He is supposed to have been influenced by the human, political and architectural Macedonian system. For as Straboni states, the Macedonians and Epyriots were using the same language, had the same way of dressing, and respected the same customs. However, the influence of the Macedonian builders cannot hide the participation of the Pelions, for the Mokrars are well known builders and the millstone is called "moker".

On the left of the third tomb door, is situated a shield with swastika motifs with a sword above it (a short, arched sword). The Swastika is found at the Lini mosaics of the 6" century and is used during the Middle Ages and is widely applied on the doors, ceilings, and family objects all over Albania of the 18th-19th century. The mosaics should also have been situated in the square before one reaches the Selca tombs.

On both sides of the 4th tomb can be seen two "niches" which might have had taurobolic features, or may have been used as a "lararium". On the same rock face of the tomb is carved a second sword which completes the taurobolic repertoire of the Selca tombs. This cemetery is supposed to have been used as a many-god temple, for the sake of Demetra, Apolloni and Vesta. Curt Rufi, in his paragraph about the war of Alexander the Great against the Pelions, describes the rams' sacrifice

At the fith tomb there are signs of fresco works. A stone bed that stands on a paw, is found at the sixth tomb. These paws were used as chest trestles until the19th century. At the same tomb is also found the door leaf divided into two parts with three separating belts where there are carvings of 15 nails, like the smiths' pegs, 6 of them are above, 3 in the middle, and the other 6 are below.

When analyzing the third tomb sarcophagus, we found astonishing similarities between the sarcophagus of Philip the 2nd discovered in Virgina, and the beds of Pydna and Curino. On the first bed a lion is carved. On the second, a snake is carved, similar to the dragon on the Selca belt and to that of the Proserpina kidnapping scene. In this scene at Philip the 2nd tomb in Virgina, the Esculapi head is used instead of the wheels axis.

The Selca sarcophagus is very similar to the Bisellium of the Etruscan couple called "Tomba Lydia", which dates back to the 8th-7th centuries BC This fact indicates that other sarcophagus, already destroyed, had existed in the Balkan territory. There can be found only their remains which have been restored according to the Jonic art of the 6th-1st centuries BC.

The taurobolic character of the Jonic "capitel" located on a pillar and situated next to the third tomb door, is evidenced by the two hunched angles of Pulvinum looking like bull's horns with the side-spirals representing his eyes. In the middle of his front is the taurobolic flower of six petals, which reminds us of the altar discovered in Durres by Leon Heuzey. The capitel itself, with its bending, creates the animal's face.

Next to the fourth tomb is dug a furrow, which is supposedly the foundation of the Big Mother sculpture, the copy of which we found in the Neolithic period of Kameniku and one thousand years, BC, in Nesakti. This motif has been, until recently, applied by us on the tombs and chimneys.

Taurobolya and cryobolya have represented family rites for Albanians who, in some cases, have converted them into human immolation. Albanian costumes, starting from Drenica and through Northern Albania, Elbasan, Myzeqe, Vlora, Gjirokastra, to Janina, are embroidered taurobolic motives such as the bullhead, the ktonik snake, the ram head, lilies and the Big Mother that represents Demetra. Albanians, according to a divine rite, did not hesitate to die if they were defending their homeland. These motives are widely spread throughout Albanian life and the Selca tombs are a symbol of talent and culture and also a good example for young artists.

DO NOT COPY

Flamur DOLI

DO NOT COPY

TIPARET ARKITEKTURORE FORMËSUESE NË KULLAT E ISA BOLETINIT

1.0. PARATHËNIE

1.1. Lëndë studimi për këtë punim do të jenë tiparet arkitekturore-formësuese në kullat e Isa Boletinit në fshatin Boletin, rrethina e Mitrovicës. Ky studim rreket të hedhë dritë rishtas mbi tiparet arkitekturore të kullave në fjalë dhe mbështetet në dokumentacionin - rilevimet arkitektonike dhe fotografitë nga terreni, të bëra nga vetë autori, në gusht të vitit 1996. Këtu do të shqyrtohet edhe kulla e parë, tashmë e rrënuar. Tiparet strukturoro-konstruktive dhe arkitekturore të kësaj rrënoje si dhe vendodhja e saj në një kodër me pozitë dominante që mbizotëron mbi krejt mjedisin e hapët përreth dëshmojnë se kjo kullë nuk ishte veç kullë banimi e tipit të rrafshit të Dukagjinit, por, njëherësh, edhe kullë e veçuar dhe e fortifikuar me karakter të mirëfilltë mbrojtës.

2.0 Me rastin e vitit jubilar, 80-vjetorit të rënies së Isa Boletinit.

2.1. Ky studim i kushtohet figurës së madhe të historisë së re të kombit shqiptar, Isa Boletinit, atdhetarit të shquar, strategut popullor, organizatorit e udhëheqësit të lëvizjes për çlirim e bashkim kombëtar. Isa Boletini u lind më 1864-ën në fshatin Boletin të Mitrovicës, në një familje me tradita patriotike, ndërsa më 23 Janar të vitit 1916 u vra në pusi nga dorë malazeze.

3.0. Pozita gjeografike e fshatit Boletin

Fshati Boletin gjendet në Veri të rrethinës së Mitrovicës; ndërsa vetë Mitrovica është e vendosur në skajin më verior të Fushëgropës së Kosovës. Në anën lindore dhe veriore të Mitrovicës, nga ana e djathtë e Ibrit, ngrihen malet që i takojnë vargmalit të Kopaonikut. Malet e këtij vargmali përfshijnë thuajse krejt Shalën e Bajgorës, e cila i përket rajonit komunal të Mitrovicës. Në përbërje territoriale të Shalës së Bajgorës, përveç fshatrave të tjera, gjendet edhe fshati i Boletinit, në një lartësi prej rreth 1100 metrash mbi nivelin e detit.

3.1. Peisazhi - Relievi i kësaj treve karakterizohet nga një përthyerje dinamike, ngase lumenjtë malorë tok me përrenjtë, me energjitë e tyre gërryese kanë formuar lugina relativisht të thella, të cilat i ndajnë malet e Shalës në forma të veçuara malore e kodrinore. Luginat e formuara kësisoj mundësojnë lidhjet natyrore të Shalës me Kosovën e të Llapit me Topllicën (1). Të tilla tiparet relievore të truallit të Shalës së Bajgorës kanë qenë ndofta arsyeja që kjo trevë të banohej që në lashtësi. Nga gjetjet arkeologjike në rrethin e Mitrovicës mësojmë se kjo trevë ka qenë banuar nga bashkësi të organizuara njerëzore shtatë mijë vjetë më parë. Ndër ta, banorët e parë që mund të përfillen si një grup

PO KOPJE

etnik i kanë takuar fisit ilir dardan. Dardanët, pas luftimesh të gjata, nga fillimi i erës sonë, ranë nën sundimin e Perandorisë Romake (2), e cila dihet që asokohe shfrytëzonte xeherorin e Trepçes. Në trevën e Shalës, përveç Trepçes së lashtë, përmenden edhe gërmadhat e një qyteze që gjendej diku në mes të fshatit Rudar dhe Boletin (3), si dhe gërmadhat majë një shkëmbi, për të cilat thuhet se i përkisnin një kështjelle nga koha e Romakëve (4). Në këtë kontekst, edhe emrat ortoilirë provojnë mirëfilli se treva e Shalës banohej që në lashtësi nga Ilirët. Në kumtesën e Karl Treimerit (Austri) "Ilirët, qenësia dhe rëndësia e tyre", në të cilën nxirren në pah mjaft përkime mes hartës së Galisë së vjetër dhe emrave të Ilirisë, jepet edhe një fjalorth ku, mes emrash të tjerë, shquhet edhe emri "Naltinë Bolentinium Mayer 192". i cili ruhet edhe sot, natyrisht në trajtën Boletin.

3.2. Trojet me tipare topografike të sipërthëna, me një përthyerje dinamike të relievit, siç ishte treva e Shalës, u banuan që në kohët më të hershme të shoqërisë njerëzore, sepse ato ofronin një mbrojtje natyrore të ngulimeve banuese. Edhe Ilirët që nga prehistoria e thellë e këtej, në periudhën e lindjes dhe zhvillimit të qyteteve të tyre, ushtruan artin e zgjedhjes së terrenit dhe të fortifikimit të vendbanimeve. Thënë ndryshe, të parët tanë vendosin vendbanimet e tyre në lokalitetet që shquheshin për një mbrojtje – fortifikim natyror, të papushtueshëm nga mësyesi si dhe në pozitat më të rëndësishme strategjike, nga ku të mbizotëronin krejt trojet përreth. E gjithë kjo u përcoll edhe te shqipëtarët, të cilët gjatë gjithë historisë së tyre luftuan kundër pushtuesve të shumtë. Në këtë kontekst, edhe të parët e familjes patriotike të Isa Boletinit, të shtrënguar prej rrethanave të krijuara nga armiqtë e zaptuesit e trevave etnike shqiptare, u vendosën në Boletin të Shalës, fshat ky që me gjasë është rrënuar disa herë nga hunët, avarët, sllavët dhe më vonë turqit (5). Po kështu edhe kulla në të cilën u lind Isa Boletini, sikundër vetë fshati i Boletinit, pas ardhjes së turqve u rrënua e u ringrit disa herë (6) . Lidhur me këtë, bashkëkohësja e Isa Boletinit, mikeshë e vërtetë e popullit shqiptar, Miss Edith Durham, duke njohur mirëfilli historinë e lashtë të popullit tonë, shkruan:

"Sigurisht se asnjë racë nuk ka luftuar për liri në të gjitha epokat sa ajo shqiptare. Lufta e Shqipërisë është luftë e gjatë kundër pushtuesve të njëpasnjëshëm... Asnjë racë e huaj nuk ka arritur të asilimilojë apo të shkatërrojë gjuhën dhe zakonet kombëtare të shqiptarëve"

4.0 Pozita strategjike e kullave të familjes Boletini

Siç u theksua më sipër, nën 3.1. dhe 3.2. vetë fshati Boletin është ndërtuar fort lart mbi nivelin e detit. Areali i gjerë i tij karakterizohet nga një reliev të përthyer e dinamik, me lugina të thella, të cilat i ofrojnë këtij fshati një mbrojtje natyrore. Për këtë disa studiues tërësinë topografike të fshatit Boletin me të drejtë e quajnë kala natyrore. Në pllajën e kodrës më të lartë të fshatit Boletin u ngrit kompleksi i kullave të familjes Boletini (fig.1). Në përbërje të këtij kompleksi, me një pozitë të mirë strategjike, ngrihej kulla, tani ruinë (fig.1... "A", dhe fig.7 - në plan të parë duken blloqet e gurëve të mureve fortifikuese të kullës së rrënuar). Kjo kullë banimi, e fortifikuar, zinte pikën më të lartë të kodrës, duke patur kështu një pozicion sundues mbi gjithë arealin e gjerë të fshatit. Të njejtat veçori e karakterizojnë edhe kullën ekzistuese të ndërtuar më vonë (shih fig 1. "B"). Kompleksi i kullave dhe stallave, nga ana jugore e kodrës më pak të mbrojtur, vjen e rrethohet me mur guri mbrojtës; ndërsa nga ana veriore nuk është i fortifikuar, ngase ajo anë bie thikë mbi terren. Muri mbrojtës, ndërtuar me gurë, zë fill që nga muri i kullës së rrënuar bri portës kryesore dhe më tej shtrihet nga ana jugore me një përthyerje të diktuar nga veçoritë që ka relievi i majës së kodrës .

DO NOT COPY

4.1 TONTA – muri rrethues i pajisur me *frëngji rrethore* .

Struktura konstruktive formësuese e murit të përthyer rrethues, ndërtuar me gurë të latuar, përbëhet nga *frëngjitë* e gdhendura në blloqe më të mëdha gurësh, në formë të një *hinke të cunguar*, me anën më të gjerë për nga oborri. Frëngjitë e murit rrethues janë vendosur në mënyrë të tillë që të mundësojnë një fushëpamje sa më të gjerë dhe në tërësinë e sistemit të shtrirjes së tyre lejonin mbrojtjen edhe nga ana e shpatijeve që lartësojnë sheshin e kompleksit të kullave. Natyrisht këto *frëngji* (fig.13) janë vendosur në një lartësi të përdorshme për luftim me armë zjarri dhe, siç mësojmë, në çdo frëngji vendosej nga një sënduk me rërë. Do theksuar se, në përbërjen strukturore dhe formuese të murit rrethues, para portës kryesore të kullës ekzistuese, është ndërtuar nga *oxhaku i oborrit*, në të cilin piqej kafja për mysafirë gjatë stinëve të ngrohta. Përveç këtij oxhaku të oborrit, në brendësinë e kullës ekzistuese, janë ndërtuar edhe shtatë oxhaqe të tjerë, nga një për çdo dhomë (odë) dhe dy (votra) në shtëpinë e zjarrit (shih fig.3 "Vl", "V").

4.2 Në përbërje të sistemit mbrojtës të murit rrethues, përveç frëngjive, kemi portën e vogël, nga ku hynin familjarë e mysafirë, pastaj portën e madhe, nga ana e pasme e oborrit, për qerret tërheqëse, si dhe shkëmbin e lashtë, me përmasa të mëdha (fig1."G"). Ky shkëmb, si pjesë përbërëse e murit rrethues mbrojtës krijon bashkë me të një sistem të njësuar mbrojtës. Në këtë shkëmb, me ndihmën e elementeve të posaçme prej hekuri të ndërfutura në shkëmb qe mbërthyer në një lartësi të caktuar një platformë dërrasash, e cila përdorej për luftim në rast rreziku apo sulmi nga armiqtë. Ky mur mbrojtës me të gjitha ato tipare të përshkruara më sipër quhet tontë (8).

Natyrisht tonta s'do parë veçan nga kulla e rrënuar apo ajo ekzistuese, me mbi 17 frëngji. Theksojmë, pra, se kulla e rrënuar, me mure shumë të trasha fortifikuese dhe, doemos, me shumë frëngji, së bashku me tontën, paraqesin një sistem të njësuar mbrojtës.

Kulla e rrënuar, me muret e saj të trasha 1,oo m, e ndërtuar prej blloqesh guri, të gjitha deri në 2,oo m, me sa dimë, është një rast unik. Duke patur të tilla tipare muresh, veçohet nga të gjitha kullat e tjera shqiptare të këtij tipi. Në vazhdim do të bëjmë fjalë për :

5.0. Tiparet arkitekturore të kullave të familjes BOLETINI

Për pa u ndalur në tiparet arkitekturore formësuese e në strukturën kompozicionale-hapësinore të kullave të familjes BOLETINI, duke sprovuar kësisoj mendimin e shprehur që në parathënie (nën 1.0), lypset të shtrohen kalimthi disa përfundime të arritura pas një pune ngulmuese kërkimore të autorit:

5.0.1. Kulla si ngrehinë banimi, me tipare të caktuara kombëtare, siç dimë, u ndërtua kryekëput nga shqiptarët. Kulla shqiptare, pas një përvoje të lashtë ndërtimore, duke iu përshtatur në një mënyrë të përkryer nevojave dhe funksionit të shumënduarshëm, u kristalizua deri në atë masë, saqë u tipizua dhe, si e tillë u ndërtua pa pësuar ndryshime. Do të thotë që ndërtimet e kullës shqiptare të Rrafshit të Dukagjinit shquhen nga e njëjta frymë krijuese, si të formësuarit e brendshëm, ashtu edhe të jashtëm të saj. Në brendësinë e mbështjellësit prizmatik të kullës (qoftë të asaj më të hershmes, të ndërtuar prej guri dhe druri, apo të asaj më të vonshmes të ndërtuar vetëm prej guri), spikat një sistem apo strukturë funksionale sipas kateve, e cila me kohë është kristalizuar deri në atë masë saqë ka arritur një stad të standartizimit apo të tipizimit. Në këtë kontekst, njësitë apo elementet e tipizuara të gjuhës arkitekturore të kullës, të kompozuara në variacione gjithfarë, sajuan vërtet një arkitekturë të njësuar, por njëherësh të larmishme dhe piktoreske (9).

5.02. Krahas kësaj e në kontekst të krijimtarisë së përgjithshme arkitekturore popullore në mbarë Kosovën, do shtuar edhe fakti se mjeshtri popullor shqiptar pas një përvoje shekullore arriti një shkallë të lartë ndërtimesh. Në këtë mënyrë ai krijoi një rend apo sistem arkitekturor, gjithë duke zbatuar me përpikmëri rregullat e kanonet stilistike, të cilat përcaktuan si formën ashtu edhe përmasat e elementëve arkitekturore. Kjo nënkupton se edhe në Kosovë, përveç shkollave të tjera popullore shqiptare, ekzistoi dhe veproi dendur edhe shkolla kosovare e mjeshtrit popullor shqiptar (10). Duke u mbështetur tani në përkufizimet e lartpërmendura, e kemi më të lehtë të mbërrijmë në përfundimet se cilit tip apo stil të të ndërtuarit i përkasin kullat e familjes Boletini.

5.1. Tiparet arkitekturore formësuese të kullës së rrënuar

Është e natyrshme që së pari të bëjmë fjalë për kullën e rrënuar (shih planimetrinë e përdhesës së saj në fig.2), meqë është ndërtuar para kullës ekzistuese.

Kulla e rrënuar, me tiparet e e mureve të katit të parë (përdhesës) të ruajtura pjesërisht deri në një lartësi prej 2 (dy) metrash, veçohet nga të gjitha kullat shqiptare të tipit të Rrafshit të Dukagjinit. E veçanta e kësaj kulle janë muret e saj të trasha 1 (një) metër, gjë që nuk e kemi hasur tek ndonjë kullë tjetër. Sa për të mbështetur këtë mendim, do të themi se, madje as edhe muret e kullave katërkatëshe të tipit të Rrafshit të Dukagjinit, siç janë ato të Currajve dhe të Rrustemajve në Strellc, apo të Osdautajve në Isniq, nuk e kishin këtë trashësi muresh, po shkonte 70 apo 75 cm . Në këtë kontekst, veçanti tjetër e kullës së rrënuar të Boletinëve është se, muret e saja në tërësi janë ndërtuar prej gurëve të gdhendur, blloqeve të gjata rreth 2 (dy) metra, fakt të cilin po ashtu nuk e hasim gjetkë. Sipas gojëdhanave, për t'i ngritur mur këto blloqe të nxjerra nga shkëmbinjtë riolite, të cilat sipas llogarisë peshonin edhe deri në 1400 kg, u këputën 700 konopë. Madje, për dallim nga literatura ku thuhet se më 22 nëntor të vitit 1908 ushtria turke e rrënoi kullën e Isës me topa (11), anasit thonë se kur turqit nuk ia dolën ta rrënojnë kullën me topa, ata ia mësynë dhe e rrënuan me "qyskia".

5.1.1. Duke i marrë parasysh tiparet, përkatësisht veçantitë strukturore-konstruktive të mureve fortifikuese, si dhe pozicionin e saj strategjik, në majën e një kodre që mbizotëron gjithë arealin e gjerë të fshatit, njëmend kjo kullë s'ishte vetëm kullë banimi, por edhe kullë e veçuar dhe e fortifikuar, me karakter të mirëfilltë mbrojtës.

5.1.2. Ndërkaq duke i marrë parasysh përfundimet e shtruara nën 5.01 dhe 5.02, nisur nga tiparet e strukturës arkitekturore të bazës përdhé të kullës së rrënuar, e cila shquhet për një planimetri në formë katrori, me përmasa 9.60 x 9.80 m, pastaj duke patur parasysh pozitën e portës kryesore dhe të shkallëve të brendshme, si dhe në veçanti faktin se e tërë përdhesja paraqet një hapësirë të lirë me një shtyllë në mes, mbërrijmë të themi se kjo kullë për nga stili i ndërtimit i përket tipit të kullës shqiptare të Rrafshit të Dukagjinit. Po e vumë në një bashkëlidhje krahasimore strukturën e planimetrisë së përdhesës sonë me strukturat planimetrike të përdhesave në kullat katërkatëshe dukagjinase (të zëna ngoje edhe më sipër), do të shohim se ato përkojnë plotësisht, jo vetëm për nga dispozicioni strukturoro-arkitekturor e funksional i përdhesës, por edhe për nga përmasat qarkore. Kështu, përmasat qarkore të bazës së përdhesës te Kulla e Currajve dhe e Rrustemajve në Strellc, janë : e para 9.75 x 8,80 m', e dyta 10,25 x 9.46', ndërsa të kullës së Osdautajve në Isniq, janë: 9,80 x 11,00 m'. Nga kjo pasqyrë shohim se edhe përmasat qarkore të bazave ishin shumë të përafërta.

DO NOT COPY

Kësaj i do shtuar edhe një tjetër e dhënë: pasi kajmekami i Mitrovicës Hajdar Beu me ushtrinë e tij, më 22 nëntor 1908, e rrënoi kullën e Isa Boletinit, ai qe i detyruar, që me familje dhe njerëz të vet tërhiqej në Isniq të Deçanit (12); kështu u vendos për do kohë në kullën e përmendur katërkatëshe të Osdautajve (13).

5.2. Tiparet arkitekturore formësuese të kullës ekzistuese

Kulla ekzistuese e familjes Boletini, mbase e ndërtuar menjëherë pas rrënimit të kullës së zënë ngoje më sipër (domethënë pas vitit 1908), është në gjendje mjaft të ruajtur. Në këtë kullë punët përgatitore për restaurimin e saj u filluan rreth vitit 1979 nga Enti Krahinor për mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Prishtinë, çuditërisht pa kurrëfarë dokumentacioni përkatës teknik ?! Edhe pse nën mbrojtjen e ligjit, punët për restaurimin e saj kanë mbetur pa u përfunduar (?!) Kjo kullë që mbi njëzet vjet shërbeu si shkollë, sot, e mbyllur për vizitorë, ka mbetur në mëshirë të kohës. Siç mësojmë nga literatura, kulla e Boletinëve gjashtë herë u dogj e u rindërtua. Herën e parë u dogj rreth vitit 1750 (14). Nga kjo themi se ndërtimi i kullave ka filluar që nga gjysma e shekullit të XVIII, apo edhe më herët, çka nuk e përjashton mundësinë që ndërtimet pararendëse të kullave për banim të kenë patur divanhane të drunjta, meqë kullat e ndërtuara vetëm prej guri janë më të vonëta.

5.2.1. Pas një kundrimi të vëmendshëm të tipareve arkitekturore formësuese dhe kompozicionale të kullës ekzistuese (të dhëna në fig.3 e deri në fig.12), mbërrijmë në përfundimin se edhe kjo kullë i përket mirëfilli tipit të kullave shqiptare të Rrafshit të Dukagjinit.

Fillimisht do të bëjmë fjalë për tiparet arkitekturore formësuese e kompozicionale të eksterierit së kullës e më pas edhe për tiparet e strukturës hapësinore-kompozicionale të interiereve të saj. Mendimet e thëna më poshtë do t'i shpleksim sipas metodës analitike krahasuese.

5.3. Tiparet arkitektonike formësuese e kompozicionale të kullës ekzistuese të Boletinëve

Formësimin arkitektonik të jashtësisë së kullës të Boletinëve e shquan e njëjta frymë krijuese, sikundër edhe kullat e tjera të kësillojta të Rrafshit të Dukagjinit.

5.3.1. Struktura parësore apo plastika e shkallës së parë të kullës së Boletinëve përkon plotësisht me ato të tipit të caktuar të Rrafshit të Dukagjinit. Struktura parësore e kësaj kulle shquhet me mbështjellës (të cilin e sajojnë muret e jashtme) në formë prizmatike dhe me bazë katrore, me përmasa 10,70 x 10,76.

5.3.2. Struktura dytësore, apo plastika e shkallës së dytë është në perkim të plotë me kullat e kësillojta të tipit të Rrafshit të Dukagjinit. Në rastin konkret, te kulla e Boletinëve, sikundër edhe tek rastet e tjera, na paraqitet vetëm një element (vëllim) arkitekturor, që në formë erkeri del nga planimetria qarkore e kullës. Ky element arkitekturor, siç shohim nga fig.7, mbështetet në dy konsola gurësh të sajuara nga mbivendosja e anëcakëve në formë të shkallëzuar. Për dallim nga nënvarianti tjetër i këtij tipi të kullave, te kulla e Boletinëve, siç shohim nga fig.9, divanhanja e saj nuk del cazë në formë konsoli nga planimetria prizmatike e kullës, por mbaron në rrafshin e murit.

Ndryshe nga kullat e tjera të Rrafshit të Dukagjinit, të cilat gjithëherë karakterizohen me pullaze katërujore (piramidale), kulla ekzistuese e Boletinëve, me pullazin e saj treujor, veçohet, të thuash, si një rast unik. Kjo veçanti, në formësimin arkitekturoro-hapësinor e kompozicional, kushtëzohet nga karakteri dhe pozicioni i saj strategjik prej kulle të veçuar. Dhe vërtet, nga ana e shpatijeve që lartësojnë sheshin

DO NOT COPY

DO NOT COPY

e kompleksit të kullave, me ngritje përkatëse të pullazit është sajuar një mur anësor në formë trekëndëshi. Në strukturën konstruktive të këtij muri gurësh, në blloqet më të mëdha, janë gdhendur frëngjitë rrethore. Këto frëngji, çelur në murin më të lartë të kullës, kanë karakter strategjiko-luftarak, pra janë ndërtuar me qëllim që të mundësojnë një fushëpamje më të gjerë e më të largët nga ana e shpatijeve.

Në përbërje të pullazit të kullës ekzistuese, struktura konstruktive dhe formësuese e strehës (shih fig.9), ashtu siç është realizuar në kuadër të punëve restauruese të papërfunduara, është punuar në mënyrë krejtësisht të gabuar dhe jo profesionale, pa njohuri e studime paraprake rreth kullës së tipit të Rrafshit të Dukagjinit. Struktura konstruktive dhe formësuese e strehës, siç është thënë, karakterizohet me tipare të njësishme dhe të dhe të mëvetësishme, andaj është dashur të ndërtohet streha e kullës ekzistuese e Boletinëve, e jo ashtu siç është realizuar (15).

5.3.3. Struktura tretësore apo plastika e shkallës së tretë, përkatësisht çeltinat si: portat, dritaret dhe frëngjitë, siç shohim nga fig.8, fig.9, fig.10, fig.11 dhe fig.12, kanë tipare formësuese të një fryme me ato të tipit të Rrafshit të Dukagjinit. Frëngjitë me tipare të njëjta i hasim edhe te kullat e tjera të tipit të rrafshit të Dukagjinit; ndër to do veçuar kulla katërkatëshe e Osdautajve, ndërtuar rreth vitit 1850 në Isniq të Deçanit.

5.4. Tiparet e strukturës hapësinore–kompozicionale dhe funksionale të brendisë së kullës ekzistuese të Boletinëve.

Tek të ndërtuarit e kullës së Boletinëve spikat e njëjta ide arkitekturore-formësuese, kompozicionale dhe funksionale, pra përkatësisht i njëjti dallim funksional sipas kateve, sikundër edhe tek kullat e tjera të tipit të Rrafshit të Dukagjinit. Në katin e parë, siç i thonë përdhesës anasit (fig.4), në aspektin strukturoro-konstruktiv, na paraqitet i njëjti formulim, sikundër edhe tek të gjitha kullat e tjera të tipit të Rrafshit të Dukagjinit. Kjo strukturë konstruktive përbëhet nga një shtyllë dhe nëntrarëz e mbërthyer mbi të, vendosur në mes të bazës katrore të mureve. Nga kjo nëntrarëz bartet edhe trau kryesor, mbi të cilin tërthorazi mbështeten trarët e drunjtë të konstruksionit meskatror (fig.6). Siç shohim nga kjo figurë, të dyja anët e poshtme të nëntrarëzës janë të zbukuruara me një ornament të lashtë, apo motiv nga kulti i diellit, aplikuar në formë lineare. Këtë ornament e hasim edhe në kohët ilire (16). Zakonisht në përdhesë strehohet bagëtia, mirëpo në këtë rast, siç shohim nga fig.1 "S", strehimi i bagëtisë bëhej në stalla. Prandaj, në përdhesë është vendosur shtëpia e zjarrit me dy vatra (fig.3 "V1", "V2") dhe dy mjedise banimi me nga një oxhak. Një gatitje të ngjashme funksionale të përdhesës e hasim, fjala vjen, edhe tek kulla trikatëshe e familjes Makaj në Junik të Deçanit (17).

Më tej, nga përdhesa e kullës së Boletinëve, shkallët e brendshme, me konstruksion prej druri, të shpiejnë te divanhanja ("DV") me dyshekllak ("D") dhe njësi të tjera arkitekturore të zakonshme për këtë kthinë (fig.4). Nga divanhanja hyhet në tri mjedise banimi – oda të burrave, me nga një oxhak. Siç shohim nga figura 4, oda e burrave ("B") ngërthen në vete një dispozicion arkitekturor-funksional të tipizuar për kullën shqiptare të Rrafshit të Dukagjinit. Ky dispozicion karakteristik i odës së burrave qëndron në faktin se, përherë hyrja në dhomë, përkatësisht dera e saj, gjendet në mes të murit dhe përballë saj oxhaku, me dy çeltina të verbra, apo dollap të vegjël anash tij. Në të majtë, në shumicën dërrmuese të rasteve, sikundër edhe në këtë rast, gjenden dy dritaret e mëdha të odës. Për të mbështetur përfundimin e sipërthënë, do t'i zëmë ngoje vetëm disa kulla të ndërtuara në Rrafshin e Dukagjinit, tek të cilat oda e burrave ka të njëjtin dispozicion arkitekturoro-funksional si ta zemë:

kulla e Osdautajve në Isniq, kulla e Currajve dhe Rustemajve në Strellc, pastaj kulla e Makajve në Junik, si dhe kulla e Haxhijajve dhe Selmanajve në Carrabreg (18) etj.

Kjo kostante e ruajtur në dispozicionin e odës është kushtëzuar nga tradita e lashtë shpirtërore e popullit shqiptar, e cila është shprehur në krijimtarinë popullore arkitekturore dhe gjithnjë është bazuar gjatë evoluimit të shtëpisë, prej një forme në formë tjetër, që nga koha e neolitit të vonët e këndej.

6.0. Përmbyllje

Gjithëkështu, në bazë të përmbajtjes studimore të shpleksur më sipër erdhëm në përfundim se kulla e familjes Boletini ngërthejnë mirëfilli në vete tiparet arkitekturore-kompozicionale dhe formësuese të kullës shqiptare të tipit të Rrafshit të Dukagjinit. Veç kësaj, duke marrë parasysh këto tipare, përkatësisht veçantitë strukturore-konstruktive të mureve rrethuese të kompleksit të kullave të Isa Boletinit, si dhe vendodhjen e tyre strategjike në pikën më të lartë të një kodre që mbizotëron gjithë arealin e gjerë të fshatit Boletin, vërtet mund të themi se këto kulla nuk kishin vetëm destinim banimi, por njëherësh ishin edhe kulla të veçuara dhe të fortifikuara me karakter mbrojtës.

S'do mend se kjo ishte e kushtëzuar nga rrethanat politiko-historike që mbretëronin në kohën e ndërtimit dhe shfrytëzimit të tyre.

DO NOT COPY

1. *Mitrovica dhe rrethina. Mitrovica 1979, faqe 13.*
2. *Po aty, faqe 5.*
3. *J.Cvijic, OSNOVE ZA GEOGRAFIJU I GEOLOGIJU MAKEDONIJE I STARE SRBIJE, Knjiga treca, Begrad 1911, faqe 1118.*
4. *Ahmet Maloku. Përparimi 7-8, Prishtinë 1962, faqe 525.*
5. *Dr. Fehmi PUSHKOLLI, Arti ushtarak I Gjeneral Boletinit, prishtinë 1996, faqe 9.*
6. *Po aty, faqe 9.*
7. *Bujku, Prishtinë 9.11.1996, faqe 12; nga "Albania and Albanias" Librarie Chapelot, 1921.*
8. *Këtë të dhënë na e bëri të ditur, më 27.081996, Prof.Ahmet MALOKU, I lindur më 1929 në Mitrovicë.*
9. *Flamur DOLI, SHKOLLA VERORE E MJESHTRIT POPULLOR SHQIPTAR, Prishtinë 19923, faqe 145.*
10. *Po aty, faqe 150 dhe 198.*
11. *Mitrovica dhe rrethina, Mitrovicë 1979, faqe 92.*
12. *Mitrovica dhe rrethina....., faqe 92.*
13. *Y.SOKOLI, Kulla që ruan baladat, "BUJKU", Prishtinë 20.09.1996, faqe 7.*
14. *Skënder LUARASI, Isa Boletini, Prishtinë 1972, faqe 10.*
15. *Për këtë më gjerësisht lexo në monografinë: Flamur DOLI, SHKOLLA KOSOVARE E MJESHTRIT POPULLOR SHQIPTAR, Prishtinë 1993, faqe 154-171.*
16. *Po aty, më gjërësisht lexo faqet: 137-139.*
17. *Shih dokumentacionin arkitektonik-rilevimin e kësaj kulle, të bërë nga autori më 1 shtator 1976.*
18. *Shih: foto dok. dhe dok. e rilevimeve të autorit.*

DO NOT COPY



Fig. 1. Situata e kompleksit të kullave të Isa Boletinit, fshati Boletin, Shalë.

DO NOT COPY



Fig. 2. Baza e përdheses së kullës së rrënuar

DO NOT COPY



Fig. 3. Baza e përdheses së kullës ekzistuese të familjes BOLETINI, fshati Boletin.

DO NOT COPY



Fig. 4. Baza e katit të kullës ekzistuese të familjes Boletini.

DO NOT COPY



Fig. 5. Oxhaku, hollësirë nga oda e burrave në kat të kullës.

DO NOT COPY



Fig. 6. Hollësirë nga shtylla dhe nëntrarëza e përdhesës së kullës



Fig. 7. Dukja e kullës ekzistuese, në plan të parë muret fortifikuese të kullës së rrënuar.



Fig. 8. Dukja ballore e kullës ekzistuese.



Fig. 9. Hollësirë nga Divanhanja e kullës.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 10. Hollësirë nga porta kryesore e kullës ekzistuese.



Fig. 11. Hollësirë nga dritarja e katit të kullës.



Fig. 12. Hollësirë nga dritarja harkore e përdhesës së kullës.



Fig. 13. Hollësirë frëngjie nga muri rrethues - TONTA.



Fig. 14. Dukja e kronit të fshatit, ndërtuar nga familja BOLETINI.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

THE ARCHITECTURAL FEATURES OF THE ISA BOLETINI TOWERS

The family towers of the distinguished patriot Isa Boletini, at Boletin Village near Mitrovica City, are the object of this study. The tower where Isa Soletini was born and the Boletin Village itself were ruined several times by the Ottoman invaders.

The Boletin village rests on a site with a very rough relief. The family compound housing the towers rests on the highest hill. This compound is made up of the two towers and the stables. It is surrounded by a protective wall, except for the northern part that has natural protection.

One of the towers (A) exists in a ruined state, whilst the more recent one,(B), is well preserved. The surrounding wall is of stone and it has two gates and several "niches" that were used for guns. As to the two gates, one is smaller used only by family members while the other gate, the main one, is bigger and can accommodate the entrance of carts.

The towers, the stables and the surrounding walls, represents an unified system of protection. The ruined tower, still preserves the planimetric configuration, where can be noticed the unusual wall thickness of 1m and the simple square form. The tower's construction style belongs to the Albanian tower type of the Dukagini Plain.

The existing tower is built after the "A" tower was ruined, which means after 1908, and also has the Albanian tower features of the Dukagjini Plain. Its planimetry has a square form, two floors and internal stairs. A fire-house with two fire-places and two living areas with the chimneys separated is situated on the ground floor. The wooden stairs lead to the divanhan area with its characteristic dyshekllek (?). The divanhan area is connected to the three living rooms.

The towers of Boletini Family represent the composing-architectural features of the Albanian tower of the Dukagini Plain. The Boletini Towers were built intending two functions: as a residence and, the reason them being separated and fortified illustrates their defending character that was conditioned by the historic-political circumstances of the time.

DO NOT COPY

Emin RIZA

DO NOT COPY

ARKITEKTURA POPULLORE SHQIPTARE
(*sprovë për vlerësimin e arritjeve të deritanishme*)

Termi "arkitekturë popullore", që lidhet me krijimtarinë ndërtimore të mjeshtrave të pashkolluar,do të përfshinte mbarë këtë krijimtari që prej muzgut të historisë e deri aty nga shek.XX, gjithë duke u luhatur sipas shkallës zhvillimore në secilin vend. Ai madje lidhet ngushtas, veçse me një gjini ndërtimore, atë të banesës, e cila me dendësinë, vazhdimësinë dhe karakterin e saj e ka bërë të vetin këtë term. Kuptohet se cilësori "popullore" u referohet ideuesve dhe ndërtuesve të veprave, pa patur lidhje me përdoruesit e tyre. Shprehja "arkitekturë popullore" i ka qëndruar kohës edhe në perqasje me simotrat e saj: arkitekturë folklorike, arkitekturë minore dhe arkitekturë vendase (vernakulare); e para thuajse sinonim, e dyta padrejtësisht përnxirëse, ndërsa e treta e mbështetur mbi tregues fort të përgjithshëm.

Parë kësisoj, arkitektura popullore shqiptare, është një realitet, i cili shtrihet në mbarë arealin tradicional e njëherazi bashkëkohor të etnosit tonë. Kjo veprimtari ndërtimore është prej parit më e lidhura me karakterin e kombit, si nocion historik pra evolutiv, në dallim nga kategori të tjera ndërtimore si ndërtimet e kultit, inxhinierike, fortifikimet etj. Këto të fundit, si në kompozimet ashtu dhe veçoritë ndërtimore, kushtëzohen ndjeshëm nga faktorë të programimeve kanonike, ato të zhvillimeve të teknikave të luftimit dhe më gjerë të shkallës së teknologjisë ndërtimore, faktorë këta pa lidhje të drejtpërdrejtë me një etnos të caktuar

Nëse do të shtronim prerazi pyetjen: "A ka arkitekturë kombëtare", do të përgjigjeshim se arkitektura popullore është kategoria ndërtimore më e afërt me nocionin komb, për arsye historiko-shoqërore, që lidhen me karakteristikat e objektit të paraqitur nga ky nocion.

Në gjendjen e sotme studimore, arkitektura popullore shqiptare, e kuptuar si emërtim i banesës popullore, haset në trojet shqiptare qysh prej antikitetit, shfaqet në gjendje rrënoje dhe e pacënuar gjatë mesjetës e më tej deri aty nga dhjetëvjeçarët e parë të shek XX, kur ajo thuajse pushon së qeni krijimtari popullore në qytet, e ca më vonë edhe në fshat. Thelbin e arkitekturës popullore shqiptare për nga shumë këndvshtrime dhe kryesisht për nga ai sasior, e përbëjnë ekzemplarët e shekujve XVIII-XIX si në fshat dhe qytet, madje të ruajtur në njësi krahasimisht të mëdha si lagje dhe bashkësi lagjesh, në rastin e qyteteve-muze.

Arkitektura popullore shqiptare, kryesisht ajo e Shqipërisë politike, tashmë njihet gjerësisht në rrethet shkencore ballkanike, duke u përfillur fillimisht si zbulesë e më pas si dukuri e rëndësishme për ndjekjen e ecurisë dhe karakterit të banesës popullore në hapësirën ballkanike,

DOKTORATURA

veçanërisht gjatë mesjetës së vonë (shek.XV-deri nga mesi i shek. XIX). Shkaqet e këtij interesimi i qartësojnë dy arësye bashkëplotësuese: larmia e theksuar tipologjike e banesës shqiptare dhe dukuritë e shumta të ruajtura deri më sot. Kjo e fundit lidhet me dy shkaqe, do të thonim specifike, së pari prapambetja relative ekonomike e Shqipërisë ndaj vendeve të tjera ballkanike, e cila pamundësonte synimet për rindërtimin apo prishjen e banesave të vjetra dhe së dyti kujdesi i treguar për mbrojtjen e këtyre vlerave, shfaqur herët, aty rreth viteve 1960. Interesimi për studime në fushën e banesës popullore shqiptare dhe arkitekturës shqiptare në përgjithësi, vjen t'i shtojë shkencave albanologjike një fushë të re studimore gjatë këtij gjysmë shekulli. Vlerat që ajo ofron për veprimtarinë vazhdëshekullore të etnosit shqiptar, ndihmojnë natyrshëm për ndriçimin e kuadrit historik të mbijetesës së tij. Historia e arkitekturës shqiptare, gjithë duke qenë disiplinë më vete, shfaqet me autenticitetin e dokumentit historik, të vlerave të rëndësishme dhe herë-herë të pazëvendësueshme, veçanërisht për historinë e etnosit tonë, rreth të cilit dëshmitë dokumentare përgjithësisht janë të kursyera e madje shpesh të mangëta. Duke e rrokur me një vështrimi sintetizues, apo ndryshe ndërdisiplinor historinë e etnosit shqiptar, themi se krijimtaria e tij ndërtimore në shekuj tashmë ka fituar vendin e duhur e të paluejtshëm në shërbim të ndriçimit autoritar të së vërtetës historike.

Studimi i arkiteturës popullore në trojet historike shqiptare, dukuri e gjysmës së dytë të këtij shekulli, paraqitet heterogjene për nga gjerësia dhe metodologjia kërkimore. Në Shqipëri, ajo shfaqet sa sistematike aq dhe e njësuar në metodën kërkimore. Në hapësirën shqiptare të ish-Jugosllavisë, posaçërisht në Kosovë, arkitektura popullore ka tërhequr vëmendjen e studiuesve vendës, kryesisht në shfaqjet e saj në fshat dhe veçanërisht të kullës-banesë. Mungesa e sistematizmit në qëmtimin e mbarë dukurive, si dhe metodologjia pa koherencën e duhur, kanë pamundësuar arritjen e një kuadri të plotë të zhvillimit të dukurisë në hapësirë e kohë. Interesimet e disa autorëve serbë për banesën qytetare kosovare, veçanërisht për disa tipa të saj, japin ndihmesë në sqarimin e kuadrit, i cili mbetet ende larg së konsideruari i plotë dhe i qartë. Banesa e trojeve etnike shqiptare në Maqedoni dhe Mal të Zi, është thuajse e pashqyrtuar. Jashtë interesit të studiuesve është edhe banesa e shqiptarëve të diasporës në Greqi dhe Italin të Jugut, ndërsa për arsyet e njohura, banesa çame pret të studiohet.

Kërkimet sistematike në fushën e arkitekturës popullore në Shqipëri i përkasin periudhës pas Luftës së Dytë Botërore. Politizimi i skajshëm i jetës në Shqipërinë enveriste, doemos qe i pranishëm në shkencat albanologjike me pasoja gjithfarë në disiplina të ndryshme të tyre, kushtëzuar nga shkalla e lidhjeve të disiplinave në fjalë me dogmën ideologjiko-politike. Studimet e arkitekturës popullore dhe më gjerë të arkitekturës shqiptare, në këtë kontekst patën fatin të përputheshin me përpjekjet e regjimit për autarki kulturore. Elozhet e përgjitjshme të tij për krijimtarinë e "masave të shtypura", depozitar i interesave të të cilave paraqitej partia-shtet, shkonin vetiu në dobi të veprimtarisë për gjurmimin, mbrojtjen dhe studimin e kësaj krijimtarie. Në këto rrethana gjithsesi kanë qenë të pranishme edhe kufizimet e natyrshme në disa aspekte të identifikimit të vlerave dhe këndshikimeve gjatë trajtimit të tyre. Ato shfaqeshin në autocensurën e kërkuesve të fushës për të mos prekur tema tabu, si dhe në theksimin apo zhvleftësimin subjektiv të dukurive të ndryshme, për të shmangur cënimin e kanuneve ideologjiko-politike.

Studimi i arkitekturës popullore në Shqipëri parakuptonte njohjen e trashëgimisë ndërtimore në këtë fusha, të shpërndarë anë e kënd vendit kryesisht në qendrat e banuara fshatare e qytetare, pa lënë mënjanë vlerat e rëndësishme të qendrave, që për arsye të ndryshme qenë

braktisur në rrjedhë të shekujve. Për rastin shqiptar kjo gjini e arkitekturës ka si burim të vetëm materialin faktik, prandaj gjurmimi sistematik dhe sipas kriteresh të drejta metodike mer rëndësi parësore, madje do të pohonim pa mëdyshje se ky moment përfshin thelbësisht procesin e studimit. Në Shqipëri, brenda harkut kohor prej tri dekadash 1960-1990 është kryer veprimtari sistematike gjurmuese thuajse në mbarë vendin, sipas kriteresh bashkëkohore. Natyrshëm kjo veprimtari është shoqëruar me vjeljen e dokumentacionit përkatës grafik, fotografik e përshkrimor, i cili ka vlerat madhore të dokumentit, për të mundësuar thellimin dhe zgjerimin e studimeve në rrjedhë të kohës.

Duke qenë se problemet e metodës kërkimore paralelisht vlejnë si për fazën gjurmuese, ashtu edhe atë studimore të mirëfilltë, po ndalemi në të.

Metoda kërkimore dihet mirëfilli se ngërthen koncepte të natyrës botëkuptimore (për të mos shpërdoruar termin "filozofike"). Veçanërisht gjatë periudhës së regjimit totalitar qëndrimi i qartë metodik paraqiste një parakusht të detyrueshëm, një lloj kredoje e cila mundësonte ose pengonte çdo kërkim, veçanërisht në fushën e shkencave albanologjike. Studiuesit shqiptarë të fushës pohonin ngultas se kishin përvetësuar botëkuptimin materialist-dialektik, i cili në rastin e dhënë donte të thoshte se dukuritë e arkitekturës popullore këqyreshin të lidhura ngushtë me realitetin ekonomiko-shoqëror të një periudhe të caktuar. Do të pohonim pa mëdyshje se në këtë krijimtari ndërtimore këto lidhje vërtet janë objektivisht thelbësore, por pa u ngucur nga interpretime të sforcuara apo nga rrjedha formale të filozofisë leniniste. Studimet serioze të kryera në këtë fushë ndër vende me tradita të hershme kulturore i japin përparësi pikërisht këtyre kushteve. Kjo e vërtetë ka fort rëndësi, pasi ngjan se në këtë fushë nuk është cënuar kërkimi shkencor, si përkundrazi u dëmtua rëndë në disiplinën e historisë, dhe ku më shumë e ku më pak në mbarë shkencat albanologjike.

Bazat e mësipërme metodike, në kushtet e centralizmit të theksuar, u shtrinë në mbarë studiuesit e fushës duke njësuar kështu metodën kërkimore dhe për pasojë edhe përfundimet e saj. Rrjedhojë e drejtpërdrejtë e kushtëzimit të realizimeve të arkitekturës popullore prej realitetit ekonomiko-shoqëror ka qenë vënia e kriterit tipologjik si thelbësor ne veprimtarinë gjurmuese dhe studimore për vlerat e kësaj krijimtarie. Udhëheqja prej këtij kriteri mbështetet prej premisës se kultura e banimit si pjesë e rëndësishme e mënyrës së të jetuarit shfaqet nëpërmjet kategorish evolutive kompozicionale, përkatësisht tipeve dhe varianteve, zgjidhje këto që synojnë të plotësojnë kërkesat jetësore në rrethana të caktuara e njëherazi në zhvillim e sipër. Ky kriter natyrisht nuk është një meditim kabineti i futur dhunshëm në përpjekjen për të rrokur thelboren në historinë e arkitekturës sonë popullore. Gjasat e shfaqjeve të kësaj kategorie ndërtimore kanë sugjeruar sheshit këtë kriter si më qenësorin, pra pasqyruesin më besnik të realitetit, të cilin e ngre në objekt studimi. Vetëkuptohet se kritere të tjera dytësore kanë qenë gjithherë të pranishëm në veprimtarinë gjurmuese-studimore të arkitekturës popullore në Shqipëri. Studimi i arkitekturës sonë popullore sipas kriterit tipologjik, atij më thelbësorit, ka parakuptuar vendosjen e dukurisë në kohë, pra kriterin kronologjik, marrë si absolut dhe, në pamundësi të kësaj, përpjekjet për të vendosur një farë kronologjie relative.

Gjurmimi dhe studimi sistematik i banesës popullore shqiptare (kemi parasysh gjithmonë atë brenda Shqipërisë politike) kanë lejuar karakterizimin dhe tiparet e saj kryesore, cilësime këto që ku plotësisht e ku pjesërisht rrokin mbarë gjininë duke tejkaluar etni e hapësira për të qenë gjithnjë të pranishme në krijimtarinë autentike popullore.

Studimet e arkitekturës popullore shqiptare, që në fillesat e tyre, kanë dalluar dhe për pasojë

PHOTOCOPY

veçuar banesën fshatare nga ajo qytetare si dy njesi të veçanta, natyrisht me lidhje të ndryshme në kohë të ndryshme. Kjo ndarje është pasojë e kriterit tipologjik, i cili e ka burimin te mënyra e jetesës, në rastin konkret rrënjësisht e ndryshme ndërmjet fshatit dhe qytetit, sepse të ndryshme janë dhe llojet e ekonomive përkatëse. Në këtë kontekst tipologjia e banesës fshatare dhe asaj qytetare janë shtjelluar veçmas, gjithë duke qenë tipe të njëjta të pranishme si në fshat dhe në qytet, kryesisht me dallime në trajtimin arkitektonik. Elementet, madje dhe shfaqjet e qarta të ekonomisë fshatare në jetën e qyteteve shqiptare të mesjetës së vonë (shek. XV - mesi i shek. XIX), janë dukuri e rëndomtë. Në vendbanimet fshatare tipizimi i banesës popullore përgjithësisht shfaqet me rajonizimin, duke qenë një apo disa tipologjitë mbisunduese në një hapësirë të caktuar, e cila zakonisht përputhet me rajonizimin tradicional. Për arsye të veçanta, një tip i dhënë banese gjendet i përhapur vetëm në një fshat. Tipologjia e banesës qytetare është qartësisht e përcaktuar. Përgjithësisht një tip haset i përhapur në disa qendra si banesa me çardak, por krahas tij ndeshen edhe tipa me përhapje të kufizuar, si banesa me hajat, madje të ndërtuar vetëm në një qendër të vetme si fjala vjen banesa gjirokastrite. Dukuritë konvergjente me tipologjinë e banesës qytetare shqiptare shfaqen qartazi aty nga mesi i shek. XIX, me lindjen e tipit të mirëfilltë të banesës qytetare në kuptimin modern të termit, pra të banesës së qytetit si qendër e vërtetë prodhimi e këmbimi, larg çdo elementi të ekonomisë fshatare. Kjo banesë, e emërtuar banesa korçare, e njohur në mbarë hapësirën ballkanike e gjetkë, spikati fort në Korçë për të ndikuar më tej në banesat tradicionale të Mesjetës së Vonë siç shihet mirë në rindërtimet e banesave të Beratit, apo përhapjen e saj, veçanërisht gjatë fillimit të shek. XX, në mjaft qytete shqiptare.

Tipologjia e banesës shqiptare të Mesjetës së Vonë dhe më qartë ajo fshatare, është fort e ndikuar nga funksionet e shumta të banesës lidhur me ekonominë familjare, pa përjashtuar banesën qytetare, veçanërisht atë të disa shtresave, madje deri në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XX. Kjo dukuri shpjegon përhapjen e gjerë të mjediseve ndihmëse në hapësirën tradicionale të banesës, parë si trualli brenda mureve rrethuese të saj. Multifunksionalizmi i banesës shqiptare në Mesjetën e Vonë gjen pasqyrim si në repertorin e mjediseve të saj, ashtu edhe në kompozimin e banesës së mirëfilltë dhe veçanërisht të ndërtimeve ndihmëse.

Kompozimi shquhet për nga larmia, gjurmë kjo e ekonomisë së copëzuar dhe me tipare autarkike. Elementi thelbësor i përbashkët i tipologjisë së banesës popullore shqiptare gjendet te njësitë themelore kompozicionale: oda, shtëpia e zjarrit, tremat e hapura, qilaret etj. Kompozimi i tyre përgjithësisht është i njësuar pavarësisht nga tipologjia, ndërsa trajtimi arkitektonik, si përbërësi më luhatës, shfaqet larmishëm madje edhe brenda një tipi. Ai, si për të aktualizuar dukurinë, ndjek modën e kohës, natyrisht duke qenë shtresat e kamura ato në radhët e para të risive; shpesh risitë në fjalë janë imitime modelesh të formësuara në qendra të zhvilluara të Perandorisë. Teknika e ndërtimit është një tjetër kategori e përbashkët, ngase vetvetiu mbetet tejet konservatore. E kristalizuar shekuj më parë dhe e kushtëzuar ndjeshëm nga materialet natyrore, apo ato me përpunim të pakët, teknika e ndërtimit në banesën popullore shqiptare ka shtrirje të gjerë hapësinore për të njëjtat teknologji ndërtimore.

Tipologjia e banesës popullore shqiptare shfaqet si një dukuri evolutive si brenda një tipologjie të caktuar, ashtu dhe në shqyrtimin e saj tërësor. Kalesa nga një variant në tjetrin, përsosjet brenda një varianti, të rejat në trajtimin arkitekturor etj., flasin qartë për tiparin zhvillimor të kësaj dukurie, tipar i cili ndjek ritme ecurish të ndryshme në kohë, dhe përgjithësisht në përpjestim të drejtë rritjeje në lidhje me rrjedhën e kohës. Ritmet e zhvillimit të shoqërisë tek e fundit kushtëzojnë ritmet e zhvillimit të

DO NOT COPY

banesës. Racionalizmi, si një tipar i përgjithshëm i arkitekturës popullore, e gjen shpjegimin te funksioni parësor utilitar i saj, i cili, i ndërthurur me prirjen e për të qenë të përkorë, shmang çdo zgjidhje jofunksionale. Përjashtime paraqesin kapriçiot e majave të shtresave të pasura, që vijnë e shfaqen kryesisht në dekoracionet, dobia e të cilave mund të lidhet veçse me vetpohimin pasuror, gjithsesi me elemente racionalë.

Banesa popullore shqiptare dhe veçanërisht ajo qytetare, përgjatë shekujve XVIII-XIX, në hapësirën ballkanike dhe atë të Turqisë aziatike, zë një vend të shquar për nga vlerat, duke pohuar brenda kufijve të njohur të objektivitetit, se ajo është dëshmia e prekshme e kulturës së lartë të banimit të shqiptarëve binjake e kulturës në përgjithësi. Studimet sistematike të arkitekturës popullore shqiptare nëpërmjet trajtimesh mbi bazë zonash, tipe banesash apo qendrash banimi kryesisht qytetare, si dhe punimet përgjithsuese monografike kanë mbërritur të krijojnë një kuadër tiparesh, karakteristikash dhe zhvillimesh në kohë të kësaj kategorie ndërtimore. Sikurse pritej, arkitektura popullore shqiptare nuk qëndroi larg rrymave kulturore në rrjedhë të kohës, të cilat prekin hapësira të gjera (pra dhe atë shqiptare) me ide, skema, formulime arkitekturore etj. Synimi për ta rrokur pa paragjykime të përparuarën, cilësi e spikatur kjo e etnosit tonë, shfaqet edhe në fushën ndërtimore. Etnosi shqiptar për shekuj u përfshi në suaza njësish tepër të gjera politike si ato të perandorive romake, bizantine e turke. Këta faktorë padyshim kanë ndikuar në marrëdhënie të ngushta kulturore të hapësirës shqiptare me atë të popujve të tjerë. Vetë tipologjia e banesës dhe veçanërisht disa tipe panballkanike në të janë tregues të qartë të cilët, krahas formulimit arkitekturor dhe sidomos dekoracionit, për nga vetë natyra kanë fuqi të madhe shtrirjeje dhe përvetësohen pa vështirësi.

Studimet e sotme të arkitekturës popullore në treva të ndryshme ballkanike, veçanërisht gjatë këtij tridhjetëvjeçarit të fundit kanë bërë përpara, duke u mbështetur kryesisht mbi materialin faktik, përgjithësisht më të paktë se ai në Shqipëri. Kuptohet se kriteret metodike nuk janë të njësuara dhe për pasojë edhe synimet për studime krahasuese në plan të gjerë gjejnë vështirësi, ndaj kur nuk ndërtohen mbi karakteristika thelbësore, por mbi elemente të dorës së dytë, mbërrijnë të kompromentojnë përfundimet. Veçanërisht problematik paraqitet synimi i gjenezës së banesës ballkanike, asaj otomane, greke, shqiptare etj. Synimi për të arritur përfundime në këtë fushë, tash për tash kur ende nuk është bërë ballafaqimi i materialeve, të themi kombëtare, mbi kriteresh të njëjta, shpesh paraqitet më fort si parashtrim hamendjesh, sesa hipotezash. Arkitektura popullore shqiptare vjen të japë ndihmesë të pamohueshme në këtë problematikë, si për larminë e pasurinë e saj ashtu dhe për hapësirën gjeografike në të cilën ajo është zhvilluar gjatë shekujsh. Problematika e gjenezës padyshim është e ngarkuar me paragjykime supremacish të pretenduara, duke e fokusuar këtë çështje si tepër të rëndësishme, për pa qenë e tillë.

Arkitektura popullore shqiptare deri në fillim të shekullit tonë paraqitet homogjene. Copëzimi i Shqipërisë etnike, në mënyrën më të keqe të mundshme, duke shkelur atë të drejtë njerëzore e ndërkombëtare, ka copëzuar dhe studimet e pritura sistematike, për një krijimtari unike. Eshtë detyra e studiuesve shqiptarë që të bashkërendojnë përpjekjet për synime të arritshme në plan metodik dhe konkret, në mënyrë që të mblidhet sa më shpejt e sistematikisht material në trojet shqiptare jashtë kufijve politikë të Shqipërisë, duke mundësuar kësisoj një studim përgjithsues për këtë krijimtari, studim i cili do të kishte vlera dhe jashtë kuadrit të shkencave albanologjike. Ai do t'i çelte udhë edhe pasqyrimit të një sërë faktorëve shtytës, apo karakteristikave të krijimtarisë popullore në fushën e banesës, të cilat, për arsye

POVIOTOPY

jashtëshkencore, kanë qenë përjashtuar ose minimizuar në studimet e derisotme.

Siç e përmendëm, shembujt e kësaj krijimtarie, të cilët i kanë qëndruar kohës deri më sot, përbëjnë bazamentin dokumentar mbi të cilin do të vazhdojnë studimet e mëtejshme të arkitekturës sonë popullore. Shumë syresh, përzgjedhur kryesisht mbi bazën e kriterit tipologjik, mbrohen nga shteti në cilësinë e Monumenteve të Kulturës. Ruajtja e këtyre vlerave të dyfishta arkitekturoro-dokumentuese është e lidhur ngushtë me kujdesin restaurues ndaj tyre, i vetmi që siguron jetëgjatësinë e autenticitetit të këtyre pasurive të pazëvendësueshme kulturore. Për rrjedhojë kujdesi restaurues, veçanërisht në këtë gjini, duhet të jetë i paprerë, kjo për shkaqet specifike lidhur me funksionin utilitar të këtyre vlerave. Në këtë fushë është e domosdoshme të vendoset koordinimi në plan metodik dhe më gjerë ende, ai i institucioneve të ngarkuara për mbrojtjen e monumenteve në hapësirat shqiptare.

Krijimi i shoqatës "Për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore historike gjithëshqiptare" me qendër në Prizren, është një nismë në drejtimin e duhur.

Arkitektura popullore, e njësuar me banesën popullore, në shembujt e cilësuar si monument kulture, shtron problemin e vërtetë të vendit të tyre në jetën e sotme. Funksioni tradicional i banimit natyrisht nuk mund t'iu hiqet veçse disa ekzemplarëve të spikatur, të kthyer në muze, ndërsa shumica e ekzemplarëve të tjerë do të vazhdojë të banohet. Në këto rrethana, përpjekjet për zbatimin e përpiktë të përkujdesjeve mirëmbajtëse, duke mos cënuar vlerat për të cilat këto vepra ruhen, kërkojnë vëmendjen dhe profesionalizmin e duhur.

Trashëgimia kulturore në fushën e arkitekturës popullore do të mbetej larg mundësive të mëdha potenciale që ajo vetbart si dëshmitar i prekshëm historiko-kulturor, për pa u pasqyruar në botime të karaktereve të ndryshme me destination si rrethet shkencore, ashtu dhe lexuesin e gjerë, brenda dhe jashtë vendit.

Me këto veprimtari, që presin të shtohen, kjo vepër shumëshekullore e etnosit tonë, do të përmbushte vërtet rolin që i takon si në jetën kulturore të vendit dhe më gjerë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

ALBANIAN FOLK ARCHITECTURE

Folk architecture is related to the constructive creation period of the illiterate masters, which starts with the twilight of history until the 20th century. The Albanian folk architecture is widely spread all over the Albanian ethnos and it mainly includes folk dwellings. Most of the examples of Albanian folk architecture are those of the 18th-19th centuries, as separate dwellings, quarters and museum cities.

Albanian folk architecture, well known in Balkan scientific circles is firstly considered as a revelation and later on, as an important phenomenon on the Balkanic scene, with its emphasized topologic variety and the good conditions of its cultural preservation.

The study of the folk architecture in Albanian historical sites is a systematic phenomenon of the second half of this century. The research methodology is systematic and unified. However, the lack of a systematic search and the incoherent methods of research on the Albanian territory of the ex- Yugoslavia explain the lack of the development of an overall framework of this phenomenon, in time and space. The dwellings of the ethnic Albanian sites in Macedonia and Monte Negro are almost unknown, while the Cameria (Greece) dwelling is yet to be studied.

The study of the folk architecture in Albania means studying this heritage all over the Country during the period 1960-1990. The strong link between dwellings and socio-economic conditions has made the typological criteria the most important one in researching this subject. It is understood that in researching folk architecture other secondary criteria are present, such as chronology, the propagation in space of the phenomenon, architectonic values, etc. In studying Albanian folk architecture, one could differentiate between the rural dwellings and the urban ones, as the two units that were separated but naturally linked with each other.

Composition has a distinctive variety in Albanian folk dwelling typology. Basic composing units tend to have their own convergent essential element. The typology of Albanian folk dwelling has been introduced as an evolutionary phenomenon, both as being inside a definite typology and on its own.

The Albanian folk dwelling and the urban one in particular assumes a distinctive place on the Balkanic space as that of Asiatic Turkey, especially during the 18th-19th centuries, representing a tangible evidence of Albanian's cultured ways of life.

Albanian folk architecture could not be distant from the ideas, schemes and architectonic formulations of the main cultural currents of the time. The Albanian ethnos have been present for centuries in the framework of vast political units that are considered an influencing factor on the Albanian dwelling typology.

Albanian folk architecture, until the beginning of this century, is considered homogeneous. The amputation of ethnic Albania has also broken the systematic studies of this unique subject. Albanian scholars in theirrespective helds should co-ordinate their efforts on the methodology and start collecting, systematically, the material on Albanians sites outside the political borders of Albania, to make possible an overall study of Albanian folk architecture.

DO NOT COPY

Ark. Shpresa PRIFTI

DO NOT COPY

NJË SHEMBULL I ZHVILLUAR I BANESËS SHKODRANE DHE PROBLEMET E RESTAURIMIT TË SAJ[1].

(*Banesa e Gjyleve*)

Banesa shkodrane me çardak, me një zhvillim të qartë tipologjik brenda një kufiri të përcaktuar variantesh[2], ruhet ende edhe sot në një mori shembujsh, shumica e të cilave në kohë janë transformuar. Kjo banesë e karakterizuar për tipizimin, si në skemën kompozicionale ashtu dhe në formulimin funksional-arkitektonik të shumë mjediseve dhe elementeve përbërës, ka arritur deri në ditët tona me realizime vlerash arkitektonike, shprehje kjo e aftësive të gjera krijuese të mjeshtrave ndërtues, duke u shquar veçanërisht tek zbukurimorja e dhomës së miqve me punimet në allçi dhe daltimet në dru. Megjithëse, thuajse i vetmi tip që u ndërtua në Shkodër që prej gjysmës së dytë të shek. XVIII e deri nga fundi i shek.XIX qe ai i banesës me çardak, vlerësohet dhe tendenca evolutive drejt zhdukjes së tipit të cilën e shohim qartë në rritjen e numrit të mjediseve që sollën për pasojë humbjen e çardakut si një element bazë të tyre, duke kaluar kështu në një ndryshim cilësor. Evoluimi gradual i banesës me çardak drejt banesës së mbylur shënon etapë me rëndësi në banesën popullore qytetare shqiptare.

Një vend të veçantë, ndër shembujt e banesës shkodrane të shek. XVIII-XIX, zë banesa e Gjyleve[3]. Ajo vjen deri në ditët tona me ndryshime cilësore dhe me një gjendje teknike mjaft të mirë, duke u vlerësuar si një nga banesat më të mëdha shkodrane. Banesa i përket zgjidhjeve më të zhvilluara të variantit me çardak në qendër, i cili paraqet arritjen më të lartë në zhvillimin morfologjik të banesës shkodrane, duke shprehur qartë shkallët e zhvillimit nga banesa e hapur drejt asaj të mbyllur. Banesa është shprehje e një përvehtësimi të qartë të tipareve kompozicionale të banesës shkodrane si dhe realizimit tekniko-konstruktiv dhe arkitektoniko-dekorativ të saj dhe të elementeve përbërës nga mjeshtrat ndërtues. E lidhur me periudhën e fuqizimit ekonomik të një shtrese të gjerë të popullsisë qytetare e cila krahas ushtrimit të tregëtisë dhe zejtarisë është e lidhur me pronën e tokës, ajo plotësonte më së miri kërkesat e borgjezisë së re shkodrane, e cila te ky tip banese vlerësoi mundësitë që i afronte ajo përshtatjes së kushteve të reja, të cilat bëhen të qarta vaçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX.

Banesa ndodhet në pjesën veri-perëndimore të qytetit, në lagjen Kongresi i Përmetit (fig.1). Ajo shtrihet në një truall mjaft të gjerë, e orientuar nga jug-lindja, rrethuar në të katër anët me mure masive guri. Në gjendjen e sotme banesa dhe mjediset ndihmëse që ndodhen brenda mureve rrethuese, kanë pësuar ndryshime, kështu që gjendja origjinale mund të ndiqet nga dëshmi gojore[4]. Reshit Bej Bushati pronar tokash e blen këtë banesë e cila përbëhej nga tre mjedise dhe



Fig. 1

çardaku. M.q.s. ishte familje e madhe dhe kishte dy djem, ai e shton atë duke ndërtuar dy mjedise të dalë në fasadë që i takojnë dy dhomave të mira. Kjo spjegon dhe faktin, se banesa ka dy porta të mëdha hyrjeje me nga një oborr secila. Pronarët e sotëm që janë pasardhësit e tij, i bëjnë një shtesë banesës, që i përket ndërtimit të krahut veri- lindor. Porta e hyrjes, ajo e krahut të majtë (të shikuesit) ndodhur me murin veri-lindor, vlerësohet si porta kryesore e banesës që i përket fazës fillestare të ndërtimit. Ajo është me përmasa të konsiderueshme, trajtuar me mjaft përkujdesje. Po në këtë faqe të murit rrethues në krahun e djathtë ndodhet porta e dytë me të njëjtat përmasa por trajtuar më thjesht. Për atë kohë madhësia si dhe paraqitja estetike e portës së hyrjes në banesë, shërbente si masë gjykimi mbi shkallën e pasurisë së familjes që jetonte atje. Të dyja këto porta të cilat dalin në rrugën kryesore, si mjaft shembuj të tjerë ekzistues në Shkodër, nuk e shohin ballin e banesës, por i rrijnë asaj prapa duke e fshehur atë nga rruga. Kjo spjegohet me fenomenin e fanatizmit dhe njëherazi të sigurisë së banesës, të cilat ishin aktuale për atë periudhë kohe.

Nëpërmjet portës së parë kalohet në një oborr jo të madh i cili me anë të një deriçke lidhet me oborrin që shërben direkt me banesën ndodhur ky para saj.

Në oborrin e parë, ndodhet një ndërtim me një kompozim të thjeshtë me kat i përbërë nga dy mjedise me lartësi të ndryshme. Sipas dëshmish gojore mjedisi më i lartë ka qenë "kulla e sanës" ndërtuar që në fazën fillestare të banesës. Pjesa më e ulët që i rrin asaj në krah ka qenë "jerevia" shtëpi përdhese e cila shërbente si vend ku pronari strehonte miqtë e dorës së dytë apo fshatarë të ardhur dhe njëherazi shërbente si vend pune për mjeshtrat gjatë stinës së ftohtë të dimrit. Nëpërmjet deriçkës futemi në oborrin e vërtetë të banesës që i rrin asaj gjatë gjithë ballit. Ky oborr ka shërbyer dhe shërben si pemishte dhe kopësht për zarzavatet për familjen. Ai është ndarë në mes me një gardh për tu shërbyer dy familjeve ku në çdo pjesë ndodhet pusi dhe govata për larjen e rrobave, dy elementë të zakonshëm të banesës shkodrane, punuar me blloqe guri dhe qarkuar me kalldrëm gur lumi. Banesa e Gjyleve i përket zgjidhjeve më të zhvilluara të variantit me "çardak" në qendër megjithëse në gjendjen e sotme, çardaku figuron i mbyllur dhe i ritrajtuar si pasojë e transformimeve që ka pësuar në kohë. Skema e kompozimit planimetriko-volumor, formohet nga një sistem blloqesh guri të vendosur kronologjikisht duke ardhur së pari blloku qëndror drejtkëndor pastaj vjen ndërtimi i dy blloqeve të dala para si dhe atij fundor dhe në fund vjen ndërtimi i bllokut veri-lindor (fig.2). Terreni i rrafshët, karakteristik për qytetin e Shkodrës me zhvillim e dy kate të të gjithë blloqeve ka bërë që banesa të ruajë një nivel lartësie në përshtatje me mjedisin rrethanor. Në bllokun qëndror kemi bërthamën qëndrore ndërlidhëse që përbëhet nga hajati, shkallët dhe çardaku. Këtu janë dy hyrjet kryesore për në banesë nga të cilat veçohet ajo e krahut të majtë e cila për nga trajtimi arkitektoniko- dekorativ si dhe mbishkrimi që mbart viti 1893 i cili i përket vitit të ndërtimit, tregon se ka qenë e vetmja hyrje për në banesë duke i koresponduar fazës së mbylljes së hajatit.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 2

Banesa në katin përdhe ka hajatin, sot të ndarë në mes, dhe tre ahure, dy nga të cilat përbëjnë bllokun qëndror si dhe i treti atë të bllokut të krahut të majtë. Në bllokun e dalë të krahut të djathtë ndodhet një mjedis ndenjeje e ashtuquajtur "sobë", ndërsa në bllokun fundor ndodhet qilari i ashtuquajtur "qileri", një mjedis ndihmës i banesës, trajtuar në lartësin e dy kateve. Ahuret dhe mjedisi i banimit lidhen midis tyre nëpërmjet hajatit ku ndodhen dy palë shkallë që të ngjisin në çardak. Çardaku i cili zë gjithë sipërfaqen mbi hajat trajtohet i mbyllur i ndarë në mes dhe i transformuar në katër mjedise banimi. Në mënyrë mjaft funksionale ai realizon ndërlidhjen midis mjediseve të banimit të cilat kanë një vendosje simetrike ndaj ndarjes së tij. Anash në të dy krahët e tij ndodhen dy dhomat e miqve që i përkasin dy blloqeve të dalë. Prapa çardakut, gjatë gjithë faqes gjatësore të tij janë vendosur në qendër oda e zjarrit dhe në të dy krahët e saj dy dhoma banimi të cilat përbëjnë bllokun qëndror kënddrejt. Po ashtu banesa ka të bashkangjitur bllokun veri-lindor me hyrje më vete e cila del në oborrin e parë të ndodhur në krahun e majtë të banesës. Këtu në katin përdhe kemi një mjedis banimi dhe dy anekse të vogla. Nëpërmjet dy palë shkallëve kalojnë në katin e sipërm ku ndodhen dy mjedise banimi dhe nje aneks i vogël. Vërejmë se kjo pjesë e banesës nuk përmban vlera tipologjiko-arkitektonike.

Programi i banesës së Gjyleve, si një nga banesat më të zhvilluara të tipit me çardak, përmbledh të gjithë funksionet jetësore për kohën kur ajo u ndërtua si pasqyruese e drejtpërdrejtë e kushteve ekonomike-shoqërore me një ndarje të dallueshme funksionale sipas kateve, ku kati përdhe është i pa banuar, ndërsa kati i parë i banuar. Megjithëse është banesë dyfamiljare ajo përfshin një numër të caktuar mjedisesh me funksione të përcaktuara si dhe skemë kompozicionale të kristalizuar që janë shkallë zhvillimi nga varianti i thjeshtë drejt atij të zhvilluar.

DO NOT COPY

Mjediset bazë të banesës shkodrane të cilat i gjejmë dhe në banesën e Gjylajve janë: oda e zjarrit, dhoma e miqve, ahuri dhe hajati. Mjediset e tjera përsërisin skemën kompozicionale të dhomës së miqve, por me një trajtim dhe dekor më të thjeshtë.

Epiqendra e kompozimit funksional të banesës rreth së cilës vendosen mjediset e tjera është oda e zjarrit e ashtuquajtur "akshiane". Për shkak të trajtimit të varfër ku shumica e këtyre mjediseve është ritrajtuar në banesën e Gjyleve, për fat, ky mjedis ka mbetur pothuaj origjinal ku gjurmët e elementeve përbërës, japin mundësinë e studimit të tij. Për vetë programin e kufizuar që ka patur, përgatitjen e ushqimit, program i cili është ruajtur deri në ditët, tona duke garantuar kështu dhe mosprekshmërinë e këtij mjedisi, ai trajtohet mjaft varfër përsa i përket elementeve përbërës. Ai është më përmasa më të vogla se mjediset e tjera të banimit dhe në gjendjen e sotme vjen i ndarë pothuaj në mes, me një perde të hollë duke krijuar dy mjedise, atë të ndejtjes në pjesën e përparme i cili ka lidhje direkte me çardakun, dhe atë të gatimit në pjesën e pasme i cili ka lidhje me qilerin. Sipër derës kemi një dritare fikse dhe po në këtë faqe, bri derës ndodhet një nike në mur. Në faqen e djathtë ndodhen dy nike që kanë qenë dollape, ndërsa në faqen përballë, duken gjurmët e një trapazani. Pjesa e gatimit në faqen e pasme ka oxhakun dhe në të dy muret anësore në pjesët fundore të tyre janë gjurmët e dy kalimeve të murosura. Oda e zjarrit ndriçohet nga baxha e ndodhur në mesin e saj. Një element karakteristik që shërbente për ndriçim dhe veçanërisht për tërheqjen e tymrave.

Çardaku është një mjedis sa i zakontë aq dhe i veçantë i banesës shkodrane. Kompozimi i tij planimetriko-volumor si dhe arkitektonik në tërësinë kompozicionale të banesës është faktor përcaktues në tipologjinë e banesës shkodrane të shekullit XTII-XIX[5]. Përmasat e tij të mëdha në variantet e ndryshme, e konsiderojnë atë si një mjedis të dorës së parë i cili krahas funksionit të ndërlidhjes veçanërisht gjatë stinëve të ngrohta merr dhe funksione banimi. Për vetë karakterin e ekonomisë së kohës, ai konsiderohej si vend pune ku përpunoheshin produktet bujqësore si dhe bëhej përpunimi i krimbit të mëndafshit mjaft e përhapur në atë periudhë në Shkodër. Njëherazi ai duhet konsideruar si sipërfaqe rezervë për familjen ku sipas nevojës krijohen mjedise të reja banimi. Këtë përshtatje e gjejmë dhe tek banesa e Gjy1eve çardaku i së cilës në gjendjen e sotme, nga një sipërfaqe pothuaj e barabartë me pjesen tjetër të banimit, për bllokun qëndror, është zvogëluar si pasojë e ndërtimit në të, të katër mjediseve.

Kështu çardaku ka humbur një sërë funksionesh, por ka forcuar atë të ndërlidhjes. Sot, çardaku trajtohet i ndarë në mes me një zgjidhje simetrike të mjediseve të katit të banuar duke përjashtuar bllokun veri-lindor. Si pasojë e krijimit të familjeve të reja, me hyrje të veçanta, çardaku tashmë nuk ndërlidh mjediset e bllokut qëndror. Funksionon vetëm lidhja me odën e zjarrit e cila del në krahun e djathtë të tij. Po ashtu respektivisht për të dy krahët, çardaku siguron lidhjen me dhomat e miqve dhe mjediset e përshtatura në të. Në krahun e djathtë të çardakut dallojmë dhe një hyrje për dhomën e miqve vendosur bri derës, e cila siguron lidhjen direkt me trapazanin. Të dy çardaqet komunikojnë me hajatin me shkallë dyrampeshe druri. Në krahun e djathtë, çardaku ruan një dritare me përmasa të konsiderueshme mbrojtur me telajo hekuri, e cila i korespondon mjedisit të përshtatur në këtë krah. Teknika e vjetër e punimit, si dhe hapësira që zë në gjithë ballin e çardakut na bën të mendojmë se kjo ka qenë dritarja origjinale, në fazën e mbylljes ku çardaku ka qenë i trajtuar me katër dritare të tilla.

Mjedisi më paraqitës dhe njëherazi nga më të shquarit e banesës shkodrane është dhoma e miqve për të cilën është shpenzuar më tepër dhe me të cilën krenohet familja e vjetër shkodrane. Në dhomën e miqve i zoti i shtëpisë pret miqtë e

nderuar, shtron darka për nder të tyre dhe natën ajo shërben edhe si dhomë gjumi për ta. Shpesh herë ajo shërben dhe si vend pune ku lidheshin marrëveshjet tregtare. Banesa e Gjyleve duke qenë në një fazë të caktuar banese dyfamiljare, ka dy dhoma miqsh të cilat zejnë dy volumet e dalë në të dy krahët e çardakut. Ato kanë të njëjtën skemë kompozicionale duke u vlerësuar ajo e krahut të djathtë e cila dallon për një trajtim më të pasur arkitektoniko-dekorativ të elementëve përbërës.

Volumi i dhomës së miqve formohet nga tre pjesë: Pjesa e përparme, e cila zë volumin kryesor të dhomës ku zhvillohet gjithë aktiviteti mikpritës, ka tavan dekorativ, dritare të shumta në të tre faqet e saj, një ose dy rafte të vendosura në dy muret anësore si dhe sergjenet, një element zbukurues prej druri që i vjen rreth e qark dhomës në tre faqe. Në faqen në ballë, mes dy dritareve ndodhet oxhaku i dekoruar me motive floreale i derdhur në allçi. Në pjesën e hyrjes ndodhet volumi musandër-trapazan i trajtuar në dy kate ku në pjesën e poshtëme ndodhet musandra për vendosjen e rrobave të natës, si dhe vendi i arkës së nuses, e vetmja paisje e dhomës. Nëpërmjet një dere e ndodhur në skajin tjetër, futemi në volumin e tretë të dhomës së miqve që është nyja sanitare e përfshirë në volumin fundor drejtkëndor të mjedisit. Ajo përbëhet nga tre pjesë, wc, hamami, vendi për larjen e duarve dhe hamamxhiku vendi i larjes së trupit, një konstantë kjo për të gjitha nyjet sanitare, karakteristike për banesën shkodrane. Edhe dy mjediset e banimit të ndodhura në të dy krahët e odës së zjarrit ku ai i krahut të majtë për nivelin dekorativ vlerësohej si dhoma e miqve e emërtuar sipas të thënave gojore "oda e të zotit të shtëpisë dhe e djemve" ndërsa ajo e krahut të majtë e emërtuar "oda e pleqve dhe e vajzave", përsërisin pothuaj të njëjtën skemë kompozicionale të dhomës së miqve duke u diferencuar nga ajo përsa i përket teknikave të ndryshme të elementëve përbërës. Këtyre mjediseve u mungojnë oxhakët si dhe nyjet sanitare si pasojë e ndërhyrjeve në kohë. Në dhomën e miqve si përgjithësisht në mjediset e banimit, nuk hyhet direkt nga çardaku, po nëpërmjet një parahyrjeje të vogël dhe të ulët e cila ndodhet nën trapazan. Prej këtu nëpërmjet një hapësire si derë futemi në dhomën e miqve. Qëllimi i parahyrjes është mbrojtja e mjedisit nga të ftohtit dhe njëherazi shërben si vend për heqjen e këpucëve, zakon i vjetër shkodran.

Ahuri është një mjedis i zakontë i banesës shkodrane. Për vetë karakterin e ekonomisë së kohës ashtu si dhe çardaku, kur ekonomia familjare ishte e detyruar të plotësonte nevojat kryesore të familjes për produkte ushqimore, ahuri ka shërbyer si vend për depozitimin e produkteve bujqësore dhe rezervave ushqimore. Shpesh herë aty instaloheshin dhe paisje pune. Të gjitha ahuret lidhen me hajatin me anë të një dere të vetme dhe ndriçohen nga një ose dy dritare të vogla, mbrojtur me hekura. Nga tre ahure që ka patur banesa e Gjyleve, ruhet në gjendje pothuaj origjinale ahuri i krahut të majtë të bllokut qëndror, i ndarë në gjendjen e sotme me një perde të hollë, ndërkohë që dy ahuret e tjerë janë transformuar me synimin e përshtatjes në mjedise banimi. Ky ahur me sipërfaqe të konsiderueshme duke e përfshirë sipërfaqen e dhomës së miqve dhe atë të odës së zjarrit të vendosura sipër tij, është një mjedis i pasuvatuar, pa tavan dhe përdhes. Në mesin e tij ndodhet një kollonë masive guri për mbështetjen e konstruksionit të dyshemeve. Dera origjinale që dilte në hajat është murosur dhe është hapur një e re e cila del në hajatin e krahut të djathtë duke i koresponduar pjesës së djathtë të ahurit. Ndërsa për pjesën e majtë të ahurit, është hapur një derë në faqen anësore që lidhet me mjedisin e jashtëm.

Hajati është mjedisi i parë me të cilën bie në kontakt njeriu sapo hyn në banesën shkodrane. Ai që të njëjtën sipërfaqe me çardakun dhe lind si pasojë e domosdoshme, qënies së tij. Nga ana funksionale, hajati është konsideruar si një mjedis ndihmës për ekonominë familjare për përpunimin,

DO NOT COPY

tharjen dhe depozitimin e produkteve bujqësore. Përgjithësisht në variantet e banesës shkodrane ai trajtohet i hapur por në banesën e Gjyleve hajati është trajtuar i mbyllur, konsideruar kjo si fazë ndërtimi e tij. Në gjendjen e sotme hajati është i ndarë në mes me një mur të plotë duke i koresponduar ndarjes së çardakut për tu shërbyer dy familjeve. Të dy pjesët e hajatit sigurojnë lidhje direkte me oborrin para banesës ku veçojmë të vetmen hyrje origjinale të banesës atë të krahut të majtë, ndërkohë që ajo e krahut të djathtë është hapur më vonë. Dera origjinale është trajtuar me mjaft përkujdesje duke mbartur në pjesën e sipërme të kornizës stemën e gjysmës së hënës me yllin pranë si dhe vitin e ndërtimit. Sot hajati ndriçohet nga dritare, nga ajo origjinale e krahut të majtë me dimensione të vogla mbrojtur me zgarë hekuri dhe ajo e krahut të djathtë me dimensione të mëdha hapur më vonë. Në krah të djathtë të derës origjinale duken gjurmët e një dritareje të murosur. Hajati i krahut të djathtë është ruajtur i pasuvatuar, përdhes dhe pa tavan, ndërkohë që ai i krahut të majtë është ritrajtuar duke e përshtatur në një mjedis të vogël ndejtjeje. Të dy pjesët e hajatit lidhen me çardakun me shkallë druri.

Në banesën e Gjyleve si rast të veçantë, takojmë në katin përdhe një mjedis banimi i cili ndodhet poshtë volumit të dhomës së miqve të krahut të djathtë. Ky mjedis, i ashtuquajturi "sobë" ka shërbyer si vend qëndrimi për familjen gjatë stinëve të ftohta të vitit. Ai ruan të njëjtën skemë kompozicionale me atë të dhomës së miqve. Duke qenë një mjedis i ulët, atij i mungon pjesa e sipërme, trapazani, ndërkohë që musandra trajtohet mjaft thjesht, pa gdhendje dhe pretendime të tjera estetike. Në faqen përballë musandrës ndodhet vatra, një e thelluar në mur dhe anash saj dy dritare mbrojtur me telajo hekuri punuar nga jashtë me korniza suvaje. Mjedisi ka një tavan të thjeshtë dërrase ku mungojnë trekendeshat dhe rozetat.

Qilari, mjedis ky jo i zakontë i banesës shkodrane, përbën bllokun fundor të banesës, ndërtimi i një faze të ndërmjetme. Ai zhvillohet në lartësinë e dy kateve dhe ka kryer funksione ndihmëse si vend gatimi dhe depozitimi të produkteve ushqimore. Në gjendjen e sotme ai është i ndarë në mes me një mur të plotë për tu shërbyer dy familjeve. Krahu i djathtë ruhet në gjendje origjinale, ndërkohë që ai i majti ka pësuar rikonstruksion të plotë, si pasojë e shtimit dhe ndarjes së familjes. Ky krah është përshtatur në një korridor me hyrje të veçantë që del në oborrin veri-perëndimor të banesës, si dhe në një mjedis të vogël ndejteje. Me anë të tre këmbë shkallëve kalohet te rrugina e ndodhur në mes të odës së zjarrit dhe mjedisit të banimit të krahut të majtë duke siguruar lidhjen me të. Krahu i djathtë i qilarit, për funksionet e veçanta që kryen, trajtohet krejtësisht ndryshe nga mjediset e tjera. Ai është mjaft i lartë, pa tavan, i pasuvatuar dhe me dysheme shtruar me rrasa guri. Në faqen e pasme ndodhet sqolli për larjen e enëve i ngritur një metër nga toka, ndërsa në faqen e djathtë një furrë ku gatuhej dhe sipër saj një dollap i futur si nike në mur. Po në këtë faqe ndodhen gjurmë të dy dritareve të murosura të vendosura në lartësi të ndryshme. Sot qilari ndriçohet nga një dritare e vetme me përmasa të konsiderushme e cila sheh në rrugë. Ai lidhet me odën e zjarrit duke u ngjitur tre këmbë shkallë dhe nëpërmjet saj del në çardak.

Banesa e Gjyleve si shumica e banesave të vjetra të tipit me çardak, është ndërtuar me një teknikë të mirë ndërtimi për vetë faktin se vjen deri në ditët tona mjaft solide veçanërisht në punimet e gurit, duke përmendur dhe ato të drurit, në brendësi të saj. Ajo ka një skemë konstruktive. Dy muret mbrojtës të vendosur paralel me çardakun si dhe ato të mjediseve të tjerë me gjerësi 60 cm janë të ndërtuar me gurë kave dhe llaç gëlqeror pa ndryshuar seksionin e tyre gjatë dy kateve. Kjo muraturë shkodrane ka një karakteristikë teknike që e dallon nga ajo e qyteteve të tjera të Shqipërisë së mesme dhe të jugut, sepse ajo ndërtohet e pa lidhur me breza druri dhe fortësia e murit spjegohet me përdorimin

DO NOT COPY

DO NOT COPY

e gëlqeres si material lidhës. Muret rrethues të avllisë janë ndërtuar me gur lumi dhe llar, gëlqere të varfër. Gjerësia e tyre shkon 50 cm dhe lartësia deri pesë metra. Ndarjet e brendëshme ato të trapazanit dhe të rruginave tek dhomat e miqve dhe të banimit janë realizuar me struktura të lehta si skelet druri veshur me parete të holla dërrase, suvatuar në të dy anët, ose thjesht dërrasa të holla fiksuar mbi binarë dërrase në një anë. Teknikën e skeletit të drurit e gjejmë dhe në çardak tek muri ndarës, tek muret e mjediseve të krijuara dhe te faqja ballore e tij, ndërtime këto të një faze të mëvonëshme. Ndarja e hajatit dhe e qilarit në mes, si dhe ndarja e ahurit të majtë të krahut të dalë në mjedise banimi, janë realizuar me mur tulle të plotë 60 cm, ndërsa ndarjet e tjera të tyre janë realizuar po me mur tulle, po 25 e 12 cm (gjë që vërteton se janë të vona). Muret e brendëshme të banesës janë të gjitha të suvatuara me përjashtim të atyre të ahureve dhe qilarit, ndërkohë që hajati është suvatuar më vonë. Teknikë më të vjetër suvatimi kanë tre mjediset e bllokut qëndror, ku vlerësohet ajo e krahut të majtë, si dhomë e miqve që është e patinuar me gëlqere përzier me fije leshi. Përgjithësisht muret e jashtëm të banesës shkodrane nuk suvatohen. Po në banesën e Gjyleve si pasojë e ndryshimeve që ka pësuar ajo në kohë, dhe pamjet e saj kanë pësuar ritrajtim. Vlerësojmë teknikën e murit të gurit të bllokut të dalë të krahut të djathtë, ndërtuar me gurë kave vendosur në rrjeshta paralele e cila spikat për ashpërsinë dhe ftohtësinë e saj. Blloku i krahut të majtë, si dhe pamja anësore e këtij krahu të banesës ruan teknikën origjinale me fugaturë guri duke krijuar vende-vende një shtresë suvaje, ndërsa faqet e tjera të banesës si pjesërisht ajo ballorja, ajo e krahut të djathtë të banesës ku hyn dhe blloku veri-lindor janë suvatuar me kohë. Tek pamja ballore vërejmë se pjesa e hajatit ku ndodhet hyrja kryesore për në banesë, nuk është e suvatuar dhe muratura e saj ka të njëjtën teknikë me breza paralel, si ajo e bllokut të dalë të krahut të djathtë. Shtresat e të gjitha mjediseve në kat janë me dërrasa të plota, të afruara mbërthyer mbi trarët e dyshemesë. Në dhomën e miqve të bllokut qëndror dërrasat janë mbërthyer me gozhdë kovaçi, një teknikë mjaft e herëshme kjo.

Çatia e banesës është e tipit vendas, ndërtuar me lëndë dhe mbuluar me tjegulla. Me interes është çatia e çardakut, konstruksioni i së cilës paraqet një skemë mjaft të qartë dhe racionale. Mbi shtyllat e çardakut me dimensione 20x20 cm kalon brezi i parë i traut 20x20 cm mbi të cilin mbështet trarët e plotë të tavanit 16x16 cm të vendosur çdo 1, 8-2 m. Mbi to kalon trau 10x10 cm i dhëmbëzuar i cili krijon mundësinë e vendosjes së binarëve vertikal, baballëkëve, 10x8 cm të cilët krijojnë pjerrësinë e çatisë. Baballëkët lidhen tërthor me binarë 8x8 cm duke krijuar një platformë për vendosjen e bishtave të gdhendur 5x7 cm të vendosur çdo 25 cm ku përfundimisht shtrohen patavra të ashtuquajtura pullazina për vendosjen e tjegullave. Strehët në banesën e Gjyleve si përgjithësisht në banesën shkodrane të shek. XIII-XIX janë mjaft të dala. Për dy mjediset e dalë në ballë, ato shkojnë deri 1,8 m, (fig.3) ndërsa për mjediset e tjera shkojnë 1,2 m.



Fig. 3

Në qoshe ato zhvillohen në formë harku duke ruajtur të pandryshuar madhësinë e daljes nga

muratura. Vende-vende streha është shkurtuar deri tek brezi i dhëmbëzuar për arsye të kalbjes së materialit drurësor.

Shkallet e banesës së Gjyleve janë shkallë të thjeshta dy rampeshe ku këmbët e para janë prej guri dhe rampa tjetër prej druri. Teknika e ndërtimit të tyre tregon se janë ndërtime të vona.

Dyert në banesën e Gjyleve kanë formë dhe teknikë të ndryshme, në vartësi të kohës dhe destinacionit kujt mjedisi i përkasin. Porta e hyrjes për në banesë ajo e krahut të majtë, vlerësuar si porta fillestare e banesës ka një trajtim dhe dekor të veçantë (fig.4) që tregon për një përkujdesje të mjeshtrit, sipas porositësit, për



Fig. 4

një përfaqësim sa më dinjitoz për vizitorin që në momentin e parë të hyrjes për në banesë. Porta është dy flegërshe druri, punuar me mjaft shije me fashatura që formojnë figura të ndryshme gjeometrike mbërthyer me gozhda kovaçi. Hapësira e saj mbulohet me një arkitra druri formë ½ rrethore mbështetur mbi dy pilastra guri të cilat përkufizojnë hapësirën e portës. Balli i qemerit si dhe streha e dalë e çative mbështeten mbi dy mure guri të dalë jashtazi saj ku janë vendosur dy kamare të ulta prej guri, simbole të mikpritjes shkodrane. Porta e krahut tjetër (fig.5) ndërtuar në një fazë më të vonë, ka të njëjtat



Fig.5

përmasa por ndryshon në trajtimin dekorativ dhe atë konstruktiv. Flegrat e portës janë të punuara me dërrasa të thjeshta vertikale qarkuar dhe ndarë me pesë hapësira me fashatura të punuara, duke maskuar gozhdat e kovaçit. Hapësira e portës mbulohet me një arkitra guri ½ rrethor. Pilastrat e portës si dhe muret e dalë jashtë saj janë punuar me teknikën e daltimit të gurit; këtu mungojnë kamaret.

Trajtim të veçantë arkitektonike-dekorativ si një rast i veçantë për banesën shkodrane (fig.6) ka dera e hyrjes në hajat. Flegra e derës është e punuar me teknikën e njohur me zemra që



Fig. 6

DO NOT COPY

DO NOT COPY

formojnë motivin e syastikës. Mbuluar me qemer guri ajo është e gjitha e kornizuar brenda një sipërfaqe katërkëndëshi këndrejt, daltuar në gur, që përfundon me një kornizë të daltuar në suva. Në pjesën e harkut ndodhet simboli i gjysëmhënës dhe ylli i Davidit, ndërsa në qendër, në pjesën e sipërme brenda sipërfaqes së daltuar është skalitur viti i daltimit 1893. Vërejmë se e njëjta teknikë e kornizimit të derës, është dhe për dy dritaret e hajatit (fig.7), me ndryshim se sipërfaqja e kornizuar vjen e suvatuar.



Fig. 7

Dyert e të gjitha mjediseve të banimit të banesës së Gjyleve si përgjithësisht në banesën shkodrane, janë njëflegërshe druri. Të gjitha kanë të njëjtin konstruksion me dërrasa të afruara vertikalisht lidhur me binarë në pjesën e pasme mbërthyer me gozhdë e pafte kovaçi. Dyert e mjediseve të banimit në dallim nga ato të ahureve, kornizohen në pjesën e sipërme me një dërrasë në formë harku e cila së bashku me flegrën e derës trajtohen në forma të ndryshme në funksion të mjedisit kujt i përkasin. Në këtë aspekt, vlerësojmë derën e hyrjes për në dhomën e miqve të krahut të djathtë, dalë në çardak (fig.8) e cila është punuar me mjaft mjeshtëri në fushën e daltimit të drurit me fashatuara të punuara dhe gdhendje të aplikuara, në dallim me atë të krahut



Fig. 8

përballë, e cila trajtohet me varfer përsa i përket dekorit. Dy dyerve të mjediseve të bllokut qëndror, ato në krah të majtë të odës së zjarrit, u mungon krejtësisht dekori dhe fashaturat e punuara. I vetmi zbukurim i tyre është fashatura e sipërme e derës që vjen në formë harku. Dera e odës së zjarrit, një përshtatje e vonë kjo, ka një teknikë tjetër duke ardhur në pjesën e sipërme me xham. Të gjitha dyert janë të pajisura me prag. Hapësira e dyerve të ahurit është e mbuluar me qemer që vjen në formë harku gjysëm rrethor, ndërsa ajo e dyerve të banimit me arkitra druri.

Dritaret në banesën e Gjyleve ruajnë formën dhe teknikën e punimit si përgjithësisht në banesën shkodrane, duke u mbuluar gjithmonë me arkitra. Në ahur, dritareve u mungon telajo e xhamit, ndërsa për mjediset e banimit, krahas telajos së xhamit, pjesë përbërëse e saj janë dhe kapakët e drurit të ashtuquajtura "kapakët e territ" të cilat sipas rastit janë të thjeshta ose të daltuara. Dritarja e përbërë nga dy kanata që lëvizin horizontalisht gjithmonë si jashtë ashtu dhe brenda konturohet me fashatura druri. Të gjitha dritaret sigurohen nga jashtë me hekura, punuar me teknikë dhe forma të ndryshme në përshtatje me mjedisin ku qëndrojnë. Kështu ato të ahureve janë thjesht zgarë hekuri (fig.9) ndërsa ato të mjedisit të banimit, ku dallohet dhoma e miqve e krahut të djathtë, janë punuar me hekur të rrahur me motive të ndryshme floreale realizuar me mjaft mjeshtëri. Për teknikën e veçantë dhe dimensione të konsiderueshme, dallohet dritarja e çardakut, e cila lëviz vertikalisht brenda konstruksionit të saj, mbrojtur me zgarë hekuri (fig.10).



Fig. 9



Fig. 10

Banesa shkodrane me çardak e shek.XIII-XIX shquhet për daltimet në dru dhe me një punim mjaft të arritur arkitektonik-dekorativ të shumë elementeve përbërës si trapazani, tavani, dyert, dollapet e murit, kapakët e dritareve dhe elementë të tjerë duke vlerësuar ato të dhomës së miqve.

Trapazani zë gjithmonë faqen e hyrjes së dhomës së miqve (fig.11) apo mjediseve të tjera të banimit. Ai është i punuar i gjithi në dru dhe i ndarë në dy kate. Në dy dhomat e miqve të krahut të dalë ky volum, ka një skemë planimetrike të njëjtë e cila ndryshon nga ajo e mjediseve në krah të odës së zjarrit. Nga një tambur i vogël dhe i ulët, futemi në hapësirën e hyrjes për në dhomë e cila ndodhet në mesin e perdes që kufizon dhomën në skajet anësore të së cilës ndodhen dy rafte të ashtuquajtura "açik rafte" (fig.12). Një korridor i ngushtë ndan këtë perde nga musandra, vendi i arkës së nuses dhe në fund dera që komunikon me nyjen sanitare që është pjesa përbërëse e

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12

kompleksit të dhomës. Në të dy krahët e trapazanit ndodhen shkallët e vogla të drunjta të maskuara që të ngjisin lart në trapazan. Musandra shërben kryesisht për të vendosur shtresat e fjetjes që i përkasin mysafirëve që flejnë natën aty. Trapazani është një mjedis i ulët me tavan të thjeshtë dërrase. Ai sheh në dhomë me tre dritare të vogla paisur me kafaz druri që shfrytëzoheshin në raste festash apo dëfrimi nga vajzat dhe gratë të cilat duke qëndruar aty, mund të shihnin pa u vënë re nga burrat, çdo gjë që zhvillohej rreth e qark. Trapazani merr dritë nëpërmjet dy dritareve të vogla që dalin në pamjen anësore. Në mjediset e banimit të bllokut qëndror; të vendosura në të dy krahët e odës së zjarrit, në mjedisin e krahut të majtë vlerësuar si dhoma e miqve, elementi trapazan-musandër ka një kompozim të ndryshëm planimetrik nga ai i përshkruar më sipër. Mungon korridori i vogël ndërlidhës, vetë balli trapazan-musandër është ai që përkufizon dhomën dhe trapazani trajtohet në formën e pesë hapësirave në formë llozhe shoqëruar me nga një parapet të ulët krijuar me listela të vendosura kryq. Në pjesën e poshtëme, në të dy skajet, kemi dy rafte të ngushtë dhe pastaj vijnë respektivisht dera e hyrjes për në dhomë dhe ajo e komunikimit me nyjen sanitare duke u vendosur në qëndër musandra dhe vendi i arkës së nuses. Këtu mungojnë shkallët e drunjta për tu ngjitur në trapazan të cilat zëvendësohen me kapanxha të instaluara në dyshemenë e trapazanit për tu përdorur me shkallë portative druri. Në dallim nga trapazanët e sipërpërmendura, ai i dhomës së krahut të djathtë, ka një trajtim të veçantë në katin e sipërm ku balli trajtohet i mbyllur me mur. Muratura është e ndërprerë nga gjashtë pilastra të kurorëzuara me kapitel në të cilat mbështeten konstruksionet e pesë harqeve, hapësira e të cilave trajtohet me piktura e peisazhe të ndryshme me ngjyra të forta ku spikat bluja, jeshilja dhe e verdha. Pjesa e poshtme e trapazanit është realizuar me një perde të hollë dërrase në mes të së cilës ndodhet hapësira

e hyrjes në dhomë dhe anash ndodhen dy dritare të vogla fikse me xhama që vështrojnë nga korridori i krijuar si pasojë e trapazanit lart.

Tavani është një element i rëndësishëm arkitektoniko-dekorativ i banësës shkodrane (fig.13). Ai përdoret vetëm në mjediset e banimit të katit të sipërm duke mos përjashtuar dhe mundësinë në mjediset e banimit të katit përdhe,



Fig. 13

siç është rasti në banesën e Gjyleve. Në të gjitha rastet, ai ka formën e një katërkëndëshi këndrejt, brenda të cilit formohet një tetëkëndësh barabrinjës ku, në të katër qoshet e tij krijohen trekëndësha dy barabrinjës. Përgjithësisht në qendër të tavanit vendoset rozeta nga e cila varet lampadari karakteristik që ndriçon dhomën. Ndër dy tavanet e dy dhomave të miqve që dalin në krah të çardakut, vlerësojmë ato të krahut të djathtë i cili shquhet përsa i përket dekoracionit të aplikuar në reliev të thellë. Tetëkëndëshi i formuar me faqe të pjerrta nga brenda, e fut paksa më brenda fushën e tavanit, në mes të së cilës është vendosur një rozetë (fig.14) që vjen në formë të rrumbullakët e përbërë nga disa rozeta me diametër më të vegjël, punuar me ornamente floreale të motivit të hardhisë. Nga rozeta qëndrore shpërndahen në të gjitha drejtimet e fushës disa kordonë të dallgëzuar të



Fig. 14

cilët përfundojnë rreth e qark fushës me një fashaturë të gdhendur. Trekëndëshat, me korniza të dala nga sipërfaqja e fushës janë të mbushura me daltime, punuar me mjaft shije pa përsëritur njëra-tjetrën. Gjithë kjo fushë, qarkohet me tre fashatura të gdhendura të cilat përfundojnë me një kornizë të vogël në formë azhuri, duke realizuar estetikisht lidhjen e tavanit me kornizën harkore prej suvaje të faqes së murit. Tavani i dhomës së miqve të krahut të majtë, trajtohet me një shkallë (fig.15) më të ulët përsa i përket dekoracionit, ndërkohë që vlerësohet ai i realizimit tekniko-artistik të



Fig. 15

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 16

rozetës. Ajo trajtohet (fig.16) në formën e një pjatance të përmbysur e përbërë në vetvete nga një rozetë e vogël qëndrore dhe pjesa tjetër vjen e ndarë në gjashtë sektorë rrethorë. Buza e kthyer trajtohet në formë azhuri me motive floreale. Fusha e tavanit vjen e ndarë me çibuk druri duke formuar figurën e rombit. Në dallim nga dy tavanet e mësipërme, ato të dy mjediseve të banimit të bllokut qëndror trajtohen mjaft varfër përsa i përket shkallës së dekoracionit dhe punimit estetik të tyre duke u vlerësuar tavani i dhomës së krahut të majtë, gdhendjet e të cilit realizohen me teknikën e daltimit në reliev të cekët, teknikë kjo më e herëshme se ajo e daltimit në reliev të thellë. Tavanit i mungon rozeta dhe kjo spjegohet me mungesën e kohës nga ana e mjeshtrit, mbasi dhe trekëndëshat janë të papërfunduar përsa i përket dekoracionit. Vlen të përmendim tavanin e mjedisit të krahut të djathtë, teknika e realizimit të së cilit ndryshon nga ato të mjediseve të përshkruara më sipër. Ai ruan të njëjtën linjë punimi me atë të trapazanit duke u trajtuar me teknikën e pikturimit mbi dru, po teknikë e hershme. Tavani i mjedisit në katin përdhe, trajtohet thjesht pa dekoracion, duke ruajtur skemën klasike të kompozimit të tavaneve, në dallim se atij i mungon rozeta dhe trekëndëshat.

Punime druri me interes janë dhe ato të dollapeve (fig.17) dhe të kapakëve të dritareve të cilat shquhen në fushën e daltimit të drurit, me një teknikë të realizuar me reliev të thellë me motive floreale. Veçojmë këto elementë, në



Fig. 17

dhomën e miqve të krahut të djathtë për teknikën e lartë të realizimit të tyre ku të bie në sy mospërsëritja e vetvetes nga dhjetë kapakë dritareje që ka dhoma (fig. 18).

Një element tjetër dekorativ i dhomës së miqve është dhe sergjia që kalon horizontalisht në nivelin e sipërm të dritareve dhe dollapit në të tre faqet e dhomës për tu lidhur me atë të

DO NOT COPY



Fig. 18

trapazanit trajtuar me disa fashatura të gdhendura, të cilat shërbejnë për vendosjen e enëve të ndryshme prej bakri dhe prej qelqi të dekoruara. Në të dy qoshet e faqes ballore janë vendosur rafte të vegjël të gdhendur që vijnë në formë trekëndëshi, të ashtuquajtura "polise" të cilat shërbenin për vendosjen e sendeve me vlerë të familjes si tasi i pareve të imta, sahati, fishekë etj.

Dhoma e miqve e banesës shkodrane shquhet jo vetëm për daltimet në dru, por dhe për punimet në allçi, realizuar te oxhakët dekorativ të cilët i gjejmë të ruajtur në të dyja dhomat e miqve të krahëve të dalë, ndërkohë që ato të dy mjediseve të banimit të bllokut qëndror nuk ruhen, (fig.19). Oxhaku vendoset gjithmonë në faqen ballore, përballë trapazanit dhe është elementi më zbukurues i dhomës. Për realizimin artistiko-



Fig. 19

dekorativ, vlerësojmë oxhakun e dhomës së miqve të krahut të djathtë (fig.20), tamburi i të cilit është i punuar me teknikën e derdhjes me kallëpe në allçi, i kurorëzuar i gjithi me plazmime plot fantazi. Anash tij dy pilastra të holla prej allçie që fillojnë nga dyshemeja, zgjerohen mbi nivelin e sergjenit me ornamente floreale realizuar në relievduke qarkuar pjesën e sipërme të tamburit. Në majë ai vjen në formë konike dhe mbaron me një rozetë trajtuar me të njëjtat ornamente. Në brendësi të oxhakut, paksa mbi nivelin e vatrës



Fig. 20

ndodhet një dritare e vogël, e cila shërben për tërheqjen e tymit, kur në vatër është ndezur zjarri.

Spjegimi i qënies së dritares qëndron në faktin se, përgjithësisht oxhaku në banesën shkodrane konsiderohet si një element dekorativ dhe jo funksional mbasi ai nuk ka dalje në çati, veçori kjo të cilën e takojmë dhe në qytete të tjera të Shqipërisë, ndërsa qënia e dritares (fig. 21), duhet konsideruar një karakteristikë lokale e qytetit të Shkodrës.



Fig. 21

Banesa e hapur me çardak me skemën e saj kompozicionale dhe programin që përmban, reflekton traditën, zakone të lidhura këto ngushtë me shtresëzimin shoqëror. Banesa e hapur e Gjyleve me kompozimin e tre mjediseve në kat, vendosur këto rradhazi bri çardakut përbën zgjidhje praktike të funksionit të ndërlidhjes midis mjediseve të banimit, ku në qendër ndodhet oda e zjarrit si bërthama qëndrore e aktivitetit ditor familjar, (fig.22). Ndërlidhja e saj me dy mjediset në krah me anë të tambureve të ulët, krijuar nga vendosja e trapazaneve mbi to, ndërlidhja e dy trapazaneve, atij që sheh në oden e zjarrit dhe tjetrit që sheh në odën e miqve si dhe ndërlidhja e odës së zjarrit me çardakun nëpërmjet rruginës, përbëjnë një lehtësi të madhe dhe komoditet në ditët e ftohta për familjen. Por, do të theksonim se, izolimi i odës së zjarrit nga çardaku si dhe ndërlidhja e dy trapazaneve mjedise këto që frekuentoheshin vetëm nga gratë, duhen konsideruar dhe si ndikime të fanatizmit që zotëronte në atë periudhë.

Kompozimi i mjediseve të banimit për banesën e Gjyleve, respekton normat projektuese të banesës shkodrane të shek. XIII-XIX me kompozimin pothuaj barabrinjës të brinjëve. Dy dhomat e miqve që dalin në çardak kanë raportin e brinjëve 1:1,3 ndërkohë që dy të tjerat të ndodhura në krah të odës së zjarrit, mjedise të fazës së parë kanë raportin 1:1. Oda e zjarrit, në raport me mjediset e tjera ka përmasa më të vogla me raportin e brinjëve 1:1,3. Thjeshtësisë së skemës kompozicionale i përket një program i varfër i cili shfaqet dukshëm në mungesën e orendive dhe paisjeve të ndryshme që i përkasin mjediseve të banimit, dukuri kjo për banesat e kësaj periudhe. Të vetmet orendi ishin arkat e nuseve, dollapet e mureve, sergjitë si dhe musandrat e raftet.

Përgjithësisht banesa shkodrane nuk shkëputet përsa i përket vlerave arkitektonike në trajtimin e pamjeve të jashtme. Vetëm pamja kryesore dallohet për transparencën e saj kushtëzuar nga hajati e çardaku me strehët e gjera. Po ashtu ritmi i dritareve si pasojë e rradhitjes llogjike qarkuar me fashatura druri dhe paisur me zgare hekuri, masat e ftohta të mureve dhe strehët e thella, të gjitha këto të ekuilibruara dhe të rregulluara arkitektonikisht bëjnë efekt

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 22

vetvetiu. Përsa i përket banesës së Gjyleve, ndërhyrjet e fazave të ndryshme në kohë kanë sjellë një disekuilibër në trajtimin e jashtëm arkitektonik të pamjeve të saj, (fig.23). Por, pavarësisht nga kjo, vlerësojmë trajtimin arkitektoniko-dekorativ të pamjes ballore (fig.24) dhe atë të krahut të djathtë (fig.3) ku spikat



Fig. 23

teknika e lartë e dekoracionit të derës së hajatit dhe dritareve të tij, e muraturës së gurit të dhomës së miqve të krahut të djathtë; uniteti arkitektonik i pamjes së djathtë me ritmin e dritareve dhe

krah të odës së zjarrit. Dhoma e krahut të djathtë ka patur lidhje direkte me çardakun me anë të derës, sot e murosur (fig.26) gjurmët e së cilës dalin në hyrje të shkallës ekzistuese. Po ashtu, gjurmët e dritareve të murosura të ndodhura mbi të dy dyert në krah të odës së zjarrit, të cilat u përkasin dy trapazaneve të vendosura mbi rruginat komunikuese, tregojnë se trapazanet merrnin dritë nga çardaku. Me ndërtimin e shtesës veri-lindore kjo dhomë iu përshtat asaj me transformimin e dritares së krahut te majtë në derë për komunikim. Vrojtimi me kujdes që iu bë pamjes së jashtme të këtyre dy dhomave nxorri në dritë gjurmë të dritareve të mbyllura mbi ato anësore (fig. 27) si dhe gjurmë të muraturës së dalë të oxhakut) mbi dritaren e mesit. Këto gjurmë hedhin dritë mbi faktin se, të dy dhomat kanë pësuar rikonstruksion



Fig. 27

të faqes ballore, e cila me mbylljen e oxhakut dhe dritareve të sipërme, ka ritrajtuar dritaret duke i zmadhuar dhe pajisur ato me zgarë hekuri punuar me motive. Po ashtu vërejmë se, ndërtimi i qilarit në pjesën e pasme të banesës, solli prishjen e dy nyjeve sanitare të dy dhomave që dilnin në formë xhepi duke ruajtur hapësirat e dyerve për komunikim me të. Transformime kanë ndodhur gjithashtu në hajat dhe çardak. Hajati ka qenë një hapësirë e plotë pa asnjë ndarje, në mesin e së cilës ka qënë një kollonë masive guri e cila sot bën pjesë në murin ndarës që është ndërtim i mëvonshëm. Hajati komunikonte me mjedisin e jashtëm me anën e një porte njëflegërshe druri dhe merrte dritë nga dy dritare të vogla mbrojtur me hekura, ku ajo e djathta sot është e murosur. Të tre këta elementë janë punuar me mjaft shije me teknikën e kornizimit në suva. Teknika e ndryshme e punimit të dyerve si dhe të suvasë të ahurit të dalë në krahun e majtë si dhe të baninit të mjedisit në katin përdhe me ato të dy ahureve të vendosura përgjatë hajatit, vërtetojnë idenë se, këto ndërtime janë të vona dhe se fillimisht hajati shtrihej përgjatë dy ahureve duke komunikuar me një derë për secilën.

Banesa e Gjyleve ka patur një shkallë të vetme masive guri. Gjurmët e gjetura në hajat hedhin dritë mbi përmasat dhe teknikën e saj. Shkalla ka qenë një rampeshë me gjatësi 1,8 m e vendosur bri portës së hyrjes në hajat si dhe kollonës masive guri. Ngjitja realizohej nga e majta në të djathtë dhe konstruksioni i saj mbështetej në dy qemer guri, njëri gjysëm rrethor dhe tjetri çerek rrethor. E njëjta llogjikë e hajatit vlen edhe për çardakun si një mjedis i vetëm, pa dy krahët e dalë që korespondojnë me dy dhomat e miqve si dhe pa katër mjediset e banimit të përshtatur në të si ndërtime të vona në përshtatje të kërkesave të kohës si dhe të shtimit të familjes. Në fazën fillestare në çardak dilnin hapësirat e tre dyreve që mundësonin ndërlidhjen e tij respektivisht, e para me odën e miqve, e dyta nëpërmjet rruginës me odën e zjarrit, dhe e treta me mjedisin e banimit. Po ashtu në çardak dilnin katër dritare nga dy çift në lartësi që i jepnin, dritë odës së zjarrit. Shtyllat e drurit të murosura në murin e bllokut të dalë në çardak (fig.28) që i korespondojnë dhomës së miqve të krahut të djathtë si dhe jastëku i daltuar i dalë gjatë punumeve të çveshjes së çardakut nga shtresat e bëra, vërteton idenë se çardaku ka qenë i hapur, i shtrirë gjatë gjithë ballit të banesës dhe se të dy dhomat e miqve dalur në krah të tij janë ndërtime të vona. Nga të

DO NOT COPY



Fig. 28

dhënat gojore del ideja e ekzistencës së një qoshku apo sofaje në krahun e majtë të çardakut, ngritur dy tre këmbë shkallë nga dyshemeja e tij konturuar me parmak druri, elemente këto karakteristike për banesën shkodrane me çardak. Trajtimi i ballit të çardakut me dritare relativisht të mëdha mbrojtur me zgarë hekuri identike më atë ekzistuese duhet të jetë një fazë e dytë e tij që i korespondon mbylljes së çardakut.

Në këndvështrimin e ekzistencës së çardakut të hapur, lind një dilemë lidhur me trajtimin e hajatit në fazën fillestare: ka qënë i mbyllur apo i hapur? Mungojnë gjurmë të plota për sqarimin e kësaj dileme, por në mbështetje të studimit të evolucionit të banesës së hapur me çardak, të datimit mbi portën e hyrjes në hajat, të evidentimit të qënies të çardakut të hapur, llogjikisht duhet të bindemi që hajati në fazën fillestare ka qenë i hapur, duke e konsideruar mbylljen e tij të njëkohëshme me mbylljen e çardakut. Vërejmë diçka me mjaft rëndësi për këtë fakt. Teknika e ndërtimit të murit të gurit të faqes së mbyllur të hajatit të krahut të majtë, (ky krah nuk ka pësuar ndërhyrje në kohë) mbas mbylljes si dhe teknika e kornizimit të dritareve të hajatit, janë identike me ato të muraturës me breza paralel dhe të dritareve të bllokut të dalë krahut të djathtë, fakt që hedh idenë se mund te jenë ndërtime të njëkohëshme.

Si konkluzion të transformimeve të rëndësishme që ka pësuar banesa e Gjyleve në kompozicimin planimetriko-volumor si dhe trajtimi arkitektoniko-estetik mendojmë se ajo kronoligjikisht, ka kaluar nëpër katër faza të plota ndërtimi (fig.2). Skema e fazës së parë (fig.22) është kjo: Në katin përdhe kemi hajatin e hapur dhe dy ahure nr.1 dhe nr.2, ndërsa në katin e sipërm ndodhet çardaku i hapur dhe përgjatë tij ndodhen tre mjedise banimi ku ai i mesit është oda e zjarrit. Në pjesën e pasme të të dy dhomave dalin nyjet sanitare në formë xhepi. Gjithë ndërtimi ka formën e një blloku këndrejtë. Kjo fazë ndërtimi i përket variantit të parë të banesës shkodrane "me çardak në gjithë ballin". Si fazë të dytë ndërtimi kemi ndërtimin e dy krahëve të dalë të cilët qëndrojnë simetrikisht me banesën. Në katin përdhe ato korespondojnë me ahurin nr.3 dhe mjedisin e banimit, ndërsa në katin e sipërm korespondojnë me dy dhomat e miqve. Në kushtet e reja, kur familja shtohet, oda e zjarrit si mjedis i vetëm gatimi, i pamundur tashmë për të përballuar fluksin e punës, sjell si pasojë ndërtimin e qilarit si një mjedis ndihmës dhe njëherazi me funksione gatimi. Pasojat e ndërtimit të tij sjellin prishjen e dy nyjeve sanitare të dalë në formë xhepi. Në mbështetje të argumentave të parashtruara më sipër të kësaj faze janë dhe mbylljet e hajatit dhe të çardakut. Viti 1983 i shënuar mbi portën e hyrjes në hajat i korespondon kësaj faze e cila paraqet skemën e një banese tashmë të mbyllur me dy volume simetrike të dalë jashtë saj si dhe një volum të vendosur në pjesën e pasme. Kjo fazë ndërtimi është përshtatja e variantit të tretë të banesës shkodrane "me çardak në qendër"që konsiston me mbylljen e çardakut. Fazës së tretë të ndërtimit i përkasin ndarjet në mes të hajatit, çardakut dhe qilarit me mur tulle 60 cm, si dhe ndërtimi i bllokut V-L. Këto ndarje me qëllimin e përshtatjes së banesës për dy familje, sollën transformime në skemën planimetriko-kompozicionale të mjediseve të banesës. Po ashtu kemi hapjen e

DO NOT COPY

portës së dytë të hajatit, ndërtimin e dy shkallëve prej druri, përshtatjen e ahurit nr.2 kushteve të reja, ndarjen e ahurit nr.1 me një perde dhe hapjen në faqen anësore të tij të një porte për komunikim me oborrin. I kësaj faze është dhe rikonstruksioni që pësoi oda e zjarrit. Ndarja e çardakut në mes bën që ky mjedis ti aneksohet tashmë krahut të djathtë të çardakut. Kjo sjell mbylljen e dritares që shikonte në krahun e majtë, dhe transformimin e saj në derë. Për krijimin e kushteve me komode, oda e zjarrit në pjesën fundore ndahet me nje perde të lehtë ku në pjesën e përparme sigurohet ndejtja dhe pjesa tjetër e lidhur me qilarin shërben për gatim. Kjo spjegon dhe transferimin e vendit të zjarrit nga faqja anësore përballë trapazanit në faqen fundore ku gjendet edhe sot. Të kësaj faze duhet të jenë dhe mbylljet e dy dyerve anësore që siguronin ndërlidhjen mes mjediseve si dhe për pasojë mbyllja e trapazanit. Po ashtu përmendim rikonstruksionin që kanë pësuar dy dhomat në krah të odës së zjarrit, veçanërisht ai i faqeve ballore me mbylljen e oxhakut dhe dritareve të sipërme dhe ritajtimin e atyreve të poshtëme (fig.35). Ndërtimi i shtesës V-L mbështetur në faqen anësore të qilarit solli dhe transformimet në të me murosjen e dritareve të ndodhura në këtë faqe dhe hapjen e një dritareje në faqen nga rruga. Faza e katërt është gjendja në të cilën ndodhet sot banesa, (para ndërhyrjes restauruese) ku futen ndarjet e lehta në hajat, ndërtimi i katër mjediseve në çardak si dhe përshtatja për banim e krahut të majtë të qilarit. Këto ndërtime dallohen që janë të vona, nga forma dhe teknika e dyerve, dritareve, tavaneve e dyshemesë etj. Pra shohim se monumenti i arkitekturës, banesa e Gjyleve është produkt i disa periudhave ndërtimi, krijim i disa brezave mjeshtrish.

U arrit në përfundim se ndërtimi i bllokut qëndror këndrejt i përbërë nga tre mjedise, oda e zjarrit dhe dy odat në krah të saj si dhe hajati dhe çardaku i hapur janë ndërtime të fazës së parë për arsyet e mëposhtëme:

Trajtimi kompozicional dhe arkitektoniko-dekorativ i brendësisë së hajatit, çardakut dhe odës së zjarrit, i elementeve përbërës të tyre, përdorimi i teknikave të herëshme si ajo e suvatimit me fije leshi, e mbërthimit të dyshemesë me gozhda kovaçi, e pikturimit në sipërfaqe druri, e daltimit të drurit në relief të cekët, aplikimi i dritareve në lartësi, janë faktor të rëndësishëm që hedhin dritë mbi teknikat e ndërtimit, karakteristikë për periudhën kohore të gjysmës së dytë të shek.XVIII ku kjo banesë ka zanafillë. Gjatë dekadave të fundit të shekullit të kaluar, banesa bëhet objekt i transformimeve të rëndësishme që cënojnë veçanërisht skemën planimetrike dhe formulimin arkitektoniko-dekorativ të pamjeve të jashtme të saj. Datimi 1893 në banesën e Gjyleve, i përputhur me këtë periudhë i pasqyron ndjeshëm këto transformime në banesën në studim. Mbyllja e hajatit e cila mban këtë datë, padyshim presupozon dhe mbylljen e çardakut, mbase pikërisht çardaku është ai mjedis që influencon dhe vendos për trajtimin e mbyllur të banesës si mjedisi cilësues i tipologjisë së banesës shkodrane të shek. XVIII-XIX. Mjediset që pësojnë transformime janë pikërisht çardaku, hajati dhe oda e zjarrit të cilat në kushte të reja shoqërore - ekonomike të fillimit të shek. XIX me zhvillimin e tregëtisë dhe formimi e shtresës së re të borgjezisë shkodrane, bëhen tashmë të papërshtatshme. Mos shfrytëzimi i plotë i sipërfaqeve të tyre të mëdha, humbja e funksioneve të mëparëshme dhe përqëndrimi thjesht tek funksioni i ndërlidhjes, mospërshtatja e trajtimit arkitektonik të pamjeve të jashtëme të banesës, janë arsyet që sollën transformimin e tyre. Ndërtimi i dy dhomave të miqve të cilët i përkasin pikërisht kësaj periudhe me zhvillimin planimetriko-kompozicional të tyre, shkallën e lartë të realizimit të elementëve përbërës arkitektonik, veçanërisht të ornamentikës së aplikuar në gdhendjet e drurit në relief të thellë dhe punimit të allçisë me kallëpe, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme të banesës të

DO NOT COPY

cilat pasurohen me zmadhimin e dritareve, kornizimin e tyre me fashatura druri dhe suvaje, përpunimi i zgarave të hekurit të dritareve me motive hekuri të rrahur, futja e daltimit të gurit në kornizë dhe muraturë, suvatimi i ballit të banesës, janë shprehje të teknikave të reja të ndërtimit të fillimit të shek. XIX. Evidentimi i transformimeve që ka pësuar banesa e Gjyleve në kohë, si dhe i vlerave tipologjiko-arkitektonike që mbart, na jep mundësinë e vlerësimit të plotë të saj, mundësuar kjo, nëpërmjet ndërhyrjes restauruese e cila bëhet e domosdoshme në kushtet e dëmtimit të pjesëshëm si dhe të mirëmbajtjes të vazhdueshme të saj. Veçanërisht paraqitet blloku qëndror i mjediseve si dhe ajo e dy dhomave të miqve të dalë në çardak me konstruksionin e çatisë, të strehëve; me dyshemetë e rëna, suvatë e dëmtuara, dritaret e kalbura etj. Gjithashtu, dëmtime ka në brendësinë e mjediseve të fazës së parë, ku paraqitet e dëmtuar suvaja e pikturuar e tavanit e trapazanit si dhe kalbja e materialit drurësor të këtyre elementeve arkitektonik. Projekti i restaurimit (fig. 29), ka për qëllim të nxjerr në pah vlerat tipologjike-arkitektonike të banesës duke e çliruar atë nga shtesat që mbulojnë si mjedise të veçanta ashtu dhe elemente konstruktivo - arkitektonik, karakteristike të banesës shkodrane. Kështu u vendos të hiqen shtesat e fazës së katërt të ndërtimit, që janë mjediset e krijuara në çardak, hajat, ahuri nr.3 si dhe në qilarin e krahut të majtë. Heqja e këtyre shtesave është e justifikuar, mbasi ato nuk paraqesin vlera me rëndësi, si në aspektin tipologjik ashtu dhe atë konstruktivo-arktektonik. Njëherazi qënia e tyre, veçanërisht ajo në çardak, deformon gjithë formulimin planimetriko-arkitektonik të banesës duke cënuar mjedisin me përfaqësues të saj, çardakun. Për vlerat e veçanta arkitektoniko- dekorative që kanë dy dhomat e miqve që dalin në çardak si përfaqësuese të zbukurimores shkodrane të gjysmës së dytë të shek. XIX, u vendos të respektohen këto shtesa dhe banesa të ruajë fazën

DO NOT COPY

PROJEKTI I RESTAURIMIT



Pamje Jug-Lindore



Fig. 29

e dytë të ndërtimit. Vërejme se, qënia e zbukurimores së këtyre dhomave, e vlerësuar si një nga punimet më virtuoze të daltimit të drurit dhe punimit të allçisë, për banesën shkodrane, ishte një faktor i rëndësishëm që e ka cilësuar këtë banesë monument kulture. Po ashtu, kompozimi planimetriko-volumor i tyre është i lidhur organikisht me ndërtimet e fazës së parë, duke e kthyer banesën nga varianti me çardak në gjithë ballin, në variantin me çardak në qendër. U pa e arsyeshme që hajati dhe çardaku të ruajnë fazën e tyre të dytë, për elementët arkitektoniko-dekorativ që trajtojnë, si dritaret dhe veçanërisht porta e hyrjes në hajat e cila mbart vitin e ndërtimit që i përket kësaj fazë, 1893 si një dëshmi e evolucionit kohor të banesës shkodrane në përgjithësi dhe çardakut në veçanti. Çlirimi i çardakut, nga shtesat do të japë mundësinë e evidentimit të elementëve karakteristikë të tij si shtyllat dhe jastëkët e drurit të dalë gjatë sondazheve, të bëhet rivendosja e dyerve të murosura të mjedisevë të fazës së parë që dalin në çardak. Për mjediset e fazës së parë, ato në krah të odës së zjarrit, do të respektohet gjendja ekzistuese e faqeve ballore, të dhomave duke i konsideruar si një trajtim të ri arkitektoniko-dekorativ të pamjes së jashtëme të banesës. Restaurimi të plotë do ti nënshtrohet oda e zjarrit, mbasi gjendja ekzistuese jo plotësisht e transformuar si dhe gjurmët e dala, e japin një mundësi të tillë. Vlerësimi i mjedisit të qilarit si mjedis ndihmës i banesës, me transformime që nuk cënojnë skemën e tij planimetrike dhe programin fillestar, e bëjnë atë të qëndrueshëm në projektin e restaurimit. Për bllokun veri-lindor u pa e arsyeshme të mbahet si ndërtim, duke u vlerësuar veçanërisht në drejtim të trajtimit arkitektoniko-dekorativ të elementëve të pamjes së jashtëme me rikonstruksionin e dritareve, veshjen e tyre me korniza të profileve të ndryshme, pajisjen me zgarë hekuri të punuar, suvatimin e muraturës si dhe mbylljen e strehëve me dru (fig.30). Të gjithë këto elementë të rinj arkitektoniko-dekorativ që pësoi banesa gjatë dhjetëvjëçarëve të fundit të shek. të kaluar kishin për qëllim të jepnin një aspekt të ri pamjes së banesës, konsideruar kjo shkallë zhvillimi të saj. Restaurimit do ti nënshtrohen të gjithë elementët arkitektoniko-dekorativ të drurit me dizinfektimin e tyre, si dhe ato të allçisë dhe pikturës murale dhe njëherazi mirëmbajtja e vazhdueshme, si ndërhyrja më efikase për ruajtjen e vlerave autentike të këtij monumenti të rëndësishëm.



Fig. 30

Për kushtet e veçanta, mundësitë e ndërhyrjes restauruese kanë qenë mjaft të kufizuara deri më sot. Është ndërhyrë në çardakun dhe hajatin e krahut të majtë, duke i çliruar ato nga shtesat e bëra në kohë. Kjo ka bërë të mundur në çardak evidentimin e elementeve karakteristik të tij, shtyllës së drurit dhe jastëkut të daltuar të murosur në murin ndarës të dhomës së miqve. Po ashtu është bërë restaurimi i çatisë së çardakut dhe i dhomës së miqve.

Projekti i restaurimit bën të mundëshme ruajtjen e embrionit të banesës shkodrane, e cila me kohë, në përshtatje me kushtet e reja ekonomiko- shoqërore, iu nënshtrua evolucionit gradual nga ai i banesës së hapur me çardak drejt banesës së mbyllur si një etapë me rëndësi në banesën popullore qytetare shqiptare.

DO NOT COPY

(1) Rilevimet janë të F.Gjonit, B.Penxha. Fotografitë janë të autorit, H.Çollakut dhe R.Veselit.

(2) Emin Riza. "Banesa Popullore në Shkodër gjatë shek. XVIII-XIX" "Monumentet" 1972, 4.

(3) Banesa e Gjylëve ndodhet në lagjen "Kongresi i Përmetit". Rruga N.Gjylbegu – Shkodër.

(4) Sipas të thënave të të zotit të shtëpisë.

(5) Emin Riza. "Banesa Popullore në Shkodër gjatë shek. XVIII-XIX" "Monumentet" 1972, 4.

(6) Emin Riza. "Banesa Popullore në Shkodër gjatë shek. XVIII-XIX" "Monumentet" 1972, 4.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DEVELOPED EXAMPLE OF THE SHKODRA DWELLING AND ITS RESTORATION PROBLEMS

Among the examples of Shkodra dwellings of the 18th - 19th centuries, the Gjyles dwelling assumes a particular place. It is appraised as one of the biggest Shkodra dwellings that has incurred qualitative changes and comes up to the present time in a very good technical condition.

The dwelling belongs to the most advanced dwelling solution composed of a center lobby which, due to the dwelling transformation in the course of time, has a closed shape, representing the best result in morphological development and clearly expressing the development steps from an open dwelling to a closed one.

The scheme of the volume plan is formed by a system of constructive units, which are placed in a chronological order, starting with the central rectangular unit and proceeding firstly to the construction of two protruding units with the latter one and at the end of the construction of the north-east unit.

The program of Gjyles dwelling is considered one of the most developed dwellings of the lobby kind of its time. It includes all of the vital functions as a direct reflection of the socio-economical conditions prevailing then, with an evident functional division by floors. The ground floor is uninhabited. And although it is a two-family dwelling, it includes a specific number of rooms with settled functions and a crystallized composition scheme that illustrates the development steps from the simplest type to the most developed one.

At this dwelling we find the main living areas of the Shkodra dwelling such as the fire chamber, the guest room, the porch and the stable. The other environments repeat the compositional scheme of the guest room, but with simpler treatment and decoration. The epicenter of the dwelling's functiona1 composition is the fire chamber named "akshihane", which is surrounded by the rest of the living areas.

The lobby is considered a common, as well as a peculiar feature, of the Shkodra dwelling. Its volume plan and the architectonic one are a defining element of the typology of Shkodra dwellings of the 13th -19th centuries. The lobby, with its huge dimensions, is considered a first area which, except for the communicative functions during the warm seasons, has authentic living functions. It was also considered a working place for the elaboration of the agricultural products and the silk-worm process, which was widely spread during that period in Shkodra.

One of the most representative and distinguished environments of the Shkodra dwelling is the guest room, which is the pride of the old Shkodra family and at the same time requires more expenses than the rest of the house. The volurne of the guest room is made up of'three parts. The forepart, which is considered the nmin volume of the room, covers hospitatity activities. It has a decorated ceiling, numerous windows in its three wall faces, one or two shelves on the side walls, and the dresser, which is a decorative wooden element and goes around the three wall faces.

DO NOT COPY

At the front wall face, between two windows, is the gypsum fire-place decorated with floral motifs. The large wall cupboard and built-in dresser, placed at the entrance, is a two storied one, where at the lower part is the wall cupboard that contains the night clothes, and the dowry chest.

At the opposite end of the room is a door that leads into the sanitary annex, which forms the third volume of the room and part of the rectangular terminal volume of the environment.

The stable is a common environment of the Shkodra dwelling. The stable and lobby were used to store agricultural products, food reserves, and work tools. All the stables are connected to the porch through a single door and are lit by two small windows protected with iron bars.

The porch, is the first environment we meet while entering a Shkodra dwelling, It shares the sarne surface with the lobby. The porch is used to dry, elaborate and store agricultural products and is considered, from a functional point of view, an auxiliary environrnent f'or the family economy. In general, we meet an open porch at Shkodra dwellings except at the Gjyles dwelling where the closed porch is considered as one of its constructive components.

The cellar is an uncommon environment of a Shkodra dwel1ing and forms the latter unit of the dwelling. It has the height of two floors and fulfills auxiliary functions for food storage and cooking.

The Gjyles dwetling belongs to that kind of dwelling tha.t was already known and widely spread during that period in Shkodra. The composition scherne and functionality, architectonic formation, are considered common characteristics of folk buildings dating from the second half of the 18th century and up to the end of the 19th century. The rich decor, the incontestable aesthetic achievements on the traditional technique of wood and gypsum elaboration, always up to date on preferences for that period, make the Gjyles dwelling comparable to only a few good exarnples of Shkodra dwellings, such as the Sumajs dwelling (Figure 27).

The Gjyles dwelling has undergone changes in its architectonic-planimetric composition, as have most of the dwelfings dating back to the 18th century and the beginning of the l9th century. These changes consist of adding new environments, rnodifying the porch and lobby, and the reconstruction ot existing environments to newer conditions.

The evolution of Gjyles dwelling took ~lace over time and, generally, according to the evolution of Shkodra dwellings in the 18th and 19th centuries, in conformity to the socio- economic conditions of that period.

There was a careful study regarding the four constructional phases that the Gjyles dwelling has been through. During the first phase, the dwelling was composed of the "front lobby" and the three living areas on the same floor, During the second phase, construction of the guest rooms on both sides of the lobby took place, as well as the closure of the lobby and the construction ofthe cellar. The third phase witnessed the construction of the north-west bloc while on the fourth, one saw the existing shape of the dwell ing.

In concfusion, it could be said that the construction of the rectangular, central unit, composed of three environments, such as the fire-roorn with the two roorns on both sides, the open lobby and the porch, all dateto the first construction phase. The reasons for this are the poor compositional, architectural and decorative treatment of the porch, lobby and fire-room interiors and also that of their cornponent parts, the use of the ancient plastering techniques with yarn; the floor nailing with forger's nails; the paintings on wooden surfaces; the wood carving in a shallow relief, and the elevated windows. These are all important factors that enlighten the scholar as to the characteristic constructional techniques of this dwelling, which dates back to the second half of the l8th century.

During the last decades of the 1ast century, the dwelling undenvent important changes that have particularly touched the planimetry and decorative-architectonic formulation ot the facades, The closure of the porch, which dates to 1893, presurnes also that of the 1obby is perhaps the environment that influenced and decided on the closed form ofa Shkodra dwelling typology for the period between the 18th and 19th centuries.

The porch, lobby and the fire-roorn, are the environments that have undergone transformations that turned out to be unsuitable due to the new socio-economical conditions at the beginning of the 19th century. The reasons that brought the transformations were the lack of use of their big surfaces and the only remaining function was the cornrnunicative one.

The two guest rooms reflect the characteristics and new techniques of building at the beginning of the 20th century, such as the planimetric-compositional development, the high quality application of the architectural component parts, especially that of the ornamental wood carving in a deep relief and the plaster working with moldings, the architectonic treatments of the dwelling's facades which are enriched with the enlargement of' the windows, their framing with wood and plaster bands, using ornamental iron bars at the windows, the carved stone at the sashes, and the plastering of the front of the dwelling.

We could give a better evaluation ot Gjyles' dwelling pointing out the transformations that occurred over time, the typologic-architectonic values, and the restoration work, as a necessity resulting our of partial damage of the dwelling and necessity for its continuous maintenance.

The restoration project (Table 3) intends to point out the typologic-architectonic values of the dwelling, which include the additionaf environments of the porch, lobby, the stable (nr.3) and also at the left side cellar.

The annexes do not have any particular typological and constructional – architectural value. At the same time, their presence, especially at the lobby, can disfigure it and the whole planirnetric-architectonic composition of the dwelling. On the other hand, for the two guest rooms with special architectonic-decorative values of the second half of 19th century, these annexes will be permitted and the dwelling will preserve the second constructional stage.

The ornamental part of the guest rooms is evaluated as one of the most virtuoso ari works of the wood carvings and pfasterworks and it is considered an important factorthat qualifies this dwelling as a monument of culture. All the wood and plaster architectonic- decorative elements and also the frescos, will be subjected to restoration work and will be continuously maintained in order to preserve the authentic values of this important monument of culture.

The restoration project enables the preservation of the Shkodra dwelling embryo that has been evolving according to new socio-economic conditions. The gradual evolution of the dwelling with an open lobby into that of a closed lobby is an important stage in Albanian tolk dwefling evolution.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

KOMUNIKATË PËR SHTYP

Instituti i Monumenteve të Kulturës është i alarmuar për situatën e trashëgimisë kulturore dhe në veçanti për atë arkitekturore dhe urbane në krahinën e Kosovës.

Fushata serbe, që në këtë moment ka për qëllim zhdukjen e elementit shqiptar në Kosovë, tani po drejtohet gjithnjë e më shumë ndaj një elementi të padukshëm në kohë lufte, ndaj trashëgimisë kulturore të Kosovës. Për këtë qëllim, në një varg qytetesh po digjen sistematikisht elementet me konotacion etnik shqiptar, duke eliminuar trashëgiminë e vjetër dhe antike me gjurmë jo serbe. Kështu po shkatërrohen jo vetëm shtëpitë, por edhe pazaret shqiptare, shatërvanet, xhamitë e mrekullueshme, ansamblet arkitekturore dhe urat antike, sitet e historisë shqiptare dhe çdo lloj monumenti kulture jo serb në Kosovë.

Kjo është goditja më e madhe që tash po i jepet memorjes shqiptare atje, në mbështetje dhe konfirmim të tezës, se Kosova nuk mund të jetë shqiptare, pasi nuk ka monumente kombëtare, dhe është serbe, pasi manastiret, që do të mbeten të vetmet monumente në Kosovë, janë serbe, (në të cilat sot ka njësi të posaçme të ushtrisë serbe që i ruajnë).

Ky është spastrimi i rradhës i trashëgimisë materiale që po ndodh në Kosovë. Djegja e shumë objekteve të shpallura dikur edhe nga qeveria e Titos si "monumente kulture" në Kosovë është treguesi i drejtpërdrejtë i kësaj.

I.M.K. me anë të kësaj komunikate i drejtohet jo vetëm opinionit nërkombëtar, por edhe opinionit serb të paverbuar nga nacionalizmi si dhe specialistëve e shkencëtarëve serbë që të protestojnë pranë qeverisë së tyre për këtë dëm të madh që i bëhet jo vetëm Kosovës, por edhe vetë reputacionit shkencor të Serbisë dhe Ballkanit në përgjithësi.

Drejtoria e Përgjithshme
e Institutit të Monumenteve të Kulturës

Janar, 1999

DO NOT COPY